

**POLITIKAT E BANKËS SË SHQIPËRISË PËR GARANTIMIN E
STABILITETIT BANKAR
-ROLI DHE EFEKTI I MASAVE MAKROPRUDENCIALE-
2006 - 2014**

Doktorant : **Orkida Ilollari (Findiku)**

Dorëzuar

Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkenca
Ekonomike, me profil Financë për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: **Prof. Dr. Adrian Civici**

Numri i fjalëve: 60500

Tiranë, Mars, 2015

ABSTRAKT

“Nuk duhet të pretendojmë që situatat të ndryshojnë nëse vazhdojmë të bëjmë të njëjtat gjëra. Krizat mund të jenë një bekim i madh si për njerëzit ashtu dhe për kombet, sepse krizat sjellin progres. Krijueshmëria lind nga vuajtjet, ashtu siç lind dhe dielli nga një natë e errët”.

Albert Einstein

Që prej gjysmës së parë të shek. XIX, krizat kanë ndodhur në mënyrë ciklike në ekonomitë kapitaliste. Krizës globale të vitit 2007, nuk mund t'i shpëtonte edhe Shqipëria nga pasojat negative. Kjo krizë ka treguar sa i rëndësishëm është për bankat qendrore reagimi i menjëhershëm nëpërmjet një fleksibiliteti të madh të aplikimit të rregullave të politikës monetare për të siguruar masa kundër këtyre krizave si dhe nënvizoi faktin se politikat tradicionale për të arritur një stabilitet makroekonomik nuk mjaftonin. Në këto momente politika monetare tradicionale u shoqërua me politikën makroprudenciale. Një sërë politikash dhe instrumentash makroprudenciale u implementuan në vitin 2007-2011 si dhe gjatë 2013, me qëllim forcimin e tyre në vitet në vazhdim.

Në periudhën e vështirë të krizës, Banka e Shqipërisë injektoi likuiditet të bollshëm në monedhën vendase në tregun ndërbankar, duke përforcuar njëkohësisht mbikqyrjen bankare dhe bashkëpunimin me autoritetet e huaja mbikqyrëse. Një zhvillim specifik është dhe rritja e kufirit të sigurimit të depozitave, lëvizje e cila shënoi një pikë kthese në krizën e besimit të publikut në sistemin bankar. Për të stimuluar rritjen e kredisë, BSH-ja uli disa herë normën bazë të interesit, zbuti kërkesat ndaj likuiditetit dhe raportimin e kapitalit, për të inkurajuar bankat, të cilat zgjeruan rritjen e kredisë. Gjatë krizës u shtuan disa amendamente në rregulloren “Për menaxhimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave tregtare”. Gjithashtu është rishikuar edhe sistemi rregullativ i menaxhimit të riskut të likuiditetit, duke implementuar për herë të parë rregulloren “Për administrimin e riskut të likuiditetit”. Për t'i ardhur në ndihmë janë adaptuar praktikat dhe rregulloret ndërkombëtare më të mira. Janë përfshirë raporte sasiore prudente me qëllim parandalimin e vështirësive të likuiditetit sistemik. Kjo rregullore do t'i ndihmonte bankat tregtare si dhe mbikqyrjen bankare që të zhvillojnë praktika të mira të menaxhimit të riskut të likuiditetit si dhe të standartizojnë analizat e likuiditetit.

Ajo çfarë u pa nga rezultatet e anketimit të personave që punojnë në poste kyçe të 16 bankave tregtare, akademike, ekonomistë të njohur, anëtarë të këshillit mbikqyrës të BSH-së, drejtues të biznese të

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

rëndësishme në vend rezultoi se, BSH-ja duke përdorur këto instrumenta makroprudenciale arriti të kontrollojë këtë proces dhe nuk lejoi të rëndohej më tej situata në vend.

ABSTRACT

“Let’s not pretend that things will change if we keep doing the same things. A crisis can be a real blessing to any person, to any nation. For all crises bring progress. Creativity is born from anguish. Just like the day is born from the dark night”.

Albert Einstein

Since the first half of the 19th century, we have observed the phenomenon of cyclical economic crises in capitalist economies. Even Albania could not escape the negative consequences and manifestations of the 2007 global financial crisis. The crisis highlighted how important it is for central banks to take immediate action to provide flexibility in monetary policy regulations and to ensure recovery from crises, and it underlined the fact that traditional policies which consider macroeconomic stability were inadequate. In these circumstances, the traditional monetary policy was well supported by macroprudential policy. A series of macroprudential policies and instruments were implemented in 2007-2011 and throughout 2013, with the aim to bolster the system in coming years.

During the difficult crisis period, the Bank of Albania injected significant volumes of liquidity in domestic currency on interbank market, which improved banking oversight and cooperation with foreign supervisory authorities. Under another specific development, the deposit insurance limit was raised and marked a major turning point in confidence in the banking system. In order to stimulate credit expansion, the BoA lowered the benchmark interest rate several times and enhanced liquidity requirements and capital levels to persuade banks to lend more. Further amendments were made to the set of rules “On risk management from large exposures of commercial banks”. Also, the regulatory requirements on liquidity risk management were revised and the regulatory rules “On liquidity risk management” implemented for the first time. The best international practices and regulations were adopted to provide additional support, while quantitative prudential standards sought to prevent any systemic liquidity occurrences. The rules would benefit commercial banks and banking oversight to instill best practices in liquidity risk management and to standardize liquidity monitoring.

The results of a survey completed by many individuals who are part of the high-level management of 16 local commercial banks, economic experts, academic members of the Supervisory Council of the BoA, and owners of important businesses in Albania, show that BoA’s use of macroprudential instruments helped to avoid the situation from escalating.

DEDIKIM

Çdo ditë, për rreth tre vite me radhë, sapo ngrihesha nga tavolina e punës, koha për të shkuar në shtëpi ku më duhej edhe njëherë të ulesha në një tavolinë tjetër, në atë të dhomës sime.

Aty, shpërndarë rrëmuqshëm gjendej sfida e radhës – tema e doktoraturës sime. Një grumbull librash dhe artikujsh prej autorëve të huaj gati për t'u përkthyer, analizuar e cituar; pyetësor për t'u formuluar; kapituj të papërfunduar të lënë mënjanë; pyetje të cilat kërkonin përgjigje dhe përgjigje të cilat nuk më kënaqnin...

Në këtë rrokullisje të përditshme ka patur momente ku shikimi bëhej i turbullt dhe dëshira për t'a shtyrë për më vonë ishte më e madhe sesa për të vazhduar më tej. Ishin momente reflektimi mbi ekuilibrat e përditshëm të cilët po prisheshin. Studimi kërkonte kohë, kohë të cilën ia merrte fëmijëve, familjes sime, miqve. Por pikërisht në ato çaste dyshimi dhe dyzimi, prezenca e vajzave të mia, Ines dhe Ester, në vend që t'a rëndonin peshën e impenjimit sikur e lehtësonin atë. Shikimi bëhej më i qartë, arsyetimi më i përzgjedhur dhe paragrafët rridhnin më shpejt.

Ia dedikoj këtë studim vajzave të mia të mrekullueshme Ines dhe Ester,

Me dashuri

FALENDERIME

Do të dëshiroja të përmend të gjithë ata të cilët më kanë ndihmuar me sugjerimet e tyre, kritikën dhe vërejtjet. I shpreh atyre mirënjohjen time të thellë për kohën dhe vëmendjen që më kanë kushtuar.

Mbi të gjitha do të dëshiroja të falenderoja udhëheqësin e temës sime, Prof. Dr. Adrian Civici, i cili ka qenë i pakursyer për të më drejtuar dhe udhëhequr në kërkimin tim, suportuar në momente të vështira të këtij studimi.

Do të doja të vazhdoja duke falenderuar për ndihmën e pakursyer që më kanë dhënë vazhdimisht Anisa dhe Keti, të cilat me durim dhe vëmendje kanë ditur të më dëgjojnë dhe interpretojnë kërkesat e mia në lidhje me këtë studim.

Një falenderim i veçantë shkon për të gjithë profesorët dhe miqtë e mi, të cilët më kanë inkurajuar dhe kanë shpenzuar pjesë të kohës së tyre për të lexuar dhe diskutuar mbi kapituj të veçantë të këtij studimi si dhe kanë dhënë ekspertizën dhe rekomandimet e tyre për plotësimin e pyetësorëve: Prof. Dr. Arjan Kadare, Prof. Dr. Zef Preci, Prof. Dr. Halit Xhafa, Prof. Dr. Anilda Bozdo, Dr. Elvin Meka, etj.

Së fundmi, por jo për nga rëndësia, do të dëshiroja të falenderoja personat më të shtrenjtë për mua: familjen time, për mbështetjen e pakursyer përgjatë kësaj sfide dhe këtij rrugëtimi të vështirë.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Lista e shkurtimeve dhe termave të përdorur	10
Lista e tabelave dhe grafikëve	12
KAPITULLI I	15
1. Hyrje	15
1.1 Literatura e përdorur.....	17
1.2 Metodologjia e punës.....	18
KAPITULLI II.....	21
2. Mekanizmi i Krizës.....	21
2.1 Ciklet ekonomike dhe krizat.....	22
Tabela nr 1. Cikli ekonomik	22
2.2 Natyra dhe origjina e krizës	25
2.3 Konteksti i përgjithshëm i krizës si dhe llojet e saj	29
Grafiku nr 1. Diagrama e krizës subprime (efekti domino).....	33
2.4 Shpjegimet teorike dhe qëndrimet për krizën	35
2.5 Shfaqja dhe efektet e kriza globale të vitit 2007 në Shqipëri.....	38
2.7 Qëndrueshmëria financiare.....	40
2.8 Lidhja midis Bankës Qëndrore dhe qëndrueshmërisë financiare.....	43
2.9 Politika monetare dhe qëndrueshmëria financiare	46
2.10 Instrumentat e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë ndaj qëndrueshmërisë finaciare në vend.....	47
2.11 Interesi parësor i Bankave Qëndrore për qëndrueshmërinë financiare	48
Tabela nr 2. Statuti i Bankës qëndrore dhe objektivi i stabilitetit financiar	48
Tabela nr 3. Mbikqyrja bankare në vendet kryesore që adoptojnë monedhën e përbashkët europiane.....	50
2.12 “Trade off” midis qëndrueshmërisë financiare dhe objektivave të tjerë të Bankës Qëndrore	51
2.13 Veprimet destabilizuese të shkaktuara nga zgjedhje aksidentale të politikës monetare	52
Tabela nr 4. Politika monetare në situatë normale dhe në situatë paqëndrueshmërie.	53
Tabela nr 5. Përdorimi i politikës monetare për të korrigjuar çekuilibrat financiarë	55
2.14 Një shpjegim teorik i paqëndrueshmërisë financiare.....	56
2.15 Faktorët që ndikojnë në paqëndrueshmërinë financiare.....	63
2.16 Paqëndrueshmëria financiare e shpjeguar nëpërmjet ciklit financiar	64
KAPITULLI III	67

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

3. Politikat makroprudenciale përkundrejt paqëndrueshmërisë financiare	67
3.1 Termi “makroprudencial”: Origjina dhe Evoluimi i tij	68
3.2 Përdorimi i termit “makroprudencial” në lidhje me risinë financiare në vitet ’80 – ‘90	70
3.3 Përdorimi i termit “makroprudencial” pas viteve 2000	72
3.4 Bashkëveprimi ndërmjet politikave makroprudenciale, politikave monetare dhe politikave76	76
mikroprudenciale	76
3.5 Ndryshimet e perspektivave makro dhe mikroprudenciale	77
Tabela nr 6. Prespektivat makro dhe mikroprudenciale	78
3.6 Rregullat dhe politikat makroprudenciale.....	78
3.7 Përshtatja dhe zhvillimi i politikave makroprudenciale.....	80
3.8 Indikatorët e paralajmërimit të krizës dhe politikat makroprudenciale të domosdoshme	82
Grafiku nr 2. Sinjalet paralajmëruese të krizave	83
Tabela nr 7. Metodot sinjalizuese të krizës.....	85
3.9 A u përshtaten të njëjtat instrumenta makroprudenciale të gjitha vendeve të prekura nga kriza?	85
3.10 Efektiviteti dhe kostot që shoqërojnë instrumentat makroprudencialë	89
KAPITULLI IV	92
4. Banka Qëndrore Europiane dhe roli i saj në krizën e fundit	92
4.1 Masat makroprudenciale që përdori Banka Qëndrore Europiane.....	93
Grafiku nr 3. Struktura e mbikqyrjes makroprudenciale në Bashkimin Europian (BE).....	94
4.2 Roli dhe detyrat e Bordit Europian të Riskut Sistemik	95
Grafiku 4. Struktura e funksionimit të ESRB-së	96
Tabela nr 8. Llojet e instrumentave makroprudenciale	97
Tabela nr 9. Shembuj të disa masave makroprudenciale të marra nga bankat qendrore	98
4.3 Instrumentat dhe ndërhyrjet e Bankës Qëndrore Europiane	99
Tabela nr 10. Instrumentat makroprudenciale si komponentë të sistemit financiar	100
Tabela nr 11. Synimet makroprudenciale, në kuadër të objektivave të përgjithshme dhe instrumentave ...	101
4.4 Instrumentat e përdorura nga BQE	101
Tabela nr 12. Përkufizimi i koncepteve themelore për instrumentat makroprudenciale	102
4.5 Menaxhimi i riskut nëpërmjet përdorimit të instrumentave makroprudenciale	103
Grafiku nr 5. Objektivat e instrumentave të politikave makroprudenciale.....	110
4.6 A funksionon politika makroprudenciale?.....	111
4.7 Eksperienca të vendeve që kanë implementuar instrumentat makroprudenciale	112
Grafiku nr 6. Objektivat e politikave të instrumentave makroprudenciale.....	114
4.8 Zbatimi i instrumentave makroprudenciale	115

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Grafiku nr 7. Tavani i LTV-së.....	117
Grafiku nr 8. Tavani i DTI.....	117
Grafiku nr 9. Tavani i kredive në monedhë të huaj	118
Grafiku nr 10. Kufiri i rritjes së kredisë	118
Grafiku nr 11. Kufizimet në valutën neto/mospërputhje të monedhës	119
Grafiku nr 12. Limitet në mospërputhjen e maturimit.....	119
Grafiku nr 13. Kërkesat e rezervës	120
Grafiku nr 14. Kërkesa për kapital kundërciklik	120
Grafiku nr 15. Kohë variabël/Provizionimi dinamik.....	121
Grafiku nr 16. Kufizime në shpërndarjen e fitimit	121
4.9 Efektiviteti i instrumentave makroprudenciale.....	122
Tabela nr 13. Përdorimi i Instrumentave Makroprudencialë.....	126
Tabela nr 14. Indikatorët makroekonomik, mesatarja në vitet 2003-2013.....	127
4.10 Europa Perëndimore	128
Tabela nr 15. Raste studimore të Europës Perëndimore.....	128
4.11 Europa Lindore dhe Vendet e Ballkanit.....	133
Tabela nr 16. Raste studimore të vendeve të Europës Perëndimore.....	133
4.12 Vendet e Amerikës së Veriut dhe të Jugut	138
Tabela nr 17. Raste studimore të vendeve të Amerikës së Veriut dhe të Jugut.....	138
4.13 Vendet e Azisë dhe Turqia.....	141
Tabela nr 18. Raste studimore të vendeve të Azisë dhe Turqia.....	141
KAPITULLI V.....	145
5 Situata e sektorit bankar dhe financiar në Shqipëri gjatë së krizës	145
Grafiku nr 17. Sistemi financiar, Shtator 2013.....	146
Grafiku nr 18. “Outstanding” i kredive, Shtator 2013.....	147
5.1 Kuadri mbikqyrës i sektorit financiar.....	149
5.2 Roli mbikqyrës i Bankës së Shqipërisë	150
5.3 Stabiliteti financiar si objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë	152
Tabela nr 19. Indikatorët e mbarëvajtjes financiare, Dhjetor 2007 – Shtator 2013.....	155
5.4 Rreziku i kreditit si rreziku kryesor i sistemit bankar	158
Grafiku nr 19. Rritja e kreditimit sipas sektorëve të ekonomisë	159
Grafiku nr 20. Ecuria e aktiveve me rrezik.....	160
Grafiku nr 21. Ecuria e raportit të kredive me probleme.....	161
Grafiku nr 22. Ecuria e klasave të portofolit të kredive me probleme.....	162

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Grafiku nr 23. Rreziku i kredisë në bilancin bankar.....	163
Grafiku nr 24. Raporti i mbulimit me provigjione i huave me probleme	163
Grafiku nr 25. Ecuria e kredisë sipas llojit të kolateraleve	164
Grafiku nr 26. Kreditimi në raport me PPB-në.....	165
Grafiku nr 27. Paraqitje e Produktit të Brëndshëm Bruto (2006-2013).....	166
5.5 Funksionimi i politikës monetare duke implementuar instrumentat makroprudenciale	167
Grafiku nr 28. Instrumenta makroprudencialë të përdorura nga bankat qëndrore dhe rregullatorët e Europës Qëndrore dhe Lindore (2004-2012).....	169
KAPITULLI VI	171
6. Fillimi i zbatimit të masave mikro dhe makroprudenciale nga Banka e Shqipërisë.....	171
6.1 Masat parandaluese që ndërmori Banka e Shqipërisë gjatë periudhës së krizës globale.....	173
6.2 Instrumentat makroprudenciale të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë	178
Tabela nr 20. Mjetet e politikës monetare	181
Tabela nr 21. Mjetet e politikës monetare dhe masat rregullatore.....	182
Tabela nr 22. Mjetet e politikës monetare dhe masat fiskale dhe administrative	184
KAPITULLI VII.....	224
7. Konkluzione	224
7.1 Rekomandime	227
SHËNIME	229
Zbatimi i instrumentave në nivel ndërkombëtar: Bazel III.....	229
SHTOJCA	234
Pyetësori	234
BIBLIOGRAFIA	243

Lista e shkurtimeve dhe termave të përdorur

Afat maturimi - përfaqëson jetën e mbetur të një instrumenti financiar.

Aftësi paguese - është vlerësimi mbi mundësinë e shlyerjes së borxhit nga një kredimarrës.

Aktiv me rrezik - Në zbatim të kërkesës për kapital, bankave u kërkohet të gjenerojnë një raport kapitali bazuar në aktivet e tyre, të ponderuara sipas një faktori rreziku që bashkëngjitet. Për kategori të ndryshme aktivesh, përdoret një faktor i ndryshëm rreziku.

Aktive të ponderuara me rrezik – janë aktivet e një banke që, sipas karakteristikave, vlerësohen të kenë rrezik tregu, operacional ose kredie sipas rregulloreve të mjaftueshmërisë së kapitalit.

Bazel III - është një kuadër rregullator ndërkombëtar mbi mjaftueshmërinë e kapitalit të një institucioni financiar, dhe që zëvendëson Bazel II në këtë fushë. Krahësuar me Bazel II, kërkesat për kapital janë më të mëdha. Njëkohësisht rregullon menaxhimin e likuiditetit të bankës. Ky kuadër do të zbatohet gradualisht deri në vitin 2019.

Choc - Kontrolli makroprudencial i cili mund t'u imponojë bankave masa të kthimit të raportit të kapitalit të tyre (ratio) në rast goditje (choc), nuk i intereson se si ajo restaurohet, qoftë nga rritja e fondeve të tyre (numëruesi) apo nga pakësimi i aktiviteteve të rrezikuara (emëruesi). Kjo është arsyeja që në fund të goditjes që prek bankat, vërehet, në përgjithësi një likuidim aktiviteteve në katastrofë, nëse tregu është i varfër në likuide, ashtu si edhe një shtrëngim të kushteve të kreditit. Këto mekanizma rrisin mundësinë e një tkurrjeje bilanci në rast goditjeje.

Ex-ante - Madhësi të programuara dhe të parashikuara

Ex-post - Që lidhen me vendime tashmë të marra

Kapital bazë - është treguesi që përbëhet nga disa zëra të bilancit të bankës si kapitali i nënshkruar, rezervat, dhe fitimet e pashpërndara. Konsiderohet si treguesi bazë i fortësisë financiare të një banke nga këndvështrimi i një rregullatori.

Kapital rregullator - është treguesi që përbëhet nga kapitali bazë dhe kapitali shtesë dhe nga një sërë përlllogaritjesh të tjera të zërave të bilancit. Përdoret për të matur mjaftueshmërinë e kapitalit.

Klasifikimi i kredisë - është metodologjia sipas së cilës bankat, bazuar në aftësinë paguese të kredimarrësit, i klasifikojnë kreditë në 5 klasa më qëllim provigjionimin e tyre.

Kredi e pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit - është kredia dhënë në një monedhë të ndryshme nga monedha e burimit të të ardhurave të kredimarrësit, që përdor për shlyerjen e kredisë.

Kredi hipotekore - është kredia që merret nga individit me qëllim investimin në pasuri të paluajtshme.

Leva financiare - është shuma e borxhit të përdorur për të financuar aktivet e një institucioni.

Likuiditet – është masa e aftësisë së një institucioni për të shlyer detyrimet afatshkurtra. Mund të përshkruajë edhe sa shpejt mund të kthehet një aktiv në para.

Linjë kredie - është një marrëveshje kredimarrjeje ku kredimarrësi mund të tërheqë shuma pjesore, për sa nuk kalohet totali i shumës së miratuar të linjës.

Mjaftueshmëria e kapitalit - është raporti mes kapitalit rregullator dhe aktiveve të ponderuara me rrezik, i shprehur në përqindje. Ky raport nuk duhet të bjerë nën nivelin 12%.

PBB - është vlera e të gjithë mallrave dhe shërbimeve të prodhuara në një vend për t'u përdorur për konsum, eksport dhe investime, gjatë një periudhe, zakonisht një vit ose një tremujor.

PBS - Një njësi e cila është e barabartë me 1/100 prej 1% pra : $1\% = 100 \text{ pbs}$. Kjo është përdorur për të treguar ndryshimin e një instrumenti financiar. Pbs zakonisht përdoret për llogaritjen e ndryshimeve në normat e interesit.

Politikë makroprudenciale - është një paketë masash për të identifikuar, monitoruar dhe parandaluar rreziqet që kërcënojnë stabilitetin financiar në një sistem financiar.

Prim rreziku - është kthimi marxhinal mbi normën pa risk të një instrumenti financiar.

Rëndësi sistemike - është situata e një aktori tregu, pjesë e infrastrukturës financiare, problemet e të cilit mund të sjellin pasoja të rënda për të gjithë sistemin financiar, duke shkaktuar kosto të larta për shoqërinë.

Risku sistematik - është quajtur materializimi i goditjeve kur mungesa e stabilitetit financiar merr përmasa të tilla të cilat dëmtojnë funksionimin e sistemit financiar deri në masën që mirëqenia dhe rritja ekonomike preken në mënyrë domethënëse (Hollo et al, 2011).

Stabiliteti Financiar - përkufizohet si stabilitet në nivevin e përgjithshëm të çmimeve ose si një mungesë e inflacionit dhe deflacionit (Duisenberg, 2001).

Stagflacioni - është një gjendje e zhvillimit të ulët ekonomik dhe papunësisë së lartë e cila shoqërohet nga një rritje e çmimeve ose inflacion. Kjo ndodh kur ekonomia nuk është në rritje, por çmimet janë, e cila nuk është një situatë e mirë për një vend.

Stanjacioni – është një periudhë e zgjatur e ekonomisë me pak ose aspak rritje. Rritja ekonomike prej më pak se 2 deri në 3% në vit është konsideruar stanjacion. Periudhat e stagnimit janë shënuar edhe nga papunësia e lartë dhe të pavullnetshme punësimit me kohë të pjesshme. Stanjacioni mund të ndodhë në një shkallë më të vogël në industri të veçanta ose kompani ose me pagat.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Të rregulluara - Ky term e ka origjinën nga problemet mikroekonomike rreth aftësisë së kreditorëve të bankës (dipozitorëve) për të monitoruar risqet që e kanë origjinën nga huadhëniet dhe nga problemet mikro dhe makroekonomike rreth stabilitetit të sistemit bankar në rastin e krizave (Bigar&Himler, 2005).

Lista e tabelave dhe grafikëve

Tabelat

Tabela nr 1: Cikli ekonomik

Tabela nr 2. Statuti i Bankës qendrore dhe objektivi i stabilitetit financiar

Tabela nr 3. Mbikqyrja bankare në vendet kryesore që adoptojnë monedhën e përbashkët europiane

Tabela nr 4. Politika monetare në situatë normale dhe në situatë paqëndrueshmërie

Tabela nr 5. Përdorimi i politikës monetare për të korrigjuar çekuilibrat financiarë

Tabela nr 6. Prespektivat makro dhe mikroprudenciale

Tabela nr 7. Metodot sinjalizuese të krizës

Tabela nr 8. Llojet e instrumentave makroprudenciale

Tabela nr 9. Shembuj të disa masave makroprudenciale të marra nga bankat qendrore

Tabela nr 10. Instrumentat makroprudenciale si komponentë të sistemit financiar

Tabela nr 11. Synimet makroprudenciale, në kuadër të objektivave të përgjithshme dhe instrumentave

Tabela nr 12. Përkufizimi i koncepteve themelore për instrumentat makroprudenciale

Tabela nr 13. Përdorimi i Instrumentave Makroprudencialë

Tabela nr 14. Indikatorët makroekonomik, mesatarja në vitet 2003-2013

Tabela nr 15. Raste studimore të Europës Perëndimore

Tabela nr 16. Raste studimore të vendeve të Europës Perëndimore

Tabela nr 17. Raste studimore të vendeve të Amerikës së Veriut dhe të Jugut

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Tabela nr 18. Raste studimore të vendeve të Azisë dhe Turqia

Tabela nr 19. Indikatorët e mbarëvajtjes financiare, Dhjetor 2007 – Shtator 2013

Tabela nr 20. Mjetet e politikës monetare

Tabela nr 21. Mjetet e politikës monetare dhe masat rregullatore

Tabela nr 22. Mjetet e politikës monetare dhe masat fiskale dhe administrative

Grafikët

Grafiku nr 1. Diagrama e krizës subprime (efekti domino)

Grafiku nr 2. Sinjalet paralajmëruese të krizave

Grafiku nr 3. Struktura e mbikqyrjes makroprudenciale në Bashkimin Europian (BE)

Grafiku nr 4. Struktura e funksionimit të ESRB-së

Grafiku nr 5. Objektivat e instrumentave të politikave makroprudenciale

Grafiku nr 6. Objektivat e politikave të instrumentave makroprudenciale

Grafiku nr 7. Tavani i LTV-së

Grafiku nr 8. Tavani i DTI

Grafiku nr 9. Tavani i kredive në monedhë të huaj

Grafiku nr 10. Kufiri i rritjes së kredisë

Grafiku nr 11. Kufizimet në valutën neto/mospërputhje të monedhës

Grafiku nr 12. Limitet në mospërputhjen e maturimit

Grafiku nr 13. Kërkesat e rezervës

Grafiku nr 14. Kërkesa për kapital kundërciklik

Grafiku nr 15. Kohë variabël/Provizionimi dinamik

Grafiku nr 16. Kufizime në shpërndarjen e fitimit

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Grafiku nr 17. Sistemi financiar, shtator 2013

Grafiku nr 18. “Outstanding” i kredive, shtator 2013

Grafiku nr 19. Rritja e kreditimit sipas sektorëve të ekonomisë

Grafiku nr 20. Ecuria e aktiveve me rrezik

Grafiku nr 21. Ecuria e raportit të kredive me probleme

Grafiku nr 22. Ecuria e klasave të portofolit të kredive me probleme

Grafiku nr 23. Rreziku i kredisë në bilancin bankar

Grafiku nr 24. Raporti i mbulimit me provigjione i huave me probleme

Grafiku nr 25. Ecuria e kredisë sipas llojit të kolateraleve

Grafiku nr 26. Kreditimi në raport me PPB-në

Grafiku nr 27. Paraqitje e Produktit të Brëndshëm Bruto (2006-2013)

Grafiku nr 28. Instrumenta makroprudencialë të përdorura nga bankat qendrore dhe rregullatorët e Europës Qendrore dhe Lindore (2004-2012)

"Një ekonomist i mirë duhet të ketë një kombinim dhuntish të rralla. Ai duhet të jetë në një farë mënyre matematikan, historian, burrë shteti dhe filozof. Ai duhet të kuptojë simbolet dhe të flasë me fjalë. Ai duhet të mendojë të veçantën në aspektin e përgjithshëm dhe të prekë abstrakten dhe konkretin në të njëjtin fluturim të mendimit. Ai duhet të studiojë të pranishmen në dritën e së kaluarës për qëllime të së ardhmes. Asnjë pjesë e natyrës së njeriut nuk duhet të jetë jashtë konsideratës të tij. Ai duhet të jetë i vendosur dhe pa luhatje humori, i përmbajtur dhe i pakorruptueshëm si një artist dhe nganjëherë aq afër tokës sa një politikan".

John Maynard Keynes

KAPITULLI I

1. Hyrje

Ky studim është një përpjekje për të punuar mbi hipoteza dhe parashikime në lidhje me pyetjet dhe mëdyshjet, të cilat janë sot në qendër të debateve të botës ekonomike, mbi sigurimin e qëndrueshmërisë financiare. Këto debate u bënë më aktuale pas krizës së fundit globale të vitit 2007.

Studimi ka për qëllim të japë një kontribut në përsosjen e mëtejshme të përdorimit të instrumentave makroprudenciale dhe impaktin real që ata prodhojnë. Ky studim synon mbledhjen dhe analizimin e të dhënave në vlerësimin e performancës së instrumentave makroprudenciale, krijimin e rregullimeve institucionale për drejtimin e politikës monetare si dhe të bëjë një parashikim në lidhje me momentin e duhur kur këta instrumenta duhet të aktivizohen. Mund të bëhet e mundur që krizat të jenë më pak të kushtueshme për ekonominë reale si dhe të arrihet një qëndrueshmëri financiare. Këto rregulla makroprudenciale, të përshtatura sipas veçorive të vendeve, mund të jenë në gjendje të mobilizojnë të gjitha mjetet e duhura për të kufizuar edhe riskun sistematik.

Fokusi i studimit është : Të studiojë politikat monetare dhe masat makroprudenciale të përdorura nga Bankat Qendrore si autoritete mbikqyrëse, duke siguruar qëndrueshmëri ekonomike, ose e thënë ndryshe, sigurimin e përmirësimit të situatave të vështira ekonomike në vend. Ashtu siç edhe citohet nga FMN në raportin e tij: "Leksione nga krizat" (Maj,2010b), *politikat e mbikëqyrjes makroprudenciale janë instrumentat kryesorë për të siguruar një qëndrueshmëri financiare*".

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Instrumentat makroprudenciale përfshijnë kërkesat e trashëguara dhe akumulimin e kapitalit në një perspektivë të dispozitave të treguesve të likuiditetit dhe vlerësimit të kujdesshëm të kolateralit.

Sipas FMN (IMF, 2011), është e nevojshme që Bankat Qëndrore të luajnë një rol kyç në këtë aset të ri makro-rregullues. Implementimi i instrumentave makroprudenciale përfshin drejtpërdrejt Bankën Qëndrore, politikat monetare të së cilës duhet të mbështeten edhe në objektivat të tjerë, krahas atyre të kontrollit tradicional të inflacionit dhe “output-gap”. Këto të fundit janë të fokusuara kryesisht në akumulimin e rreziqeve të sistemit financiar me natyrë makroprudenciale për të fituar një rritje të elasticitetit të sistemit financiar. Bankierët qëndrorë duhet të marrin parasysh pasojat e vendimeve të tyre mbi qëndrueshmërinë financiare, ata janë quajtur shpesh edhe si “*mbrojtësit e monedhës*”.

Një politikë e inflacionit të synuar, shumë e përshtatshme sidomos në SHBA, është përmendur si bashkëpërgjegjëse për krizën e gushtit të vitit 2007 (IMF, 2011c). Një enigmë e panjohur për të ardhmen është e shprehur me një pyetje: Sistemi aktual i normave të ulëta të interesit, mund të krijojë kushte për kriza të reja? Këtu janë fokusuar F.Giavazzi e A.Giovannini (2010), që hedhin idenë se “mbështetja në inflacionin e synuar mund të prodhojë norma të ulëta interesi, të cilat mund t’a fusin në kurth ekonominë”. Normat e ulëta të interesit nxisin operatorët financiarë të shfrytëzojnë maksimalisht “efektin levë” dhe të marrin përsipër rreziqe, duke rritur probabilitetin e një krize të re. Një krizë e re financiare kërkon norma të ulëta interesi për të mos dekurajuar perspektivat e saj për rimëkëmbje. Në një sistem financiar të dobët, bëhet akoma më e vështirë rritja e normave të interesit. Për të dalë nga ky rreth vicioz dhe për të ndjekur më me efikasitet objektivat tradicionalë makroekonomikë të qëndrueshmërisë së çmimeve është e nevojshme ndihmesa e bankave qëndrore, si përsa i përket politikave monetare, ashtu edhe kornizës rregullatore makroprudenciale, deri në arritjen e qëndrueshmërisë financiare (IMF, 2011c).

- Kufizimet

Në një studim të gjerë ka kufizime, pasi trajtohet një problem që diskutohet vazhdimisht në nivele të larta bankare dhe në institucione të rëndësishme ndërkombëtare. Zhvillimet janë të shpejta dhe kjo përbën edhe kufizimin e këtij studimi. Gjatë periudhës së krizës të 2007, deri në ditët e sotme, BSH po përshtat instrumentat makroprudenciale por në këtë pikë janë të pashmangshme kufizimet.

- Arritja e një qeverisje të fortë është e vështirë kur sukcesi nuk është lehtësisht i matshëm por kostot janë të menjëhershme.
- Kalibrimi i instrumentave makroprudencialë është i vështirë në kuadër të pasigurisë për transmetimin e mjeteve makro.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

- Dallimi i riskut sistemik është i vështirë, edhe pse janë hedhur hapa përpara në zhvillimin e qasjeve kuantitative.
- Mbyllja e boshllëqeve rregullatore është e nevojshme dhe sfiduese pasi shpesh kërkon ndryshime legjislative.
- Politikat makroprudenciale priren për t'u anashkaluar, si në nivel kombëtar ashtu dhe përmes arbitrazhit cross-border.
- Përdorimi fleksibël i mjeteve është i nevojshëm për të mbajtur ritmin me zhvillimet në sektorin financiar, por kjo mund të bjerë ndesh me traditat politike dhe ligjore (IMF, 2013c).

1.1 Literatura e përdorur

Literatura ku mbështetet studimi është e gjerë. Një nga politikëbërësit në fushën e politikave makroprudenciale është FMN. Autorët që kanë shkruar rreth temes janë M.Friedman, D.Fernbach, E.Mandel, J.A.Allison, F. S.Mishkin, S.G.Eakins, Greenspan N.Roubini, P.Krugman, etj. Për instrumentet makroprudenciale në Shqipëri, burimet kryesore të përdorura janë BSh dhe Instat. Këto instrumenta janë implementuar vetëm gjatë krizës së fundit.

Origjina e termit “makroprudencial” daton në vitet 1970, në kontekstin e dokumentave të Komisionit Cooke (pararendës i Komitetit të Bazelit për Mbikqyrjen Bankare). Palët e përfshira në politikat monetare nuk e mendojnë njësoj këtë term. Sipas FMN (2011a), sugjerohet se me këtë do të kuptojmë një politikë e cila ka për qëllim të mirëmbajë qëndrueshmërinë financiare. Sipas Galati dhe Moessner (2011), referencat publike ndaj politikave makroprudenciale kanë filluar në mes të viteve 1980 dhe u zhvilluan më tej në vitet 2000. Ky term filloi të përdoret në kohën kur u shfaqën dhe problemet e para të asaj periudhe. Që nga ajo kohë e deri në ditët e sotme, ky term është marrë si një qasje e vazhdueshme ndaj rregullimit dhe mbikqyrjes financiare, por është përdorur me termin ekzakt “politikë makroprudenciale”, vetëm pas krizës së fundit botërore (Galati & Moessner, 2011).

Politikat dhe instrumentat makroprudenciale përkufizohen si një seri masash që kanë për qëllim monitorimin, parandalimin dhe adresimin e risqeve të vazhdueshme, si dhe minimizimin e kostos së këtyre krizave të herë pas hershme (IMF, 2011c). Në të njëjtin studim theksohet se përvoja e krizës së fundit tregon se qëndrueshmëria makrofinanciare nuk mund të sigurohet edhe nëse përdoren praktikat më të mira ndërkombëtare në mbikqyrjen financiare.

Autorë i ndajnë instrumentat makroprudenciale në bazë të ndikimit të tyre në zbutjen e prociklikalitetit të sistemit financiar, duke futur në këtë grup instrumenta si ato të kapitalit kundërciklik, variacionet

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

kundërciklike, raportet maksimale të “loan to value” (LTV), kërkesat e provigjionimit, etj (IMF, 2011c). Grupi tjetër ka për qëllim të zvogëlojë riskun e ekspozimeve të përbashkëta. Instrumentat që mund të përmendim në këtë grup janë ato të afateve të mospërputhjeve të maturimit dhe raporti neto i qëndrueshëm i financimit. Një grupim tjetër i instrumentave makroprudenciale vjen nga BIS që lidh kategoritë makroprudenciale me masat makroprudenciale (IMF, 2011c).

1.2 Metodologjia e punës

Do të shqyrtohet lidhja e politikave makroprudenciale me qëndrueshmërinë e ekonomisë reale, si edhe me rritjen e kësaj ekonomie. Metodologjia ka të bëjë me të dhënat makroekonomike, paqëndrueshmërinë financiare dhe me mungesën e mbikqyrjes makroprudenciale. Studimi do të përdorë të dhënat të cilat i përkasin kryesisht periudhës para si dhe gjatë krizës së fundit të vitit 2007.

Mendimet shkojnë nga kritikën e aplikimit të modeleve në fuqi, në aplikimet më të reja pothuajse të paparashikueshme, traumatike për koston e jetesës së popullsisë, deri në politikën e stabilizimit në dëm të pretendimeve të fitimeve marzhinale dhe nën kontrollin e presioneve të çmimeve.

Studimi do të fokusohet në efektin e politikave makroprudenciale për të përmirësuar ekonominë, inflacionin, si edhe krijimin e një mjedisi të favorshëm ekonomik për biznesin në tërësi. Objektivi kryesor i modelit evropian është edhe krijimi i një mjedisi ekonomik të favorshëm.

Do të shfrytëzohen të dhënat nga statistikat ndërkombëtare, FMN, Eurostat, Instat, BSH, BQE, FED, ESRB, BIS, BB, etj.

Për t’i ardhur në ndihmë studimit si edhe për të kuptuar inpaktin e masave, janë anketuar persona të rëndësishëm burimor të cilët punojnë në banka tregtare, drejtojnë biznese të rëndësishme, specialistë, anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës së BSH-së, ekonomistë e akademikë. Kanë plotësuar anketat në mënyrë të saktë 68 persona nga 75 të anketuar. Gjatë intervistës, përveç përgjigjeve të pyetjeve, kanë dhënë opinione, vlerësime rreth këtyre instrumentave makroprudenciale të përdorur në vendin tonë. Të gjitha rezultatet e anketës janë përpunuar me programin SPSS.

Hipotezat

Janë 2 hipoteza të ngritura gjatë këtij studimi:

Hipoteza 1:

Garantimi i efektit pozitiv të masave makroprudenciale të adoptuara nga Banka e Shqipërisë në lidhje me huatë me probleme dhe stabilitetin bankar e financiar kërkon që instrumentat makroprudenciale të konceptohen në mënyrë komplekse, të aplikohen si masa parandaluese dhe t'i paraprijnë situatave të vështira ekonomike e financiare të vendit.

Hipoteza 2:

Për të patur një mbikëqyrje bankare efektive që garanton stabilitetin financiar dhe makroekonomik afatgjatë, si dhe për të qenë efikas në parandalimin e krizave potenciale kërkohet adoptimi i strukturave mikro dhe makroprudenciale cilësore si elementë plotësuese e shoqëruese të politikave monetare.

Pyetjet kërkimore

Gjatë këtij studimi, për problematikën dhe rëndësinë e përdorimit të instrumentave makroprudenciale, pyetje kërkimore janë si më poshtë:

- Përveç instrumentave tradicionale, çfarë masash duhet të implementohen, për të mundësuar menaxhimin e krizave dhe qëndrueshmërinë bankare e financiare?
- A ka mundësi Banka Qëndrore të sigurojë qëndrueshmërinë financiare dhe makroekonomike afatgjatë duke përdorur instrumentat makroprudencialë edhe politika monetare jo-konvencionale?
- A ka bashkëveprim ndërmjet politikës monetare, makroprudenciale dhe mikroprudenciale?
- Nëse Banka Qendrore e Shqipërisë ka implementuar instrumentat makroprudenciale, çfarë efektesh po japin ato, si dhe cila është kosto e implementimit të tyre?
- A mund të themi se masat makroprudenciale të suksesshme në një vend funksionojnë për të gjitha vendet e tjera?

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Në Kapitullin II do të bëhet prezantimi i mekanizmit të krizës dhe cikleve ekonomike nëpër të cilat kaloi kriza e fundit. Do të jepen arsyet e shpërthimit të krizës si dhe etapat nëpër të cilat kaloi ajo. Do të jepen qëndrimet dhe shpjegimet teorike për krizën.

Në Kapitullin III do paraqiten politikat makroprudenciale përkundrejt paqëndrueshmërisë financiare, duke dhënë një shpjegim të origjinës dhe evoluimit të termit “makroprudencial”. Do shpjegohen ndryshimet e prespektivave makro dhe mikroprudenciale, si edhe rregullat dhe politikat makroprudenciale. Nën optikën e masave të Bazel III do shikohet mbikqyrja makroprudenciale.

Kapitulli IV, prezanton me BQE dhe rolin e saj në krizën e fundit. Jepet një listë e detajuar e masave jostandarte makroprudenciale, që përdori BQE, si edhe roli i secilës nga këto masa.

Janë marrë në shqyrtim raste studimore të vendeve të ndryshme dhe është parë se çfarë masash janë marrë për të përballuar krizën si dhe sa të efektshme kanë qënë këto masa në tejkalimin e kësaj krize. Është bërë dhe një analizë krahasuese e këtyre rasteve studimore.

Në Kapitullin V, është marrë në studim situata ekonomike në vend si dhe politikat monetare të BSH. Janë parë rregulloret si dhe instrumentat makroprudenciale që aplikoi BSH-ja. Analiza bazohet në të dhënat e variablave ekonomike para dhe pas krizës. Nga analiza konkludohet nëse masat makroprudenciale të ndërmarra nga BSH kanë dhënë efekt në paralizimin e krizës ose të mbajtjes së situatës ekonomike në stanjacion.

Kapitullin VI : është bërë një kërkim cilësor i mbështetur në një sondazh mbi impaktin dhe efektin në kohë të masave makroprudenciale të BSH. Qëllimi kryesor është mbikqyrja e qëndrueshmërisë financiare dhe makroekonomike nga BSH gjatë krizës së fundit dhe periudha më afatgjata. Kjo kërkon adoptimin e strukturave të referimeve makroprudenciale të përcaktuara me saktësi, si një element ndihmës në përshtatjen, zbatimin dhe përmirësimin e këtyre masave në të ardhmen.

Konkluzionet dhe rekomandimet jepen në Kapitullin VII të studimit.

KAPITULLI II

“Në botë ka shumë teori, pasi secila është e bazuar në supozime të ndryshme rreth botës. Është lidhja midis tyre, sesa logjika ajo që është më e debatueshmja”.

Lesley P.Cook

2. Mekanizmi i Krizës

Dihet se krizat në ekonominë kapitaliste nuk janë unike apo të rralla. Për një periudhë të gjatë historike, nisur që nga fundi i Luftës së II-të Botërore dhe deri në mesin e viteve '70 të shek.XX, ekonomitë kapitaliste kanë përjetuar një periudhë të gjatë zgjerimi, të cilat më pas kanë kaluar në periudha të shkurtra reçesioni (IMF, 2011b). Kriza botërore e fundit ishte ajo e vitit 1929, e cila lindi në SHBA dhe më pas u përhap në mbarë botën. Në atë periudhë, në ekonomitë më të zhvilluara kapitaliste si SHBA dhe Britani, norma mesatare e papunësisë në për një periudhë të gjatë ishte 20-25%, qeveritë e këtyre vendeve ishin të pafuqishme në lidhje me këtë fenomen, madje politikat ekonomike kufizuese, duke mos kuptuar natyrën e krizës, e përkeqësuan gjendjen (Eorld Financial Revieë, 2014).

Kriza e vitit 2007, shpërtheu njësoj si ajo e 1929 dhe përsëri në SHBA. Përpara se të përballemi me shkaqet specifike dhe origjinën e kësaj krize, le të analizojmë dukurinë e krizës në përgjithësi në ekonomitë kapitaliste.

Çfarë kuptojmë me fjalën krizë dhe cilat ishin shkaqet që e sollën?

Zakonisht, termi “**krizë ekonomike**” përdoret për të treguar një periudhë kohore në të cilën ndodh një rënie e fortë dhe e zgjatur e nivelit të aktivitetit ekonomik. Sipas Business Dictionary, kriza ekonomike përkufizohet: “*si një situatë në të cilën ekonomia e një vendi pëson rënie e shkaktuar nga kriza financiare. Një ekonomi e cila përjeton një krizë financiare ka të ngjarë të ketë një rënie të produktit të brëndshëm bruto (PBB) dhe pakësim të likuiditeteve. Një krizë e tillë merr formën e reçesionit ose depresionit*”.

Po çfarë ndodh ? Gjatë krizës, kompanitë nuk mund të shesin produktet apo prodhimet e tyre dhe në këtë pikë ndodh dukuria që rezervat rriten, ndërsa të ardhurat dhe konsumi ulen. Si rrjedhojë, çmimet bien dhe papunësia rritet. Rritja e papunësisë çon në ulje të të ardhurave dhe të konsumit. Të gjitha këto së bashku shkaktojnë një rënie të investimeve dhe të prodhimit. Nëse kjo gjendje vazhdon për një

kohë të gjatë, atëherë ekonomia shkon drejt fazës së depresionit, ashtu siç ndodhi në periudhën 1929-1939. Kriza ekonomike globale e viteve 1929-1939 ashtu edhe kriza e fundit (2007), origjinën e kanë në të njëjtin vend, SHBA. Ato erdhën pas një faze euforie rritjeje dhe zgjerimi ekonomik e industrial. Kriza ndryshe mund të shpjegohet duke analizuar konkretisht financat, prodhimin, strukturën e tregjeve, kreditë, si dhe lidhjet komplekse midis mekanizmave financiare dhe ekonomisë reale.

2.1 Ciklet ekonomike dhe krizat

“Cikli i biznesit është karakteristika kryesore e ekonomisë së tregut”.


J.M. Keynes

Ekonomia kapitaliste është një model ciklik. Diskutimet midis akademikëve, ekonomistëve dhe historianëve lidhen me kohëzgjatjen e cikleve ekonomike, me mundësinë për t'i korrigjuar ato dhe parandaluar krizat. Kriza është edhe elementi kulmor i ciklit ekonomik. Krizat shpërthejnë në momentin kur ky element kulmor ka arritur pikën maksimale. Është e rëndësishme të tregohet lëvizja ciklike ekonomike përpara se të bëhet analiza e krizës (Kuznets, 2010).

Cikli ekonomik kalon në disa faza:

- Rimëkëmbja
- Zgjerimi
- Reçesioni
- Depresioni

Tabela nr 1. Cikli ekonomik



Burimi: Kuznets (2010) sipas modelit të Schumpeter

Gjatë fazës së *rimëkëmbjes*, çmimet, prodhimi, punësimi dhe të ardhurat **rriten** derisa arrijnë një pikë maksimale, e cila njihet edhe si faza e *zgjerimit*, ndërsa gjatë fazës së *recensionit* ndodh e kundërta. Në recesion punësimi, prodhimi, çmimet dhe të ardhurat **ulen** deri sa arrijnë nivelin minimal, që është edhe faza e *depresionit*. Pas kësaj faze, zakonisht fillon përsëri *rimëkëmbja*. Në këtë mënyrë ky cikël vazhdon kursin e tij normal. Nëse cikli përsëritet me rregullsinë me të cilën ai është e paraqitur në grafikun e mësipërm, themi se ekonomia do të jetë në një fazë të qëndrueshme, pra pas çdo faze të kaluar ekonomia do të rikthehet në një të mëparshme¹.

Nga përvoja historike tregohet se ekonomia transformohet, pra shoqëria arrin të pasurohet duke arritur një trend ciklik i cili përsërit formën, por që vazhdimisht ndryshohet në thelb. Në strukturën ekonomike ndodhin shumë ndryshime që e modifikojnë atë në thellësi, kur kalohet nga një cikël në tjetrin. Tashmë është e jetuar dhe e provuar që ekonomitë kalojnë nga një cikël në tjetrin, edhe kur këto ekonomi gjenden në një nivel superior punësimi, prodhimi dhe të ardhurash. Kjo situatë me prirje rritëse është quajtur teknikisht nga ekonomistët si “trend”².

Natyrshëm lindin edhe pyetjet : Përse ekonomia kapitaliste ka një prirje ciklike? Cilat janë forcat ekonomike që e bëjnë këtë që të ndodhë? Kalecki dhe Keynes janë dy autorët, që kanë kontribuar në shpjegimin e kësaj dukurie. Roli më i rëndësishëm ekonomik në një ekonomi kapitaliste, luhet nga sipërmarrësit. Janë këta të fundit të cilët me vendimet e tyre të investimit, përcaktojnë dhe ndikojnë në nivel global luhatjet ciklike dhe aktivitetin ekonomik. “Gjatë mirëqenies - shkruan Kalecki (1990), rritet jo vetëm shkalla e aktivitetit, por edhe çmimet”. Të dy këta faktorë çojnë në një rritje të përfitueshmërisë, duke sjellë forcimin e investimeve. Investimet varen nga një numër variablash ekonomikë, por veçanërisht nga kthimi i pritshëm, pra fitimet e realizuara nga shitja e mallrave të prodhuara. Zbatimi i “urdhrave” për të investuar shkakton pas një kohe të caktuar një zgjerim të produktivitetit, i cili çon më pas dhe në një rënie të përfitueshmërisë. Si rrjedhojë bien njëkohësisht çmimet dhe shkalla e aktivitetit. Frenimi i investimeve ndikohet nga rënia e shkallës së aktivitetit, që përsëri përkthehet, pas një kohe të caktuar, në një tkurrje të prodhimit, që çon në rritjen e çmimeve³.

Gjatë periudhës së “mirëqenies” (prosperitetit), e cila përkon me fazën **e rimëkëmbjes - zgjerimit**, të ciklit ekonomik, kërkesa për mallra rritet. Kjo çon në një rritje të çmimeve. Si pasojë stimulohet edhe rritja e kapacitetit të prodhimit. Çmimet e prodhimit dhe kërkesa, të cilat janë në rritje të vazhdueshme,

¹ Simon Kuznets, “Schumpeter's Business Cycles”, *American Economic Review*, vol. 30, n. 2, pp. 257-271

² Friedrich Hayek, *Prices and Production and Other Works: F.A. Hayek on Money, the Business Cycle and the Gold Standard*

³ Kalecki M.; “Il ciclo economico”, in *Antologia di scritti di teoria economica*, Il Mulino, Bologna, 1979.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

do të çojnë në rritjen e përfitueshmërisë të korporatave. Pra, rritja e përfitimit të korporatave nënkupton një rritje të përgjithshme të fitimeve të tyre në tërësi. Sipas Kaleckit (1979), kjo ecuri virtuozë e variablave kryesorë ekonomike dhe sidomos e fitimeve ndikon pozitivisht edhe në pritshmëritë optimiste të sipërmarrësve. Në aktivitetin e investimeve do të ndikojnë përfitueshmëria dhe pritshmëritë. Si pasojë, do të rritet prodhimi për mallra të rinj dhe pas një periudhe të caktuar kohore kjo do të çojë në një zgjerim të prodhimit. Kjo gjendje krijon një kapacitet të tepërt të prodhimit, i cili thekson akoma më shumë konkurrencën midis kompanive. Këto kompani për të qarkulluar mallin e tyre të akumuluar në magazina, do të detyrohen të ulin çmimet. Kjo situatë e krijuar nuk vjen rastësisht, por shfaqet në formën e skontove dhe promocioneve. Ndërkohë, pritshmëritë që kanë sipërmarrësit fillojnë të bëhen negative dhe ndiqen nga një pesimizëm për situatën e krijuar. Në këtë moment, fillon edhe rënia e përfitimeve. Kjo situatë në fillim i dobëson investimet dhe arrin aty deri sa i frenon ato. Si rrjedhojë, prodhimi fillon të kontraktohet. Në këtë pikë, fillon edhe faza e **reçesionit**, që gradualisht kalon në fazën e **depresionit**. Karakteristikë e saj është tkurrja e prodhimit, e cila së bashku me pesimizmin e krijuar çojnë deri në mbylljen e ndërmarrjeve dhe të institucioneve⁴. Kur kriza arrin në depresion, jo vetëm ndërmarrjet jofitimprurese falimentojnë, por edhe ato që deri në atë periudhë kishin fitime të konsiderueshme, rrezikohen. Në periudhën e depresionit, reduktimi drastik i prodhimit çon në një mungesë të ofertës ndaj kërkesës dhe kjo kërkesë e tepërt shkakton një rritje në marzhet e fitimit, si dhe një rritje të çmimeve të vetë ndërmarrjeve. Pritshmëritë tashmë të përmirësuara të fitimit tek sipërmarrësit, çojnë në rritjen e investimeve dhe sipërmarrjeve të tyre dhe në këtë moment fillon një rimëkëmbje e re e ciklit të biznesit. Shpjegimi i ciklit të treguar bazohet në ndërveprimin midis investimeve dhe përfitueshmërisë, i cili nuk llogaritet për variablat e tjera ekonomike shumë të rëndësishëm, sic janë p.sh. tregjet financiare, kreditë, etj⁵.

Për sa thamë më lart, cikli i biznesit presupozohet si një ekonomi kapitaliste me konkurrencë të lirë, ku pavarësisht ndryshimeve ciklike të kësaj ekonomie apo situatave historike, mbetet konstante edhe në tregjet e sotme të dominuara nga monopolet ose oligopolet.

⁴ Arthur Spiethoff, "Krisen", Handwörterbuch der Staatswissenschaften, 1925; përkthim në anglisht: "Business Cycles", International Economic Papers, 1953, n. 3, pp. 75-171

⁵ Kalecki, Michal. "Political Aspects of Full Employment".

“Frika dhe euforia janë forca dominuese, por frika është shumë herë më e madhe sesa euforia. Flluskat ngjiten ngadalë teksa krijohet euforia. Dhe më pas godet shumë ashpër frika. Kur fillova t’a vërej këtë, pësova një tronditje intelektuale. Kriza është ai fenomen që bën që çdo gjë të bjerë”.

Alan Greenspan

2.2 Natyra dhe origjina e krizës

Në ekonominë kapitaliste kriza është një dukuri ekonomike komplekse. Interpretimi dhe mënyra e të kuptuarit të krizave vazhdon të jetë e tillë. Nëse nuk do të ishte kaq vështirë, atëherë me kalimin e kohës dhe nga krizat e mëparshme, do të kishim mësuar mënyrën se si duhej ta kontrollonim dhe menaxhonim atë, në mënyrën më të mirë të mundshme dhe pse jo, të arrinim edhe ta shmangnim atë përfundimisht. Kriza e vërtetë mund të shpjegohet vetëm nga lëvizja reale e prodhimit kapitalist dhe konkurrencës së "kreditit"⁶, duke analizuar ndërveprimet komplekse midis strukturës ekonomike, formës së tregut dhe tregjeve financiare.

Duke u nisur nga kriza e vitit 1929, krizat bashkëkohore shpërthejnë gjithmonë kur cikli ekonomik arrin kulmin. Periudha përpara shpërthimit të krizës u karakterizua nga euforia e tregjeve financiare, ku ndërmjetësit (brokers) kryenin shumë operacione spekulative. Operacione “spekulative” konsiderohen të gjithë ata që i kryejnë në vend të hapur, ku tregtarët blejnë dhe shesin letra me vlerë në tregjet e aksioneve për të marrë hua paratë e nevojshme për ekzekutimin e kontratave nga bankat dhe pa mbulimin e nevojshëm të kapitalit⁷. Kur mekanizmi i pagesave fillon të vështirësohet dhe përhapet tek të gjithë operatorët e tregut, bankat pretendojnë shlyerjen e parave të huazuara. Në këtë moment të gjithë përpiqen për të shitur letrat me vlerë, me qëllim rimarrjen e shumave të nevojshme. Është kjo koha kur çmimi i letrave me vlerë bie në mënyrë dramatike dhe në këtë mënyrë ndodhin falimentime zinxhir për operatorët dhe institucionet financiare. Në këtë mënyrë kriza e likuiditetit transmetohet edhe në kompanitë e prodhimit; si pasojë prodhimi zvogëlohet, kompanitë mbyllen, fillojnë shkurtime të vendeve të punës, falimentimet dhe në këtë situatë kalohet në një papunësi masive. Nga kujtesa historike, kur krijohet situata e përshkruar më lart, del edhe spektri i krizës së “Depresionit të Madh” i të 1929. Kjo datë ka qënë dhe vazhdon të jetë një kthesë në historinë e kapitalizmit bashkëkohor. Ka pasur lloje të ndryshme krizash ciklike dhe përpara kësaj krize, por asnjëra prej tyre më parë nuk kishte pasur të tilla rezultate ekonomike e shoqërore katastrofike (Field, 2011). Nëse analizohet historia e

⁶ Marx, K. 1979 *Teorie sul plusvalore*, vol. II, cap. XVII, pag 555-584, Editori Riuniti, Roma

⁷ Bank for International Settlements, 2011.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Anglisë, një vend lider në shekullin e 19-të, përpara Luftës së I-rë Botërore, shikohet se krizat shpërthenin me një rregullsi rreth çdo 10 vjet.

Kriza në Angli në 1825-1920⁸

Vitet e fillimit të krizave						
1825	1836	1847	1857	1866	1890	1920/21

Galbrath⁹ shpjegon se: “*Ne nuk mund të jemi të qartë nëse nuk njohim historinë, pasi teoritë dhe zgjidhjet e problemeve ekonomike janë gjithmonë rezultat i kohës dhe i vendeve ku ato lindin dhe zhvillohen*”. Baza empirike dhe historia e teorisë së ciklit ekonomik është ndërtuar pikërisht mbi analizën e këtyre krizave. Friedrich Engels¹⁰ shprehet se: “*Në fakt që nga viti 1825, vit kur shpërtheu kriza e parë, e gjithë bota industriale dhe tregtare si dhe shkëmbimi i prodhimeve midis popujve civile ka patur një cikël, ku çdo 10 vjet ka rënë në krizë. Tregtia ngushtohet, produktet grumbullohen dhe janë me shumicë, paraja zhduket, si dhe kredi nuk jepen më, atëherë fabrikat ndalojnë punën e tyre dhe falimentimet bëhen më të shumta*”.

Stanjacioni¹¹ zgjati me vite, prodhimet dhe forcat prodhuese ranë ndjeshëm në sasi të mëdha, deri sa mallrat e akumuluar filluan të lëvizin vetëm për arsyen e vetme të zhvlerësimit. Prodhimi i madh gradualisht rimori rrugëtimin e tij. Industria u transformua duke përsheptuar ritmet industriale dhe tregtare. Që prej fillimit të vitit 1825 dhe deri në vitin 1877 u testua gjashtë herë karakteri i këtyre krizave, të cilat Fourier i ka cilësuar si “*crise plethorique*” ose kriza të bollëkut.¹² Në këtë pasazh historik krizash, Engelsi thekson natyrën ciklike të krizave, që ndikojnë në ekonominë kapitaliste. Fourier (Riasanovsky, 1969) e përcakton krizën si një *krizë të bollëkut*. Për herë të parë në historinë e krizave të njerëzimit ato janë shkaktuar jo nga *uria*, por nga *bollëku*, pra pikërisht paradoksi i varfërisë shkaktuar nga bollëku, tashmë po bëhet realitet.

Në periudhën 1825-1921 në ekonominë botërore kishin ndodhur edhe kriza të tjera. Epiqendra e krizës ishte Franca në vitet 1828, 1838, 1864 dhe më pas në vitin 1882. Në të gjithë kontinentin europian gjatë viteve 1848 deri 1857, kriza shpërtheu pothuajse në të njëjtat vende. Italia, së bashku me Anglinë në

⁸ Charles Kindleberger, *Euforia e panico. Storia delle crisi finanziarie*, Editori Laterza, 1981

⁹ John Kenneth Galbrath “Storia dell economia”.

¹⁰ Engels F.; *Anti-Dühring*, 1878

¹¹ Stanjacioni është një periudhë e tejzgjatur me rritje shumë të vogël ose pothuajse fare në ekonomi. Kur ka një rritje ekonomike vjetore 2%-3% konsiderohet stanjacion. Kjo periudhë shoqërohet gjithashtu me papunësi të lartë.

¹² “History of Economic Analysis” pg 178

vitin 1866 kanë qenë vendet e epiqendrës së krizës. Gjatë vitit 1873, kriza e pati origjinën njëkohësisht në Gjermani, Austri dhe në SHBA. Duke u nisur nga kjo periudhë dhe deri në ditët e sotme, po supozohet se SHBA do të bëhen epiqendra e të gjitha krizave në botë. Në vitet 1873-1890 siç edhe dëshmohet nga Engelsi¹³ : *“Pas çdo krize ciklike, vitet e stanjacionit, degradimi i mallrave të grumbulluara në magazinë dhe shkatërrimi i forcave prodhuese, pasohen nga fenomeni i ripërtëritjes, duke filluar kështu një fazë të re zhvillimit”*. Sistemi ekonomik kishte energjitë dhe forcat e mjaftueshme për t’u ringritur vetëm, pra pa asnjë ndërhyrje të forcave të jashtme. Kriza e 1929 ishte një përjashtim që nuk e konfirmonte rregullin ekzistent të sistemit kapitalist.

- Depresioni i madh

Tronditja e parë e madhe e kapitalizmit ishte kriza e vitit 1929 e cila përfshiu periudhën nga tetori i vitit 1929 deri në fillimin e luftës së II-të botërore. Kriza shpërtheu në bursën e Neë York-ut në periudhën 24-29 tetor 1929. Ishte një krizë tipike burse. Kjo situatë shpejt u shndërrua në krizën ekonomike më të madhe të shekullit të XX-të. Galbraith theksonte se: “28 dhe 29 tetor 1929 do të ishin dy ditët më shkatërruese në historinë e bursës së Neë York-ut dhe ndoshta në gjithë historinë e bursës¹⁴”.

Dëshpërimi dhe humbja e besimit infektoi menjëherë investimet dhe konsumin. Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve dhe kompanive u gjendën pa likuiditet dhe u detyruan të mos bënin shlyerjen e kredive edhe të bllokunin pagat, duke ndërprerë prodhimin duke shkuar deri në falimentim. Kriza e 1930 u bë një krizë e mirëfilltë bankare e cila shkaktoi 2298 falimentime bankare në vitet 1930-31 në SHBA¹⁵. Në 1933, niveli i papunësisë në SHBA arriti në 24,9% të popullsisë aktive. Menjëherë pas SHBA, ajo filloi të përhapej në gjithë botën. Fillimisht u shfaq në Europë, në vendet të cilat bankat e tyre kishin lidhje të ngushta me bankat amerikane. Hollanda, Anglia, Franca dhe Spanja i drejtuan sytë nga kolonitë për të kompensuar tregtinë dhe mbështetur ekonominë e tyre¹⁶. Brenda vitit 1931, Europa dhe Rusia u prekën rëndë nga kriza. Gjermania pati një papunësi që shkante deri në 25%, duke rritur kështu deluzionin dhe revoltën e popullsisë për qeverinë dhe duke favorizuar kushtet për ardhjen në fuqi të nazizmit. Italia u përfshi nga një çrregullim i madh ekonomik dhe papunësi e lartë, duke i hapur rrugë kështu fashizmit. Analizat, reflektimet dhe komentet mbi shkaqet që prodhuan krizën e madhe të viteve 1929-1933, si dhe arsyet e transformimit të saj nga recesioni në depresion apo mbi efektin dhe racionalitetin e politikave dhe masave të ndërmarra për daljen prej saj, vazhdojnë deri në ditët e sotme,

¹³ Engels F.; *Anti-Dühring*, 1878

¹⁴ John Kenneth Galbraith, *La crise économique de 1929, anatomie d’une catastrophe financière*, Payot, 1989

¹⁵ Federal Reserve Bank of New York For the Year Ended December 31, 1931
(http://fraser.stlouisfed.org/docs/historical/frbny/1931_frb_newyork.pdf)

¹⁶ Adrian Civici, “Iluzionet monetare”

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

pa arritur të gjendet një konsensus i pranuar nga të gjithë. Janë të pafundëm artikujt, studimet, librat, analizat dhe konferencat kushtuar kësaj teme. Çdo shkollë e mendimit ekonomik është përpjekur t'a shpjegojë në këndvështrimin dhe tezat e tyre krizën, por njëkohësisht kundërshtonin apo hidhnin poshtë edhe argumentat e të tjerëve¹⁷.

- Shpjegimet e ekonomistëve keinsianistë dhe marksistë se “*kriza erdhi si pasojë e përqëndrimit dhe diferencimit të pabarabartë të pasurisë*”, kundërshtohet si e pamjaftueshme për të argumentuar detajet e krizës.
- Shpjegimi “monetarist” i Friedman dhe Schwartz i dhënë në librin “Historia monetare SHBA (1963)”¹⁸, konsiderohet si i pjesshëm.

Kindleberger vlerëson se “*për ta shpjeguar këtë krizë, është e domosdoshme të merren në konsideratë një numër shumë i madh faktorësh*.”¹⁹

Grupimi i parë i interpretimeve përmbledhet në shpjegimin e krizës si pasojë dhe efekt i spekulimeve në bursë. Çmenduria e bursës është origjina e krizës, si dhe papërgjegjshmëria e bankierëve, që i dhanë rrugë të lirë spekulatorëve. Aktiviteti bankar dhe ai financiar, në vend që të financonte ekonominë reale, financoi spekulimet e dyshimta, duke bërë që bursa të njihte avancime të paimagjinueshme. Në periudhën kur bursa u shemb, ndodhi që kreditë dhe huatë bankare nuk mund të paguheshin më dhe si rrjedhojë, bankat u asfiksuan. Në periudhën 1929-1934, afro 8000 banka falimentuan. Ekonomia tashmë e privuar nga kreditë dhe financimet, u paralizua krejtësisht. Kjo ishte arsyeja që kriza filloi të përhapej dhunshëm edhe në ekonominë reale.

Grupi i dytë i interpretimeve bazohet në një shpjegim “monetar”. Sipas tyre ishte “*krijimi monetar i shfrenuar*” i viteve 1920, ai që krijoi flluskën inflacioniste dhe shpërthimin e krizës. Shëmbja e sistemit financiar ishte rrjedhim logjik dhe pasojë fatale e presionit të jashtëzakonshëm të ushtruar për të ulur përqindjet e interesit në mënyrë që të sigurohej një ekspansion galopant i kreditit²⁰. M.Friedman²¹, gjykonte se ishte politika monetare kufizuese Fed në vitin 1928, ajo që shkaktoi frenimin dhe zvogëlimin e kredive. Gabimi sipas tij, ai që shkaktoi krizën, ishte një devijim nga rregulli monetar i domosdoshëm në këto raste, sepse Fed duhet të kishte bërë pikërisht të kundërtën, pra t'a furnizonte tregun dhe sistemin bankar me likuiditet të bollshëm.

¹⁷ Ben Bernanke, Essays on the Great Depression, Princeton University Press, 2005.

¹⁸ M.Friedman et Anna Schwartz, A monetary history of the United States, 1867-1960

¹⁹ Charles Kindleberger, 1986, La Grande Crise Mondiale 1929-1939, Economica premiere edition 1973

²⁰ Ludwig von Mises “A Treatise on Economics”

²¹ Friedman “Capitalism and Freedom”

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Autorë të tjerë si B.Bernanke²², theksojnë se: *“banka qëndrore, në vend që të mbante një qëndrim të ngurtë, duhej të kishte mbushur tregun me likuiditet dhe të lehtësonte maksimalisht kredinë bankare”*. Të njëjtin pozicion mban edhe ish presidenti i Fed, A.Greenspan. Të dy këta presidentë të Fed-it, e zbatuan teorinë e tyre në përballimin e të gjitha krizave financiare e monetare që prekën SHBA në periudhën 1987-2010. Ndërkohë, ekonomisti J.Rueff, e shikon origjinën e krizës, tek sistemi i “Gold Exchange Standart” (i miratuar në konferencën e Gjenevës të vitit 1920²³), si një efekt stabilizues, i cili e mbante sistemin në ekuilibër. Borxhi i SHBA-së, para vitit 1929, arriti deri në 370% të PBB. Bursa në këtë periudhë njohu një zgjerim spektakolar dhe si përfundim gjithë piramida e borxheve u shemb, duke provokuar kështu krizën totale. Kjo piramidë i kishte rrënjët në disekuilibrat financiarë. Shumë ekonomistë bëjnë të njëjtin krahasim dhe shikojnë të njëjtin mekanizëm për krizën financiare globale 2007-2013.

Shpjegimi tjetër ka natyrë “marksiste” dhe bazohet në arsyetimin se: “akumulimi i kapitalit dhe rënia e fitimit janë origjina kryesore e krizave të sistemit kapitalist”. Një super akumulim i kapitalit krijon super prodhim të provokuar nga kriza. Ekonomistët marksistë mendojnë se këto janë kriza ciklike organike në vetë natyrën e kapitalizmit dhe zhvillimi i tyre kalon detyrimisht nëpërmjet krizave ciklike të pashmangshme. Edhe Keynes-i i jep një shpjegim të ngjashëm kësaj dukurie, sipas tij: *“përqëndrimi i pasurisë i zvogëloi shumë mundësitë konsumit që aparati prodhues kishte nevojë për t’u zhvilluar në ekuilibër, duke prodhuar papunësi masive. Vetëm ndërhyrja e shtetit nëpërmjet investimeve publike mund të rikthente punësimin e plotë dhe të pengonte krizën ose të minimizonte efektet e saj”*²⁴.

Shpjegim të përafërt japin edhe “teoritë e rregullimit”, të cilët mendojnë se ekonomitë e zhvilluara destabilizohen si pasojë e progresit teknologjik dhe organizmit shkencor të punës ose “taylorizimit”. Avancimi i shpejtë i prodhimit në raport me pagat, pra me mundësinë e konsumit, shpjegohet me faktin se situatat e superprodhimit bëhen shkak për kriza monetare recesioni apo depresioni.

2.3 Konteksti i përgjithshëm i krizës si dhe llojet e saj

Duke folur përpara Kongresit Amerikan, A.Greenspan (Hahm & al.,2011), e përshkroi krizën financiare hipotekore si *“një tsunami i kredive që ndodh një herë në shekull”*. Një krizë financiare

²² “Essays on the Great Depression”

²³ Marrëveshja e Gjenevës (1922) parashikonte që vetëm dy monedha, ajo Amerikane dhe Britanike mund të konvertoheshin në ar, ndërkohë që monedhat e tjera thjesht e përcaktonin vlerën e tyre në raport me arin. Vendet e tjera nuk ishin të detyruar t’i paguanin në ar detyrimet e tyre, por mund ti paguanin ato në dollar ose lira, stërlina të pranuar edhe si rezerva valutore nga bankat qendrore respektive.

²⁴ Keynes, John Maynard “Treatise on Money”.

ndodh kur: “një rritje e informacionit asimetric si pasojë e një çrregullimi në tregun financiar shkakton probleme serioze të përzgjedhjes së pafavorshme dhe të rrezikut moral, duke i bërë tregjet financiare të paafta për kanalizimin e fondeve në mënyrë eficiente nga depozituesit tek individët dhe bizneset me mundësi për investime produktive²⁵”. Kur tregjet financiare nuk arrijnë të funksionojnë në mënyrë eficiente, atëherë aktiviteti ekonomik tkurret ndjeshëm.

- Krizat financiare dhe llojet e saj

Ka shumë kufizime për krizat të dhëna në studime të ndryshme. Një përkufizim i përgjithshëm mund të cilësohet edhe si: “Humbja e besimit mbi monedhën e një vendi ose aktiveve të tjera financiare që shkaktojnë tërheqjen e fondeve nga investitorët”²⁶. Caprio²⁷ dhe Mishkin²⁸ argumentojnë që: “krizat financiare zakonisht iniciojnë ose nxisin falimentim të sistemit bankar dhe luajnë rolin kryesor në rënien e çmimit të aktiveve financiare, më shpesh në tregjet e kapitalit dhe letrave me vlerë”. Bordo, Eichengreen, Klingebiel dhe Martinez-Peria²⁹, i përcaktojnë krizat financiare: “si episode të luhatshmërisë së tregjeve financiare, karakterizuar nga probleme të rëndësishme likuiditeti dhe falimentim të pjesëmarrësve në tregjet financiare”.

Portes (1998) e cilëson: “një krizë financiare është një çrregullim i tregjeve financiare që dëmton kapacitetin e këtyre tregjeve për të shpërndarë kapital dhe për rrjedhojë, ndërmjetësimi financiar dhe investimet ndalen”. Ndërsa disa studiues të tjerë i përkufizojnë krizat financiare si ngjarje që në shumicën e rasteve shoqërohen me rënien e çmimeve të aktiveve financiare ose e thënë ndryshe, si shpërthim i të ashtuquajturave “fluska”³⁰ të tregjeve të aktiveve të ndryshme financiare. Një krizë financiare shoqërohet me veprimet e publikut që papritur thithin rezervat e sistemit bankar detyrohet të ndërhyjë për të parandaluar krizën³¹.

- Shpërthimi i krizës së vitit 2007, etapat dhe arsyet e saj

“Për herë të dytë në shtatë vjet, shpërthimi i një fluske të madhe asetesh, shkaktoi një dëm të madh në tregjet financiare mbarë botërore. Në të dy rastet, si fluska e kapitalit në vitin 2000 dhe fluska e kredisë në vitin 2007, bankat qendrore ishin në gjumë gjatë këtij ndryshimi. Mungesa e disiplinës

²⁵ Financial Market Regulation in the Wake of Financial Crises: The Historical Experience: Banca d'Italia November 2009

²⁶ Roberto Chang and Andres Velasco (May, 2001), "A Model of Financial Crises in Emerging Markets

²⁷ Caprio & Kunt, (1998)

²⁸ Mishkin (1996)

²⁹ Prill 2001

³⁰ Të ashtuquajturat “fluska” i referohet rritjes artificiale të çmimeve të aktiveve financiare.

³¹ Rules and Institutions for Sound Fiscal Policy after the Crisis (Marika Cioffi, Daniele Franco and Maria Rosaria Marino) (Banca d'Italia), April 2011

monetare ishte bërë një vulë globalizimi. Bankat qendrore nuk arritën të siguronin një bazë të qëndrueshme në tregjet financiare botërore dhe të një ekonomie globale”.

Stephen Roach, Morgan Stanley

Gjithcka filloi të shfaqej gjatë 2007 duke u përkufizuar thjesht si një krizë financiare që e kishte origjinën në kreditë e këqija, në tregun e pasurive të patundshme amerikane. John B.Taylor ka thënë³²: *“Si pasojë e mosndërrhyrjes së qeverisë, nga mosdiagnostifikimi i problemeve të kreditimit bankar si dhe në problemet e likuditetit, ishte shkaku që ndodhi kriza e fundit”.* Tregjet e aksioneve në mbarë botën po pësonin humbje të mëdha. Vetëm tregu amerikan në atë periudhë kishte pësuar një rënie prej 40%. Ndodhi ajo që tashmë nuk kishte më kthim. Shumë kompani financiare, duke përfshirë bankat tregtare, bankat e investimit dhe kompanitë e sigurimeve, falimentuan. Në atë periudhë u shtruan pyetje të cilat kërkonin përgjigje:

- A do të mbetet e lokalizuar vetëm në SHBA?
- Do të përhapej edhe në Europë?
- Do të prekte edhe vendet emergjente si dhe ato në zhvillim?

Ndikimi që kjo krizë ka patur në ekonominë reale, ishte në propocione të mëdha dhe ende sot po përjetohen efekte negative³³. Falimentimi i bankës 158 vjeçare “Lehman Brothers”, e cila ishte një ndër katër bankat më të mëdha të investimeve në SHBA, ishte vetëm një shpërthim në sipërfaqe të krizës financiare, por sigurisht jo fundi i saj dhe i tronditjeve që po kalonte ekonomia amerikane në veçanti dhe ajo globale në përgjithësi. Në këtë falimentim ndikoi edhe kriza e njohur e kredive në SHBA, ose e quajtur ndryshe “kriza e kredive mortgage-it”³⁴. Ndikim pati edhe rënia e vlerës së dollarit në tregjet ndërkombëtare, tronditjet në tregjet ndërkombëtare të naftës, të energjisë, kriza e çmimeve të produkteve bujqësore si dhe ushqimore etj. Të gjithë këto faktorë kanë qenë të pranishëm më shumë se kurrë, për gati dy vjet në ekonominë amerikane dhe padyshim edhe në atë globale³⁵.

Kësaj krize po t’i shtohet edhe zbatimi i politikave të gabuara investuese dhe kredituese të kësaj banke në sektorin e “housing loans” (dhënia e kredive për shtëpi pa kritere shtrënguese, rritja e paaftësisë paguese si edhe e kthimit të këtyre kredive) arrihet në përfundimin se pleksja e këtyre faktorëve dhe elementëve, ishte në themel të kësaj ngjarjeje tronditëse. Reagimet dhe ndërlikimet në sistemin

³² John B.Taylor “Getting Off Track”: How Government actions and Interventions Caused prolonged and worsened the Financial Crisis” pg 23

³³ Spaventa, Luigi “La grande crisi finanziaria del nuovo millennio 2009” pg34

³⁴ “housing loans”- kreditë për blerje shtëpie

³⁵ Anastas Angjeli, 2013, “Në etet e krizës”


Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

financiar amerikan si dhe në ekonominë globale në atë kohë, sigurisht që nuk munguan. Inflacioni arriti deri në 5,4%, ndërkohë u vu re që çmimi i të gjithë llojeve të energjisë si gaz, naftë, energji elektrike pësoi një rritje të lehtë. American International Group (AIG), shoqëria më e madhe e sigurimeve në SHBA dhe në botë, vetëm dy ditë pas falimentimit të bankës “Lehman Brothers” i bëri kërkesën autoriteteve të shtetit amerikan për “ndihmë dhe mbështetje financiare”, pasi i deklaroi atyre situatën e saj të vështirë financiare në të cilën ndodhej. Ndodhi që situata e kredive të 20 bankave më të mëdha pësoi një rënie të vlerës prej 300 miliardë dollarësh, vlerë kjo e njëjtë me atë që FED përdori për të nxitur kreditimet nga ana e saj (Swedberg, 2010).

Secila bankë po përpiqej që “të largonte rrezikun nga vetja e saj”. Proçesi i shkrirjeve të tyre, blerjes apo shitjes, tashmë ishte i pranishëm në tregun financiar. Nga ana tjetër u ndjenë menjëherë tronditjet në bursat e New York-ut, Azisë, Europës ku vlerat dhe indekset e këtyre aksioneve shënuan ulje të menjëhershme. Kjo dukuri çoi në humbjet e disa bankave dhe investitorëve në bursa, të cilat ishin të konsiderueshme duke rritur më tej pasigurinë në këto tregje. Tronditja e tregjeve financiare ndërkombëtare si dhe falimentimi i kësaj banke u shoqërua menjëherë me uljen e çmimeve në tregjet ndërkombëtare të naftës, si rrjedhojë e uljes së kërkesës.

Diagrama e krizës “subprime”³⁶

Grafiku nr 1. Diagrama e krizës subprime (efekti domino)



Burimi: Hui Tong, Shang-Jin Wei (2008)

- Tregu i shtëpive

Në fund të 2006, mbas shpërthimit të filluskës së kredive “mortgage” të blerjes së shtëpive, çmimet ranë ndjeshëm. Kjo periudhë i gjeti huamarrësit e kredive hipotekore të paaftë për të paguar kreditë e tyre. Aftësia e refinancimit të kredive hipotekore ra ndjeshëm. U rritën në vazhdimësi edhe rastet ndaj mospagesave të kësteve të kredive. Kjo situatë krijoi presion në ekonomi, duke e rritur rrezikun e recesionit. A. Greenspan shprehet³⁷: “përderisa çmimet e shtëpive patën këtë goditje dhe përderisa vlerat janë të paqëndrueshme, kriza detyruesht do të vazhdojë”.

³⁶ Kjo diagramë ilustron se si rënia në tregun e strehimit transferohet në tregjet financiare, duke dëmtuar bankat dhe ekonominë gjatë periudhës së vitit : Kriza subprime e kredive të banesave

³⁷ <http://opinionjournal.com/editorial/feature>

- Tregu Financiar

Sipas Greenspan³⁸: *“shkaku i krizës ishte euforia nga bindja që ekzistonte se tregjet monetare vetërregullohen”*. Ashtu sikurse këto flukse monetare u bënë të pasigurta ose ranë, investitorët dhe institucionet financiare që merreshin me Mortgage-backed securities (MBS) u përballën me humbje të mëdha. Ata u detyruan të shisnin asete për të mundur kompesimin e fitimit të munguar. Për shkak të humbjeve kapitali bankar i vlefshëm për kreditim ra. Disa banka të mëdha dhe dhjetëra kompani hipotekore falimentuan. U rritën normat e interesit dhe si rrjedhojë kreditë u bënë edhe më të shtrenjta. Duke e krahasuar me periudhën e “bum-it”, kredia u bë në mënyrë të konsiderueshme, më pak e vlefshme si dhe ranë ndjeshëm investimet në biznes.

- Përgjigjet e Qeverisë dhe të Industrisë

Bankat Qëndrore ndërhyjnë duke ulur normat e interesit për të mundur stimulimin e ekonomisë. Vlera tatimore (paketa stimuluese) u siguruan nga taksapaguesit e SHBA dhe pronarët e shtëpive për rifinancimin e hipotekave të tyre. Veprimet e qeverisë, u morën në periudhën midis viteve 2007-2008, pra jo në momentin kur u shfaqën ndikimet në tregun financiar. Një ndër masat kryesore që ndërmori atëherë edhe Rezerva Federale ishte ulja disa herë e normave të interesit gjatë fazave të krizës. Nga sa u përshkrua më sipër, kuptohet se çfarë ndodhi në tregun e kredive imobiliare amerikane, ajo “pjesë” e limituar e sektorit financiar, nga ku edhe nisi shkëndija e parë e krizës globale 2007. Interesa shumë të ulta, gati në 1% për periudhën 2002 deri 2004, si edhe mbajtja e kësaj norme për një periudhë të gjatë, sipas shumë ekonomistëve, ka qënë një element veçanërisht i dëmshëm, i cili u verifikua me një “bum” të blerjeve imobiliare.

Sipas skemës klasike, “banka financon huamarrësin dhe nëse huamarrësi nuk arrin të paguajë këstet e kredisë, atëherë në këtë situatë banka merr pronën” (Bellenzier, *et al* 2010).

Disa ekonomistë (Pressacco 2008, Margiocco 2008, Passarella 2009, Barba e Pivetti 2010³⁹) këtë dukuri e kanë cilësuar si një komponent politik dhe social, *“konçensionimi i kredive me norma të favorshme shikohet si një rishpërndarje e të ardhurave në favor të klasave më të varfra, duke mbajtur paga të ulta të punëtorëve”*. Me fjalë të tjera, mundësia e dhënë për të blerë shtëpi, këtyrë klasave të shoqërisë ishte një kompesim për pabarazinë e shpërndarjes së pasurisë. Personalitete të shquar të botës ekonomike dhe financiare si Alan Greenspan, Dominique Strauss Kahn, Ben Bernanke, Jean Claude Trichet, etj., atë periudhë e kanë trajtuar me shumë kujdes. Ata krizën e cilësuan si *“një turbolencë të tregjeve financiare amerikane”*, e cila duhej menaxhuar me kujdes, si intensitetin e saj ashtu edhe

³⁸ Alan Greenspan “Age of Turbulence”

³⁹ Këta autorë kanë publikuar artikujt e tyre në revistën on line “Ekonomia dhe Politika: Revista on line e politikës ekonomike.

përhapjen e saj në Europë dhe në vende të tjera të botës. Shumë shpejt “turbulencat” e tregjeve financiare goditën rëndë dollarin amerikan, i cili filloi të zhvlerësohej me shpejtësi në raport me euron dhe duke nxjerrë në pah edhe një situatë alarmante të ekonomisë amerikane.

Krizë konjunkturë, reëesion apo stagflacion? Pesimizmi i ekonomisë, financave, biznesit dhe konsumatorëve amerikanë vazhdoi të rritej dita ditës. Në tremujorin e parë të vitit 2008, kriza financiare filloi të shfaqej edhe në Europë, fillimisht në Angli, pastaj në bankat zvicerane, gjermane, franceze etj. FMN-ja i vlerëson në rreth 1000 miliardë dollarë humbjet nga kjo krizë, ndërkohë që parashikimet që ajo bënte nuk ishin aspak optimiste për nivelin e rritjes ekonomike dhe inflacionin në ekonominë kryesore të planetit. U arrit në përfundimin se zgjidhjet e ofruara për daljen nga krizat e mëparshme, nuk po vlenin si “receta” për krizën aktuale.

2.4 Shpjegimet teorike dhe qëndrimet për krizën

“Depresioni i Madh, si periudhat e tjera të papunësisë së madhe, është prodhuar nga keqmenaxhimi qeveritar dhe jo nga ndonjë destabilitet si pjesë e ekonomisë private”.

Milton Friedman

Sipas mendimit të tre ekonomistëve, R.Boyer, M.Debove dhe D.Plihon⁴⁰ “krizat financiare ritmojnë dhe kompozojnë vetë historinë e kapitalizmit”, duke marrë shpesh “formën e krizave binjake apo trinjake”, që do të thotë një përzierje të problemeve të bursës me ato financiare dhe ekonomike.

Interpretimi i krizave ndjek në thelb tre linja themelore, që përkojnë me tre mendime kryesore ekonomike:

- Teoria marksiste
- Teoria neoklasike
- Teoria Keynesianist

Interpretimi marksist:

"Ata që kanë kapitalin do të stimulojnë klasën punëtore për të blerë gjithnjë e më shumë mallra të shtrenjta, shtëpi dhe teknologji, duke i shtyrë ato, për të marrë më shumë kredi, derisa borxhi i tyre

⁴⁰ Robert Boyer, Mario Debove et Dominique Plihon, Les crises financieres, CAE, La documentation française (413 p)

bëhet i padurueshem. Borxhi papaguar do të çojë në falimentimin e bankave, të cilat duhet të nacionalizohen dhe shtetit do t'i duhet të marrë rrugën e cila përfundimisht do të çojë në komunizëm”.

Karl Marx, 1867

Marks mendonte se kriza “është pjesë e pandarë e analizës së sistemit kapitalist”. Ai argumentonte se edhe në një ekonomi të thjeshtë monetare mundësia e krizave ekziston. Kjo mundësi është reale, për faktin e thjeshtë se shkëmbimi ndërmjetësohet nga paratë. Për Marks-in në një ekonomi të thjeshtë monetare paraja nuk është vetëm një mjet i thjeshtë teknik, i cili shërben për të lehtësuar këmbimin, por paratë janë edhe një mjet këmbimi dhe lehtësojnë levizjen e mallrave, ku paraja ndan në dy pjesë të veçanta, blerjen dhe shitjen.⁴¹ Gjëja më insistuese - shkruan Marks-i (1867) tek “Kapitali” është se “lëvizjet kontradiktore të shoqërisë kapitaliste janë peripecitë e ciklit të industrisë moderne dhe kulmi i këtyre ngjarjeve çon në krizën e përgjithshme”.⁴²

Teoria neoklasike është ende zotëruese dhe po studiohet edhe në ditët e sotme. “Nuk ka një teori të mirëpërcaktuar të krizave dhe depresioneve botërore”. Pranimi i ligjit “Say”⁴³, sipas të cilit “çdo prodhim krijon kërkesën e vet” nënkupton edhe pamundësinë e krizës. Si mund të jetë e mundur që të grumbullohen mallrat e pashitura në magazinat e ndërmarrjeve? Teoria e mohon. Ekonomia e tregut është gjithmonë në gjëndje të vetëkontrollohet. Por, që të ndodhë kjo, është e nevojshme që forca të tilla të jashtme si shteti mos të ndërhyjnë në sipërmarrjen e lirë private, duke vështirësuar funksionimin natyral të tregut. Pagat dhe çmimet fleksibël do të lejojnë gjithmonë në sistemin ekonomik të arrijnë një ekuilibër të punësimit të plotë. Kur kjo nuk ndodh, shkak është gjithmonë sistemi i jashtëm. Krizat dhe depresionet thjesht nuk munden dhe nuk duhet të ekzistojnë. Nga e gjithë kjo, shkruan Galbraith, “mund të mos gjendet ilaçi për depresionin nëse depresioni është përjashtuar nga teoria. Mjekët, madje edhe ata me një reputacion të mirë dhe më të zotët, nuk e kanë një kurë apo ilaç për një sëmundje që nuk ekziston”⁴⁴.

Lionel Robbins dhe Joseph A. Schumpeter kanë argumentuar se nuk nevojitet të bëhet asgjë për të dalë jashtë krizës. Shkak i krizës ishte që të kërkohej akumulimi i “toksinave” në sistem dhe shërimi mund të vinte vetëm me largimin spontan të këtyre të fundit. Schumpeter shprehet se “Kjo nuk është e gjitha, analiza jonë na çon të besojmë që shërimi është autentik nëse ai vjen nga vetvetja”⁴⁵. Friedman,

⁴¹ Marx, K.; *Teorie sul plusvalore*, vol. II, cap. XVII, pp. 555-584, Editori Riuniti, Roma, 1979.

⁴² Marx, K.; *Teorie sul plusvalore*, vol. II, cap. XVII, pp. 555-584, Editori Riuniti, Roma, 1979.

⁴³ Jean-Baptiste Say (1767-1832) ekonomist i njohur francez

⁴⁴ Galbraith, J.K.; *Storia dell'economia*, Rizzoli, Milano, 1987

⁴⁵ Schumpeter, J.A., “Depressions”, in *The Economics of the recovery programs*, McGraw Hill, New York, 1934.

ekonomisti që frymëzoi ringjalljen e liberalizimit, e lidh krizën e 1929, si dhe depresionin që u pasua, me gabime të politikës monetare të Rezervës Federale. Friedman shkruan: *“Ne tani e dimë, që dikush e dinte edhe më parë, se depresioni nuk ishte prodhuar nga një falimentim i një ndërmarrjeje private, por nga një dështim i pushtetit publik”, rregullimi i vlerës së parave dhe të valutës së huaj, paaftësia e autoriteteve publike në menaxhimin e parasë, nuk është vetëm një kuriozitet historik, por vazhdon të bejë pjesë edhe në realitetin e sotëm”*⁴⁶.

Për Keynes, si edhe për Marks, kriza nuk është aksident. Sistemi ekonomik nuk është gjithmonë në gjendje që të vetërregullohet. Ekuilibri midis ofertës dhe kërkesës mund të jetë ose jo, dhe kursimet nuk janë gjithmonë domosdoshmërisht të njëjta me investimet. Kërkesa efektive për mallrat e konsumit dhe të investimeve mund të mos jetë e përshtatshme në atë nivel të prodhimit dhe kjo mund të prodhojë një bllokim të mekanizmit ekonomik. Receta klasike, si ulja pagave dhe e çmimeve, në vend që të vendoste në ekuilibër sistemin, pra të siguronte një punësim të plotë, mund të çonte monedhën në depresion. Kriza nuk është prodhuar nga mungesa e bollëkut. Të gjithë shohim se kompanitë kanë vështirësi të shesin produktet e tyre. Nëse mekanizmi ekonomik është bllokuar, si mund që “sakrificat” të kontribuojnë në zgjidhjen e krizës? “Sakrifika” e të pasurve mund të ketë një kuptim, vetëm nëse do të çojë në një rishpërndarje të të ardhurave në favor të atyre punëtorëve me të ardhura të vogla, duke nxjerrur kërkesën për konsum që do të kontribuonte në një rimëkëmbje të ekonomisë. Nëse qeveritë dhe ndërmarrjet do të praktikonin politika që do të çonin në sakrifika, pra në ulje të pagave, kriza mund të përkeqësohej duke provokuar kështu edhe një depresion të madh.

Keynes (1979) mbi këtë pikë ishte i qartë : *“Nëse varfëria jonë do të vinte për shkak të një tërmeti apo luftë, kjo do të shkaktohte mungesën e të mirave esenciale si dhe mungesë burimesh për prodhimin e tyre dhe nuk na mbetet tjetër veçse të punojmë shumë për të arritur mirëqënien”*.

Pasi është përcaktuar problemi, atëherë mund të jemi në gjendje të zgjedhim edhe mënyrën se si do gjejmë edhe “ilaçin”. Ka akoma njerëz që besojnë që rrugëdalja është vetëm një punë e vështirë, sakrifika, durim, kursim dhe metoda më të mira në biznes, si dhe një aktivitet bankar shumë i kujdesshëm. Përsa u përket mënyrave të përballimit të këtyre krizave periodike ndeshen dy rryma të kundërta të mendimit ekonomik.

Njëra mbron parimin e “mekanizmit perfekt të tregut”, që pretendon se ekonomia kapitaliste e tregut është një ekonomi e “vetërregullueshme”. Pra, tregu me konkurrencën e tij perfekte është i aftë të rivendosë ekuilibrin e ekonomisë në mënyrë automatike, pa ndërhyrje nga jashtë. Ndjekësit e kësaj

⁴⁶ Friedman, M. e R.; “Anatomia di una crisi”, in *Liberi di scegliere*, Longanesi , Milano 1979

rryme pretendojnë se ndërhyrja për përballimin e krizave duhet vetëm atëherë kur ato shkaktohen nga faktorë të jashtëm. Ata gjithashtu pohojnë se në periudhat e pasigurisë, ekonomia mund të ndikohet nga goditje të jashtme, të paparashikueshme dhe të pësojë çregullime e rënie, që ndikojnë në sjelljen e njerëzve dhe në çmimet. Kjo rrymë e mendimit ekonomik në dekadat e fundit ishte përfaqësuar nga rryma neoliberalet, e cila në fillim të viteve 70 të shekullit XX kundërshtoi ballë për ballë rrymën *keinsiane* dhe *neokeinsiane*.

Sipas rrymës keinsiane:

Të dhënat historike tregojnë se krizat përfaqësojnë një element endogjen të ciklit ekonomiko-financiar. Ato janë dukuri të vetëfunksionimit të sistemit kapitalist, të cilat janë të pashmangshme. Përballimi i këtyre krizave kërkon përpunimin e politikave shtetërore të antikrizës. Sipas Kejnstit, teza neoliberalet e “tregut perfekt” duhet zëvendësuar me tezën “e paqëndrueshmërisë ekonomiko-financiare”, e cila e ka burimin në dy shkaqe:

- a) Së pari, çmimet e aktiveve që merren parasysh në llogaritjen e gjendjeve pasurore nuk formohen në tregjet përkatëse në të njëjtën mënyrë siç formohen çmimet e mallrave dhe të shërbimeve në tregjet e tyre (Keynes, 1983).
- b) Së dyti, paraja përfaqëson një mjet publik dhe kjo do të thotë se sjelljet ndaj parasë mund të jenë vetëm sjellje kolektive. Në periudhat e krizave paraja luan një rol vendimtar. Përcaktimi i vlerës së elementëve të pasurisë (aktiveve) mund të bëhet vetëm nëpërmjet parave dhe kriza financiare-kreditore krijon pikërisht zvogëlim likuiditetesh. Nëse shihen tregjet e mallrave, atëherë del se kërkesa varet nga nevojat e blerësve, nga dëshira e tyre si dhe nga dobishmëria, prandaj me plotësimin e këtyre arrihet edhe mbingopja e konsumatorëve. Këta faktorë kanë një burim tjetër në krahasim me ofertën. Prandaj me rritjen e kërkesave të konsumatorëve çmimet fillojnë të ngrihen. Pas njëfarë kohe, kur konsumatorët shohin çmimet e ngritura, reagojnë duke kufizuar blerjet e tyre. Kemi të bëjmë kështu me një teori klasike të kërkesës dhe të ofertës, ku madhësia e kërkesës dhe ofertës përcaktohet nga faktorë të tjerë që nuk kanë të njëtin burim (Keynes, 1983).

2.5 Shfaqja dhe efektet e kriza globale të vitit 2007 në Shqipëri

Krizës globale të 2007, nuk mund t’i shpëtonte edhe Shqipëria. Vendi ynë ka një ekonomi që gjeneron pak të ardhura. PBB dhe eksportet nuk janë aq të mëdha si në vendet e tjera të botës së zhvilluar. Efektet e krizës financiare ndërkombëtare u shfaqën në tremujorin e fundit të 2008. Kjo u dallua nga ngadalësimi i kreditimit, zhvillimet në bilancin e pagesave, rënia e optimizmit tek sipërmarrësit e

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

bizneseve edhe sipërmarrësit individë, në formën e ngadalësimit të rritjes ekonomike dhe rënies së të ardhurave. Këto efekte negative do të thelloheshin më shumë në 2009.

Tregjet financiare ndërkombëtare, edhe pse inekzistente në Shqipëri, janë të rëndësishme për bankat mëmë të bankave shqiptare. Kjo për faktin e thjeshtë të marrjes së fondeve të nevojshme. Këto banka varen nga fondet e huazuara për të mbështetur aktivitetet e tyre të kreditit, të cilat janë jetike për veprimtarinë e tyre në Shqipëri. Bankat të cilat kanë një raport të shëndetshëm kredish ndaj depozitave, mund të ishin më të suksesshme në shmangien e shpenzimeve të tilla. Shpenzimet shtesë do të përkthehen në një kosto më të lartë të huamarrjes, e cila më pas do të transmetohet në ekonomi, ku lojtarët janë shumë të varur nga huatë për financimin e aktiviteteve të tyre. Një nga masat kryesore që sistemi bankar ndërmori në Shqipëri ishte frenimi i kredidhënies, i cili pak kohë më parë ishte shumë agresiv. Në këtë moment sistemi bankar u karakterizua nga vështirësitë në procesin e kreditimit, pasi edhe kostot e huamarrjes ishin të larta. Ndodhi që raporti i kredive problematike të rritej. Niveli i lartë i kredive me probleme ngadalësoi kështu, edhe normën e rritjes së aktiviteteve të kredisë. Edhe në Shqipëri u pasqyrua trendi global, pra pati një rënie të çmimeve në sektorin e pasurive të patundshme, e cila do të rrezikonte situatën në sistemin bankar dhe në ekonominë reale. Reduktimi i të ardhurave nga emigrantët si dhe ulja e eksporteve, janë disa nga efektet e para, me të cilat vendi u përball. Zhvlerësimi i lekut tregoi qartë se shqiptarët po përballeshin me krizën botërore.

Disa faktorë që treguan ndikimet e krizës në Shqipëri: 1) Rritja e inflacionit dhe zhvlerësimi gradual i lekut në tregun valutor; 2) Një rënie drastike e shitjeve të pasurisë së patundshme; 3) Rënie në procesin e marrjes së kredive dhe të depozitave bankare; 4) Rritja graduale e çmimeve e lidhur sidomos me artikuj të konsumit. Kriza financiare shkaktoi rënie në fuqinë blerëse, ky fakt u confirmua edhe nga rënia e importeve.

Ndikimi i krizës u vu re nga : 1)rënia e investimeve të huaja; 2)rënia e të ardhurave nga emigrantët; 3)rritja e çmimeve të produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore; 4)shtrëngim i kredive nga ana e bankave tregtare; 5) ndikimi në tregun e shtëpive, si rezultat i një ndryshimi në çmimet e lëndëve të importuara; 6)rënia e normës së interesit të depozitave në bankat tregtare.

Remitancat patën shumë ndikim në ekonominë shqiptare. Dërgesat e emigrantëve përbëjnë një ndihmë ekonomike të vlefshme jo vetëm për familjet e tyre, por edhe për ekonominë në tërësi. Shqipëria ka një rrjet financiar shumë të kufizuar, gjë që nuk u jep mundësi qytetarëve të shpenzojnë më shumë se të ardhurat e tyre. Gjithashtu, pjesa më e madhe e familjeve ka një nivel modest të të ardhurave për jetesë. Një rënie e këtij niveli për shkak të ndikimit të krizës financiare, veçanërisht si rezultat i rënies së të ardhurave nga dërgesat e emigrantëve, ka bërë që familjet të shkurtojnë shpenzimet.

Cilët sektorë janë prekur nga kriza në vendin tonë?

BSH-ja në raportin e për qëndrueshmërinë financiare (2013) thekson se nga pasojat e krizës ekonomike botërore, sektori i ndërtimit, bizneset eksportuese, si dhe ato të industrisë përpunuese ishin sektorët më të prekur. Sipas bankave tregtare, në Shqipëri janë pikërisht bizneset e këtyre sektorëve, të cilat kanë më shumë vështirësi në shlyerjen e kredive bankare. Si pasojë e tkurrjes së kreditimit të ekonomisë në përgjithësi, sektori i ndërtimit shfaq probleme likuiditeti, si rrjedhojë edhe e stepjes së konsumatorëve për të investuar. Edhe sektori i eksportit pati probleme të likuiditetit, nga vonesat e partnerëve të huaj. Bankat tregtare nga ana tjetër, filluan të bënin analiza më të kujdesshme për kredidhënien, ndërkohë që normat e interesit pësuan rritje, veçanërisht ato në monedhën euro. Bankat ishin të rezervuara nga financimet afatgjata. Arsye tjetër e shtrëngimit të kredidhënies ishte edhe rritja e “kredive të këqija” (NPL). Lidhur me kushtet e dhënies së kredisë, bankat tregtare forcuan standardet e aplikuara për kredinë nëpërmjet rritjes së kërkesës për kolateral, në raport me madhësinë e huasë. Tashmë bizneseve, do t’ju duhet të zotërojnë sasi më të mëdha të pasurive të paluajtshme për të bërë të mundur lëvrimin e kredisë nga bankat.

2.7 Qëndrueshmëria financiare

“Në mungesë të një standarti të artë, nuk ka asnjë mënyrë për të mbrojtur kursimet nga konfiskimi nëpërmjet inflacionit. Nuk ka asnjë rezervë të sigurt të vlerës”.

Alan Greenspan

Duke u përqëndruar në shprehjen “qëndrueshmëri financiare”, Banka e Anglisë për herë të parë e ka përdorur këtë term në 1994, për të përshkruar ato objektiva të politikës monetare, të cilat nuk ishin të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me qëndrueshmërinë e çmimeve. Për qëndrueshmërinë financiare janë dhënë shumë përkufizime. Guvernatori i Bankës Qendrore Suedeze, në vitin 2004, pohonte se, “koncepti i qëndrueshmërisë financiare mbetet i vështirë për t’u përcaktuar”⁴⁷. Wim Duisenberg⁴⁸, mendon se, “qëndrueshmëria monetare është përcaktuar si qëndrueshmëri në nivelin e përgjithshëm të çmimeve, e cila kuptohet si mungesa e zjarrit inflacioniste ose e presioneve deflacioniste”.

Qëndrueshmëria financiare, në të kundërt, nuk ka një përkufizim të thjeshtë dhe të pranuar nga të gjithë. Pavarësisht nga kjo, duhet të ketë një konsensus të gjerë fakti se, qëndrueshmëria financiare bën

⁴⁷ Heikensten (2004).

⁴⁸ Presidenti i BQE nga 1/06/1998 deri në 31/10/2003 ku pasardhesi i tij ishte Jean-Claude Trichet.

të mundur një funksionim të mirë të elementëve kyç, të cilat përbëjnë të gjithë sistemin financiar⁴⁹. Është e rëndësishme të nënvizojmë se termi “qëndrueshmëri financiare”, kohët e fundit ka hyrë në literaturë si rrjedhojë e krizës dhe vëmendja e bankave qendrore për këtë aspekt ka qënë gjithmonë e dukshme. Kujtojmë se një nga motivet që kanë sjellë krijimin e FED në vitin 1913, ka qënë pikërisht kujdesi për qëndrueshmërinë bankare në SHBA. Greenspan,(2007) shprehet se: “*FED është themeluar për t’i dhënë fund periudhës së paqëndrueshmërisë monetare dhe financiare dhe për të caktuar detyrat makroekonomike, si ajo e kontrollit monetar, ashtu edhe e mbikqyrjes bankare*”.

Pjesa më e madhe e studiuesve që kanë bërë studime “qëndrueshmërisë financiare” kanë preferuar të analizojnë tematika të tilla, duke iu referuar konceptit të saj të dyfishtë, duke u përpjekur për të dhënë një përkufizim “paqëndrueshmërisë financiare”. Për ata ka rezultuar më e lehtë të përkufizojnë “paqëndrueshmërinë financiare”, duke u bazuar në analizën e historisë ekonomike të shek.XX-të, në identifikimin e gjendjeve të tilla dhe në shkaqet e tyre të mundshme. Qëndrueshmëria financiare nuk i përket vetëm qëndrueshmërisë së institucioneve financiare. Ajo duhet studiuar edhe nga këndvështrimi makro, pasi ka një sërë bashkëveprimesh dhe lidhjesh me sjelljen e politikave monetare. Blejer ka cilësuar: se “kushdo që ka disa njohuri mbi këtë temë mund të thotë se qëndrueshmëria financiare promovon dhe stimulon zhvillimin. Në fakt, nga këndvështrimi i përgjithshëm analitik, dalin disa probleme me formulimin se, qëndrueshmëria financiare promovon zhvillimin ekonomik⁵⁰”.

Nëse bëjmë një kërkim në literaturë rreth qëndrueshmërisë dhe zhvillimit, marrim shumë rezultate, por nëse kërkimi bëhet për qëndrueshmërinë dhe zhvillimin monetar, atëherë ne marrim shumë më pak rezultate. Kuptimi dhe interpretimi i qëndrueshmërisë financiare vazhdon të jetë shumë i debatueshëm edhe sot. Edhe pse lidhja midis zhvillimit dhe qëndrueshmërisë financiare nuk është përcaktuar mirë, është e qartë se niveli i zhvillimit financiar zakonisht shoqërohet me rritje ekonomike. Thënia e Blejer, është sa e pranueshme aq edhe e debatueshme. Qëndrueshmëria financiare në përgjithësi, i referohet qëndrueshmërisë së nivelit të çmimeve. Kështu që, lufta kundër inflacionit është njohur pak a shumë si objektivi i qëndrueshmërisë monetare dhe si rrjedhojë, ka shumë pak diskutim rreth tij. Kundërshtime nuk ka rreth faktit se qëndrueshmëria monetare matet në termat e qëndrueshmërisë së nivelit të çmimeve. Në parim ekzistojnë dy përcaktime për “paqëndrueshmërinë financiare”: Përcaktimi i parë nga Mishkin⁵¹, i cili përcakton paqëndrueshmërinë financiare, nga pasojat e saj. Mund të ndodhin tronditje në sistem, të cilat nuk bëjnë gjë tjetër, veçse e ndalojnë sektorin financiar të dërgojë fonde në

⁴⁹ Qëndrueshmëri Financiare përkufizohet si, qëndrueshmëri në nivelin e përgjithshëm të çmimeve ose si një mungesë e inflacionit dhe deflacionit (Duisenberg, 2001).

⁵⁰ Mario I. Blejer, Banka e Anglise (2009)

⁵¹ Financial Markets & Institutions

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

destinacione drejt investimeve frutdhënëse. Paqëndrueshmëria financiare ndodh kur tronditjet nuk zhduken në sistem, në mënyrë të tillë, që të izolojnë sektorin financiar nga vetë tronditjet. Kjo krijon një situatë në të cilën sektori financiar ndalon së kryeri funksionet e tij të pritshme. Sipas Mishkin⁵², paqëndrueshmëria financiare çon në ndalimin e efektivitetit të sektorit financiar.

Ekziston një përcaktim i dytë, nga Crockett (2000), (BIS- Banka e Rregullimeve Ndërkombëtare). Ai bën një diskutim të rëndësishëm midis dy llojeve të qëndrueshmërisë. Crockett thotë se, “kur dikush flet rreth qëndrueshmërisë në sektorin financiar duhet të jetë në gjendje të dallojë midis dy llojeve: qëndrueshmërinë e institucioneve financiare dhe qëndrueshmërinë e tregjeve financiare”. Paqëndrueshmëria në tregun financiar është luhata e çmimeve të aseteve të cilat, duke reaguar ndaj ndryshimeve, nuk mund të parashikohet. Ndërsa, paqëndrueshmëria e institucioneve financiare ndodh kur ata nuk mund të përmbushin rolin e tyre. Por, nga çfarë shkaktohet paqëndrueshmëria financiare. Në dy dekadat e fundit kemi parë një rritje të nivelit të paqëndrueshmërisë financiare.

Në literaturën ekonomike janë vërejtur tre prirje të përgjithshme, që ndikojnë në paqëndrueshmërinë financiare (Bezemer, 2011).

Së pari, paqëndrueshmëria financiare është rritur ndjeshëm si pasojë e volumit të ndërmjetësimit financiar.

Së dyti, mjetet financiare janë bërë edhe më të ndërlikuara e të ndërthurura.

Së treti, institucionet financiare ndërkombëtare janë integruar së tepërmi, duke rritur nivelin e rrezikut sistematik. Kur ndodh një luhataje në një pjesë të sistemit, ka shumë mundësi që kjo të përhapet në mënyrë të shpejtë.

Çdokush mund të supozojë se impakti i këtyre tre prirjeve është: “*Sa më i madh të jetë sistemi financiar, aq më i ndërlidhur dhe më i ndërlikuar bëhet ai*”.

Sektori financiar është i ndryshëm nga pjesa tjetër e ekonomisë, sepse ka karakteristika të brendshme që e bëjnë këtë sektor teorikisht më të prirur ndaj paqëndrueshmërisë financiare.

Duhet të kemi parasysh se:

- a) Është çështja e informacionit. Ata që kërkojnë hua mund të dinë shumë më tepër rreth situatës së tyre financiare, sesa ata që japin hua.
- b) Është problemi i rrezikut moral (Dowd, 2009). Thënia e famshme e Keynes se: “*në qoftë se i detyrohesh 100 paund bankës, është problemi yt, por kur i detyrohesh 1 milion paund atëherë*

⁵² Mishkin, F. (2008), ‘How should we respond to asset price bubbles?’

është problemi i bankës”, do të thotë se janë përpjekjet e bankës, ato që do të evitojnë falimentimin tënd.

- c) Ndërsa çështja fundit është përzgjedhja e pafavorshme. Shpesh përzgjedhja e një klienti bëhet në mënyrë rastësore ose sipas një “feeling”⁵³. Mund të ndodhë që për të patur fitim më të madh duhet të rrezikosh më tepër, gjë që shkakton paqëndrueshmëri në sistem.

Si pritët të ndikojë paqëndrueshmëria financiare mbi zhvillimin? Paqëndrueshmëria financiare, sipas Crockett (2000), humb konfidencën, e cila vlerësohet si një kusht parësor për zhvillim. Ajo shkakton edhe mbyllje institucionale, që pasohen me rënie të investimeve. Paqëndrueshmëria ndikon edhe në sektorin fiskal, duke rritur koston e veprimeve dhe shtuar problemet brenda sistemit të pagesave.

Si mund të veprohet në mënyrë që të zvogëlohet paqëndrueshmëria financiare? Dihet se qëndrueshmëria financiare është një e mirë publike. Kushdo mund të shijojë disa përfitime nga qëndrueshmëria financiare. Ky është një justifikim teorik për ndërhyrjen e domosdoshme të qeverisë, për të reduktuar dhe ruajtur tregun nga paqëndrueshmëria financiare⁵⁴. Një tjetër argument është se sektori financiar është i ndryshëm. Ai është subjekt i falimentimeve të tregut dhe këto lloj falimentimesh të përmendura si më sipër, justifikohen me ndërhyrjen e qeverisë. Për të forcuar qëndrueshmërinë financiare dikush mund të thotë, “lëreni tregun të qetë”. Ato institucione që nuk mund të ruajnë qëndrueshmëri dhe që nuk mund të përmbushin kontratat e tyre duhet janë të destinuara të mbyllen. Kuptohet qartë se për të ndaluar krizën, është e rëndësishme të kemi informacion të saktë si dhe një aftësi të mirë për të ndërhyrë në treg, në kohë reale.

2.8 Lidhja midis Bankës Qëndrore dhe qëndrueshmërisë financiare

Natyrshëm lindin disa pyetje: 1) A ekziston një “*trade-off*” midis qëndrueshmërisë monetare dhe asaj financiare? 2) A mundet që banka qëndrore të sigurojë qëndrueshmërinë financiare pa u ndikuar në arritjen e objektivave të saj tradicionale, kontrollin e çmimeve? 3) Është e drejtë t’i shtosh politikës monetare edhe objektivin e qëndrueshmërisë financiare? 4) Cilët janë instrumentat në dispozicion të autoriteteve të mbikqyrjes dhe bankës qëndrore për të siguruar qëndrueshmërinë financiare?

Gjatë viteve të fundit është dëshmuar se, për ekonomitë e përparuara dhe në një masë të vogël për ekonomitë më pak të përparuara, forcimi i procesit të rritjes së PBB-së dhe reduktimi i inflacionit, çojnë në një rritje të qëndrueshmërisë. Kombinimi i tyre sipas Bencivelli & Zaghini (2012) është

⁵³ ndjenjë

⁵⁴ Joseph E. Stiglitz, “Knowledge as a Global Public Good” in *Global Public Goods*

përcaktuar si “Moderim i Madh”. Cilat janë motivet që e bënë këtë situatë të favorshme ? Bazuar mbi literaturën për këtë çështje jepet një përgjigje figurative: “*Good Practice, Good Policies, or Good Luck*” (Ahmed *et al*, 2002)

Tre janë shpjegimet e mundshme për këtë periudhë.

- **“Good practice”**(*praktika të mira*): cilësohen si ndryshime strukturore të sistemit industrial, politikat më të mira të menaxhimit industrial, për shembull politikat “just in time”(në kohën e duhur), përmirësimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë (Quality Management), përmirësimi i sistemit operacional (Operations Management) dhe kur përdoret në kontekstin e prodhimit dhe shërbimit, të përmirësimit të teknologjive të reja.
- **“Good policies”**(*politika të mira*): Menaxhimi më i mirë i politikave ekonomike, me një konsensus të gjërë mbi politikën monetare .
- **“Good luck”**(*fat i mbarë*): Goditje të vogla nga oferta. Sipas kësaj, situata pozitive do të varej vetëm nga mungesa e goditjeve të pafavorshme .

Elementi i “*Good Practice*” është trajtuar kryesisht nga studiues të Operation Management. Janë dy arsye të dhëna, për të shpjeguar periudhën e “Moderimit të Madh” që mund të përmbliken : “Good Policies apo Good Luck?”. Clarida, Gali, Gertler (2000), Romer dhe Romer (2002), Cecchetti dhe të tjerë (2007) nënvizojnë rëndësinë e politikës monetare në periudhën e “Moderimit të Madh”. Besueshmëria e politikës monetare është arritur duke braktisur vizionin tepër optimist në lidhje me efektet e politikës monetare, e cila karakterizoi vitet ’60 dhe ’70 dhe gjeneroi një rritje të fortë mbi inflacionin. Mund të thuhet se në periudhën e “Moderimit të Madh” është bërë politikë monetare stabilizuese dhe vendimet e së cilës janë përmirësuar. Vlerësimet e këtyre politikave për vitet ’60 dhe ’70 tregojnë se, përgjigjia e politikës monetare po të mos ishte në gjendje të prodhonte një kufizim real ndaj inflacionit të tepërt, atëherë kjo politikë do ishte përcaktuar si destabilizuese (Bencivelli & Zaghini, 2012). Në të kundërt, vlerësimet për drejtimin e politikave monetare pas politikës monetare antiinflacioniste (Volcker, 2009) tregojnë një qëndrim të ndryshëm për t’a siguruar atë, pra që kjo politikë monetare të bëhet stabilizuese. Ky ndryshim në sjellje, ndihmon për të ndaluar rritjen e inflacionit duke prodhuar fenomene të stabilizimit që ndodhën gjatë periudhës së Moderimit të Madh. Teoria e “Moderimit të Madh” varet shumë nga përmirësimi i politikës monetare (Greenspan, Volcker). Ekonomistët (Luca Benati – BQE dhe Harron Mumtaz - Banka e Anglisë) kryen një analizë, ata kanë “transportuar në kohë” strategjitë monetare të disa bankierëve qëndrore dhe arritën në përfundimin se, zgjedhjet e politikës monetare të bëra nga ana e tyre edhe pse shumë të ndryshme, nuk do të kishin

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

sjellë një ndryshim të rëndësishëm të kuadrit ekonomik në periudhën e referimit⁵⁵. Ky rezultat është disi i çuditshëm, pasi nxjerr në pah një paradoks, “*sipas këtij kërkimi aftësitë e bankierëve qendrorë kanë pak ndikim mbi politikën monetare*”. Benati dhe Mumtaz (2007), kanë theksuar se inflacioni i madh ishte i lidhur në pjesën më të madhe të goditjes së kërkesës, pavarësisht ndikimit të politikës monetare. Në studimet e tyre, këta dy autorë i referohen një kërkimi të ngjashëm të bërë duke analizuar rastin e Britanisë së Madhe (Benati, 2007) dhe shpjegojnë se si ky shtet, ka pasur një zhvendosje nga episodi i “Inflacionit të Madh” në atë të “Moderimit të Madh”. Pra, është kaluar nga një situatë në të cilën politika monetare ishte konsideruar në thelb si e padobishme për qëllim të kontrollit të inflacionit në atë situatë ku instrumentat e politikës monetare u konsideruan si instrumenta vendimtare (Benati & Mumtaz, 2007). Bankat qendrore kanë arritur një “fitore” mbi inflacionin. “Moderimi i Madh”, përveç reduktimit të inflacionit, kishte edhe një ndikim të rëndësishëm në qëndrueshmërinë e çmimeve të pasurive të patundshme. Për qëndrueshmërinë financiare, çfarë mund të thuhet? A është e drejtë që politikës monetare t’i jepej si detyrë edhe objektivi i qëndrueshmërisë financiare? Përgjigjia ishte negative. Mendohej se banka qendrore, vetëm në bazën e rezultateve të shkëlqyera të “Moderimit të Madh”, dinte të kryente më së miri detyrën e saj të monitorimit të inflacionit dhe të stabilizimit të “output gap”. Sistemi financiar nga ana e tij, ka mekanizma të autokontrollit që sigurojnë mbulimin nga rreziqet. Ndodh që rreziqe të tilla vijnë “të ndara” në të gjithë sistemin dhe arrijnë ta bëjnë atë të padëmshëm (Benati & Mumtaz, 2007).

Një politikë monetare që ndjek ekskluzivisht indeksin e inflacionit të çmimeve të mallrave të konsumit dhe të output gap-it, duket sikur ka një përjasje shumë kufizuese. Pra, politika monetare duhet në fakt, të trajtojë çështjen e rritjes së paqëndrueshmërisë së çmimeve të aseteve, të cilat mund të çojnë në një situatë shumë të ndjeshme financiare dhe mund të kenë koston e një luhatjeje të inflacionit të output-it (Rabanal *et al*, 2009). Janet Yellen, shprehet se: kriza e fundit ka nxjerrë në pah lidhjen e ngushtë midis politikave monetare, ku nga njëra anë kishte si objektiv kryesor arritjen e nivelit maksimal të punësimit dhe të qëndrueshmërisë së çmimeve dhe nga ana tjetër detyrë kryesore e asaj politike u bë mbikqyrja e qëndrueshmërisë së sistemit financiar (Yellen, 2009). Aktualisht studiuesit kanë eksploruar mënyrat në të cilat, nga njëra anë politika monetare mund të luajë një rol të madh në menaxhimin e riskut sistematik, nga ana tjetër rregullorja mund të jetë e dobishme për të arritur objektivat makroekonomikë⁵⁶.

⁵⁵ “U.S. Evolving Macroeconomic Dynamics - A Structural Investigation” botuar nga BQE (Working Paper Series, April 2007).

⁵⁶ Bundesbank Symposium on Financial Stability and the Role of Central Banks (2008)

2.9 Politika monetare dhe qëndrueshmëria financiare

Tregjet financiare e kanë të domosdoshëm rolin e bankave qendrore në nxitjen e qëndrueshmërisë financiare. Në paragrafin e mëposhtëm përballemi me një pyetje vendimtare: *A është e drejtë të thuhet se qëndrueshmëria financiare duhet të jetë një objektivi i qartë i bankës qendrore, krahas objektivave të tjerë, si qëndrueshmëria e çmimeve dhe rritja ekonomike e qëndrueshme?*

Së pari, duke bërë një analizë mbi argumentin, duke studiuar lindjen dhe evolucionin e bankave qendrore mund të vëmë re sesi qëndrueshmëria financiare ka qenë konsideruar gjithmonë një objektivi themelor. Përgjigjia duhet të jetë: “për bankat qendrore si objektivi i tyre kryesor duhet të kenë objektivi i qëndrueshmërisë financiare”

Kriza e fundit ka treguar sesa i rëndësishëm është reagimi i menjëhershëm në rast të krizave, edhe nëpërmjet një fleksibiliteti të madh të aplikimit të rregullave të politikës monetare për të siguruar masa kundër kësaj krize dhe që instrumentat e politikës monetare, të jenë të mjaftueshëm për të përballuar të gjitha mundësitë natyrore, duke përfshirë edhe rastet e falimentimit të një sistemi të rëndësishëm financiar. Natyrshëm lind diskutimi që lidhet me vlerësimin e saktë të peshës që i duhet dhënë objektivit të qëndrueshmërisë financiare, në raport me objektivat e tjerë si kontrolli i qëndrueshmërisë së çmimeve, mbështetja e rritjes ekonomike. Sipas Schinasi (2004 e 2009) dhe Ferguson (2003) objektivi i qëndrueshmërisë financiare të bankës qendrore, duhet të ketë edhe dy aspekte plotësuese:

Së pari, lind nevoja që të ndiqet një politikë “*ex ante*”⁵⁷ për parandalimin e fenomeneve të paqëndrueshmërisë.

Së dyti, është i përshtatshëm një menaxhim i mirë i post-pasojave, atëherë kur tregjet janë të paqëndrueshme. Përsa i përket aspektit të parë, lind pyetja: Çfarë mund të bëjë një bankë qendrore? Ajo duhet të ndjekë objektivat e saj tradicionalë, që do të thotë të promovojë një mjedis makroekonomik të qëndrueshëm, të karakterizuar nga një inflacion i ulur dhe një rritje të qëndrueshme ekonomike (BIS, 2009b). Për të zbatuar një politikë monetare me synimin kryesor uljen e inflacionit, bankat qendrore duhet të jenë të përfshira edhe në aktivitetet të tjera si për shembull, në formulimin e ligjeve financiare ose zbatimin e mbikqyrjeve më efektive bankare (Schinasi, 2004).

Sipas Ferguson, (2003) në situatat e krizave, bankat qendrore mund të përdorin instrumentat themelorë, për të ndihmuar në zbutjen e presionit mbi likuiditetin dhe për të forcuar besimin e publikut. Presionet e likuiditetit mund të jenë përballuar nëpërmjet lidhjeve të linjave të drejtpërdrejta të kredive të institucioneve financiare në vështirësi (në rolin e tyre të huadhënies si zgjidhje në momentin e fundit).

⁵⁷ Kur rezultatet duhet të jenë të parashikuara në avancë

Instrumentat e politikës monetare përdoren për të reduktuar koeficientin e rezervës së detyrueshme dhe natyrisht në uljen e normave të interesit.

2.10 Instrumentat e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë ndaj qëndrueshmërisë finaciare në vend

Kriza globale e 2007, nxiti tërheqjen e depozitave nga bankat tregtare në Shqipëri dhe si rrjedhojë, pati mungesë likuiditeti në të gjithë sistemin bankar. Përdorimi i instrumentave të politikës monetare të BSH pati për qëllim administrimin e likuiditetit, duke synuar në orientimin e normave afatshkurtra të interesit rreth nivelit të normës bazë të interesit. Krahas këtij objekti këto instrumenta janë përdorur edhe për zhvillimin e tregut ndërbankar. Operacionet e tregut synojnë rritjen e efikasitetit të transmetimit të politikës monetare, nxitjen e aktivitetit në tregun ndërbankar dhe njëkohësisht, plotësimin e nevojave të tij (BSH, 2013). Kjo u reflektua në rritjen e normave të interesit dhe ngadalësimin e aktivitetit të bankave në tregun e parasë. Për të lehtësuar sistemin bankar në vend, BSH aplikoi ndryshime në disa prej instrumentave monetare të saj.

- Operacioni kryesor i tregut

Një nga instrumentat kryesorë për realizimin e operacioneve të tregut të hapur ishte dhe marrëveshja e riblerjes me maturim një javor. Për të administruar tepicën sezonale të likuiditetit të gjeneruar nga kthimi i parasë dhe nga fondet e buxhetit, BSH filloi të tërhiqte likuiditetet nëpërmjet marrëveshjes së riblerjes me maturim një javor (BSH, 2013).

- Operacionet e tregut të hapur

Operacionet e tregut të hapur janë operacione rregulluese dhe operacione strukturore. Operacionet e tregut të hapur janë operacionet bazë për administrimin e likuiditetit nga ana e bankës qendrore. Pra, dinamika e ngjarjeve të krizës, kërkoi përdorimin e të gjitha instrumenteve të tregut të hapur (BSH, 2013).

- Operacionet rregulluese të tregut

Në ndryshim nga operacioni kryesor i tregut, i cili përdoret me frekuencë javore, operacionet rregulluese të tregut përdoren me hark kohor të papërcaktuar. Kjo ndodh në situata të veçanta, kur lind nevoja për zbutje të luhatjeve të normave të interesit, të shkaktuara nga lëvizje të papritura dhe afatgjata të likuiditetit të sistemit (BSH, 2013).

- Operacionet strukturore të tregut

Këto lloj operacionesh përdoren në rastet kur lind nevoja për rregullime afatgjata të strukturës së likuiditetit, të cilat realizohen nëpërmjet blerjes ose shitjes të bonove të thesarit. Qëllimi kryesor i

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

këtyre operacioneve është rregullimi i strukturës së tregut. Në fillim të vitit 2008, Banka e Shqipërisë uli portofolin e saj të bonove të thesarit dhe në fund të po këtij viti BSH-ja organizoi pesë ankande për blerjen me të drejta të plota të bonove të thesarit nga bankat tregtare (BSH, 2013).

2.11 Interesi parësor i Bankave Qëndrore për qëndrueshmërinë financiare

Për një kohë të gjatë, bankat qëndrore kanë patur një interes të madh për qëndrueshmërinë financiare. Kjo vihet re kur paqëndrueshmëria financiare çon në një kërcënim serioz dhe mund të ndikojë në arritjen e objektivave të rëndësishme makroekonomike, në rritjen e prodhimit dhe nivelit të çmimeve. Pothuajse të gjithë bankat qëndrore, kanë fuqinë për të vepruar si huadhënës në rastet e krizave financiare. Ky funksion historik i bankave qëndrore, si një burim potencial i likuiditetit dhe ndihmës në raste emergjente, e kryer kjo nëpërmjet operacioneve të tregut të hapur ose nëpërmjet normës së refinancimit, bën të nevojshme që bankat, nga njëra anë të mbajnë nën kontroll tregjet për të vëzhguar shenjat e paqëndrueshmërisë dhe nga ana tjetër, të jenë të përgatitura për të zbatuar lëvizjet e nevojshme me qëllim sigurimin e likuiditeve.

Qëndrueshmëria financiare është një objektiv i rëndësishëm për të gjitha bankat qëndrore dhe ky objektiv është theksuar në forma dhe në shkallë të ndryshme në statutet e bankave qëndrore më të rëndësishme.

Tabela nr 2. Statuti i Bankës qëndrore dhe objektivi i stabilitetit financiar

Banka Qëndrore	Mbikqyrja Bankare	Objektivat
Banka e Anglisë	Financial Services Authority (FSA)	Banka e Anglisë ka si qëllim mirëmbajtjen e stabilitetit të çmimeve. Ajo ka edhe mbështetjen e Qeverisë së Mbretërisë, përta i përket objektivave të saj për rritjen ekonomike dhe të punësimit. Ekziston një memorandum i mirëkuptimit midis Bankës së Anglisë dhe qeverisë për të përcaktuar përgjegjësitë e bankës për stabilitetin financiar. Kjo i cakton Bankës së Anglisë përgjegjësitë në tri drejtime: a)Në stabilitetin e sistemit të infrastrukturave financiare, (pra në veçanti atë të sistemit të pagesave), b)në stabilitetin e sistemit monetar dhe c)në monitorimin e sistemit financiar në gjithë tërësinë e tij.
Banka e Japonisë		Objektivi i kësaj banke si një Bankë Qëndrore, është ai i emetimit të monedhës së ligjshme dhe të bëjë kontrollin e këmbimit të monedhës.” Banka Qëndrore ka si objektiv të garantojë rregull në likuiditet të fondeve midis bankave dhe institucioneve të tjera financiare, duke kontribuar

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

		<i>kështu në mirëmbajtjen e një sistemi të rregullt financiar.”</i> Kontrolli monetar dhe ai i këmbimit, nëpërmjet ndjekjes së stabilitetit të çmimeve, propozon qëllimin për të kontribuar në një zhvillim të shëndetshëm të ekonomisë kombëtare.
Banka Kanadeze	Office of the Superintendent of Financial Institutions (OSFI)	Të disiplinosh kreditë është paraja më e mirë me interes e jetës ekonomike të vëndit, për të kontrolluar dhe për të mbrojtur vlerën e jashtme të monedhës kombëtare dhe për të lehtësuar, në sajë të kontrollit të saj, luhatjet në nivel të përgjithshëm të prodhimit, tregtimit të çmimeve dhe të punësimit në përputhje me objektivat e politikës monetare dhe të nxisë mirëqënien ekonomike dhe financiare të Kanadasë.
Federal Reserve	Federal Deposit Insurance Corporation (FDIC), the Office of the Comptroller of the Currency (OCC)	Bordi i guvernatorëve të Federal Reserve System dhe Federal Open Market Committee, propozojnë qëllimin e rritjes së agregatëve monetare dhe mbajtjes për një periudhë afatgjate, si dhe të kreditit, të krahasueshme me potencialin për zgjerimin ekonomik afat gjatë, në mënyrë që të ndjekin qëllimet e punësimit, çmime stabile dhe norma interesi afatgjatë të moderuara.
Riksbank (Suedi)	Financial Supervisory Authority (FSA)	Objektivi i politikës monetare i Bankës Qëndrore Suedeze është mbajtja e stabilitetit të çmimeve. <i>“Pra, Banka Qëndrore e Suedisë të promovojë një sistem të pagesave efficient dhe të sigurt.”</i>
BQE	Nuk ekziston një njësi për kontrollin e stabilitetit financiar: Kontrolli i sistemit bankar i është besuar organizmave mbikqyrës të shteteve.	Objektivi kryesor i ESCB ⁵⁸ është mbajtja e stabilitetit të çmimeve. Përveç këtij objekti, ajo mbështet politikën ekonomike në tërësi në BE-së, për të kontribuar në realizimin e objektivave të Komunitetit. <i>“ESCB kontribuon në kryerjen sa më mirë të politikave të ndjekura nga autoritetet përgjegjëse për mbikqyrjen prudenciale të institucioneve të kreditit dhe të stabilitetit financiar”.</i> <i>“Detyra themelore që duhet të kryhet nëpërmjet ESCB, duhet të jetë : nxitja e një funksionimi të mirë të sistemit të pagesave.”</i>
Reserve Bank of New Zealand	Reserve Bank of New Zealand	Funksioni kryesor i Bankës është që të zbatojë një politikë monetare, që synon arritjen e objektivit të ruajtjes ekonomike stabilitetin dhe nivelit të përgjithshëm të çmimeve. <i>“Në formulimin dhe zbatimin e politikës monetare të bankës qëndrore, duhet të merret parasysh efikasiteti dhe fuqia e sistemit financiar”.</i>

Burimi : i përshtatur nga Ferguson (2003) dhe Haan (2007)

Tabela nr 2, tregon pjesë të rëndësishme të statuteve të ndryshme të disa bankave qëndrore. Teksti me shkronja të pjerrëta, tregon pasazhet që duhen për të siguruar një objektiv të qartë për bankat qëndrore në kërkim të qëndrueshmërisë financiare. Në shumë raste, referimet për qëndrueshmërinë financiare do të ulin kontrollin e integritetit të sistemit bankar dhe funksionimin efikas të sistemit të pagesave.

⁵⁸ European System of Central Banks

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Në tabelën nr 3 është paraqitur një kolonë, e cila tregon institucionet që merren në mënyrë specifike me arritjen e qëndrueshmërisë së sistemit bankar.

Tabela nr 3. Mbikqyrja bankare në vendet kryesore që adoptojnë monedhën e përbashkët europiane

BQE	Austria	Financial Market Authority (FMA)
	Luksemburgu	Commission de Surveillance du Secteur Finance (CSSF)
	Belgjika	Banking and Finance Commission (BFC)
	Finlanda	Financial Supervisory Authority
	Hollanda	De Nederlandsche Bank (DNB)
	Spanja	Banco de Espana
	Franca	Banque de France/Commission Bancaire
	Portogallia	Banco de Portugal
	Greqia	Bank of Greece
	Irlanda	Irish Financial Services Regulatory Authority (RA)
	Gjermania	BaFin
	Italia	Banca d'Italia

Bankat qendrore kombëtare, në 6 prej 17 shteteve të eurozonës, janë direkt përgjegjëse të mbikqyrjes prudenciale. Sipas Alessi (2012), krijimi i BE dhe BQE ka përfshirë nga njëra anë, transferimin e politikës monetare të shteteve anëtare të komunitetit dhe nga ana tjetër, ka theksuar nevojën e kombinimit të çentralizimit të politikës monetare, me ndarjen e kompetencave mbikqyrëse bankare dhe me heqjen e kufijve midis tregjeve, rritjen e konkurrencës midis ndërmjetësve financiarë dhe me praninë e rreziqeve të larta të krizës dhe përhapjes së saj. Rasti i Greqisë dëshmoi, se ishte e nevojshme ekzistenca e një institucioni, i cili të ishte në gjendje të jepte udhëzime më vlefshme të përgjithshme. Teksti final i Traktatit (Inal, 2010) duket në fakt i ndryshuar, në krahasim me qëllimet fillestare. Ai nga njëra anë, ngarkon Bordin Europian të Riskut Sistemik (ESCB), për të kontribuar më mirë në kryerjen e politikave të mbikqyrjes kujdesëse mbi institucionet e kreditit dhe të mbikqyrjes së qëndrueshmërisë në sistemin financiar, dhe nga ana tjetër, pranon kompetenca të gjera mbikqyrëse të Bankave Qendrore të Autoriteteve Kombëtare të disa vendeve, që adoptojnë një monedhë të vetme (Alessi, 2012).

Scheller (2006), shpjegon se kjo zgjidhje e ndërmjetme, larg idesë së “in medio stat virtus”⁵⁹, ka ndikuar në shfaqjen e disa paqartësive, të cilat kanë çuar në interpretime të ndryshme për përgjegjësitë e BQE mbi mbikqyrjen bankare, duke bërë që të lindë nevoja për të reflektuar mbi mundësinë e rishikimit të mundshëm të kuadrit rregullator të mbikqyrjes bankare, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel komunitar. Në shumë vende europiane është zbatuar një proces rishikimi i kontrolleve

⁵⁹ Aristotel :virtyti ndodhet midis zgjidhjesh

organizative mbi tregjet financiare. Po cili është modeli institucional, i aftë për të përballuar karakteristikat e reja të ndërmjetësimit, duke u fokusuar në veçanti, në ndarjen e përgjegjësisë midis autoriteteve të ndryshme, ose në përqëndrimin e një organizmi të vetëm me kompetenca mbikqyrëse? Sipas Scheller, (2006) rruga që duhet të ndiqet është duke forcuar pushtetin mbikqyrës të BQE-së me përgjegjësinë e ruajtjes së qëndrueshmërisë dhe mbrojtjes së transparencës së tregut.

2.12 “Trade off” midis qëndrueshmërisë financiare dhe objektivave të tjerë të Bankës Qëndrore

Siç është përmendur edhe më lart, qëndrueshmëria financiare mund të jetë një objektiv i rëndësishëm për bankat qëndrore, sidomos për ato që e konsiderojnë parësor objektivin e mbikqyrjes së qëndrueshmërisë së çmimeve. Problemi real nuk është nëse qëndrueshmëria financiare duhet të jetë ose jo objektiv i Bankës Qëndrore, por mënyra dhe pesha e rëndësisë që duhet t’i atribuohet arritjes së saj. Banka Qëndrore nga njëra anë, mund të fokusohet tërësisht mbi objektivin e qëndrueshmërisë së çmimeve, por jo duke u kujdesur për qëndrueshmërinë financiare vetëm kur kriza ka marrë zhvillim. Banka Qëndrore është e kujdesshme ndaj dukurisë së paqëndrueshmërinë financiare dhe e gatshme të zbatojë një politikë monetare “paraprake”, për të përballuar një situatë të tillë të mundshme. Mbështetësit e kësaj politike ndërhyrëse, Borio dhe Lowe (2002), të cilët duke argumentuar se çekuilibrimet financiare mund të zhvillohen edhe në periudha, kur çmimet janë stabël dhe kur niveli i të ardhurave është i afërt me potencialin, e gjykojnë saktë qasjen “ndërhyrëse” nga ana e një banke qëndrore, e cila duhet të ndjekë qëllimin për qëndrueshmërinë financiare (Hahm *et al* 2011).

Ka tre çështje, që lidhen me analizën e shkallës së ndërhyrjes për Bankat Qëndrore, për ndjekjen e objektivit të qëndrueshmërisë financiare. Problem kryesor është të kuptohet se si qëllimi i qëndrueshmërisë, mund të ndërveprojë me qëllimet e tjera të politikës monetare tradicionale.

Së pari, duhet t’i jepet një peshë objektivit në fjalë, i cili ndikon në drejtimin e politikës monetare për arritjen makroekonomike.

Së dyti, ka të bëjë me perceptimin nga ana e operatorëve të tregut, si dhe nga përpjekjet e bankës qëndrore në ndjekjen e objektivit të qëndrueshmërisë financiare, po ashtu edhe ndaj reagimeve të mundshme që këto përpjekje mund të japin. Duket se banka qëndrore, e cila adopton një qasje aktive në ndjekje të objektivit të qëndrueshmërisë financiare, mund të krijojë situatën e “moral hazard”⁶⁰.

⁶⁰ Rrezik moral është gjendja, në të cilën njëra palë përfshihet në një ngjarje me risk, duke e ditur se është e mbrojtur ndaj këtij risku dhe pala tjetër do të marrë përsipër koston. Të dyja palët kanë informacion jo të plotë në lidhje me njëri-tjetrin.

Së treti, është problem që një sjellje shumë “proaktive” e Bankës Qëndrore, e cila duke mbikqyrur qëndrueshmërinë financiare, mund të arrijë të rrisë luhatshmërinë e variablave makroekonomikë (Hahm *et al*, 2011).

- **Bashkëveprimi me objektiva të tjerë.**

Një tjetër çështje është stabilizimi i lidhjes midis peshës, që bankat qëndrore i caktojnë arritjes së qëndrueshmërisë financiare dhe peshës së objektivave të tjerë. Në shumë raste, kjo peshë nuk mund të jetë më e madhe se objektivi i qëndrueshmërisë financiare. P.sh., një “paralizë” e papritur në tregjet financiare, rrezikon të jetë e lidhur me një dobësim të kërkesës agregate. Në këtë rast, ndjekja e objektivave “tradicionale” të politikës monetare dhe arritjes së qëndrueshmërisë janë pothuajse në marrëveshje dhe të dyja justifikojnë miratimin e politikave stimuluese, duke ulur normën e interesit. Një rritje e panevojshme e disponibilitetit në ofertën e kredisë mund të jetë e shoqëruar dhe nga një rritje të prodhimit. Vlerësimet mbi qëndrueshmërinë financiare, që kanë tendencë për të mbështetur zbatimin e një politike monetare shtrënguese, janë të justifikuar, në rradhë të parë, nga arritja e objektivit të stabilizimit të objektivit makroekonomik dhe të *output gap* (Hahm *et al*, 2011).

Disa studiues kanë theksuar mundësinë e një *trade off* midis arritjes së objektivave tradicionalë makroekonomikë dhe ndjekjes së qëndrueshmërisë financiare. Një interes tepruar për qëndrueshmërinë e tregjeve financiarë, mund t’a bëjë më të vështirë edhe veprimin e politikës monetare të bankës qëndrore, që synon të mbrojë qëndrueshmërinë e çmimeve ose të minimizojë *output gap*.

2.13 Veprimet destabilizuese të shkaktuara nga zgjedhje aksidentale të politikës monetare

Një problem tjetër, lidhur me qasjen “aktive” të bankës qëndrore për synimin e qëndrueshmërisë financiare, është mundësia që ajo mund të kontribuojë si e paqëllimshme në ndryshueshmërinë e variablave makroekonomikë. Sipas Friedman (1968)⁶¹, kur ndikimi i veprimeve të politikës monetare është i pasigurt, atëherë një politikë monetare shumë “ndërhyrëse”, çon në uljen e luhatjeve të output-it, por mund të ndodhë që të çojë lehtësisht edhe në efektin e kundërt. Autorë, si Borio dhe Lowe (2002), pretendojnë se banka qëndrore mund të jetë në gjendje të ndërmarrë masa për të bërë të mundur plasjen e flluskave të ardhshme, në mënyrë që të parandalojë pasojat e rënda që mund të shkaktohen. Bankat qëndrore, duhet të shkojnë kundër rrymës deri në atë masë, sa shtrembërime të tilla në çmimet aseteve

Kjo ndodh kur huamarrësi e di se dikush tjetër do të paguajë për gabimin që ai bën. Kjo nga ana e tij i jep motivim për të vepruar në një mënyrë të rrezikshme. Ky koncept ekonomik është i njohur si rrezik moral.

⁶¹ Friedman, Milton, 1968, “The Role of Monetary Policy”, American Economic Review.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

mund të çojnë në një ndikim negativ mbi mundësitë e rritjes së inflacionit dhe të output gap. Zbatimi në praktikë i kësaj metode “ndërhyrëse” dhe e përkthyer ndryshe si një politikë “monetare efikase”, në pamje të parë duket shumë problematike, për shkak të numrit të variablave të përfshirë dhe kompleksitetit të problemit. Edhe pse mund të arrihet të identifikohet një flluskë, për të kalibruar veprimet e politikës monetare të nevojshme në mënyrë që të bëjë të mundur shpërthimin e saj pa shkatuar dëme serioze për ekonominë reale, mund të rezultojë jashtëzakonisht e ndërlikuar.

- Politika monetare dhe flluskat spekulative. Si mund të ndërhyhet?

Në këtë pjesë, do synojmë të kuptojmë lidhjen që ekziston ndërmjet formimit të flluskave spekulative dhe situatave të disekuilibrave financiarë, gjithashtu edhe mundësitë e ndërhyrjes së politikës monetare. Mund të themi që politika monetare reagon ndryshe, në varësi të faktit nëse situata është normale (objektivi i qëndrueshmërisë së çmimeve) dhe sigurisht, që ka tjetër ndikim dhe sjellje, kur situata është jashtë normalitetit, si edhe e karakterizuar nga zhbalancimet financiare.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet një skemë, e cila është më e zbatueshme në ndërhyrjet e FED (Federal Reserve) dhe ndërhyrjet e Bankës Qëndrore Europiane (BQE).

Tabela nr 4. Politika monetare në situatë normale dhe në situatë paqëndrueshmërie.

Politika monetare	Në situatë krize financiare	Në situatë normale
Lloji i politikës	Elastike; E shpejtë; E vendosur	Koherente në kohë; Pritjeje; Të ngadaltë
Informacioni përkatës	Të dhëna financiare mbi formimin e çekulibrit	Inflacioni; rritja ekonomike
Horizonti strategjik	Periudha: e shkurtër dhe shumë e shpejtë	Periudha: e mesme; e gjatë
Drejtimi dhe dimension i ndërhyrjeve	Preferohet një zgjerim i tepërt, sesa një zgjerim i pamjaftueshëm	E shtrirë ose kufizuese, por e përshtatur gjithmonë për nevojat aktuale.

- Çfarë është flluska spekulative?

Flluska spekulative, zakonisht shkaktohet nga pritshmëritë e larta për zhvillim në të ardhmen. Gjithashtu, edhe nga vlerësimet e çmimeve ose faktorë të tjerë, të cilët mund të shkaktojnë rritje në vlerat e aseteve. Kjo bën që të rritet volumi i tregtisë dhe të ketë më shumë blerës se shitës, investitorët kanë pritshmëri të larta dhe ndodh që çmimet rriten më shumë se sa vlera e sygjëruar nga analizat objektive⁶². Një flluskë spekulative identifikohet si rezultat i një mosvazhdimësie teknologjike ose ekonomike. Dukuria vazhdon të përhapet deri kur një ndryshim i situatës ekonomike, prodhon një valë skepticizmi ndërmjet investitorëve, të cilët gjatë kësaj faze ndryshojnë, duke provokuar kështu

⁶² (online economic dictionary: www.investopedia.com)

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

shpërthimin e fluskës. Sipas Garber, (2000) problemi është i vështirë për t'u zgjidhur, pasi të shpërthesh në mënyrë artificiale një fluskë është një operacion, i cili mund të jetë i dëmshëm ose praktikisht i pamundur. Me ndihmën e mjeteve dhe të instrumentave, në dispozicion të bankës qendrore, fluskat e krijuara brenda sistemit bankar, mund të jenë më të lehta për t'u menaxhuar. Bankierët qendrorë studiojnë rritjen e kreditit dhe duhet të jenë në gjendje të interpretojnë situatën, si dhe të jenë të aftë për të ndërhyrë në kohë.⁶³

Ortodoksia mbizotëruese deri pak vite më parë, lidhur me këtë pikë, prirej në fakt të përjashtonte ndërhyrjen e bankës qendrore, për të qeverisur dukurinë e ndryshimit të çmimit të aktiveve financiare dhe reale, e sqaruar kjo, edhe në artikullin e Bernanke-Gertler (2001), të cilët thonë se, për të vënë në përdorim politikën monetare për të shfryrë fluskat spekulative, duhet bërë një ndërhyrje neurokirurgjikale, ku në vend të bisturisë të përdoret një sharrë elektrike. Mendimi i përbashkët para krizës ishte se, banka qendrore, nuk duhej të reagoje apo ndërhynte në lëvizjet e çmimeve por vetëm atëherë, kur inflacioni kishte një impakt të drejtpërdrejtë mbi parashikimet e rritjes së tij ose të *output gap*. Pra, banka qendrore duhet të jetë e gatshme të ndërhyjë vetëm në rast se, një rënie e çmimeve të disa mallrave, do të kërcënonte aftësinë e saj për të përmbushur objektivat e saj ligjore të kontrollit të inflacionit dhe të stabilizimit të *outputit gap*.⁶⁴

Teoria tradicionale e mosndërhyrjes së bankave qendrore në përgjigje të formimit të fluskave spekulative, bazohet në dy pika kryesore:

Së pari: politika monetare shfaqet si një instrument “i paaftë” për të plasur fluskat në mënyrë efektive, sidomos ato fluska që kanë të bëjnë me një zonë specifike të tregjeve financiare, si p.sh. është rasti i një rritjeje të tepërt të çmimit të aksioneve të teknologjisë ose duke marrë edhe rastin real siç edhe ndodhi, që ishte rritja e çmimeve të shtëpive në zona të caktuara.

Së dyti: është pothuajse e pamundur për të përcaktuar saktë, nëse çmimi i një aktiviteti financiar është mbi vlerën e tij themelore.

Një konsideratë e tillë për politikën monetare lind nga fakti, se ajo, duke patur në dispozicion instrumentin e ndryshimit të normës së interesit, nuk mund të jetë “e kalibruar” me saktësi në rastet kur në dukje jemi afër një rreziku real. Politika monetare mund të ketë ndikim vetëm mbi variabla të tjerë financiarë dhe makroekonomikë, kjo është edhe arsyeja që e bën këtë politikë të jetë e kufizuar.

⁶³ (Rosser, 2000)

⁶⁴ J.M Keynes “What is Money”? *The economic journal*

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Tabela nr 5. Përdorimi i politikës monetare për të korrigjuar çekuilibrat financiarë

Përdorimi i politikës monetare për të korrigjuar çekuilibrat financiarë	
Kundërshtimet	Përgjigjet
Vështirësi për të kalibruar politikën monetare: - Nga njëra anë, një rritje e vogël e normës së interesit mund të mos jetë e mjaftueshme. Nëse banka qendrore bën një politikë shtrënguese të pamjaftueshme dhe çmimet e aseteve vazhdojnë të rriten, atëherë është rreziku i humbjes së besueshmërisë së bankës qendrore, që ka falimentuar (Yamaguchi, 1999) si dhe me një nxitje për një “eufori të shfrenuar” (Greenspan, 1996), pra një besim jo i kushtëzuar mbi qëndrueshmërinë e bumit për një kohë të gjatë. - Nga ana tjetër, një rritje e normave të interesit mund të çojë në një shtrëngim të politikës monetare me efekte negative, duke shkaktuar shpërthimin e flluskës (hard lending), si dhe të çojë ekonominë në recesion.	- Ky është një kundërshtim paksa i fortë, ku mund t’i jepet përgjigje, por i duhet referuar asimetrisë në kostot e gabimeve të politikës monetare. - Nëse rritja ekonomike është e mjaftueshme dhe bumi nuk është i fortë, mund të ndodhë që veprimet e politikës monetare të kenë efekt të kundërt, pra të kundërshtojnë këtë rritje, në këtë pikë, kjo politikë duket e paefektshme.
- Një përpjekje për t’iu përgjigjur këtyre çekuilibrave, mund të çojë në rritje të padëshiruar të paqëndrueshmërisë së variablave ekonomike (Bernanke Gertler, 2001). - Autoritet monetare nuk janë në gjendje të njohin çekuilibrat financiarë në kohën e duhur për të mundësuar veprimin në terren me mjetet parandaluese. - Ekziston një vështirësi reale në përcaktimin e rinjohjes së flluskave spekulative, kur ajo është duke u formuar.	- Problemi i identifikimit të çekuilibrit financiar të pranishëm, po trajtohet shpesh edhe në literaturë. - Borio dhe Lowe (2004) përcaktojnë dy tregues që janë në gjendje për të parashikuar episode të krizës bankare mbi bazën e rregullimit, krahasuar me trendin: çmimi aksioneve në raport me kredinë e sektorit privat. - Analizat empirike të kryera nga (Borio & Lowe 2002) na lejojnë të përcaktojmë një sërë kushtesh për të cilat mund të zhvillohen çekuilibrat: rritja e tepruar e kreditit dhe e shkallës së levës së ndërmjetësive janë një vazhdueshmëri që ka karakterizuar periudhën paraardhëse të të gjitha krizave.
Edhe pse është e mundshme nga pikëpamja teorike, një përgjigje e politikës monetare do të jetë e vështirë për t’u kuptuar nga publiku. Një bankë qendrore që rrit normat e interesit në mungesë të presioneve inflacioniste të dukshme, por vetëm mbi bazën e një rreziku të ardhshëm të krizës financiare duke bërë kështu që të shpërthejë flluska që po formohet.	Banka qendrore duhet të ketë autoritetin e nevojshëm për të justifikuar veprimet e tyre dhe duhet të ketë mandate të qartë për të kontrolluar qëndrueshmërinë financiare. Gjithashtu, ajo duhet të sigurojë një transparencë të mjaftueshme në vendimet e politikës monetare

Burimi: Burimi: www.bis.org

Si pasojë e krizës, ka shumë raste që bankat qendrore duhet të jenë më aktive në përgjigje të sinjaleve që tregojnë formimin e një flluske spekulative. Ky nocion është përshkruar shpesh si një domosdoshmëri për të shkuar drejt flluskës⁶⁵, me arsyen se banka qendrore duhet të ndërhyjë për të ulur çmimet e aseteve, kur sipas standarteve historike shfaqeshin shumë të larta. Për më tepër, ky është një opinion për pjesën më të madhe të studiuesve, ekonomistëve dhe pjesëmarrësve të tregut. Sipas opinionit të tyre, duhet që autoritetet që mbikqyrin sistemin bankar, të mos kufizohen vetëm në rregullin duke përdorur “rubinetin” e kostos së parasë dhe të sasisë së monedhës, por edhe duhet të marrin në konsideratë disponibilitetin e operatorëve për të siguruar burime.

Mbikqyrja duhet të frenojë ato banka të cilat kanë hapur “rubinetin” e kredisë, nga ana tjetër duhet të stimulojë këto banka se kur duhet t’i mbyllin. Pra, bëhet fjalë për të implementuar indikatorë të përshtatshëm likuiditeti (“liquidity coverage ratio”), që kërkohen nga bankat, për të mbajtur asete likuide të nevojshme, për të përballuar situata stresi financiare dhe të jenë në gjendje të kontrollojnë lëvrimin e kredisë. Nga shpjegimi që Rosser (2000) bën, një element tjetër i rëndësishëm është edhe adoptimi i kërkesave të kapitalizimit të bankave, duke i detyruar që të plotësojnë rezervat e tyre, kur ekonomia është në lulëzim, duke mos dekurajuar huazimin e burimeve të reja të një sistemi ekonomik dhe financiar, që është duke u rritur me shpejtësi dhe që shihet i fortë. Sipas shumë studiuesve, nëse politikat e rregullimit makroprudenciale, zbatohen në kohë, atëherë ato janë edhe më premtuese. Përveç kuadrit të rregullimit makroprudencial, bankat qendrore kanë në dispozicion disa instrumenta të politikës monetare, të cilat mundën pjesërisht të sigurojnë arritjen e qëndrueshmërisë financiare nëpërmjet kontrollit të çmimeve të aseteve.

2.14 Një shpjegim teorik i paqëndrueshmërisë financiare

Bernanke & Gertler (1987)⁶⁶ e përcaktojnë brishtësinë financiare, një shpërthim të një krizë të vërtetë financiare, si një situatë në të cilën huamarrësit potencialë, kanë një vlerë të pasurisë së tyre neto shumë herë më pak sesa madhësia e projekteve investuese, ku ata dëshirojnë të implementojnë.

Për të kapërcyer këtë situatë, huamarrësit e rrisin shumë rëndësinë e projektit, në mënyrë që të arrijnë kreditimin e nevojshëm, që faktikisht, duke supozuar edhe në rastet më të këqija nëse investimi

⁶⁵ “lean against the bubble”. Kjo shprehje u kundërshtua nga Charles L. Evans, Presidenti i FED Chicago, pra për të nxitur politika monetare që synojnë arritjen e një reduktimi të caktuar në çmimet e aseteve. Në të kundërt, sipas ekonomistit amerikan, objektivi i ndërhyrjes nuk duhet të jetë ai që ul të gjitha kostot e çmimeve të aseteve për të siguruar që bollëku i tepruar në tregjet financiare nuk duhet të paraqesë kërcenim për sistemin financiar.

⁶⁶ “Financial Fragility and Economic Performance,”

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

dështon, ata nuk janë në gjendje të ripagujnë me pasuritë e tyre (kolaterali i lënë) dhe jo me tepër me të ardhurat nga vetë projekti. Kjo situatë, e cila potencialisht mund të degradojë deri në një krizë financiare, rezulton me kosto të larta, me rritje të rrezikut të kredisë, rritje të kostove të shërbimit si edhe me rritje të detyrimeve dhe tarifave financiare të papaguara nëpër banka, etj.

Crockett (1997)⁶⁷ përcakton paqëndrueshmërinë financiare si një situatë, në të cilën performancat e mira ekonomike reduktohen nga luhatjet e çmimeve të aseteve financiare si dhe nga aftësia e ndërmjetësve financiare, për të përmbushur detyrimet e tyre kontraktuale.

Crockett përqendrohet në disa të këtij përkufizimi.

Së pari, paqëndrueshmëria financiare është e karakterizuar nga kostot ekonomike (mbi ekonominë reale).

Së dyti, shqetësimet janë fokusuar më shumë në dëmin potencial, sesa në atë aktual.

Së treti, autori shpreh konceptin e riskut sistematik⁶⁸ dhe të ndërlidhjes, që do jetë baza e kontributit të saj, në lidhje me konceptin “makroprudenciale” (Crockett, 2000). Ky përkufizim, lejon të arsyetojmë se të gjitha institucionet që kanë ekspozime të mëdha dhe që janë ndërlidhur gjerësisht, pa marrë parasysh faktin se ato janë përfshirë drejtpërdrejtë në sistemin e pagesave, mund të shkaktojnë dëme në sistem në rast falimentimi (Crockett, 1997).

Bernanke & Gertler (1999) lidhin situatën e paqëndrueshmërisë financiare me luhatshmërinë e çmimeve të aseteve, e cila shkakton luhatshmëri tek çmimet, krahasimisht me vlerën e tyre fillestare, përpara se të plasë spontanisht flluska spekulative. Duke u përqendruar në nxitjen e paqëndrueshmërisë financiare, Mishkin (1999) e përcakton si një përkeqësim të efikasitetit të sistemit financiar aftësinë e tij të shpërndarjes së burimeve efikase, e përcaktuar kjo, nga një përkeqësim i kushteve të pashmangshme të funksionimit të sistemit dhe të një përzgjedhje të pafavorshme (moral hazard).

Allen dhe Gale (2000), në studimet e tyre, kanë krahasuar krizat financiare, të cilat kanë ndodhur në disa vende të industrializuara (Japoni, Norvegji), si edhe në vende në zhvillim (Meksikë), duke shpjeguar se kriza ndjek një rrugë të karakterizuar nga tre faza:

Faza e parë, është përbërë nga periudha e risive, e liberalizimit financiar ose nga vendimet e bankës qendrore për rritjen e kreditimit nëpërmjet eliminimit të koeficientit të rezervës obligatore. Pra, po përjetohet një fazë e tejzgjatur e rritjes së çmimit të aseteve dhe në përgjithësi e një rritjeje të aktivitetit

⁶⁷ Crockett National Bank

⁶⁸ Risku sistematik është një risk të cilit një ngjarje i shkakton humbje të besimit në një pjesë kryesore të sistemit financiar, që ka pasoja serioze për ekonominë reale (G-10 report on financial sector consolidation, 2001)

të ekonomisë reale. Kjo mund të jetë një nga mundësitë e krijimit të një flluske spekulative e paracaktuar për të shpërthyer (Allen dhe Gale, 2000).

Faza e dytë, është edhe momenti kur ndodh shpërthimi i flluskës, si edhe rënia në një kohë shumë të shkurtër e çmimit të aseteve.

Faza e tretë, është e karakterizuar nga falimentimet, të cilat ndodhin në institucionet financiare tepër të dobëta. Falimentime të tilla mund të kenë një efekt sistemik, duke bërë kështu transferimin e krizës në sektorin real të ekonomisë.

Ferguson (2003) e përcakton paqëndrueshmërinë financiare si një situatë e karakterizuar nga tre elementë:

- Disa *asset class*⁶⁹ të rëndësishme, pësojnë luhatje të forta negative. Kështu formohet një flluskë spekulative e cila fryn çmimet e titujve dhe në një moment të dytë, luhatjet janë në drejtim të kundërt. Kjo shoqërohet edhe me një rënie të fortë të vlerave të titujve .
- Disponibiliteti i kreditimit reduktohet në mënyrë drastike, si në tregun e brendshëm, ashtu dhe në atë të jashtëm.
- Manifestohet një shmangie e konsiderueshme e ofertës agregate, në krahasim me kërkesën.

Një tjetër përkufizim interesant është edhe ai i FMN (IMF, 2003), që fokusohet në disa tipe të ndryshme “arriti”, që mund të karakterizojnë një sistem financiar. Ai përkufizon periudhat e paqëndrueshmërisë financiare, si periudha krizash të tregjeve financiare, ku aftësia e sistemit rezulton e dobët për të siguruar një rregullim të funksionimit, duke preferuar në këtë mënyrë, që të transferojë rreziqet. Nëse kriza transferohet në tregun e mallrave dhe të ekonomisë reale, ndodh që të sjellë kështu një reduktim të “output-it”. Për Schinasi (2004)⁷⁰, një sistem financiar lehtëson ecurinë e ekonomisë, e cila është në gjendje të përballojë çekuilibrat financiarë të brendshëm ose të jashtëm. Sipas Schinasi, qëndrueshmëria financiare bën të mundur që: 1) të vlerësojë, të alokojë dhe të menaxhojë riskun financiar, 2) të lehtësojë alokimin efikas të burimeve financiare në aspektin hapësinor, si dhe të krijojë ndikime nga akumulimi i pasurisë në rritjen e ekonomisë dhe të zhvillimit social. Allen dhe Wood (2006) kanë një përcaktim tjetër interesant. Ata veçojnë disa karakteristika të paqëndrueshmërisë financiare, duke u fokusuar mbi dy aspekte thelbësore, nga njëra anë, mungesa e besimit midis ndërmjetësve financiarë dhe publikut dhe nga ana tjetër, kritika për idenë e efikasitetit brenda përkufizimit të qëndrueshmërisë financiare. Përsa i përket debatit për mungesën e besimit

⁶⁹ Asset class: një grup asetesh që kanë karakteristika të ngjashme, sillen në mënyrë të ngjashme në treg dhe janë nën të njëjtat ligjesh dhe rregullash (www.investopedia.com)

⁷⁰ International Monetary Fund (2004)

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

ndërmjet publikut dhe ndërmjetësve financiarë, e cila mund të çojë deri në bllokim të sistemit të pagesave, Allen & Wood janë dakord me deklaratën e Schwartz (1986), i cili jep këtë përkufizim të krizës financiare: *“një krizë financiare ushqehet nga frika e pamundësisë së pagesave të çfarëdo lloj vlere, e cila i detyron bankat të ndërmarrin veprime mbi bazën monetare”*.

Mishkin (1991) dhe Issing (2003) e përcaktojnë qëndrueshmërinë financiare kur: *“një sistemi financiar, i cili është në gjendje të sigurojë në një mënyrë të qëndrueshme dhe pa ndërprerje të mëdha një shpërndarje efikase të kursimeve drejt projekteve të investimeve fitimprurese”*. Allen dhe Wood, shprehen se në shumicën e rasteve, nuk është e mundur të bësh gjykime pozitive mbi projektin e investimeve, përderisa ai nuk ka përfunduar, por edhe pasi ai të ketë përfunduar, mund të ketë kundërshtime në lidhje me rezultatin aktual të projektit të investimit. Të gjitha përkufizimet e tjera rreth qëndrueshmërisë financiare, na rikthejnë edhe njëherë, në aftësinë e këtij sistemi për të alokuar burimet e tij drejt projekteve fitimprurese të investimeve. E parë nga një tjetër këndvështrim, efikasiteti i alokimit të burimeve nuk është një element themelor i karakteristikës së brëndshme të qëndrueshmërisë financiare, por mund të shihet si një pasojë e qëndrueshmërisë financiare⁷¹. Mund të ndodhë që pasuritë financiare të shkojnë drejt titujve të mbivlerësuar dhe që sistemi të jetë në gjendje të alokojë në mënyrë eficiente burimet drejt projekteve të investimeve dhe në kushte të një pasigurie mbi të ardhmen, të vlerësohen sot për sot, më fitimprurëse (Allen dhe Wood, 2006). Kriza ekonomiko-financiare e viteve 2007-2013, i përballi politikat monetare me sfida të reja, në lidhjet dhe implikimet që ato kanë me qëndrueshmërinë financiare në përgjithësi si dhe me politikat e menaxhimit të borxheve e deficiteve buxhetore, në veçanti. Një nga pyetjet që shtrohet ndaj politikave monetare : a duhet që politikat monetare të luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare, zvogëlimin e efekteve negative të borxheve sovraane dhe përmirësimit të shëndetit ekonomik në përgjithësi? ⁷² Për momentin, ky është një debat teorik e akademik shumë prezent në mjediset shkencore. Përpara krizës financiare kishte një konsensus pothuajse absolut për fushën e veprimit dhe detyrave të politikave monetare, ndërkohë që për periudhën pas-krize, lidhjet ndërmjet politikave monetare dhe qëndrueshmërisë financiare janë akoma duke u studiuar dhe analizuar. Ekspertët e shpjegojnë këtë me faktin se ekonomitë e vendeve të zhvilluara, gjatë gjysmës së dytë të shek. XX-të, asnjëherë nuk u përballën me një krizë financiare të ngjashme me krizën e 2007. Ekonomitë e këtyre vendeve kaluan nga periudha e inflacionit të lartë dhe stagflacionit të viteve ‘70, në një periudhë dezinflacioniste në

⁷¹ Andrew Crockett (BIS management speeches 2000)

⁷² Frederic S. Mishkin Monetary policy strategy: Lessons from the crisis.(NATIONAL BUREAU OF ECONOMIC RESEARCH February 2011)

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

vitet '80, duke arritur në konkluzionin se: “dezinflacioni nuk kishte prodhuar rritje ekonomike të qëndrueshme dhe zvogëlim të papunësisë, por në të kundërt, kishte çuar në një paqëndrueshmëri monetare me pasoja negative për rritjen dhe punësimin”⁷³. Përtej debateve mbi efektet e favorshme makroekonomike të kësaj periudhe, mbi ndikimin e ristrukturimit të mjaft ekonomive, apo përmirësimin e teknikave të drejtimit, duket se ka një konsensus të gjerë në lidhje me efektin pozitiv të politikave monetare të ndjekura në këtë periudhë (Svensson, 2009).

Së pari: objektivi i qëndrueshmërisë së çmimeve nuk ka kosto të ndjeshme për aktivitetin ekonomik, ndërkohë që politikat monetare që kishin synuar rritjen ekonomike kundrejt çmimit të një inflacioni të lartë, kishin dështuar.

Së dyti: evolucioni afatgjatë i inflacionit ishte përcaktuar nga politikat monetare të aplikuara të cilat kishin si objektiv kryesor “qëndrueshmërinë e çmimeve”. Ideja, se kontributi më i mirë që politika monetare mund të japë për rritjen ekonomike dhe punësimin, ishte siguri i qëndrueshmërisë së çmimeve, i cili tashmë kishte triumfuar. Bankat qendrore ishin orientuar më shumë drejt “flexible inflation targeting”(inflacioni fleksibël i synuar), në vënd që të zbatonin një “strict inflation targeting” (inflacioni strikt i synuar) (Svensson, 2009).

Së treti, efekti pozitiv i premtimeve dhe besimit tek bankat qendrore, se ato do t’i qëndronin strikt objektivit të qëndrueshmërisë së çmimeve.

Së katërti, konsensusi se bankat qendrore kishin nevojë për një kuadër ligjor dhe institucional të qëndrueshëm, që të forconte autoritetin dhe besueshmërinë e politikave monetare si dhe përqëndrimin e tyre vetëm tek objektivi i qëndrueshmërisë së çmimeve (Svensson, 2009).

Shkaqet e paqëndrueshmërisë financiare janë të ndryshme. Në fakt, politikat makroprudenciale efikase, lehtësojnë fushën e veprimit të politikave monetare, duke i shmangur atyre implikimin në objektivat shtesë. Bankat qendrore, në analizat për vendimarrjet e tyre në politikat monetare, duhet të marrin parasysh elementët që shkaktojnë çekuilibra financiarë, pasi kriza e fundit tregoi se rreziqet e qëndrueshmërisë financiare janë gjithashtu, edhe rreziqe të qëndrueshmërisë së çmimeve. Kjo nënkupton zgjerim të horizontit të politikave monetare dhe një ndryshim në komunikimin e tyre, në raport me publikun dhe aktorët ekonomikë.⁷⁴ Në ambjentin e ekspertëve të politikave monetare dhe bankave qendrore po fillon të zerë vënd mendimi se, për të siguruar qëndrueshmërinë financiare duhen forcuar politikat kujdesëse dhe makroprudenciale, të cilat kufizojnë risqet sistemike, që burojnë

⁷³ Macroeconomic Policy and Poverty Reduction (IMF 2001)

⁷⁴ G.Galati (Macroprudential policy ,BIS 2011)

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

kryesisht nga ndërveprimi dhe ndërlidhjet midis institucioneve të sistemit financiar dhe pjesës tjetër të sistemit ekonomik.

Para shpërthimit të krizës, ekzistonte një konsensus i gjerë për lidhjet ndërmjet politikave monetare dhe qëndrueshmërisë financiare, pasi duke siguruar qëndrueshmërinë e çmimeve politika monetare ndihmonte drejtpërdrejt edhe në qëndrueshmërinë financiare, se qëndrueshmëria financiare lehtësonte transmetimin e politikës monetare, e cila nuk ishte tronditur asnjëherë, si në rastin e krizës financiare 2007-2013⁷⁵.

Dy dekada përpara krizës financiare, u shfaqën si një *“koeçidencë hyjnore”*⁷⁶, në të cilën politika monetare e fokusuar tek qëndrueshmëria e çmimeve dhe niveli i inflacionit mjaftonte tërësisht, për të siguruar qëndrueshmërinë financiare dhe makroekonomike. Autorë si Svensson (2013), shkojnë akoma më larg, kur nënvizojnë se, politikat monetare relaksuese e akomoduese ishin ato që mbollën farën e krizës financiare globale dhe stimuluan aventurat drejt rreziqeve të mëdha të ndërmjetësve apo derivativëve financiarë. Objektivi i qëndrueshmërisë së çmimeve ishte një kusht i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm, për të siguruar qëndrueshmërinë financiare, pasi qëndrueshmëria financiare përfitonte më shumë nga politikat kujdesëse të rregullimit dhe kontrollit, sesa nga politikat monetare. Debatimi më i madh zhvillohej për faktin nëse, politika monetare duhej të merrte parasysh apo të shpërfillte çështjen e çmimit të aktiveve dhe nëse po, në çfarë formash dhe me çfarë mënyrash?

Një kategori ekspertësh, mbronin idenë se, çmimet e aktiveve apo variablave të tjerë financiarë duhet të merreshin parasysh nga politikat monetare, vetëm në rastet kur ato krijojnë ndërlidhje në ecurinë e inflacionit në periudha më të shkurtëra se dy vjet, të cilat mbulonin vendimet bazë të politikave monetare⁷⁷. Pra, ato nuk mund të ishin objektiva specifike, por thjesht indikatorë që merreshin në konsideratë nga bankat qendrore kur bënin parashikimin e inflacionit dhe rritjes, pasi flluskat financiare ishin të vështira të identifikoheshin në kohë reale dhe se këto flluska nuk krijojnë detyrimisht paqëndrueshmëri financiare apo fluktuacione makroekonomike të rëndësishme.

Ekspertë të tjerë mbronin idenë se, bankat qendrore duhej të merrnin parasysh çmimet e aktiveve dhe çekuilibrat financiarë, edhe përtej implikimeve që këto mund të kishin mbi inflacionin, pra për periudha më të gjata se 2 vjet⁷⁸. Ata e vinin theksin tek pasojat negative makroekonomike, që mund të shkaktoheshin nga shpërthimi i flluskave financiare, duke u përpjekur të frenohen ngritjet e çmimeve të

⁷⁵ Osinski, Jacek, Katherine Seal, and Lex Hoogduin “Macroprudential and Microprudential Policies: Toward Cohabitation,” (IMF, 2013a)

⁷⁶ La note d’analyse Avril 2013 no. 330 Economie Finances

⁷⁷ IMF(2011, The interaction of monetary and macroprudential policies-background paper)

⁷⁸ IMF(2011, The interaction of monetary and macroprudential policies-background paper)

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

aktiveve, nëpërmjet politikave të quajtura *“lean against the wind”*. Sipas Svensson (2013), në periudhën 1970-2007 ishte grupi i parë ai që zotëroi. Por, ky konsensus gati 50 vjeçar, mbi rolin dhe objektivat e politikave monetare, u prish nga kriza financiare globale që shpërtheu në vitin 2007. Megjithëse është ende herët të arrihet në konkluzione konsensuale mbi mësimet e krizës, në debatet dhe analizat mbi të ardhmen e politikave monetare, po sintetizohen “leksione”, që duhen marrë në konsideratë për periudhën e re post-krizë⁷⁹.

Si të tilla, mund të përmenden :

- Qëndrueshmëria e çmimeve nuk mjafton për të siguruar qëndrueshmërinë financiare dhe aq më pak, për të siguruar qëndrueshmërinë makroekonomike. Inflacioni nuk është treguesi i duhur që të paralajmëron për flluskat e ardhshme financiare e monetare që po krijohen, të cilat mund të shpërthejnë nga çasti në çast, aq më tepër që këto flluska, të çojnë menjëherë në paqëndrueshmëri financiare dhe makroekonomike, duke vështirësuar së tepërmi transmetimin e vetë masave të politikave monetare. Sigurimi i qëndrueshmërisë makroekonomike nuk arrihet vetëm duke synuar qëndrueshmërinë e çmimeve, por dhe duke kërkuar politikat kujdesëse.
- Moslejimi i përshpejtimit të inflacionit në periudha krize nënkupton se, edhe në kushtet e tkurrjes së aktivitetit ekonomik si pasojë e krizës, politikat monetare relaksuese kanë efekte pozitive.
- Identifikimi i paqëndrueshmërisë financiare në kohë reale kërkon evidentimin dhe studimin e shumë indikatorëve specifikë, përtej çmimit të aktiveve si objektiv të politikave monetare, të tilla si, çmimet në sektorin e pasurive të patundshme, nivelin e borxhit të aktorëve ekonomikë, kostot e financimit të bizneseve, ecurinë e kredisë, paqëndrueshmërinë e financave publike dhe borxheve sovrane, etj.
- Nuk janë vetëm politikat monetare, por edhe politikat kujdesëse dhe ato ekonomike, të cilat duhen të implikohen seriozisht në administrimin e paqëndrueshmërisë financiare. Politikat monetare nuk mund ta luftojnë të vetme krizën ekonomike dhe paqëndrueshmërinë financiare. Në këto kushte, kërkohet forcimi i rolit të politikave mikro e makroprudenciale, me qëllim zhdukjen e risqeve sistemike të sistemit. Politikat makroprudenciale efikase, të paracaktuara për të rritur kapacitetet e rezistencës së sistemeve financiare, ia lehtësojnë fushën e veprimit politikave monetare (Civici, 2014).

⁷⁹ Civici, revista Bankieri janar 2014

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Politika monetare kontribuon në qëndrueshmërinë financiare dhe nuk shkon në kah të kundërt me qëndrueshmërinë e çmimeve. Të përqendrohesh ekskluzivisht në qëndrueshmërinë e çmimeve në një horizont që nuk i kalon dy vitet, përbën rrezik për qëndrueshmërinë financiare dhe për pasojë, për vetë qëndrueshmërinë afatgjatë të çmimeve⁸⁰.

Nëse politika monetare ndikon në qëndrueshmërinë financiare, atëherë ajo realizon me sukses dhe objektivin e saj tradicional, pra atë të qëndrueshmërisë afatgjatë të çmimeve. Domosdoshmëria e përcaktimit të mandateve të qarta për politikat monetare dhe ato makroprudenciale, bëhet në mënyrë që të rritet efica e këtyre dy politikave edhe nëpërmjet kombinimit të tyre. Kriza financiare nxorri në plan të parë rëndësinë e qëndrueshmërisë financiare dhe tregoi se vetëm objektivi i qëndrueshmërisë së çmimeve, është i pamjaftueshëm për të siguruar qëndrueshmërinë makroekonomike dhe veçanërisht çështjet e borxheve sovra e defiçiteve buxhetore⁸¹.

Pyetja që kërkon zgjidhje është: A duhet që në të ardhmen të mendohet për një mandat më të gjerë për politikat monetare, në mënyrë që ato të kontribuojnë më drejtpërdrejt në çështjen e qëndrueshmërisë financiare? “Politikat makroprudenciale efikase lehtësojnë fushën e veprimit të politikave monetare, i shmangin atyre implikimin në objektiva shtesë përtej atij të qëndrueshmërisë së çmimeve, pasi kjo krizë tregoi qartë domosdoshmërinë dhe efektshmërinë e përsheptimit të inflacionit dhe besueshmërisë së bankave qëndrore në politikat monetare të qëndrueshmërisë së çmimeve”⁸². Theksohet edhe një herë, misioni i bankave qëndrore, për domosdoshmërinë e artikulimit ndërmjet politikave monetare dhe makroprudenciale.

2.15 Faktorët që ndikojnë në paqëndrueshmërinë financiare

Pas krizës së 2007 lindi e nevoja që të rishiheshin rregullat e politikës makroekonomike dhe të rregullimit financiar. Gjatë periudhave, të cilat në pamje të parë duket se janë të qëndrueshme, mund të krijohen çekuilibra, deri në atë pikë sa të krijohen lëkundje të ndjeshme të pasurive, për shkak të veprimit të një elementi provokues. Gjatë periudhës së krizës, u pa një zbehje e mbështetjes nga ana e sektorit bankar, i cili ndikoi në rritjen e financimeve për huamarrësit, si edhe uli investimet dhe konsumin (Svensson, 2013). Në këtë mënyrë, kriza bëhet shkak që të arrihet të kuptohet më mirë roli dhe impakti i tregjeve finaciare, i kredisë dhe i parasë, në kohën kur ato më shumë, konsideroheshin si

⁸⁰ Preamble Economic and financial developments ,Prudential regulation and supervision Report 2012

⁸¹ Bezemer 2011, Causes of financial instability:”Don’t forget finance”,working paper No 665

⁸² La note d’analyse avril 2013 n^o 330

ndërmjetës të thjeshtë të ndërveprimeve për alokimin e burimeve⁸³. Duhet të kuptojmë se, kur sistemi financiar nuk është i qëndrueshëm, atëherë mund të bëhet gjenerues i krizave. Sipas Smaghi (2009), nocioni “qëndrueshmëri financiare”, përmbledh në të njëjtën kohë ndërveprimet jo të qëndrueshme midis tregjeve financiare, infrastrukturat e tregjeve, institucionet financiare si dhe raportet në mes sferës financiare dhe botës reale.

Përqasja kryesore i shpjegon krizat si një korrigjim i pashmangshëm i dobësive dhe çekuilibrave të grumbulluara në një periudhë “shkëlqimi” të sistemit global⁸⁴. Minsky e zgjeron vizionin Keinsianist të rëndësisë të marrëdhënieve financiare dhe të impaktit të huasë (borxhit) duke shtuar se, sektori financiar dhe ai monetar, është pikërisht ai, që synon të maksimizojë fitimet e veta. Në këtë kuadër, financimi i investimeve ashtu sikurse edhe rregullimi institucional që siguron perspektivën e fitimit, mbeten guri themelor i problemit që trajtohet. Ekziston një tjetër trajtim i problemit mbi qëndrueshmërinë financiare, që e përcakton atë si çrregullim të sistemit financiar, i cili jep një goditje sistematike, me burim nga jashtë (ekzogjene) dhe i vështirë për t’u parashikuar. Ky përcaktim duket më pak i përdorshëm, pasi nuk na mundëson të ndjekim simptomat e dobësive në brendësinë e një sistemi financiar. Nën këtë këndvështrim, arrijmë të shpjegojmë faktin se sistemi financiar paraqitet si një lëvizje e alternuar e fazave të qëndrueshmërisë, rregullimi të rreptë dhe nga paqëndrueshmëria në financimin spekulativ, të shoqëruar me një dobësim institucional. Është vënë re, se përsëritja e krizave bankare dhe financiare, që nga fundi i shekullit XIX, ndjek ciklin financiar sipas të njëjtës skemë⁸⁵. Dobësisë strukturale të sistemit, duke iu shtuar edhe interesat ekonomike e lënë të bjerë vetë, pa mundur që të seleksionojë nivelet e transformimit të maturisë optimale për financimet ekonomike, si edhe të ndikohet nga panike bankare⁸⁶.

2.16 Paqëndrueshmëria financiare e shpjeguar nëpërmjet ciklit financiar

Cikli financiar e sintetizon evolucionin në gjirin e ekonomisë, të përceptimeve të vlerës dhe riskut, të detyrimeve financiare dhe të shmangies së riskut që vetëushqehet dhe që përçohet në fazat e mëtejshme

⁸³ La note d’analyse avril 2013 n° 330

⁸⁴ Minsky H. (1977), “The financial instability hypothesis: An interpretation of Keynes and an alternative to ‘standard’ theory”, *Challenge*, p. 20-27.

⁸⁵ Reinhart C.M. et Rogoff K. (2009), *This Time is Different: Eight Centuries of Financial Folly*, Princeton University Press.

⁸⁶ Voir Diamond D.W. et Rajan R.G. (2011), “Fear of fire sales, illiquidity seeking, and credit freezes”, *The Quarterly Journal of Economics*, vol. 126 (2).

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

të zgjerimit (shtrirjes) dhe vetë krizës (Borio, 2012)⁸⁷. Cikli financiar, i cili nuk duhet ngatërruar me ciklin real të aktivitetit ekonomik (business cycle), zbulon më parë reagimin dhe qëndrimin e agjentëve (sipërmarrjeve, menaxherëve dhe bankave) ndaj tregjeve financiare, nëpërmjet vendimeve të tyre, të huave dhe investimeve.⁸⁸

Cilat janë karakteristikat e ciklit financiar ?

Kur flasim për karakteristika, nënkuptojmë luhatje të kredisë dhe të çmimeve imobiliare, duke përkrahur edhe dinamikën e tyre (Drehman dhe të tjerët, 2012)⁸⁹. Këto variante që zhvillohen së bashku, karakterizojnë në mënyrë të zbehtë marrëdhëniet e ndërsjellta në mes detyrimeve financiare dhe perceptimit të vlerës dhe riskut⁹⁰. Ngritja dhe ulja e variacioneve të fuqishme të shumave të debive private janë në raport me të ardhurat, ashtu sikurse edhe të çmimeve të aktiveve financiare në raport me debitë. Mbajtja e aktiveve, si garanci për të hyrë në borxhe, e zgjeron edhe më tepër ciklin. Studimi i luhatjeve të ciklit financiar, në raport me ciklin ekonomik për disa vende si Franca, SHBA dhe Mbretëria e Bashkuar, ka nxjerrë në pah se cikli financiar prodhon faza të zgjatura që nxisin shtrirjen (zgjerimin) të shoqëruara me ngadalësim të ndjeshëm, mbi një periudhë prej më shumë se një dekade, kundrejt zgjatjes për më pak se 8 vjet që i duhet një cikli ekonomik (La note d'analyse, 2013). Vihet re gjithashtu, se amplituda dhe frekuenca e ciklit financiar, respektivisht më e dobët dhe më e madhe se e ciklit ekonomik, shfaqin nivele kulmore përpara shfaqjes së krizave në bursa si p.sh “crash” i vitit 1987 në SHBA, kriza financiare e 2008-ës, kriza e “Credit Lyonnais” e vitit 1994, kriza bankare “sekondare” në Mbretërinë e Bashkuar në vitet 1974-1976.

Në një sistem të strukturuar mirë, uniformizimi i këtyre avancimeve, që në termat bankare do të thotë një kontratë në të cilën banka i jep klientit një shumë parash të siguruara nga tituj ose prona të tjera, sjell një varësi reciproke të strategjive financiare, që nga analizat e fundit, sjellin zgjerimin e amplitudës të cikleve financiare në rritje ose ulje. Ky mekanizëm, bën që cikli financiar të përforcojë fluktuacionet e ciklit ekonomik dhe mund të shkaktojë përtej krizave bankare ose të bursës, kriza të ekonomisë reale. Dobësia financiare duke ushtruar një ndikim mbi ekonominë reale, bën të nevojshme që të kufizohet krijimi i çekuilibrave “ex-ante” dhe të kufizohen kostot “ex-post” (që lidhen me vendime tashmë të marra) (La note d'analyse, 2013).

⁸⁷ Borio C. (2012), “The financial cycle and macroeconomics: What have we learnt?”, BIS Working Papers, n° 395.

⁸⁸ “The macroeconomics of capital” Structure by Roger W. Garrison

⁸⁹ Drehman et al. (2012), “Characterising the financial cycle: Don't lose sight of the medium term!”, BIS Working Papers, n° 380,

⁹⁰ Schularick M. et Taylor A.M (2012) “Credit booms gone bust. Monetary policy, leverage cycles and financial crises, 1870-2008”.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Janë tre lloj politikash që hyjnë në këtë kontekst :

- ✓ Politika kujdesëse, e cila mund të zbusë prociklicitetin e sistemit bankar.
- ✓ Politika fiskale, e cila duhet të jetë e kujdesshme në periudhat e ekspansionit ekonomik.
- ✓ Politika monetare, e cila gjithashtu duhet të reagojë kundër lindjes së çekuilibrave financiare.

Për të përballuar këtë paqëndrueshmëri financiare, e cila u përhap nga SHBA në Europë, lindi si nevojë zbatimi i një politikë makroprudenciale.

KAPITULLI III

3. Politikat makroprudenciale përkundrejt paqëndrueshmërisë financiare

Kriza e fundit financiare tregoi se në çfarë shkalle, stabiliteti i çmimeve nuk mjafton për të siguruar stabilitetin financiar. Mbikqyrja financiare dhe autokontrolli i tregut që dominojnë, nuk mjaftojnë që të parandalojnë euforinë sistemike në të cilën degradimi i disa operacioneve financiare do të kishte pasoja të rëndësishme, jo vetëm mbi tërësinë e sistemit financiar, por edhe mbi vetë ekonominë reale (La note d'analyse, 2013). Propozimet e bëra më parë për rregullimin financiar ishin të orientuara drejt të ashtuquajturës politikë e kujdesit maksimal. Objektivi ishte mbajtja e stabilitetit financiar global, ku pretendohet parandalimi i rreziqeve që lidheshin me sistemin financiar dhe në zbutjen e impaktit të tyre mbi ekonominë në rast krize. Evolucioni i regjimeve ekonomike financiare dhe monetare ka përforcuar ndërvarësinë e tyre, duke bërë një ripërcaktim të zonave të shtrirjes së veprimit respektiv të tyre, pra të vetë regjimeve ekonomike, financiare dhe monetare⁹¹.

Me qëllim që të kuptohet si promovohet stabiliteti financiar dhe stabiliteti i çmimeve, është e nevojshme të njihen rolet dhe konturet e politikës financiare dhe politikave makroprudenciale, si edhe raportet reciproke ndërmjet tyre.⁹² Studimet ekonomike na japin nota inkurajuese rreth ndërtimit dhe koordinimit të këtyre dy tipeve të politikave ekonomike. Ato na lejojnë të kuptojmë që politika “makro-menaxheriale” zhvillohet brenda BQE-së nëpërmjet krijimit të një komisioni pranë autoritetit të kontrollit, pavarësia e të cilit është e garantuar (La note d'analyse, 2013). Sikurse u pa nga kostot e krijuara prej krizës së fundit financiare të vitit 2007, propozimet për një reformë dhe përforcim të kontrollit financiar u forcuan dhe u shumëfishuan në të gjitha vendet e prekura. Në mënyrë që situata e krizës të ishte më e zbutur, kuadri i kontrollit që mbizotëroi ishte krijimi i një mundësie më të mirë për vlerësimin e rrezikut, i cili kanosej për shkak të ndërveprimeve midis shoqërive financiare. Kjo politikë e re, e cilësuar si politika makroprudenciale nëpërmjet instrumentave të mbikqyrjes, kontrollit dhe rregullimit financiar, ka nevojë për arbitrazhe të rëndësishme institucionale.

Në SHBA dhe vendet e eurozonës, vërehet një ndryshim në aspektin e pavarësisë së bankës qendrore dhe të autoriteteve përgjegjëse për rregullimin financiar. Përdorimi i një rregulli të ri që prek ofertën e kredisë në sistemin financiar, rrezikon të hyjë në konflikt me politikën monetare, e cila nga ana e saj ushtron kontroll mbi këto kredi. Nga sa thamë më lart, duhet të përcaktohen politika më të

⁹¹ La note d'analyse, 2013

⁹² Bank of england: “Financial stability” paper No 24 October, 2013

përshtatshme, me qëllim evitimin e politikave që punojnë në sens të kundërt. Për të arritur këtë qëllim, është parësore që të mirë-analizohen ndikimet e sferës financiare mbi ekonominë reale, si dhe të funksionimit të politikës monetare. Modelet ekonomike janë sofistikuar pas krizës, me objektivin e kuptimit më të thellë të ndërmjetësve financiarë dhe të marrëdhënieve të ndërsjellta me sferën e ekonomisë reale (La note d'analyse, 2013).

3.1 Termi “makroprudencial”: Origjina dhe Evoluimi i tij

Pas krizës së fundit, termi "makroprudencial" është bërë shumë i rëndësishëm dhe i përdorshëm në sistemin financiar. Megjithatë ky term është përdorur edhe shumë kohë para krizës, kuptimi i tij mbetet i panjohur. Sipas IMF (2011b) origjina e këtij termi daton në fund të viteve 1970, në kontekstin e huadhënieve ndërkombëtare bankare. Përpjekjet ndërkombëtare për të përforcuar sistemin financiar, janë përqëndruar në përmirësimin e orientimit makroprudencial të kuadrit rregullues dhe mbikqyrës, pra i një fokusi të zgjeruar mbi sistemin financiar si një i tërë dhe lidhjen e tij me makroekonominë. Bini Smaghi(2013) shprehet se, mbikqyrja e stabilitetit financiar dhe makroekonomik në periudha afatgjata, kërkon adoptimin e strukturave të referimeve makroprudenciale, të përcaktuara këto me saktësi, si një element ndihmës, në përshtatje dhe përmirësimin e metodave të politikës monetare që funksionojnë edhe sot.⁹³

Pas krizës, i është kushtuar shumë vëmendje termit "makroprudencial" për vetë rëndësinë e tij. Që nga origjina e tij në fund të viteve 1970, termi përcakton gjithmonë shqetësimet mbi stabilitetin e sistemit financiar dhe lidhjen e tij me makroekonominë. Vlen të theksohet se fokusi specifik i këtyre shqetësimeve ka ndryshuar me kalimin e kohës. Shqetësimet janë të lidhura me kreditimin e tepruar për vendet në zhvillim, ndikimin e inovacionit financiar dhe zhvillimin e tregjeve të kapitalit, ndikimin e rregullores mbi prociklilitetin e sistemit financiar si dhe implikimet e dështimit të institucioneve të rëndësishme (IMF, 2011b).

Përdorimi i termit “makroprudencial” u përhap për të theksuar pamjaftueshmërinë e rregullimit makroprudencial, i cili ka ekzistuar edhe më parë për të siguruar qëndrueshmërinë e vetë sistemit financiar. Bernanke (2009) vë në dukje se rregullimi makroprudencial i marrëveshjeve të Bazel I dhe II, ishte një rregullim individual, i cili synonte sigurimin e aftësive paguese të institucioneve bankare.

⁹³Lorenzo Bini Smaghi,Thorvald Grung Moe: SUERF – The European Money and Finance Forum, Vienna, 2013

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Ky rregullim nuk merr në konsideratë riskun sistemik⁹⁴, i cili krijohet nga efektet e transmetimit që ndodhin midis bankave, si dhe për lindjen e pasojave të padëshirueshme për një sistem financiar në rast “shoku”. Borio thekson se kjo është edhe arsyeja që lindi nevoja për një orientim makroprudencial⁹⁵.

Bank for International Settlements (BIS) ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të qartësuar kuptimin e këtij termi, duke e përcaktuar dhe referuar atë me antonimin e tij "mikroprudencial". Në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, termi i referohet përdorimit të mjeteve prudenciale (të kujdesshme) me objektiv të qartë promovimin, stabilitetin e sistemit financiar në tërësi dhe jo domosdoshmërisht të institucioneve individuale brenda tij (IMF, 2011b). Shumica e mjeteve të përdorura, kanë për qëllim rregullimin dhe mbikqyrjen e institucioneve individuale. Sfidë kryesore është që të arrihet një ekuilibër më i mirë në përdorimin e tyre, me qëllim që të bashkëjetojnë me sukses të dy perspektivat. Ky është pikërisht synimi i përpjekjeve në bashkësinë ndërkombëtare në ditët e sotme (Crockett, 2000).

Ashtu siç konfirmohet edhe nga FMN në raportin për “Leksione nga krizat” (Maj, 2010), thuhet se: Politikat e mbikqyrjes makroprudenciale janë instrumentat kryesore për të siguruar një stabilitet financiar. Në të vërtetë ato mund të arrijnë të “zvogëlojnë” përsëritjen e risqeve sistematike dhe të dobësive strukturale. Instrumentat makroprudencialë përfshijnë kërkesat e trashëguara dhe akumulimin e kapitalit në një prespektivë të provigjioneve të treguesve të likuiditetit dhe vlerësimit të kujdesshëm të kolateralit.

Kriza e fundit financiare ka ndikuar në rëndësinë e matjeve të faktorëve të riskut sistemik, i cili mbetet një faktor kyç në politikat makroprudenciale dhe rregullatore. Për këtë arsye, matja e riskut sistemik mund të ndikojë në identifikimin dhe vlerësimin e kërcënimeve të stabilitetit financiar. Një bankë qendrore nuk mund t’i shmangë përgjegjësinë e saj për ruajtjen e stabilitetit financiar, edhe pse nuk është i përcaktuar si një mandat i saj specifik. Politika e stabilitetit financiar ka si objektiv të ofrojë shërbimet stabël të ndërmjetësimit financiar, të shërbimeve të pagesave, ndërmjetësimit të kreditit dhe të sigurimit ndaj riskut. Këtë e bën duke u munduar që të evitojë ciklet e bumit dhe shkatërrimit për kreditë dhe likuiditetin, të cilat ndikuan në krizën e fundit financiare, si dhe të reduktojë mundësinë për kredi për disa familje dhe biznese private. Një nga debatet që edhe sot është prezent në lidhje me objektivat makroprudenciale është nëse këto të fundit mbrojnë bankat nga cikli apo ekonominë nga bankat.

⁹⁴ Risku sistemik i përcaktuar si zhvillim që kërcënon stabilitetin e sistemit financiar dhe për pasojë ekonominë reale (Bernanke, 2009).

⁹⁵ Borio C. (2003), “Towards a macroprudential framework for financial supervision and regulation?”, BIS Working Papers, n° 128.

3.2 Përdorimi i termit “makroprudencial” në lidhje me risinë financiare në vitet ’80 – ’90

Sipas Borio (2003), termi makroprudencial është përdorur shumë kohë më parë ndërsa i shkruar në një dokument publik, ai daton në vitin 1986, në raportin e ECSC⁹⁶. Ky raport i kushton të paktën disa paragrafë diskutimit të konceptit të politikave makroprudenciale dhe se si risitë financiare mund të rrisin rrezikun për sistemin financiar në tërësi. Gjithashtu, raporti përcakton politikën makroprudenciale si një politikë që promovon ose nxit sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit financiar në tërësi dhe mekanizmit të pagesave.

Box 4: Përdorimet e para të termit “makroprudencial” dhe hezitimet ndaj huadhënies në fund të viteve ’70.

Nuk është e lehtë të identifikohet saktësisht se kur është përdorur për herë të parë termi "makroprudencial". Të dhënat e BIS, tregojnë se paraqitja e këtij termi për herë të parë në një kontekst ndërkombëtar daton në vitin 1979, në një takim të Komitetit Cooke, paraardhës i Komitetit të Bazelit. Ky komitet theksoi se problemet mikroekonomike filluan të shtrihen apo të transformohen në probleme makroekonomike. Autoritetet financiare tashmë ishin të shqetësuara në lidhje me implikimet e stabilitetit makroekonomik dhe financiar, të ritmit të shpejtë të kreditimit të vendeve në zhvillim dhe ky ishte rezultati që ata shqyrtonin politika alternative dhe t'i adresonin ato (Clement, 2010). Në mars të vitit 1978, patën jehonë shqetësimet e shprehura në Raportin Vjetor të 47-të BIS. Ky i fundit, kishte përgatitur një dokument për diskutim në lidhje me implikimet e rritjes së çmimeve të naftës për bankat huadhënëse ndërkombëtare dhe stabilitetin e sistemit bankar ndërkombëtar. Rezultat i këtij diskutimi ka qenë një raport i ECSC (Euro-Currency Standing Committee), finalizuar në korrik të vitit 1978. Në këtë raport, theksi u vu pikërisht në lidhjen midis rregullave prudenciale dhe shqetësimeve makroekonomike dhe në këtë mënyrë ata vendosën të përdornin termin "makroprudencial". Sipas Borio (2003) shfaqja e dytë e termit "makroprudencial" është në një dokument dytësor, i paraqitur nga Banka e Anglisë, nga këshilltari i BIS dhe kryetari i ECSC. Në këtë dokument të tetorit të vitit 1979, shqyrtohet përdorimi i masave prudenciale si një nga disa mënyrat e mundshme për të arritur kufizimin e kreditimit. Në të theksohet qartë kontrasti i qasjes së rregullave tipike mikroprudenciale dhe mbikqyrja e bankave individuale me rregullat makroprudenciale. Dokumenti vë në dukje tre arsye se si perspektivat mikroprudenciale mund të dështojnë nëse nuk merren parasysh shqetësimet e mëdha makroprudenciale. Së pari, rritja apo zgjerimi i çdo banke të veçantë në pamje të parë, mund të duket i qëndrueshëm, ndërsa kreditimi i përgjithshëm mund të mos jetë i tillë. Së dyti, bankat individuale tentojnë të shohin si shumë kritike rrezikun e normës së interesit dhe nënvlerësojnë rëndësinë e rrezikut të likuiditetit. Së treti, perceptimi i rrezikut mund të jetë i pamjaftueshëm, duke u fokusuar ngushtë në performancën e kredive individuale në të kaluarën, në vënd të një rreziku më të gjerë të huamarrësve në tërësi.

⁹⁶ Borio, C (2003): "Towards a macroprudential framework for financial supervision and regulation?", CESifo Economic Studies, vol 49, no 2/2003, pp 181–216. Also available as BIS Working Papers, no 128, February.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Fokusi kryesor është mbi tregjet derivate të mbyllura ose të izoluara, duke i parë ato si promotore të rritjes së asteve të tregut të kapitalit. Raporti nxjerr në pah disa dobësi si: nënçmimi i rrezikut të instrumentave të reja; arbitrazhi rregullator; pakalueshmeria e rrezikut që rrjedh nga ndërlidhjet në sistemin financiar; mbivlerësimi i likuiditetit; mbingarkesat e pagesave dhe të sistemeve të shlyerjes; vëllimi i madh i transaksioneve; rritja e madhe e borxhit në përgjithësi.

Në vitet që pasuan, termi "makroprudencial" nuk u përmend më në skenën financiare. Ai vazhdoi të përdoret vetëm në disa rregulla dhe dokumenta të brendshme të BIS, kryesisht nga ECSC. Një dalje tjetër në skenë e këtij termi është përsëri në raportin e ECSC në 1992, "*Zhvillimet e fundit në marrëdhëniet ndërkombëtare*".⁹⁷ Ky raport u përgatit nga një grup pune, i ngarkuar nga qeveritë e G10 që të përqëndroheshin në rolin dhe bashkëveprimin e bankave në tregjet jo-tradicionale, për të shqyrtuar lidhjet mes segmenteve të ndryshme të tregjeve ndërbankare, duke marrë në konsideratë shqetësimet makroprudenciale, mbi të cilat këto aspekte mund të ndikojnë (Clement, 2010). Një grup i mëvonshëm i ECSC, zgjodhi të përfshijë termin pikërisht në titullin e raportit të tij, "*Çështje që lidhen me matjen e madhësisë së tregut dhe rreziqet makroprudenciale në tregje*".⁹⁸ Shqetësimet kryesore të politikave të identifikuar në raportin e Brockmeijer, u lidhën me mungesën e transparencës në këto tregje dhe përqëndrimin e treg-marrjes në funksionet e disa institucioneve, të cilat mund të dëmtojnë fuqinë e likuiditetit të tregut. Një vazhdimësi e përpjekjeve politike, çuan në mbledhjen e statistikave më të mira të ketyre tregjeve⁹⁹. Termi gjithashtu, shfaqet në një kapitull të veçantë mbi evolucionin e bankave qëndrore në Raportin e 67-të vjetor të BIS¹⁰⁰. Në të dyja rastet, ai është përdorur për të nxitur politikën në dobi të përmirësimit të stabilitetit dhe sistemit financiar, kryesisht duke u fokusuar në lidhjet me të gjitha institucionet dhe tregjet. Nga fundi i viteve 1990, termi "makroprudencial" ka filluar të përdoret edhe jashtë ambjenteve të bankut qëndror, ku me krizën financiare aziatike të vitit 1997, veçoi si nxitës kryesor (BIS, 1997). Në janar të vitit 1998, siç citohet edhe në raportin e FMN (2011f), "Drejt një kuadri për zërin e sistemit financiar" thekson se: "*Mbikqyrja efektive bankës qëndrore duhet të shihet nga bankat si një prani e vazhdueshme*. Kjo arrihet kryesisht nëpërmjet monitorimit *off-site*, si mikro dhe makroprudenciale. Analiza makroprudenciale bazohet në inteligjencën e tregut dhe informacionin makroekonomik dhe fokusohet në zhvillimin e mjeteve të

⁹⁷ BIS (1992)

⁹⁸ Brockmeijer Report, BIS (1995).

⁹⁹ Bis (1996) (Raport i Yoshikuni) i përgatitur nga një grup pune nga ECSC i prezantuar në korrik 1996, gjithashtu u përdor edhe termi "macroprudential"

¹⁰⁰ BIS (1997).

rëndësishme të tregut, të ndërmjetësve të tjerë financiarë, si dhe zhvillimet makroekonomike dhe zhbancimeve të mundshme. Politika kryesore përfshin zhvillimin e statistikave më të mira, për të vlerësuar dobësitë e sistemit financiar, të ashtuquajtur "treguesit makroprudencial".¹⁰¹

3.3 Përdorimi i termit “makroprudencial” pas viteve 2000

Një tjetër moment historik për termin "makroprudencial", u arrit në vitin 2000. Menaxheri i përgjithshëm i BIS, A.Crockett mbrojti argumentin se: arritja e stabilitetit financiar, kërkon forcimin e perspektivës makroprudenciale, e cila ishte një përpjekje për të siguruar një përkufizim më të saktë analitik të dy perspektivave, i parë si mënyrë e pashmangshme e bashkëjetesës së kujdesshme.

Ai veçoi dy karakteristika dalluese të qasjes makroprudenciale.

Së pari, fokusi iu dha sistemit financiar në tërësi, me qëllim kufizimin e kostove të shqetësimit financiar, në kuadër të prodhimit (makroekonomik).

Së dyti, njohja që rreziku agregat ishte i varur me sjelljen kolektive të institucioneve financiare (endogjen).

Nga ana tjetër, objektivi i qasjes mikroprudenciale u përkufizua si kufizuese e riskut të dështimit të institucioneve individuale, e justifikuar në mënyrë të qartë në aspektin mbrojtës së depozituesit ose të investitorit. Kjo qasje ishte parë si trajtimi i rrezikut agregat dhe si sjellje kolektive e pavarur e institucioneve (exogenous). (Crockett 2000)

E rëndësishme është se përjashtohet mundësia që veprimet mund të shfaqen individualisht racionale, të cilat në total figurojnë me rezultate të padëshiruara për shkak të faktorëve të jashtëm.

Një shëmbull nga Borio (2001), ishte ai i turrjes nga bankat individuale në kohën e stresit, i cili mund të shkaktojë “fire-sales” (shitja e mallrave ose asetëve me çmime tepër të ulura) dhe krizës së kredive, duke rritur kështu edhe riskun e sistemit financiar në tërësi. Nga ana tjetër, u pa se qasja makroprudenciale ka dy dimensione:

Dimensioni i parë ishte se si rreziku evoluon me kalimin e kohës, dmth proceset reciprokisht janë amplifikuese midis sistemit financiar dhe ekonomisë reale. Ky u bë i njohur edhe si "prociklikaliteti" i sistemit financiar.¹⁰²

¹⁰¹ Këta tregues janë quajtur edhe me vonë “treguesit e mbarëvajtjes financiare” pas një propozimi të Bordit të FMN (FMN, 2001)

¹⁰² Shihet në vecanti Borio (2001) dhe së fundmi BIS (2009a)

Dimensioni i dytë ishte se si rreziku është shpërndarë brënda sistemit financiar. Fokusi këtu ishte në institucione që kanë ekspozime të ngjashme në sistemin financiar dhe që ndërlidhen midis këtyre institucioneve. Kjo thirrje u bë për kalibrimin e mjeteve “prudenciale” që kanë lidhje me rëndësinë sistematike të institucioneve individuale, d.m.th kontributin e tyre ndaj rrezikut të përgjithshëm. Për shëmbull, institucionet për të cilat dështimi ishte më shkatërrues për sistemin në tërësi, do të ishin subjekt i standarteve të forta BIS (2009a). Përkufizimi i përdorur prej mbikqyrësve bankarë ishte më i saktë sesa ai i mëparshmi. Në veçanti, politika makroprudenciale u përqëndrua në mbikqyrjen dhe rregullimin e institucioneve individuale. Si e tillë, ajo përjashton politikat e përgjithshme të krijuara për përmirësimin e infrastrukturës financiare. BIS (2000), thekson se dallimi midis dimensioneve mikro dhe makroprudenciale të stabilitetit financiar shihet më qartë në drejtim të objektivave, detyrave dhe konceptimin e mekanizmave që ndikojnë në rezultatet ekonomike.

- **Konceptimi i politikës makroprudenciale**

Ekonomistët nuk e mendojnë njësoj përkufizimin e politikës makroprudenciale (FMN, 2011a). Për Galati & Moessner (2011), termi “politikë makroprudenciale” është përdorur përgjithësisht pas krizës së fundit edhe pse dëshmitë e përdorimit të tij të parë, datojnë në vitet '70. Kjo politikë e lindur fill pas disekuilibrit të sistemit financiar botëror që priu ndryshimet e mëdha në vitet '80 përgjatë gjithë historisë së saj është marrë shpesh si një qasje sistematike ndaj rregullimit dhe mbikqyrjes financiare, d.m.th. e lidhur me makroekonominë (Galati & Moessner, 2011). FMN-ja sugjeron se: *në terma të përgjithshëm, politika makroprudenciale është politikë që synon të mirëmbajë stabilitetin financiar, megjithëse nuk jep përkufizimin se ç'është ky i fundit* (FMN, 2011b). Politika makroprudenciale mbështetet në tre modele, si një përpjekje teorike e politike për të ndërlidhur rregullimin e politikës makroprudenciale me sistemin financiar të përbashkët: Modeli i Njohjes Kolektive; Modeli i Mirëqenies Kolektive; dhe Modeli Aktorial (La Torre & Ize, 2009 siç citohet nga Borges dhe Gon, 2013). Modeli i parë lidhet me inxhinierinë dhe ekonominë e sistemit, që do të thotë se: pjesët që përbëjnë një sistem e kanë të vështirë të dallojnë dinamikën, brendinë dhe ndërveprimet e sistemit si një i tërë. Kjo çon në rritje të pasigurisë dhe arrin të shtrembërojë veprimet e aktorëve në këndvështrimin e qëndrueshmërisë sistematike. Me modelin aktorial nënkuptohet se: administratorët arrijnë të përfitojnë nga asimetria e informacioneve.

Ata i maksimizojnë fitimet e tyre në pjesën më “të mirë” ose pozitive të një cikli, dhe ia lënë aspektet negative të tjerëve, edhe kur aspekti negativ përforcohet indirekt nga sjellja e tyre e mëparshme. Ky aspekt mund të arrijë të ndikojë në modelin e dytë, që është mirëqenia kolektive.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Kriza financiare globale (2007-2013) nxiti debatin për pasojat e risqeve të qenësishme ose të amplifikuara nga sistemet financiare. Veprat empirike dhe teorike të nxjerra prej vitit 2007 kanë zhvendosur në nivele të pazakonta kornizat analitike dhe institucionale të politikës makroprudenciale. Disa nga temat më të nxehta që ndikojnë në debatin e politikës makroprudenciale, e cila mund të shihet si një kornizë politike ku adresohen rregullat financiare prudenciale dhe ndërveprimi i politikës monetare me mjedisin e përgjithshëm makroekonomik:

- nevoja për të vënë kufi midis politikave makroprudenciale dhe atyre monetare;
- veçimi funksional i aktorëve që kujdesen për politikën monetare dhe atyre që mendojnë kryesisht për të ruajtur stabilitetin financiar;
- mjaftueshmëria dhe efektiviteti i mjeteve financiare dhe i instrumentave për të vlerësuar e zbutur rreziqet sistemike, si në nivel kombëtar, ashtu dhe në operacionet ndërkufitare të agjentëve financiarë;
- zgjedhja e kornizës institucionale efektive e përshtatur për një realitet lokal, si dhe ndërtimi i një arkitekture ndërkombëtare paralele për të ndihmuar aksionet kombëtare dhe vendosur standarte të politikës makroprudenciale, që të pranohen ndërkombëtarisht.

- **Çfarë është politika makroprudenciale?**

Me politikë makroprudenciale arrijmë të kuptojmë përpjekjet e bëra nga të gjithë politikëbërësit makroprudencialë të cilët tentojnë të kufizojnë riskun sistematik, pra riskun e prishjes së ofertës për shërbime financiare, të shkaktuara nga dëmtimi i sistemit financiar. Gerlach (2013) shprehet se kjo çon në situata serioze negative, si për ekonominë, ashtu edhe për mirëqenien. Zakonisht, përdoren mjetet prudenciale që mbikqyrësit makroprudencialë i vënë në përdorim për të limituar rrezikun e shëndetit të kompanive financiare individuale. Sado të shumta të jenë politikat që mund të përdoren për të forcuar në tërësi sistemin financiar, vetëm ato politika që kontrollohen nga politikëbërësit makroprudencialë, përbëjnë të ashtuquajturën politikë makroprudenciale (Gerlach, 2013).

- **Përse shërben politika makroprudenciale?**

Kriza 2007-2013 nënvizoi faktin se politikat tradicionale për të arritur stabilitet makroekonomik, nuk mjaftonin që të siguronin edhe stabilitet financiar ose dhe më gjerë. Veprimet e kompanive individuale mund të krijojnë ndërvarësi dhe kishte gjasa të zhvillonin edhe rrezikun sistematik (Gerlach, 2013).

Argumenti që lindi për nevojën e përdorimit të politikës makroprudenciale, qëndron në tre faktorë:

Së pari: prirja e sistemit financiar në tërësi, për të amplifikuar tronditjet e forta. Për shëmbull, bankat mund të reagojnë ndaj një ekonomie në rënie duke ndërprerë kreditimin.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Së dyti, instrumentat ndihmës mund të ekspozohen shumë ndaj tronditjeve të pafavorshme. Për shëmbull, ndërvlerësia mes çmimit të kredisë dhe të aktiveve mund të çojë në një situatë ku kredia e bankave rrit çmimin e aktiveve, pra edhe vlerën e kolateraleve.

Së treti, lidhjet financiare që rrisin cënueshmërinë e sistemit ndaj tronditjeve të forta. Megjithëse shumë prej këtyre lidhjeve mund të shfaqen në formën e ekspozimeve direkte, ato mund të “kapen” nga rregullatorët dhe të shfaqen si garanci të nënkuptuara në derivate dhe tregje financiare (Gerlach, 2013).

- Cilat janë mundësitë e politikës makroprudenciale?

Politika makroprudenciale kryesoi axhendën politike financiare ndërkombëtare në vazhden e krizës së fundit dhe si fushë politikash ekonomike është relativisht e paprovuar (BIS, 2010). Nuk ka akoma një konsensus të gjerë për praktikat më të mira të provuara në këtë fushë dhe në këtë pikë politikëbërësit që po mundohen t’u zbatojnë atë, u përballën me një sërë zgjedhjesh të vështira.

Së pari, politikëbërësi makroprudencial duhet të ushtrojë një ose shumë instrumente politike për të adresuar një rrezik sistematik të caktuar. Shfrytëzimi i instrumentave të shumëfishta është i dobishëm se lejon politikëbërësin të ndjekë aspekte të ndryshme të të njëjtit rrezik sistematik. Mund të rezultojë negative për faktin se shumë instrumente nënkuptojnë më tepër rrjedhoja të paqëllimshme dhe këto raste njihen shpesh si rrjedhje rregullatore.

Nga kërkimet e fundit për bankat angleze (Aiyar et al, 2012), për shëmbull, thuhet se bankat “e rregulluara”¹⁰³ e ulin kreditimin, siç edhe pritet në përgjigje të kërkesave makroprudenciale më të shtrënguara për kapital që synojnë të zbusin ciklin e kreditimit. Ndërsa, bankat e “parregulluara” e rrisin kreditimin në përgjigje të kërkesave më të shtrënguara për kapital ndaj një grupi përkatës bankash të rregulluara. Rrjedhja rregullatore është e konsiderueshme (ESRB, 2011).

Së dyti, politikëbërësit duhet të zgjedhin mes objektivave ndaj rrezikut sistematik. Për shëmbull, duke synuar transaksionet e llojeve të caktuara, instrumentat politike mund të ishin potencialisht më efektive dhe më të sakta.

Së treti, politikëbërësit makroprudencialë duhet të barazpeshojnë konfidencialitetin dhe rregullat. Instrumentat që bazohen në rregulla funksionojnë me anë të një parimi për treguesit e rrezikut sistematik. Këto rregulla veprojnë si mbrojtës kundër paaftësisë së politikëbërësit dhe tolerancës, për të parashikuar kohën dhe madhësinë e efekteve të politikës.

¹⁰³ Ky term e ka origjinën nga problemet mikroekonomike rreth aftësisë së kreditorëve të bankës për të monitoruar risqet që e kanë origjinën nga huadhëniet dhe nga problemet mikro dhe makroekonomike rreth stabilitetit të sistemit bankar në rastin e krizave (Bigar & Himler, 2005)

Në fakt, këto rregulla janë të vështira për t'u hartuar e zbatuar. Kurse diskrecioni i lejon politikëbërësit të mësojnë nga ndërveprimi ndërmjet sistemit financiar, ekonomisë dhe politikës makroprudenciale.

Së katërti, politikat duhet të kalibrohen me kohën.

Një politikë makroprudenciale efektive i gërsheton të dyja: rregullat e pandryshueshme në kohë që vështirësojnë formimin e rrezikut sistemik, si dhe politikat që shtrëngohen, kur rreziku sistemik perceptohet të jetë rritur në nivele të konsiderueshme rrezikshmërie (BIS, 2011).

3.4 Bashkëveprimi ndërmjet politikave makroprudenciale, politikave monetare dhe politikave mikroprudenciale

Politikat makroprudenciale bashkëveprojnë me politikat monetare, si dhe me ato mikroprudenciale në mënyra nga më komplekset, por rregullat e përbashkëta dhe koordinimi, janë thelbësore. Një nga mësimet e nxjerra është se politikat makroprudenciale kanë qënë në harresë deri pak vite më parë, edhe pse ato kanë ndërveprime komplekse me politikat monetare.

Dihet se një bankë qendrore në mandatin e saj ka si objektiv kryesor stabilitetin e çmimeve. Ky është edhe kontributi më i mirë që autoritetet monetare mund të sigurojnë në mbështetje të stabilitetit të sistemit financiar. Kriza tregoi se politika monetare arrin të influencojë në variabla si çmimet e aktiveve dhe kushteve financiare, pasi performanca e tyre ndikon në stabilitetin financiar.

Angelini et al (2011) i vënë theks rëndësisë dhe koordinimit mes politikave monetare dhe ato makroprudenciale. Pra, kur ndodhin goditjet shok në sistemin financiar, ndryshon edhe sjellja e sistemit bankar për të kredituar ekonominë. Për një bankë qendrore është optimal bashkëpunimi me autoritetet makroprudenciale, deri në pikën e devijimit të përkohshëm nga objektivi i saj kryesor i stabilitetit të çmimeve dhe e gjitha kjo, në emër të favorit të stabilitetit të sistemit financiar.

Një çështje tjetër e diskutueshme dhe komplekse, është lidhja midis politikave mikro dhe makroprudenciale si themeli për stabilitetin e sistemit bankar. Nuk mund që të imagjinohet suksesi i mbikqyrjes makroprudenciale, pa mbështetjen e mbikqyrjes mikro (Angelini et al, 2012). Në fakt, mbikqyrja mikroprudenciale ka si objektiv të saj, menaxhimin e kujdesshëm të subjekteve të veçantë, gjithashtu kjo politikë kufizon prociklikalitetin e sistemi financiar, si dhe rrezikun agregat. Ndërsa, disa nga instrumentat më tipik të politikave makroprudenciale, si psh LTV (*loan-to-value ratios*), treguesit e likuiditetit, si dhe kërkesat e kapitalit nuk janë gjë tjetër, përveç se instrumente mikroprudencialë të kalibruar dhe të rregulluar, për t'u përdorur dhe për t'iu përgjigjur qëllimit makroprudencial. Duke i grupuar të njëjtat mjete, të cilat janë edhe të dallueshme (makro ose mikro)

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

nga autoritetet mbikëqyrëse, ata mund t'i vënë në funksionim, për të ndjekur qëllime, të cilat janë të ndryshme, por edhe të ndërlydhura. Mund të ndodhin edhe situata konfliktuale, të cilat mund të shfaqen me probabilitet më të lartë në fazat negative të ciklit ekonomik. P.sh.,ndodh që autoritetet mikroprudenciale mund të kërkojnë kërkesa shtesë të kapitalit, kjo për shkak të gjendjes së bilancit të një institucioni të vetëm, kurse nga ana tjetër, autoritetet makro, mund t'i kërkojnë sistemit bankar në tërësi, që të përdorin elementë zbutës të kapitalit të akumuluar në fazat pozitive të ciklit, në mënyrë që të shmanget kriza e kredive (Angelini, et al, 2012).

3.5 Ndryshimet e perspektivave makro dhe mikroprudenciale

Objektivi i prespektivës së politikave makroprudenciale përkufizohet si kufizues kostosh në ekonomi nga shqetësimet financiare si pasojë e politikave të ndjekura. Objektivi mund të mendohet si kufizimi i mundësisë së dështimit dhe kostot përkatëse, që e shoqërojnë këtë dështim. Ky i fundit është shprehur edhe si kufizimi riskut sistematik. Ndërsa, për objektivin e prespektivës së politikave mikroprudenciale mund të themi se është kufizimi i mundësisë së dështimit të institucioneve individuale (Crockett, 2000). Prespektiva makroprudenciale fokusohet më shumë në risqet dhe dështimet që lidhen me to, sesa në analizat krahasuese ndërmjet institucioneve. Këto të fundit, shihen nga politikat makroprudenciale si më pak të rëndësishme, pasi nuk të çojnë në rrugën e duhur. Prespektiva mikroprudenciale nga ana tjetër, është e kundërta. Kjo prespektivë e konsideron çdo institucion në të drejtën e vet dhe nuk merret me korrelacionet në vetvete dhe e shikon karahasimin e organizatave me njëra tjetrën, si një mjet monitorimi (Crockett, 2000). Bazuar në Crockett (2000), mund të themi se: rregullimi tradicional mikroprudencial synon të rrisë sigurinë dhe qëndrueshmërinë e institucioneve financiare individuale, në krahasim me atë makroprudencial, i cili fokusohet në mirëqënien e sistemit financiar në tërësi.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Tabela nr 6. Prespektivat makro dhe mikroprudenciale

Prespektivat makro dhe mikroprudenciale		
	Makroprudenciale	Mikroprudenciale
Objektiv i afërm	Stresi i kufizimit të gjerë të sistemit financiar	Stresi i kufizuar i institucioneve private
Objektivi final	Shmangia e kostos së PBB	Mbrojtja e konsumatorit (investitor/ depozitues)
Karakteristikat e rrezikut	Konsiderohet si e varur nga sjellja kolektive (“endogjene”)	Konsiderohet si e pavarur nga sjellja e agjentëve individuale (“ekzogjene”)
Korrelacionet dhe ekspozimet e përbashkëta në të gjitha institucionet	E rëndësishme	E parëndësishme
Kalibrimi i kontrolleve prudenciale	Në aspektin e rrezikut të sistemit të gjërë	Në aspektin e rrezikut të institucioneve individuale

Burimi :Borio 2003

Nën perspektivën mikroprudenciale, risku është marrë si ekzogjen duke supozuar një “shock të mundshëm”, i cili mund të shkaktojë një krizë financiare. Prespektiva makroprudenciale nga ana tjetër, pranon se faktorët e riskut mund të cilësohen endogjenë, me dukuri sistemike. Në vijim të asaj që është thënë me lart, politika makroprudenciale u drejtohet institucioneve individuale financiare, tregjeve si dhe ekspozimit të tyre të përbashkët ndaj faktorëve ekonomikë e rrezikut. Ajo gjithashtu fokusohet në sjelljen prociklike të sistemit financiar, në përpjekje për të nxitur stabilitetin në tërësi (Hahm et al, 2011). Roli i politikës mikroprudenciale dhe asaj monetare ndërthuren me njëra-tjetrën, ndërsa roli i politikës makroprudenciale është i ndarë nga dy të parat¹⁰⁴. Politika makroprudenciale ka si qëllim të stabilizojë çmimin e kombinuar të shërbimeve dhe mallrave në një ekonomi. Një tjetër objektiv kryesor i kësaj politike është edhe sigurimi i stabilitetit financiar, i cili ofron në mënyrë konstante shërbimet e ndërmjetësve financiarë gjatë gjithë ciklit të kredisë. Qëllimet e politikave makroprudenciale në fakt, janë të ngjashme me qëllimet e politikës makroekonomike.

3.6 Rregullat dhe politikat makroprudenciale

Termi "makroprudencial" ka marrë një rëndësi të veçantë në sistemin financiar. Një tipar i rëndësishëm i tij është heterogjeniteti i sistemit financiar. Pjesëmarrësit e tregut kanë tendencën të jenë heterogjenë, por si pasojë e faktorëve rregullatorë ose jo-rregullatorë, iu drejtuan tendencës së homogjenitetit (Bank

¹⁰⁴ Burimi: Bank of England – The role of macroprudential policy; A discussion paper– November 2009

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

of England, 2009). Krijimi dhe zhvillimi i elementeve makroprudenciale për arritjen e një stabiliteti financiar, ka tërhequr shumë vëmendje dhe interes në periudhën e krizës. Politikëbërësit bien dakort që këto politika makroprudenciale, duhet të ulin riskun e sistemit financiar. Ata kërkojnë të forcojnë sistemin financiar duke e ndihmuar që të vazhdojë të funksionojë në mënyrë të qëndrueshme, pa patur nevojën e ndihmës emergjente (Bank of England, 2009).

Politikat makroprudenciale ndyshojnë nga politikat e menaxhimit të krizave financiare. Dallimi midis tyre është se këto politika duhet të përcaktohen saktë dhe pastaj të vihen në zbatim. Politikat makroprudenciale, përveç objektivit të tyre kryesor, karakterizohen edhe nga dy elemente të tjerë që janë:

- a) Fusha e tyre e veprimit është sistemi financiar në tërësi, duke përfshirë këtu edhe lidhjet ndërmjet sferës financiare dhe ekonomisë reale.
- b) Lloji specifik i instrumentave, fusha e veprimit dhe mënyrat e tyre specifike të përdorimit.

Sa më shumë të njihet sistemi financiar dhe mënyra e “sjelljes” së tij, aq më të larmishme bëhen instrumentat dhe politikat rregulluese e mbikqyrëse financiare.¹⁰⁵

Mbikqyrja makroprudenciale

Mbikqyrja makroprudenciale ka për qëllim identifikimin dhe vlerësimin në kohë të zhvillimeve në lidhje me sistemin financiar, si dhe të paralajmërojë e të japë rekomandime (Bank of England, 2011). Sipas një përkufizimi të Bundesbank (2013) stabiliteti financiar është: *“aftësia e stabilitetit financiar që të përmbushë funksionet e veta kyçe në çdo kohë, në mënyrë të veçantë shpërndarjen e burimeve financiare dhe rreziqeve, si dhe të sigurojë një infrastrukturë financiare efikase”*.

Mbikqyrja e stabilitetit makroekonomik dhe financiar kërkon adoptimin e strukturave të referimeve makroprudenciale, të përcaktuara si një element ndihmës në përshtatje dhe përmirësimin e metodave të politikës monetare që funksionojnë edhe në ditët e sotme (Warwick Commission, 2010). Rregullimi makroprudencial ka si objektiv kryesor: garantimin e stabilitetit të sistemit financiar në tërësinë e tij, ju imponon autoriteteve rregulluese përmirësimin dhe kompletimin e analizës së rrezikut të riskut sistematik dhe ju kërkon atyre që të kenë në dispozicion instrumentat e nevojshëm për trajtimin e këtij risku (Bank of England, 2009).

¹⁰⁵ Adrian Civici “Revista Bankieri 2013”

3.7 Përshtatja dhe zhvillimi i politikave makroprudenciale

Një politikë makroprudenciale nuk është gjë tjetër veçse një orientim makroprudencial i rregullimit financiar. Ai përqëndrohet mbi riskun sistemik dhe paqëndrueshmërinë e variablave të sistemit financiar, tashmë të njohur dhe në karakterin transversal (të shtrirjes horizontale, në gjërësi) dhe dinamik (të shpejtësisë së shtrirjes) së këtyre risqeve (IMF, 2011a).

Me karakterin “transversal” kuptojmë riskun brenda institucioneve në një moment të caktuar, që ka për qëllim një vlerësim më të mirë të peshës së interesave, midis institucioneve financiare.

Karakterit “dinamik” i shtimit të riskut në kohë, kërkon zgjedhjen e karakterit prociklik të sistemit financiar. Sipas IMF (2011b) ekzistojnë tre faktorë të jashtëm, prej nga mund të krijohet risku sistemik:

- ✓ Faktorë që lidhen me likuidimin e aktiveve në rast katastrofe (fire-sale) gjatë fazës së tkurrjes të ciklit financiar dhe rënies së çmimeve të aktiveve, duke ndikuar në bilancin e bankave.
- ✓ Faktorë që lidhen me strategji imituese d.m.th që krijojnë dobësi të ngjashme me krizat bankare.
- ✓ Faktorë që lidhen me ndërveprimin, që çon në shtrirjen e stresit financiar nëpërmjet ndërvartësive kontraktuale të bankave.

Politika makroprudenciale fokusohet në frenimin e vatrave të riskut gjatë fazave të zgjerimit, si dhe korrigjon presionet e ndërhyrjes së transferuar nga jashtë. Për të realizuar këto objektiva, janë të nevojshme tre etapa (IMF, 2011b) :

- i) Etapa e analizës makroprudenciale, nëpërmjet mbikqyrjes së krijimit të risqeve .
- ii) Kontrolli i zbatimit të politikës makroprudenciale, nëpërmjet seleksionimit të indikatorëve të cilët zbulojnë drejtpërdrejt materializimin e këtyre risqeve.
- iii) Rregullimi makroprudencial, nëpërmjet krijimit dhe shfrytëzimit të instrumentave korrigjues dhe parandalues.

Për të kuptuar faktorët përcaktues të riskut sistemik dhe të përmasave të tij mund të ndërthuren etapat e mbikqyrjes dhe kontrollit. Këto përpjekje mundësojnë zbulimin e një risku të mundshëm. Zhvillimi i riskut bëhet me anë të zbatimit të modeleve parashikuese të konfiguruar si instrumenta rregullatorë. Kjo të fundit, shoqërohen me nevojën e zbatimit të instrumentave të kujdesit për shtrirjen e kredisë, të likuiditetit dhe të kujdesit të kapitalit (La note d’analyse, 2013). Risqet e jashtme mund të evitohen duke përdorur strategji të ngjashme me ato të institucioneve bankare dhe duke shfrytëzuar instrumenta të rregullimit të kapitalit.

Zgjerimi i rezervave në fondet bankare është një nga mënyrat që shërben si “amortizues goditjesh” në rast të ndonjë situatë kërcënuese të papritur. Bankat mbajnë paraprakisht fonde të veçanta në periudhën e zgjerimit, që të mundësojnë një efikasitet për të përmirësuar situatën e krizës, për të zbutur ngërçin në periudhën e ngadalësimit dhe për të kufizuar rrezikun e kredisë në periudhën e zgjerimit. Në këtë mënyrë, rritja e fondeve nga vetë bankat, i çon ato, t'i trajtojnë vetë kostot e krijuara prej huave të rrezikuara, kurse aspekti i tyre dinamik mund të ulë koston e adaptimit në rast situatash të papritura (IMF, 2011b).

Në rast se ka një risk të lartë krediti bankar, i cili është edhe një burim i paqëndrueshmërisë atëherë, instrumenti që mund të përfordhet dhe të përdoret në raste të tilla dhe që shërben si masë shtrënguese të drejtpërdrejt mbi sasi të kredisë bankare, është ai i raporteve hua-vlerë të bankës (LTV – loan to value ratio), që do të thotë në raportin midis një huaje dhe vlerës së tregut të aktivitetit që ai financon ose në raportet hua-të ardhura (interesave), nga menaxhimi i DTI (debt to income ratio). Për të sistemuar rreziqet e jashtme që lidhen me likuiditetet e aktiveve, rirforcimi i rezervave me fondet e veta, do të nxisë për të shitur aktivet e tyre me vlera të ulura në rast të një situatë të papritur (IMF, 2011a).

Në rast se këto shitje vijnë gjatë fazës së katastrofës nga rënia e tregjeve të rifinancimeve ose financimeve, sikurse edhe ndodhi gjatë krizës së fundit, është e nevojshme të kufizohet risku i likuiditetit që vjen nga financimi afatshkurtër.

Propozimet e Bazel III, përmbanin futjen e dy raporteve të likuiditetit (BIS, 2014).

1. Raportin për një periudhë afatgjatë, i cili është “*net stable funding ratio*.”
2. “*Liquidity coverage ratio*” raport ky, për një periudhë afatshkurtër.

Këto masa janë të pamjaftueshme, pasi ato e fokusojnë riskun e likuiditetit individual të institucioneve dhe nuk janë kundërciklike, por fikse¹⁰⁶ dhe aq më tepër, nuk marrin parasysh financimin afatshkurtër prej institucioneve jo të rregulluara (kontrolluara). Një instrument tjetër që parashikohet të përdoret është edhe taksa “a forfait” e mbështetur nga një financim afatshkurtër, që nxit kosto të mbuluara nga vetë banka për këtë financim të rrezikuar¹⁰⁷. Në këtë rast, duke mbuluar të dy anët e bilancit, detyrimet e kapitalit dhe masat e rregullimit të financimit afatshkurtër, do të jenë masa plotësuese. Kur risku është i lartë, institucionet financiare të ndërlidhura, mund t'i shfrytëzojnë instrumentat e lartpërmendura. Pra, në këtë kuadër themi se, kufizimet në përbërjen e aktiveve bankare, kufizojnë subvencionin e mbuluar

¹⁰⁶ Duke kërkuar një raport (ratio) të lartë likuiditeti gjatë një periudhe tensioni, nxitja (inkurajimi) i shitjes së aktiveve ose shitja me zbritje (ulje) është një masë e sforcuar.

¹⁰⁷ Perotti E. et Suarez J. (2011), “A Pigovian approach to liquidity regulation”, International Journal of Central Banking, vol. 7(4).


të institucioneve dhe shmangin operacionet e rrezikuara, të cilat nuk mbulohen prej tyre (La note d'analyse, 2013).

3.8 Indikatorët e paralajmërimit të krizës dhe politikat makroprudenciale të domosdoshme

Nga studimet e bëra, modeli i përdorur si indikator i krizës është në gjendje t'a tregojë atë dy vjet në avancë, me anë të vëzhgimit të rritjes së çmimeve të aseteve dhe kredisë (IMF, 2013b). Indikatorët paralajmërues nuk janë të përsosur në matjen e rrezikut të një krize financiare. Nga studimet e mëparshme është vënë re se, rritja e shpejtë e kredisë dhe bumet e kreditit, janë dy faktorët kryesorë që paralajmërojnë një krizë bankare (Laeven & Valencia, 2010). Këto indikatorë mund të paralajmërojnë 2-3 vjet para ngjarjes (FMN, 2011b dhe 2012a, Lund - Jensen, 2012, Dell'Ariccia, IGA, Laeven, Tong, 2012, BCBS, 2010c, Drehmann et al, 2012). Koha e ndërhyrjes kërkon kujdes, pasi duhet marrë parasysh natyra jo perfekte e sinjalit të dhënë dhe ndërhyrja, si pasojë e një sinjali të rremë. Në të tilla raste, dy mundësitë janë që të ndërhyet menjëherë për të zbutur pasojat ose të pritët derisa të merret një sinjal i fortë paralajmërues. Gjithashtu, bazuar në këto indikatorë paralajmërues, është e rëndësishme që politikëbërësit të marrin në konsideratë të gjitha arsyet pro dhe kundër, në shmangien e krizës ose reduktimin e saj (IMF, 2013b).

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Grafiku nr 2. Sinjalet paralajmëruese të krizave



Burimi: IMF, 2013b

Për të vlerësuar krijimin e risqeve sistemike duhen parë disa tregues. Sipas Blancher et al (2013) për ardhjen e projektit "SysMo", duhet të kombinohen modele të ndryshme dhe metoda, për të arritur në vendimin nëse: do të vepohet dhe kur? P.sh., treguesit dhe modelet në lidhje me rreziqet e ndërtimit brenda sektorit financiar duhet të kombinohen me modelet e çmimit të aktiveve për të parë nëse ka mbinxhje sektoriale. Përveç kësaj, modelet e parashikimit të krizave janë të dobishme në ndjekjen e probabilitetit të krizës. Politikëbërësit duhet të marrin vendim të bazuar pjesërisht në gjykim dhe pjesërisht në këto kombinime të ndryshme të këtyre modeleve (IMF, 2013b). Ata duhet të nisen nga një parashikim bazë, për të parë përfitimet dhe kostot e politikave makroprudenciale. Në parashikimin bazë përfshihen vlerësimet e politikëbërësve për riskun e krizës si dhe parashikimet e tyre për ecurinë e ekonomisë.

- Efektet anësore të politikave makroprudenciale

Politikëbërësit duhet t'i kushtojnë kujdes strukturës financiare të ekonomisë dhe të përdorin instrumentat makroprudenciale më efektive (IMF, 2013b). Efektet anësore ekzistojnë kur ka një shkëputje mes mbikqyrjes dhe rregullimit të subjekteve financiare dhe aktiviteteve dhe formave të ndërmjetësimit të këtyre subjekteve. Kur merren masa të ashpra nga politikat për veprimet bankare, me

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

institucionet e tjera ndodh e kundërta, duke funksionuar jashtë rregullave të lojës. Në rastet kur kufizohen operacionet lokale nga politikat makroprudenciale, atëherë subjektet i përhapin rreziqet diku tjetër (IMF, 2013b). Pasoja të tjera të papritura të politikave makro mund të jenë edhe migrimi i aktiveve në hijen e sektorit bankar, gjë që e bën të vështirë identifikimin e riskut sistemik. Aplikimi i politikave dhe mjeteve mund të çojë në çrregullime strukturore të sistemit financiar, i cili mund të ketë pasoja sistemike. Politikat e implementuara në një vend për të adresuar riskun e saj sistemik, mund të kenë pasoja të papritura në zhvendosjen e riskut në vende të tjera (IMF, 2013b). Sipas po të njëjtit studim, puna për efektivitetin dhe dukuritë e tjera që lidhen me instrumentat makroprudencialë është akoma në progres, pasi janë ende në fazë testimi. Ka ende shumë punë për t'u bërë në lidhje me modelin analitik që kombinon së bashku të gjithë elementët. Që të funksionojë politika makroprudenciale, përfitimet “*ex ante*” duhet të jenë më të larta sesa kostot (IMF, 2013b). Edhe pse kjo është një punë ende në progres, analizat po japin informacione të vlefshme. Performanca e indikatorëve paralajmërues është shumë e rëndësishme, pasi në rastin e reagimit ndaj sinjaleve të rreme ka kosto të larta financiare (IMF, 2013b). Jo të gjitha instrumentat e përdorura mund të japin efekte të menjeherëshme ose efekte në kohë. Për shembull, rasti i politikave të provigjionimit nuk është provuar akoma në shumë vende, por edhe në ato vende që janë përdorur këto të fundit, nuk kanë patur efekte të dukshme. Ndër masat që kanë dhënë më shumë rezultat dhe që kanë ndikuar në rritjen e kredive dhe rritjen e çmimeve të shtëpive, mund të përmendim kërkesat për rezervë, LTV si dhe peshën e riskut të kapitalit. Duke ndikuar në rritjen e kredisë dhe çmimet e aseteve, *këto tre instrumente mund të ulin shanset e krizës dhe rrisin ndjeshëm përfitimet e politikës* (IMF, 2013b). Përvoja ndërkombëtare tregon se rritja e kreditimit mund të jetë një parashikues i fuqishëm i krizave financiare. Monitorimi i rritjes së tepruar të kredisë është pika e fillimit për të vlerësuar riskun sistemik të krijuar. Dy studimet kryesore që shqyrtojnë kufijtë janë: Dell' Ariccia et al (2012) dhe FMN (2011) në Raportin Global të Stabilitetit Financiar (GFSR). Metoda e Dell' Ariccia-s sinjalizon për bumet e kreditit. Metoda e GSFR sinjalizon për krizat që kanosen për një periudhë 2-vjeçare. Sipas studimit të IMF, tregohet se kjo metodë parashikon më herët, sesa bumet e Dell' Ariccia. Në tabelën e mëposhtme tregohet një krahasim mes dy metodave. IMF ka marrë në studim disa shtete dhe me ngjyrë të kuqe është shënuar periudha në të cilën këto metoda paralajmërojnë krizën dhe me ngjyrë jeshile është shënuar metoda GFSR, ndërsa me të verdhë metodat e tjera (IMF, 2013b).

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

0 – Asnjë sinjal

1 – Metoda GFSR

2 – Metoda Dell'Arricia

3 – Të dy sinjalet

Tabela nr 7. Metodatat sinjalizuese të krizës

Vendet	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Shqipëria	0	0	0	0	0	0	1	1	1	1
Bosnia & Herzegovina	0	0	3	3	2	3	3	3	3	0
Bullgaria	0	0	3	3	3	3	3	3	3	
Kanada	0	1	0	0	0	1	1	0	0	
Kroacia	0	3	3	2	2	3	3	1	0	
Republika Çeke	0	0	0	0	0	3	3	3	1	
France	1	0	0	0	0	0	0	0	1	1
Finlanda	0	0	0	1	1	1	1	0	1	1
Gjermania	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1
Greqia	3	3	1	1	1	3	3	3	0	0
Italia	1	0	0	1	0	1	1	1	1	1
Hollanda	3	0	1	1	1	1	0	1	1	1
Rumania	0	0	0	3	2	3	3	3	1	
Spanja	1	1	1	3	3	3	3	3	1	1
Mbretëri e Bashkuar	1	1	1	1	1	1	3	3	3	1
SHBA	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Zvicra	0	0	0	1	0	1	1	1	0	1

Burimi: IMF,2013b

3.9 A u përshtaten të njëjtat instrumenta makroprudenciale të gjitha vendeve të prekura nga kriza?

Në disa prej këtyre vendeve janë bërë ndryshime në instrumentat makroprudencialë, me qëllim rregullimin financiar dhe mbikqyrjen. Vendet që janë goditur rëndë nga kriza, janë më të prirura për të bërë reforma. Ketu mund të përmendim Mbretërinë e Bashkuar, Belgjikën, Irlandën dhe SHBA (Nier, et al, 2011). Nëse mungon një kuadër efektiv i politikave makroprudenciale ose është i paperfillshëm, integrimi i madh financiar dhe tregjet financiare, mund të bëhen një kërcënim i vërtetë për stabilitetin ekonomik dhe financiar. Pavarësisht madhësisë së një vendi, krizat financiare mund të kenë efekte shkatërruese në ekonominë në të cilat mund të rrezikojnë shkrirjen e qeverive dhe kapërcimin e kufijve kombëtarë. Marrëveshjet efektive bëjnë të mundur që autoritetet të marrin masa parandaluese, të cilat

janë të dëshirueshme dhe të nevojshme për të gjitha vendet, pavarësisht shkallës së tyre të zhvillimit (IMF, 2011b).

"Një rregull nuk i përshtatet të gjithëve" kështu që marrëveshjet duhet të marrin parasysh kushtet lokale të vendit. Disa vende caktojnë një vlerë më të madhe për të arritur një konsensus të gjerë, para se të ndërmerren veprimet, ndërkohë që ka vende të tjera që përdorin kontrollat. Ndërsa bilanci shihen për të kontrolluar abuzimet e kompetencave nga politikëbërësit, duke përfshirë këtu edhe bankën qendrore. Marrëveshjet institucionale për rregullat financiare dhe të mbikqyrjes janë shpesh të rrënjësura thellë në histori dhe bazohen në kuadrin ligjor. Autoritetet duhet të jenë të vetëdijshme për kostot e larta të tranzicionit që mund të krijohen nga një rishikim radikal i marrëveshjeve institucionale, kur marrëveshjet ekzistuese nuk kanë "dështuar" në mënyrë të dukshme. Në disa vende të tjera, zgjedhja e modelit të mund të ketë kufizime ligjore dhe kushtetuese (Nier, et al, 2011).

- A ka një model të vetëm që i përfshin të gjitha?

A ekziston një model i vetëm institucional makroprudencial, i cili mund të funksionojë për një numër të madh vendesh? Apo një rregull makroprudencial nuk i përshtatet të gjithëve? Madhësia dhe kompleksiteti i sistemit financiar, si dhe niveli i konkurrencës ndërmjet institucioneve, mund të kenë një influencë në përzgjedhjen e modelit makroprudencial. Eksperienca ka treguar se në ekonomitë e hapura edhe një sistem i thjeshtë financiar, mund të zgjerohet me shpejtësi dhe të bëhet më kompleks, duke shkaktuar risk sistematik.

Shembull tipik është Islanda, ku raporti i aktiveve ndaj PBB-së u rrit nga 200 % në 1000 % për disa vite (2003-2008), me burim kryesisht nga zgjerimi i tregjeve të financimit. Tregjet e shitjes me pakicë (p.sh. kredite hipotekore në monedhë të huaj) dhe risitë e produktit me shumicë (p.sh. shkëmbimet e kredive), mund të ndryshojnë natyrën dhe forcën e ndërlidhjeve, në kuadër të sistemit financiar, si dhe forcën e reagimeve makro-financiare, në përgjigje të goditjeve agregate (siç ishte përvoja e disa vendeve në krizën e fundit). Pra, mund të ndryshojë shpejt madhësia dhe kompleksiteti i sistemit financiar. Ato, mund të mos jenë një forcë shtytëse në përzgjedhjen e modelit institucional.

Regjimi i politikës monetare - mund të ndikojë në zgjedhjen e modelit makroprudencial. Në rastet që banka qendrore ka ndikim të vogël në politikën monetare, mund të reduktohet reputacioni ndër-shtetëror i kësaj banke, në funksion të politikës makroprudenciale (Nier, et al, 2011).

Burimet në dispozicion - përfshijnë një gamë njohurish teknike, si dhe aftësinë e institucioneve për të paguar staf të trajnuar dhe për të patur menaxhim të niveleve të larta. Vendet që mundësojnë këto kërkesa, kanë gjasa të përfitojnë me efektivitet nga aplikimi i politikës makroprudenciale. Në ato

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

vende, ku nuk është e lehtë për të patur staf të kualifikuar, siç ndodh në vendet në zhvillim ose ato me të ardhura të ulëta, mund të ketë një përfitim më të madh nga burimet në dispozicion.

Historia e strukturave ekzistuese institucionale - Goodhart & Schoenmaker (1995) shpjegojnë se si dallimet historike në rolin e bankave qendrore si ofrues të burimeve, kanë formuar shkallën në të cilën bankat qendrore në Europë gradualisht, kanë zënë një rol rregullator dhe mbikqyrës. Vendet në të cilat bankat qendrore janë krijuar së fundmi kanë përvojë të ndryshme. Modeli themelor institucional mund të ketë ndikim në mandatin e institucionit që është caktuar për makroprudencialitetin.

Ekonomia politike – Problemet e ekonomisë politike, janë objekt lobimi i fortë i grupeve të veçanta të interesit dhe kërkon ekspertizë teknike. Megjithatë, institucionet mund të përfshijnë bankat qendrore, dhe në disa raste mund të preferojnë debat më të madh politik dhe ndarje organike të pushteteve (Nier, et al, 2011).

Traditat ligjore - ndikojnë në zgjedhjen e modelit. Për shembull, mbrojtja me kushtetutë e autonomisë së agjensive, mund të jetë një pengesë ligjore për çdo model që përfshin udhëzime të detyrueshme ndërmjet tyre.

Faktorët e mësipërm, mund të kenë një efekt të fortë në zgjedhjen e modelit. Përmasat dhe kompleksiteti i sistemit financiar dhe i kornizës ekzistuese të politikës monetare, pritet të ketë vetëm një efekt relativisht të butë në zgjedhjen e modeleve.

Jo të gjitha modelet institucionale, janë po aq të favorshme për një politikë makroprudenciale efektive, edhe pse zgjedhja e marrëveshjeve institucionale për politikë makroprudenciale, duhet të marrë parasysh kufizimet specifike të vendit. Dobësitë mund të mbulohen duke implementuar masa mbrojtëse apo mekanizma shtesë, por ato nuk mund të funksionojnë mjaftueshëm, aq sa për t'a kthyer dobësinë në forcë dhe t'a bëjnë modelin më efektiv (IMF, 2011). Marrëveshjet jo-formale janë më pak elastike ndaj sjelljeve jobashkëpunuese të njerëzve, të cilat mund të vërehen në çdo shoqëri. Formalizimi i proceseve me anë të institucioneve ose mekanizmave, mund të kufizojnë rreziqet e lidhura me ndryshimet në individë të rëndësishëm, stimujt si dhe cilësinë e marrëdhënieve personale.

Cilat janë kushtet që duhet të plotësohen për çdo model të caktuar, që të funksionojë më mirë?

- Strukturat mbikqyrëse dhe rregullatore, të cilat janë të ndara dhe komplekse, nuk kanë shanse të favorizojnë në tërësi zbutjen efektive të risqeve sistematike. Mund të ndodhë që ndarja të zvogëlojë efikasitetin e identifikimit të riskut, si dhe të rrisë mundësinë që sistemi financiar të arrijë të zhvillohet në mënyra të cilat rrezikojnë stabilitetin e sistemit në tërësi. Për shkak të nevojës për marrjen e vendimeve kolektive, ndarja e strukturave mund edhe të sjellin pakënaqësi, të cilat zvogëlojnë shanset e kthimit të rrezikut. Kur tregu i letrave me vlerë, mbikqyrja mikroprudenciale,

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

ndodhen jashtë bankës qendrore, atëherë lidhja institucionale e cila kalon ndër këto funksione të politikës, mund të jetë ndihmë për identifikimin e risqeve dhe zbutjen e tyre (Nier, et al, 2011).

- Një rol të rëndësishëm në politikën makroprudenciale, duhet të luajë edhe banka qendrore për të shfrytëzuar ekspertizën në dispozicion, si dhe të sigurojë ndërveprim me funksionet e tjera të bankës qendrore, duke përfshirë sigurimin e likuiditetit, politikën monetare, si dhe mbikqyrjen e sistemeve të pagesave.

- Menaxhimi i krizës, si dhe parandalimi i riskut sistemik janë funksione të ndryshme politike, të cilat duhet të mbështeten nga marrëveshje të veçanta.

Për të plotësuar kërkesat e palëve, ndodh që në shumë raste mund të jetë e drejtë të lindin marrëveshje për politikë makroprudenciale, të veçuara këto nga struktura e administrimit të krizës (IMF, 2011f).

- Në fushën e analizimit, identifikimit efektiv, si dhe të monitorimit të riskut sistemik, duhet të merren parasysh disa aspekte të renditura, si më poshtë:

Mekanizmi për shpërndarjen e informacionit duhet të jetë gati. Duhet të sigurohet informacionit i nevojshëm, si dhe gatishmëria e të dhënave dhe për vlerësimin e risqeve sistematike. Kjo realizohet duke eliminuar pengesat ligjore për ndarjen e të dhënave, dhe duke krijuar mekanizma specifikë për centralizimin e informacionit dhe për mbledhjen e të dhënave. Duhet të sigurohet informacioni i nevojshëm për vlerësimin e riskut sistemik nga të gjitha palët që kanë akses te të dhënat.

- Mandati makroprudencial duhet t'i caktohet vetëm një institucioni , pra komisionit vendimarrës, i cili mund të jetë përgjegjës për përmbushjen e objektivave. Për të siguruar bashkëpunimin me organin kryesor ose komitetit të politikave, duhet vendosur stabiliteti financiar në mandatin e disa institucioneve. Ndarja e mandatit makroprudencial nëpër disa organe mund të çojë në probleme të cilat reduktojnë përgjegjshmërinë dhe stimujt të cilat mund të jenë të vështira për t'u kapërcyer.
- Një institucion, i cili është i përfshirë në analizën e riskut sistemik, duhet të ketë akses në të gjitha informacionet e disponueshme. Analizat e pjesshme duke marrë parasysh edhe natyrën komplekse të ndërveprimeve brenda sistemit financiar, nuk mund të kenë të njëjtin vlerësim.
- Bankat qendrore kanë shpesh rol kryesor në vlerësimin e riskut, pasi vlerësimi i riskut sistemik përfshin një analizë komplekse të sistemit financiar, si dhe të lidhjes së tij me ekonominë.
- Institucionet janë ato që duhet të promovojnë vullnetin për të vepruar dhe zvogëluar rrezikun e veprimit. Me anë të ligjeve ne fuqi, përcaktohet dhe një mandat për të marrë informacionet në lidhje me veprimin në kohën e duhur dhe efektivitetin e politikave makroprudenciale.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Këtë mandat duhet t'a marrin ato institucione, objektivat e së cilave lidhen me objektivin e politikës makroprudenciale. Për këto institucione, mosveprimi, ka kosto të lartë (Nier, et al, 2011).

- Mekanizmat e llogaridhënies nuk duhet të lejojnë shumë hapësirë për të lobuar për politika makroprudenciale, për interesa të veçanta. Këto mekanizma duhet të projektohen në mënyrë të tillë, ku nuk çenojnë efektivitetin e politikës makroprudenciale. Nga ana tjetër këto mekanizma duhet të ofrojnë mbrojtje nga politikat makroprudenciale tejet kufizuese. Ato mund të kërkojnë një shkallë të lartë transparence, përfshirë publikimin e një strategjie politike dhe komunikimin e vendimeve.
- Ndarja institucionale mes kontrollit mbi mjetet e politikës dhe vendimeve politike, duhet shmangur. Me anë të mekanizmave mundësohet drejtimi i veprimtarisë së agjencive të ndryshme, ndërkohë që ruajnë autonominë e tyre institucionale. Këto mund të jenë në formën e rekomandimeve jo detyruese. Një mundësi tjetër mund të ishte ndërtimi i instrumentave specifike makroprudenciale dhe përdorimi i tyre nga vendimmarrës të politikave makroprudenciale (Nier, et al, 2011).
- Integrimi institucional i funksioneve rregullatore financiare brenda bankës qendrore, mund të mbështesë koordinimin efektiv të politikës makroprudenciale me atë monetare, si dhe me politikën mikroprudenciale, por kjo kërkon masa mbrojtëse. Politikat makroprudenciale nuk duhet të jenë një mjet që ndikon në pavarësinë e politikës monetare. Në shumë raste, mekanizmat e veçantë të llogaridhënies për politikë monetare dhe makroprudenciale kanë gjasa të jenë më të dobishëm.

Kur pushtetet vendimarrëse ndahen midis disa agjensive, është e nevojshme të krijohet një komitet koordinues, që do t'i ndihmojë autoritetet të kenë një vlerësim të përbashkët rreth risqeve (Nier, et al, 2011).

3.10 Efektiviteti dhe kostot që shoqërojnë instrumentat makroprudencialë

- Efektiviteti i mjeteve makroprudenciale

Sipas Turner (2010), analizat empirike për efektivitetin e instrumentave makroprudenciale, japin një informacion shumë të kufizuar. Për më tepër, mungon një informacion në lidhje me vijueshmërinë e këtyre instrumentave për të ardhmen. Eksperiencia me instrumentat makroprudenciale në Spanjë ka treguar se provigjionimi ka patur një ndikim të vogël në rritjen e kredisë (BIS, 2011). Konstatohet se, provigjionet dinamike edhe pse nuk japin shumë garanci për përballimin e humbjeve të kredisë, kanë treguar se kanë qenë të dobishme në Spanjë gjatë krizës së fundit financiare. Efektiviteti i tyre ka qenë në rritjen e elasticitetit të sistemit bankar në tërësi dhe të bankave në veçanti (Borio & Shim, 2007).

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Sipas Nadauld dhe Sherlund (2009) eksperiencia me SHBA, tregon se rritja e kërkesave të kapitalit mund të kufizojë rritjen e fluskës. Lo (2009) propozon se një agjensi e re e pavarur, duhet të mbledhë të dhënat për çmimet e tregut, për asetet dhe aktivet, si në bilanc, ashtu dhe jashtë tij, detyrimet të firmave financiare amerikane, në mënyrë që të monitorohen levat, si dhe kushtet e likuiditetit në sistemin bankar, gjithashtu edhe ndjeshmëria e portofolit ndaj ndryshimeve ekonomike (BIS, 2011).

Vështirësia në marrjen e të dhënave që nevojiten për studimet empirike në lidhje me instrumentat makroprudenciale ka qënë dhe një nga faktorët që ka ndikuar në mungesën e modeleve të përcaktuara të lidhjes në mes të makroekonomisë dhe sistemit financiar. Ekzistojnë pak të dhëna në literaturë për qëllimet e politikës makroprudenciale (BIS, 2011). Sibert (2010), sugjeron se një agjensi në zonën e euros, duhet të mbledhë të dhëna të ngjashme me ato të SHBA. Këto të dhëna sipas tij, do të përdoren vetëm për të matur simptomat, dhe jo shkaqet e paqëndrueshmërisë financiare, duke patur vështirësi në interpretimin e të dhënave të riskut sistemik. Kjo gjë bën që edhe vlerësimi i ndërlidhjes me pasojat e rrjetit të mos jetë i plotë (BIS, 2011). Një çështje e rëndësishme që mbetet e hapur është se si të trajtohet çështja në dimensionin ndërkombëtar, që deri më tani ka prekur vetëm aspektin e lëvizjeve të mëdha të kapitalit dhe të cikleve jo të sinkronizuara të biznesit. Problemi qëndron në arbitrazhin rregullator për vetë faktin se, huadhënia ka pasoja në efektivitetin e instrumentave makroprudenciale. Ky problem ndeshet në Eurosistem dhe ka qënë objekt i diskutimeve për ESRB. Një çështje tjetër po aq e rëndësishme është nëse duhet të kufizohet risku i likuiditeteve në monedhë të huaj, nëpërmjet instrumentave makroprudenciale (BIS, 2011). Politika makroprudenciale, në mënyrë që të jetë e efektshme, kërkon një perspektivë shumëpalëshe. Problemet e veprimit kolektiv ndodhin jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe ndërkombëtar. Edhe në rastet kur vendet kanë një politikë makroprudenciale shumë të mirë, kombinimi i përgjithshëm i politikave makroprudenciale të secilit vend, mund të jetë po aq i mirë në rastin kur ciklet financiare nuk janë të sinkronizuara në të gjithë vendet ose kur ndërmjetësit sistemikë mund t'i shmangen këtyre politikave të marra nga autoritetet kombëtare. Integrimi financiar paraqet një sërë sfidash specifike për efektivitetin e politikave kombëtare makroprudenciale (IMF, 2013c).

- Së pari, politikat kombëtare që përmbajnë rreziqet e krijuara nga një rritje e shpejtë e kreditit të brendshëm mund të çojnë në rritjen e privilegjonimit të kreditit “cross-border”(ndërkufitar).
- Së dyti, në një vend mund të rritet mundësia e krizave si pasojë e mosveprimit me forcë të instrumentave makroprudencialë, gjë që ndikon negativisht në vendet e tjera.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

- Së treti, në vendet ku institucionet financiare kanë partnerë me juridiksione të shumëfishta, komplikohet vlerësimi i riskut sistemik dhe mund të çojë në mosmarrëveshje midis autoriteteve vendase dhe atyre pritëse.
- Së katërti, politikat për forcimin e qëndrueshmërisë së institucioneve sistematike në një vend, mund të shkaktojnë aktivitetet e tyre, për të emigruar në vende të tjera.

- **Cilat janë kostot e aplikimit të një instrumenti makroprudencial?**

Zbatimi i instrumentave të politikave makroprudenciale ka shpenzime afatshkurtër, veçanërisht në aspektin e humbjeve të prodhimit. Sa më i gjerë të jetë efekti i elementit makroprudencial dhe sa më e shtrënguar të jetë vendosja e tij, aq më i kushtueshëm do të jetë implementimi i atij instrumenti. Studime të ndryshme tregojnë se kostot e disa mjeteve të sistemit të gjerë, siç janë kërkesat e kapitalit, nuk mund të kenë kosto të konsiderueshme në krahasim me përfitimet e mundshme të tyre (CGFS, 2012). Kostot e përshtatjes së këtyre instrumentave përcaktohen pjesërisht edhe nga kostot administrative dhe ato të mbikqyrjes së implementimit. Ekziston tendenca për të favorizuar mjetet, që mbështeten në mjetet ekzistuese mikroprudenciale.

Pasi zgjidhet një instrument, bëhet projektimi dhe kalibrimi i tij (CGFS, 2012). Mungesa e aplikimit të instrumentave makroprudencialë në një vend, mund të rrisë probabilitetin e krizës. Si pasojë e lidhjeve të forta financiare që janë krijuar ndërmjet vendeve, kur një krizë financiare shpërthen në një vend, ajo ndjehet në gjithë rajonin ose në gjithë botën. Mungesa e parandalimit për të përmbajtur riskun sistemik, mund të imponojnë kosto të konsiderueshme në vendet e tjera (IMF, 2013c).

KAPITULLI IV

“Kur shkruhet në gjuhën kineze fjala "krizë" është e përbërë nga dy karaktere: i pari përfaqëson rrezikun dhe tjetri përfaqëson mundësinë”.

John F. Kennedy

4. Banka Qëndrore Europiane dhe roli i saj në krizën e fundit

BQE është një nga institucionet kryesore, që menaxhon vendet që përdorin monedhën euro, dhe ruan stabilitetin e çmimeve në BE. Ajo është përgjegjëse për kuadrimin dhe implementimin e politikave monetare dhe ekonomike të BE-së. Qëllimi i saj kryesor është që të mbajë çmimet stabël, të kontrollojë inflacionin (Scheller, 2006). Detyra tjetër e është që të mbajë sistemin financiar të qëndrueshëm, duke siguruar një mbikqyrje të plotë mbi institucionet dhe tregjet financiare. BQE bashkëpunon me bankat qëndrore të 28 vendeve të Komunitetit Europian (KE). Ato së bashku formojnë sistemin europian të bankave qëndrore (European System of Central Banks –ESCB).

BQE drejton bashkëpunimin ndërmjet bankave qëndrore në eurozonë, të 17 shteteve europiane, që aktualisht përdorin monedhën euro. Kjo bankë mbikqyr, duke kontrolluar prerjen e monedhave dhe luhatjet e normave të interesit. Struktura është e përbërë nga tre borde vendimarrëse (IMF, 2011a):

- Këshilli i përgjithshëm: është këshilluesi më i madh i BQE-së dhe përfshin të gjithë guvernatorët e bankave qëndrore të Europës, si presidentin ashtu edhe zv/presidentin e BQE-së.
- Bordi ekzekutiv: menaxhon veprimet e përditshme dhe veprimet vendimarrëse. Ai përbëhet nga presidenti dhe zv/presidenti i BQE-së, si dhe 4 anëtarët e zgjedhur nga Këshilli Europian.
- Këshilli qeverisës: përbëhet nga bordi ekzekutiv dhe gjithë guvernatorët e bankave qëndrore të eurozonës. Ai adapton vendimet mbi politikat monetare të eurozonës.

Në fillimet e krizës 2007 u diskutua shumë edhe roli i BQE-së. Pjesa më e madhe e politikëbërësve kërkonin që BQE-ja të vepronte, duke blerë borxhin e këtyre vendeve në tregun dytësor për një kohë të pacaktuar, gjë e cila nuk përfshihej në mandatin e saj. BQE krijoi një raund të ri për blerjen e bonove, për të ulur kostot e borxheve të shteteve të eurozonës, të cilat po kalonin një periudhë të vështirë. Për vendet anëtare, kjo do të thoshte “kushte strikte buxhetore” (IMF, 2011a): Kjo ishte edhe rrjedhoja e fuqizimit të rolit të BQE-së si mbikqyrëse e bankave më të mëdha të eurozonës, gjithashtu kjo do të

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

nxiste dhe integrimin europian¹⁰⁸(Alessi, 2012). Hanspeter K. Scheller¹⁰⁹ shkruan se: BQE ka një mandat të saktë dhe qartë; ajo ka përgjegjësi të mëdha përpara qytetarëve dhe përfaqësuesve të tyre, për zbatimin e këtij mandati. Gjithashtu, BQE ka edhe përgjegjësi ekskluzive për të centralizuar politikën e kursit të këmbimit, si dhe një politikë të vetme monetare për eurozonën. Me qëllim për të arritur një stabilitet në çmime, BQE duhet të vendoste normat bazë të interesit për eurozonën dhe si rrjedhojë, të mbante normat e inflacionit më pak se 2% në periudha afatmesme (IMF, 2011a).

Disa përgjegjësi të tjera të BQE sipas Alessi (2012), janë se ajo duhet të:

- Të monitorojë luhatjet e çmimeve.
- Të menaxhojë rezervat valutore të eurozonës, për të mbajtur kursin e këmbimit nën kontroll.
- Është emetuesi i vetëm i kartmonedhave dhe rezervave bankare.
- Autorizon bankat qendrore kombëtare për të nxjerrë kartmonedhat.
- Ndhmon autoritetet kombëtare, për të mbikqyrur tregjet financiare dhe institucionet financiare.

Krizat financiare e kanë detyruar BQE-në, të dalë jashtë rolit të saj tradicional. “Reagimi i ngadalshëm i autoriteteve europiane për krizën e fundit krijoi një vakum, që e ka detyruar BQE të ndërhyjë menjëherë dhe me vendosmëri, si institucioni i vetëm mbikqyrës në eurozonë, kur më parë nuk ka qënë praktikë e saj¹¹⁰.

4.1 Masat makroprudenciale që përdori Banka Qendrore Europiane

Politika monetare e BQE-së është përgjegjëse për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve në zonën e euros. Pra, u bë e domosdoshme që kjo politikë e vetme monetare të hynte në fuqi në të gjitha vendet anëtare (ECB, 2013). U dallua qartë se gjatë krizës, transmetimi i sinjaleve të politikës monetare nuk ishin të njëjta në të gjitha vendet. BQE në 9/08/2007, mori disa vendime të jashtëzakonshme, modifikoi strukturën operacionale, si dhe përdori një sërë masash të cilat duke u ndërthurur me veprimet e qeverive të eurozonës, luajtën një rol të rëndësishëm në parandalimin e një dështimi financiar (ECB, 2013).


¹⁰⁸ The Role of European Central Bank September 2012

¹⁰⁹ Hanspeter K. Scheller, 2006, The European Central Bank: History, Role, and Functions

¹¹⁰ Economist – Tetor 2011.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Grafiku nr 3. Struktura e mbikqyrjes makroprudenciale në Bashkimin European (BE).



Burimi : <http://www.esrb.europa.eu>

Në gusht të vitit 2007 kur filloi kriza, BQE reagoi shpejt duke ofruar likuiditet shtesë përkohësisht për bankat në nevojë (IMF, 2011a). Përveç reduktimit të normave të interesit në përgjigje të krizës, u ndërmorën një sërë masash të jashtëzakonshme, të cilat u quajtën masa "jo-standarte" dhe kishin të bënin me menaxhimin e likuiditetit, në mënyrë që këto politika monetare të ishin sa më të efektshme. Këto masa "jo-standarte", plotësonin listën e masave standarte që përdoren edhe përpara kësaj krize. Vendimet e BQE-së për normat e interesit, synonin stabilitetin e çmimeve, ndërkohë që ato jo-

standartet bënin të mundur, që efekti i dëshiruar i këtyre vendimeve, të përhapej në të gjithë eurozonën (ECB, 2013). Ndër masat jo-standarde që u ndërmorën mund të përmendim:

- Politikën për ndarjen e plotë të rifinancimit, përkundrejt kolateralit.
- Zgjatjen e maturimit të rifinancimit deri në tre vjet dhe zgjerimin e strukturës së kolateralit.

Këto masa mundësonin sigurimin e kredive për institucionet e kreditit. U vëzhgua se, kushtet e financimit të tregut, në shumicën e rasteve karakterizoheshin nga frika dhe stresi i pjesëmarrësve të tregut. Trichet (Trichet J.C, 2009) në një fjalim të tij listoi disa masa që ndërmori BQE. Ai theksonte se: “Në mes të shtatorit të vitit 2008 BQE përdori një mënyrë të re të sigurimit të likuiditetit, duke ofruar një rifinancim mbi nivelet që bankat kishin marrë për rezervat në kohë normale. Gjithashtu, BQE përshtati rifinancimet, pra përdori një “normë fikse ” dhe zgjati në kohë maturimin e operacioneve”.¹¹¹

Masat e lartpërmendura nuk do të funksionin, nëse nuk do të kishte një numër të madh të palëve pjesëmarrëse në operacionet e rifinancimit. Listës së gjatë iu shtua një numër i konsiderueshëm pjesëmarrësish, pas ndryshimeve të bëra në tetor të vitit 2007 (ECB, 2013). Masa të tjera u morën në takimin e muajit maj të vitit 2007 të Këshillit Drejtues të BQE-së. Njëra nga këto masa ishte: zhvillimi i likuiditetit nëpërmjet sigurimit të rifinancimeve afatgjata për një periudhë 12 mujore, gjë që do të zgjaste më tej maturimin e likuiditeve, që BQE-ja u jepte bankave të tjera me një normë fikse.

Përfshirja e Bankës Europiane të Investimeve në politikat monetare të Eurosistemit kishte qëllim që të mundësonte akses në likuiditetet e kësaj banke, si dhe plotësimin më me lehtësi të kërkesave shtesë, nëpërmjet programit të saj të huadhënies (ECB, 2009).

4.2 Roli dhe detyrat e Bordit European të Riskut Sistemik

Bordi European i Riskut Sistemik (ESRB) u themelua në vitin 2010 si pjesë e një reforme, që kishte për qëllim, që të përmirësonte mbikqyrjen financiare në Komunitetin European (KE). Ai ka një numër të konsiderueshëm detyrash, që përfshijnë monitorimin dhe vlerësimin e riskut, matjen e tij, si dhe adaptimin e politikave, në përgjigje të këtij risku. Monitorimi i riskut bëhet duke analizuar informacionin e mbledhur me anë të indikatorëve financiarë të stabilitetit ose indikatorëve paralajmërues. Risqet identifikohen dhe kategorizohen sipas rëndësisë, duke vlerësuar implikimet e mundshme. Në kuadrin e politikave, pasi bëhet analizimi, ESRB-ja mund të japë paralajmërime dhe


¹¹¹ECB, 2009 : Jean –Claude Trichet (International Symposiumk marking the 50th anniversary of Bank Al-Maghrib)

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

rekomandime. Paralajmërimet kërkojnë vëmendjen e të adresuarve, përkundrejt riskut sistemik të identifikuar, pa ndonjë përshkrim të detajuar të veprimeve që duhen ndërmarrë. Rekomandimet përfshijnë këshilla mbi veprimet që duhen marrë, në lidhje me këtë risk (ESRB 2012). Organizmat të cilëve ESRB-ja u drejtohet me paralajmërimet dhe rekomandime janë: Bashkimi European (BE), shteteve anëtare të BE, si dhe autoriteteve mbikqyrëse kombëtare në BE. Një nga sfidat për ESRB-në në mbikqyrjen e riskut sistemik, është edhe zhvillimi i një prespektive makroprudenciale, duke marrë parasysh mbikqyrjen në nivelin mikro. Bordi i përgjithshëm i ESRB, ka në përbërjen e tij guvernatorë të bankave qendrore dhe funksionarë të lartë të autoriteteve mbikqyrëse financiare nga të gjitha vëndet anëtare të BE, presidentin dhe zv/presidentin e BQE-së, një anëtar të Komisionit European, si dhe tre anëtarë të European Supervisory Authority (ESA).

Grafiku 4. Struktura e funksionimit të ESRB-së

Struktura e funksionimit të ESRB-së



Burimi: <http://www.esrb.europa.eu>

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

- Masat makroprudenciale të Bordit European të Riskut Sistemik (ESRB)

Listuar sipas tabelës së mëposhtme, në përgjithësi ekzistojnë tre lloje instrumentash (Gerlach, 2013).

Tabela nr 8. Llojet e instrumentave makroprudenciale

Objektivat	Instrumentat
Forcimi i aftësive ripërtëritëse të infrastrukturës financiare	• Rritje e publikimeve për informacionin financiar • Kërkesa për marzhin reduktues për klering • Amortizatorë për riskun sistemik strukturor
Parandalimi dhe zbutja e rritjes së kreditimit dhe i levës financiare	• Amortizatorë kundërciklik të kapitalit • Kërkesa kredi, të ardhura/borxh • Raporti makroprudencial i levës financiare • Kërkesa sektoriale të kapitalit
Parandalimi dhe zbutja e mospërputhjes në maturitetet dhe likuiditetet e tregut	• Modifikime makroprudenciale në raportin e likuiditetit (psh. raporti për mbulimin e likuiditetit) • Kërkesa për marzhin reduktues • Kufizime jo të ponderuara makroprudenciale për financime më pak të qëndrueshme • Kufizime makroprudenciale në burimet e financimit
Kufizimi indirekt dhe direkt i ekspozimit	• Kufizime për ekspozimet e mëdha • Kërkesa për pjesëmarrësit në kleringun qëndror
Kufizimi i impaktit sistemik të inçentivave të lidhura jo në mënyrë të drejtë, për reduktimin e rrezikut moral	• Mbifaturime për kaptalet e institucioneve financiare sistemikisht të rëndësishme

1. Instrumenta të likuiditetit: kanë për qëllim të sigurojnë që bankat të kenë likuiditet të mjaftueshëm, për t'i bërë ballë goditjeve të mundshme. Këto instrumenta, gjithashtu përfshijnë edhe kufizime të mospërputhjes në maturitete dhe kërkesat për rezerva (Gerlach, 2013).
2. Instrumenta të kapitalit: synojnë të reduktojnë trendin e rrezikshmërisë, duke rritur kështu koston e bankave dhe për të ndërmarrë masa të caktuara, duke rritur kërkesat e kapitalit për këto aktivitete. Amortizatorët kundërciklikë të kapitalit dhe sigurimi i dinamikave për rezervat e kredive të humbura, janë disa shembuj të instrumentave të kapitalit (Gerlach, 2013).
3. Instrumentat e kreditit: synojnë të kufizojnë akumulime të rrezikshme ose përqëndrime në kreditë bankare. Këto instrumenta përfshijnë njëkohësisht masa indirekte të tilla si, limite mbi raportin kredi-vlerë (LTV) dhe raportin borxh-të ardhura (DTI) dhe masa direkte të tilla si, tavani për kreditë ose tavan mbi rritjen e kreditimit (Gerlach, 2013).

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Ekzistojnë edhe instrumenta të tjerë që lidhen me disa fusha të politikës, siç është për shembull, politika e konkurrencës e cila kufizon apo inkurajon konkurrencën ose politika monetare, ku mund të përmendim kërkesat e rezervës dhe nivelin e normave afatshkurtra të interesit. Këto instrumenta mund të përdoren për të mbështetur politikën makroprudenciale. Nëse këto instrumenta makroprudenciale nuk janë nën kontrollin e politikëbërësve, ato nuk përbëjnë politikën makroprudenciale dhe në rastin më të mirë nuk kanë gjasa për të luajtur më shumë sesa një rol dytësor (IMF, 2013).

Tabela nr 9. Shembuj të disa masave makroprudenciale të marra nga bankat qendrore

Masat mikroprudenciale		Masat e bankave qendrore	Masat fiskale
Dimensione “cross-section”	Dimensione të përkohshme		
- Rregullat mbi kapitalin minimal - Raporti stabël i financimit - Raporti i mbulimit të likuiditetit - Rregulla mbi rrezikun e kreditimit - Limite mbi ekspozimin e kreditimit	- Masa mbrojtëse të marzheve të kapitalit - Provigjione dinamike - Pesha e rrezikut të aseteve nën tryshninë e ciklit ekonomik - Raporti i levës - Limitet e raportit të kredisë drejt kostos së shtëpive - Kufijtë e variablave “haircuts” në vlerësimin e instrumentave financiare	- Rishikimi i termave për marrjen e likuiditeteve ose përdorimi i infrastrukturave të pagesave - Ndryshimet e rregulloreve mbi rezervat bankare	- Taksa mbi institucionet me rëndësi sistemike - Rregullore mbi zbritjen e interesave të paguara nga debitorët.
-Rritja e intesitetit të mbikqyrjes -Rregulla për trajtimin e bankave të dobëta -Rregulla mbi pagat			

Burimi: IMF (2011b)

Sipas IMF(2011b), masat makroprudenciale në shumicën e rasteve janë të lidhura me fusha të tjera, por nuk janë të pakta rastet kur ato kanë natyrë mikroprudenciale. Është e nevojshme që:

- Të qartësohen mandatet e supervisorëve për mbikqyrjen makroprudenciale.
- Të menaxhohen konfliktet e mundshme ndaj autoriteteve mbikqyrësve.
- Të jetë e qartë dhe e mirëpërcaktuar hierarkia e objektivave.
- Të vendosen kritere të qarta për përdorimin e masave, për të arritur objektivat makro.
- Të vlerësohet ndikimi dhe mekanizmat e bashkëveprimit ndërmjet masave të ndryshme.

4.3 Instrumentat dhe ndërhyrjet e Bankës Qëndrore Europiane¹¹²

Një pjesë e rëndësishme e zhvillimit të instrumentave makroprudenciale është përshtatja e mjeteve ekzistuese mikroprudenciale, (psh kërkesat për të mbajtur kapitalin dhe likuiditet të lartë) dhe limitin e aktiviteteve. Qëllimi është që këto instrumente, të përshtaten në mënyrë dinamike në përgjigje të rreziqeve financiare (CGFC, 2011).

- Specifikat e instrumentave makroprudenciale

Këto instrumenta synojnë të kombinojnë efektet e dy dimensioneve të riskut sistemik, si dhe të adaptohen sa më mirë me dy fazat që karakterizojnë ecurinë e këtij risku. Gjatë fazës së parë, që është ajo e *akumulimit të riskut*, këto masa “preventive”, duhet të rrisin rezistencën e sistemit financiar dhe të kontrollojnë amplitudën e cikleve financiare, duke moderuar ofertën e kredisë, respektuar nivelet e kapitalizimit dhe likuiditetit, etj (CGFC, 2011).

Në fazën e dytë, që është ajo e materializimit, duhet të zbutet çdo element i destabilitetit financiar dhe limitohet e rregullohet shfaqja e panikut. Një masë apo instrument, vlerësohet si makroprudencial, në momentin që ai lejon të zvogëlohet probabiliteti i formimit të një rreziku financiar sistemik (CGFC, 2011). Për instrumentat që trajtojnë problematikën e ndërlidhjeve dhe ndërveprimit ndërmjet bankave, të uniformitetit të portofoleve apo funksionimit të sistemeve bankare paralele, termi makroprudencial, ka hapësirën e tij maksimale të veprimit”¹¹³.

¹¹² CGFC Paper, No 38, May 2011 Macroprudential Instruments and frameworks: a stocktaking of issues and experiences

¹¹³ Adrian Civici, Revista Bankieri 2013

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Tabela nr 10. Instrumentat makroprudenciale si komponentë të sistemit financiar

		Komponentët e Sistemit Financiar				
		Banka ose depozitë-konsumues		Investitori jo bankar	Tregu i kapitaleve (secured)	Infrastruktura financiare
		Bilanci	Kontrata Kreditimi			
Dobësi	Sistemi i levës	• Raporti i kapitalit • Pesha e rrezikut • Provigjionimi • Shpërndarja e fitimit dhe e kufizimeve • Limiti i rritjes së kredisë	• LTV Cap • Limiti i shërbimit, borxhit / të ardhura • limiti i maturimit		Kufiri i marzhit	
	Likuiditeti ose rreziku i tregut	• Kërkesat e likuiditetit / rezervës • kufizimi i kreditimit në monedhe të huaj • Kufiri i mospërputhjes së monedhës	Rregullat e vlerësimit	Monedha lokale ose kërkesa për monedhë të huaj për rezerva	Veprimet e bilancit në bankën qendrore	këmbimi tregtar
	Ndërlidhshmëria	• Limitet e përqëndrimit • pagesë shtesë në kapitalet sistemike • nënkategorizim				palët korresponduese

Burimi: Bis 2010

Instrumentat ekzistues mikroprudencial, mund të përdoren për nxitjen e elasticitetit të sistemit financiar. Ato mund të përdoren për të kufizuar ekspozimin e sistemit financiar apo dobësinë ndaj goditjeve. Instrumentat në këtë kategori përfshijnë kapitalin dhe likuiditetin e kërkesave, kufizime në lloje të veçanta të kreditimit, kufizime në mospërputhje të monedhës ose masa që forcojnë infrastrukturën financiare .

Tabela e mëposhtme tregon disa shembuj të instrumentave makroprudenciale, të cilat kategorizohen nga faktorët e riskut, të cilët kanë ndikim ose kufizojnë edhe komponentët e tjerë të sistemit financiar. Këto instrumenta mund të aplikohen në ato sektorë, ku pabarazitë sistemike përkatëse janë në zhvillim e sipër. Komiteti i Bazelit për mbikqyrjen bankare, konsideroi implementimin e këtyre masave, për të nxitur krijimin në kohë të mira, të një mbulesë të kapitalit, të cilat mund të përfitohen në periudha stresi¹¹⁴. Pra siç shihet në tabelën nr.11, tregohen disa ndryshime në stilin e politikave

¹¹⁴“Consultative proposals to strengthen the resilience of the banking sector announced by the Basel Committee”, Basel Committee on Banking Supervision press release, 17 December 2009.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

makroprudenciale. Disa instrumenta mund të zbatohen ndaj të dy qëllimeve siç janë :a) përmirësimi i elasticitetit të sistemit financiar ndaj goditjeve, b) si dhe për të moderuar ciklin financiar.

Tabela nr 11. Synimet makroprudenciale, në kuadër të objektivave të përgjithshme dhe instrumentave

Synimet makroprudenciale, në kuadër të objektivave të përgjithshme dhe instrumentave Një krahasim i stilizuar		
	Synimi	
	Për të përmirësuar elasticitetin e sistemit financiar ndaj goditjeve	Për të moderuar ciklin financiar
Metoda e përgjithshme për arritjen e qëllimit	Rikalibrimi i mjeteve mikroprudenciale, duke marrë parasysh riskun sistematik	Përdorimi i mjeteve dinamike në përgjigje të ciklit financiar
Karakteristikat kryesore të instrumentave	Mund të jetë stili mikroprudencial ose makroprudencial	Prirjen të jenë stili- makro: aplikimi i gjerë, d.m.th në të gjitha bankat apo tregjet
Frekuencat e përshtatjes	Shqyrtime në përgjithësi më pak të shpeshta (p.sh. në përgjigje të ndryshimeve strukturore në sistemin financiar), por me përshtatje apo rregullime më të shpeshta	Kanë tendencë që të rishikohen periodikisht dhe të rregullohen me shpesh, në përgjigje të luhatjeve të ciklit financiar

Burimi: Bis 2010

4.4 Instrumentat e përdorura nga BQE¹¹⁵

Në një studim të FMN-së (2011b), sipas një anketimi, rreth 51 sektorë të ekonomisë ishin të prekur nga risku sistematik. U përdorën rreth 34 instrumenta, ku mund të përmendim masat mikroprudenciale, instrumenta monetare, etj. Më poshtë janë listuar instrumentat, disa nga të cilat janë përdorur që prej viteve '90.

- ✓ Peshat e riskut e ndryshueshme me kohën
- ✓ Provigjionime dinamike
- ✓ Kufiri për kredinë ose rritjen e saj
- ✓ Tavani i LTV
- ✓ Tavani i borxhit kundrejt të ardhurave (DTI)
- ✓ Kërkesat për rezervë

¹¹⁵ Burimi: FSB, IMF, and BIS, *Macroprudential Policy Tools and Frameworks, Progress Report to the G20*, October 2011

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

- ✓ Masat e forta të sigurisë për kolateralin

Mjetet për amplifikimin e mekanizmave të riskut sistematik (IMF, 2011b):

- ✓ Limiti në mospërputhje të maturimit
- ✓ Kufiri kreditimit në monedhë të huaj
- ✓ Kufizime të mospërputhjeve të monedhave
- ✓ Tarifë për fondet jo kryesore

Mjetet për të lehtësuar dobësitë strukturore dhe kufizimi i efekteve nga stresi (IMF, 2011b):

- ✓ Lehtësimi i humbjeve të tjera që lidhen me rëndësinë sistematike
- ✓ Politikat e dhënies së informacioneve për tregjet dhe institucionet që mund të preken nga risku sistematik.
- ✓ Kërkesat e zgjidhura për Systemically Important Financial Institute (SIFI-s)

Tabela nr 12. Përkufizimi i koncepteve themelore për instrumentat makroprudenciale

Tavani në DTI	DTI janë rregullat prudenciale që përdoren më vete nëpër banka, për të patur sigurimin e cilësisë së aseteve. Kur përdoren në kombinim me LTV, DTI-ja mund të kontribuojë në përmirësimin e kredidhënies. Përshtatjet e DTI-së mund të bëhen në një mënyrë kundërciklike, për të adresuar faktorin kohë në riskun sistematik (IMF, 2011b).
Provigjionimi Dinamik / Të ndryshueshme me kohën	Provigjionimi tradicional dinamik kalibrohet duke u bazuar eksperiencën e humbjeve dhe mund të përdoret për të zbutur ciklikalitetin në sistemin financiar. Kërkesa për provigjionim, mund të dalë si e nevojshme për të limitizuar zgjerimin e kreditit. Ajo mund të rregullohet duke u bazuar në një formulë të caktuar ose në diskrecionin e hartuesit të politikbërësit, për të ndikuar në kreditimin e bankave në mënyrë të kundër ciklike (IMF, 2011b).
Tavani i LTV	LTV vendos një detyrim për pagesë fillestare për ata që duan të marrin hua për shtëpi. E thënë ndryshe, ky detyrim kufizon prociklalitetin e kreditimit kolateral që çmimet e banesave dhe mundësia e familjeve për të marrë hua në bazë të vlerës së kolateralit, të bashkëveprojnë në mënyrë prociklike. Megjithatë, përshtatja e LTV e bën atë një instrument më të fuqishëm të politikave kundërciklike (IMF, 2011b).
Tavani i kredive në monedhë të huaj	Kreditë në monedhë të huaj i bëjnë huamarrësit e pambrojtur ndaj risqeve të këmbimit valutor që nga ana tjetër, e bëjnë huadhënësin subjekt të riskut të kreditit. Nëse ekspozimi është i madh, atëherë risku mund të bëhet më i madh (IMF, 2011b).
Tavani i rritjes së kredidhënies	Në kreditë bankare apo kreditë në një sektor specifik mund të vendoset një tavan. Qëllimi i tij është që të zbehtë çmimin e ciklit të kredisë, në rastet kur kemi rritje kredie dhe në rastet e kredive të një sektori të veçantë (si psh pasuritë e patundshme), mund të përdoren për të mbajtur nën kontroll inflacionin e çmimit të aseteve, si dhe për të kufizuar ekspozimin përkundrejt një risku të veçantë (IMF, 2011b).
Kërkesat e rezervës	Ky instrument përdoret për dy qëllime: 1) për të zbehur çmimet e ciklit të aseteve, meqë ato ndikojnë direkt në rritjen e kredisë. 2) është t'i japë një mbrojtje likuiditetit që mund të përdoret për të lehtësuar një krizë të likuiditetit sistematik kur nevojitet (IMF, 2011).

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Kufizimet në pozicionin e hapur të monedhës ose mospërputhje e monedhës	Këto mjete rregullatore prudenciale, zvogëlojnë ekspozimin e bankave ndaj riskut të valutave. Përveç kësaj, këto mjete përdoren për të zbutur luhatjet e forta të kursit të këmbimit të shkaktuara nga konvergjenca e blerjeve ose shitjeve të valutës nga bankat. Këto efekte nga jashtë, rrisin riskun e kredisë të huamarrësve të pambrojtur me borxh të lartë . (IMF, 2011b).
Kufizimet në mospërputhje të maturimit	Kufizimet në mospërputhje të maturimit mund të përdoren për të trajtuar riskun sistematik, pasi zgjedhja e asetëve krijon një “shpejtësi shitjesh të asetëve”. Gjatë një krize, pamundësia e një institucioni financiar për të përmbushur detyrimet e saj afatshkurtër për shkak të mospërputhjeve të maturimit, mund t’i detyrojë ato që të likuidojnë asetet, duke imponuar një shitje me shpejtësi në pjesën tjetër të sistemit financiar. Mungesat e financimit të disa institucioneve, mund të rezultojnë në një krizë të likuiditetit sistematik (IMF, 2011b).
Kufizimet në shpërndarjen e fitimit	Kërkesat për rregulla prudenciale kanë për qëllim të sigurojnë mjaftueshmërinë e kapitalit të bankave. Kur fitimet e pashpërndara i shtohen kapitalit të bankës, atëherë kufizimet tentojnë që të kenë një efekt kundërciklik në kreditë bankare gjatë periudhës së rënies. Një rol të ngjashëm me Bazel III kishte dhe ruajtja e kapitalit (IMF, 2011b).
Kërkesa kundërciklike të kapitalit	Kërkesa për kapital kundërciklik, mund të marrë formën e peshave të riskut të krijuara gjatë rritjes së zgjerimit të kredisë dhe të reduktuara gjatë krizës, për të siguruar një mbështetje, në mënyrë që bankat të mos zvogëlojnë asetet për të përmbushur kërkesat e kapitalit (IMF, 2011).

Burimi: IMF 2011b

4.5 Menaxhimi i riskut nëpërmjet përdorimit të instrumentave makroprudenciale

“Politika makroprudenciale është përcaktuar si përdorimi i mjeteve kryesisht prudenciale për të kufizuar riskun sistematik. Një element qendror në këtë përkufizim është nocioni i riskut sistematik, risku i ndërprerjeve të shërbimeve financiare që është shkaktuar nga një dëmtim i të gjithë ose një pjesë të sistemit financiar dhe mund të shkaktojë pasoja të rënda negative për ekonominë reale”.

FMN 2013

- Raporti kredi-vlerë (LTV)

Kufijtë e LTV-së janë përdorur zakonisht për të ulur riskun sistematik që lind nga boom-i (krizat), në mënyrë të veçantë në tregun e pasurive të patundshme. LTV-të janë shumë të përhapura në vendet e Azisë dhe Europës (IMF, 2013), së pari në Azi, rreth viteve 2000 dhe më pas në Europë në prag të krizës globale financiare.

Projektimi dhe kalibrimi: Duke kufizuar shumën e kredisë nën vlerën aktuale të pronës, LTV-ja mund të ndihmojë për të frenuar rritjen e çmimeve të shtëpive, duke kufizuar në këtë mënyrë borxhin. Ky quhet efekti përshpejtues financiar. Ka raste kur LTV-ja përdoret për të përmbushur objektivat sociale,

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

si për shembull, t'i japin mundësi financimi edhe familjeve me të ardhura të ulëta. Zbatimi i LTV-së në fillim të ciklit të kredisë, siguron një efekt parandalues risku (IMF, 2011b).

Një instrument përkundrejt disa instrumentave : shumë shtete e përdorin LTV-në duke e kombinuar atë me instrumenta të tjera makroprudenciale. LTV-ja është kombinuar zakonisht ose me DTI-në¹¹⁶ ose me kërkesat e rezervës. Vendet si Kanada, Hong Kong, Singapor dhe Tajlandë e përdorin LTV-në si një instrument të veçantë (IMF, 2011b).

E fokusuar përkundrejt me bazë të gjerë: gjysma e vendeve i vendosin kufijtë LTV-së për kreditë hipotekore, në varësi të vlerës së pronës ose të qëllimit të blerjes. Vende si Kanadaja apo Singapori kufizojnë në këtë mënyrë financimet për investorët tregtarë ose për investime spekulative (IMF, 2011b). Në Hong Kong, LTV-ja maksimale lidhet me vlerën e banesave për popullsinë, ndërsa në Kore normat vendosen duke parë, nëse prona është ose jo, në një zonë spekulative. Disa vende kanë krijuar projekte strehimi sociale ose kërkojnë siguracion për kredi në vlera të larta.

Rregullat përkundrejt gjykitimit themi se: gjykimi është përdorur nga të gjitha vendet për të përshtatur LTV-në dhe nuk ka prova për përdorimin e rregullave (IMF, 2011b).

Fikse përkundrejt e ndryshueshme me kohën: në Hong Kong, Kinë dhe Kore LTV-ja është rregulluar në përputhje me pozitën ciklike, duke u shtrënguar gjatë “bumit” të pasurive të patundshme.

Në disa vende të tjera si Liban, Suedi, Kolumbi dhe Malajzi u mbajt normë interesi e qëndrueshme LTV-je, për të siguruar një zbutës minimal krahas rritjes së paqëndrueshme të çmimeve të shtëpive. Rregullimet nuk janë kryer domosdoshmërisht në mënyrë ciklike (IMF, 2011b).

Efektiviteti: në vende si Koreja, LTV-ja përdoret për një pjesë të caktuar të tregut, por efektiviteti nuk është bindës. Të dhënat statistikore tregojnë se LTV-ja ka një efekt të dukshëm në rritjen e kredisë dhe çmimeve të pronës. Ky efekt mund të zbehet në tregjet dinamike, kështu që duhet të shtrëngohen kufijtë e këtij instrumenti, si p.sh., në Hong Kong dhe Singapor.

Arsyet Pro janë :

- Ka mundësi për një efekt të menjëhershëm.
- Synon risqet në tregun e shtëpive.

Arsyet Kundra janë:

- Mund të jetë i nevojshëm rikalibrimi, nëse tregjet dinamike nuk i bëjnë të detyrueshme kufizimet.
- Nevojiten të dhënat e debitorëve në lidhje me çmimin e pronave.

¹¹⁶ Debt Service to Income limits

- **Kreditë dinamike-Provigjione të humbura** (Dynamic Loan-Loss Provisioning)

Ky instrument përbëhet nga katër sisteme kryesore (BIS, 2011):

Sistemi i parë, kërkon që bankat të kenë provigjione të vazhdueshme, kundrejt një normë bazë, ku norma bazë është fluksi mesatar i provigjioneve përmes ciklit të kredisë.

Sistemi i dytë, përfshin një mekanizëm aktivizimi, që shkakton akumulimin e provigjioneve dinamike gjatë një ngritje ekonomike dhe tërheqje e këtyre të fundit gjatë rënies.

Sistemi i tretë, vendos normat e provigjioneve, bazuar në riskun që paraqet secili nga klientët.

Sistemi i katërt, ka të bëjë me provigjionet kundërciklike, me përshtatje të normave të provigjionit.

Spanja për shembull, ishte shteti i parë që implementoi *Dynamic Loan-Loss Provisioning* dhe ky shembull u ndoq më pas nga vendet e Amerikës Latine (IMF, 2011b).

Projektimi dhe kalibrimi: Provigjionet Dinamike (PD) ekuilibrojnë tendencën për rezervë të ulët, kur cilësia e kredisë është e lartë. Për rrjedhojë, kostoja marzhinale e këtyre provigjioneve zbutet gjatë ciklit të kredisë. Koha më e përshtatshme për të krijuar rezerva është në fillim të ciklit të kredisë, por duhet pasur kujdes që të ndryshohen normat, nëse ndryshojnë rrethanat (IMF, 2011a).

Fikse përkundrejt e ndryshueshme me kohën: normat e provigjionimeve kanë qënë të pandryshuara për të gjitha vendet, përveç Spanjës, që i ndryshoi ato në vitin 2004.

E fokusuar përkundrejt me bazë të gjerë: provigjionet dinamike kanë norma fikse të veçanta për kreditë e individëve. Në shumicën e vendeve, dy klasat e lartpërmendura të PD-së kanë të njëjtën mënyrë aplikimi për të gjitha bankat. Përjashtim bën Meksika dhe Kili, që e ndryshojnë normën në varësi të riskut që paraqet kredimarrësi (IMF, 2011b).

Rregullat përkundrejt gjykimit: ka vende që i përdorin PD-të në formë strikte. Në këto vende, ato konsiderohen një sistem i bazuar në rregulla. Disa vende i kanë përshtatur normat e provigjioneve në mënyrë kundërciklike me diskrecion. Për arsye se këto nuk janë të kalibruara për të përballuar humbjet, është shumë e vështirë, që këto të krijojnë një zbutës (IMF, 2011b).

Një instrument i përdorur përkundrejt shumë instrumentave: të prezantuara në disa shtete si Meksikë e Kolumbi, këto instrumenta bëjnë pjesë në masat makroprudenciale, por në Spanjë është përdorur si një i vetëm. Kombinimi i PD-së me masat e tjera makroprudenciale zvogëlon humbjet dhe rrit rezervat. Efektiviteti i PD-së tregohet nga faktet statistike, por PD nuk është krijuar për të përballuar humbje të mëdha të paparashikuara ose për të frenuar rritjen e shpejtë të kredisë. Një shembull që mund të

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

përmendim është Spanja, e cila kishte për qëllim të arrinte që të mbulonte më shumë se gjysmën e humbjeve nga kreditë, por përsëri humbjet i tejkaluan të gjitha parashikimet¹¹⁷.

Arsyet Pro janë:

- Zbutje e kostove të provigjionimit në ciklin e kreditit.
- Rezervat kundërciklike mbulojnë humbjet e krijuara nga kreditë.

Arsyet Kundra janë:

- Nëse kalibrimi nuk është i rregullt, mund të çojë në mbi-provigjionim dhe humbjet janë më të ulëta sesa ato të parashikuarat.
- Nevojiten të dhëna mbi humbjet e mundshme ose fluksin e provigjionimit
- **Kërkesat për Rezervë**

Kërkesat për rezervë (KR), janë përdorur me nivel të ulët prudencialiteti dhe vendin e tyre e kanë zënë shpesh politika jo aq direkte. Si një mjet makroprudencial, normat e kërkesave për rezervë mund të rriten. Në një pjesë të madhe të vendeve janë përdorur kërkesat për rezervë, si një nga instrumentat makroprudenciale, për të nxjerrë në pah risqet që lidhen me rritjen e tepërt të kredisë, si dhe për t'u mbrojtur nga risqet e likuiditetit (Gray, 2011).¹¹⁸

Projektimi dhe kalibrimi: kërkesa për rezervë është një instrument makroprudencial, ku një nga qëllimet e saj është të ngadalësojë rritjen e kredisë. Kjo masë duhet të aplikohet më tepër, në raste kur bankat përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të sistemit financiar (BIS, 2011).

E fokusuar përkundrejt me bazë të gjerë: kërkesat për rezervë janë përgjithësisht më të planifikuara, sesa një kurs i vetëm që aplikohet në të gjithë bazën.

Fikse përkundrejt e ndryshueshme me kohën: kërkesat për rezervë përdoren shpesh në mënyrë kundërciklike, duke u rritur gjatë një boom-i dhe duke u zvogëluar ose eliminuar gjatë rënies. Normat e kërkesave për rezervë në kushtet e një boom-i, vendosen tepër të larta, sidomos për kërkesa për rezervë marzhinale. Një rast që pasqyron këtë, është edhe Bullgaria, e cila e kishte kaluar kufirin e rritjes së kredisë me 2% dhe kishte rezerva 400% (IMF, 2011b).

¹¹⁷ Saurina (2009), "Loan Loss Provisions: A working Prudential Tool"

¹¹⁸ Gray, S., 2011, "Central Bank Balances and Reserve Requirements," IMF Working Paper No. 11/36 (Washington: International Monetary Fund).

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Rregullat përkundrejt gjykitimit: kërkesat për rezervë, janë përshtatur duke u bazuar në eksperiencat dhe gabimet e mëparshme, kurse normat në të tilla raste përcaktohen nga rrethanat. Efektiviteti i kërkesave për rezervë vlerësohet nga statistikat. Kërkesat për rezervë janë të suksesshme në uljen e prociklikalisht të rritjes së kredisë. Kohëzgjatja e efektit të tyre nuk mund të përcaktohet me saktësi nëpërmjet analizave, por mund të thuhet se kërkesat për rezervë, duhet të kalibrohen në mënyrë periodike, që të vazhdojnë të jenë efektive (IMF, 2011b).

Arsyet Pro janë:

- Efiçensë e menjëhershme.
- Të thjeshta për t'u implementuar dhe përshtatur.
- Ndërtojnë një instrument zbutës likuiditeti.
- Mund të bashkëveprojnë shumë mirë edhe me instrumenta të tjera makroprudencialë.

Arsyet Kundra janë:

- Në qoftë se janë shumë komplekse është e vështirë të aplikohen.
- Të lehta për t'u anashkaluar, zbehet efektiviteti i tyre.
- Kufizojnë kreditë për bizneset e vogla dhe të mesme.
- Mundësi migrimi të riskut

- Kreditimi në monedhë të huaj

Huadhënia në monedhë të huaj shoqërohet me shqetësimin e riskut që lidhet me to. Risku krijohet në momentin që huamarrësi nuk e merr pagën në monedhën e huaj dhe e ka të pamundur të paguajë këtë hua, në rastet e ndryshimeve të theksuara të kursit të këmbimit.

Gjatë krizave të mëparshme kjo ka krijuar efekte sistemike të rëndësishme. Masat e përdorura për të zvogëluar riskun janë të njëjta me ato për të kufizuar ekspozimet, si dhe masat për të krijuar mbulime janë të njëjta me ato të instrumentave të LTV-së të rregulluara nga monedha e huasë (Hahm et al, 2011).

Projektimi dhe kalibrimi i masave që lidhen me huadhënien në monedhë të huaj: qëllimi i krijimit të tyre është të krijojë një mbulesë kundër rënies, si dhe të kufizojë rritjen e huasë në monedhë të huaj për huamarrësit e pa mbrojtur. Shkalla e kufizimit varet nga të dhënat që ekzistojnë dhe ndikimi i mundshëm i zhvlerësimit në tipe të ndryshme huamarrësish (BIS, 2011).

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Këto masa janë miratuar në shumë vende. Disa vende morën masa gjatë krizës, për të frenuar ekspozime të reja, por ata kishin ende një stok të madh huash në monedhë të huaj (IMF, 2012).

Një instrument përkundrejt shumë instrumentave: vendet të ndryshme kanë patur metoda të ndryshme të trajtimit të masave për huadhënien në monedhë të huaj.

- Duke qënë se kërkesat për rezervë kanë si qëllim të trajtojnë riskun e likuiditetit dhe masat e huadhënies në monedhë të huaj të ndërtojnë një mbulesë, shumë vende i kanë përdorur këto të fundit për të trajtuar më shumë se një çështje ose objektiv.
- Në disa vende përdoret vetëm një masë për të kufizuar ekspozimin, siç është ndalimi i huadhënies në monedhë të huaj. Brazili e ndaloi plotësisht këtë huadhënie gjatë viteve 2000 dhe Austria për një periudhë të caktuar në 2008-2010 (IMF, 2013).
- Disa vende përdorin më shumë se një mjet për të ndërtuar mbulesë. Këto masa kanë lidhje me rritjen e peshës së riskut për huatë në monedhë të huaj dhe ndikojnë drejtpërdrejt në kapital. Shembull është Kroacia me një rritje peshë-risku në 150% (IMF, 2012).

E fokusuar përkundrejt me bazë të gjerë : vende të ndryshme përdorin shkallë të ndryshme planifikimi dhe masash për ekspozimet e huave në monedhë të huaj. Ka vende si Hungaria dhe Turqia, që e kanë ndaluar huanë në monedhë të huaj për kredi për blerje shtëpie (IMF, 2012).

Fikse përkundrejt e ndryshueshme me kohën: masat për huatë në monedhë të huaj aplikohen me parametra të përcaktuar, pasi këto kanë peshë të madhe të riskut.

Rregullat përkundrejt gjykimit: mënyra që përdoret për të matur riskun e huave në monedhë të huaj është sipas formulave të caktuara. Këto masa përshtaten herë pas here, duke marrë në konsideratë efektet që ato do të kenë në banka.

Efektiviteti: masat për huatë në monedhë të huaj sipas statistikave janë të suksesshme, por efektiviteti i tyre zbehet kur ato kombinohen me masa të tjera (IMF, 2011b).

Arsyet Pro janë:

- E bazuar në formula, që ofron parashikueshmëri më të madhe në mjedisin rregullator.
- Mund të ndihmojë për të ndërtuar një mbulesë.
- Mund të realizohet relativisht lehtë.
- Mund të inkurajojë më tepër kreditimin në monedhën vendase.

Arsyet Kundra janë:


- Mundëson vëzhgimin e migrimit të riskut për institucionet financiare jo-bankare ose në fusha të tjera.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

- Mund të kontribuojë për të futur shtrembërime ose keqkuptime, për të tërhequr fondet nga institucionet ndërmjetëse financiare, të tilla si bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit, në mënyrë që ata të investojnë direkt.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Grafiku nr 5. Objektivat e instrumentave të politikave makroprudenciale



Burimi: IMF Financial Stability and Macprudential Policy Survey, 2013

4.6 A funksionon politika makroprudenciale?

Akoma nuk është e qartë, nëse këto politika kanë përmirësuar mirëqenien, stabilitetin afatgjatë financiar apo kanë inkurajuar suksesin e deflacionit me fluskën e pronave (Elliott, et al 2013). Sipas një sondazhi të FMN në vitin 2010, u vu re se dy të tretat e 49 vendeve të anketuara kishin aktivizuar instrumente makroprudenciale që prej vitit 2008 (FMN, 2013). Në të kaluarën, është vënë re se ekonomitë e tregjeve në zhvillim kanë qenë më të shpejta dhe më të gatshme për të përdorur instrumentat makroprudenciale, sesa vendet e zhvilluara. Kriza e fundit ka bërë që shumë vende të zhvilluara, duke përfshirë dhe ato të BE individualisht dhe si anëtarë të ESRB-së, të konsiderojnë akoma më shumë përdorimin e instrumentave makroprudenciale (Gerlach, 2013).

Në vitin 2010 në Zelandën e Re, Banka Qëndrore prezantoi dy raporte të likuiditetit. Njëra ishte për të rritur rezervat bankare të likuiditetit dhe tjetra një raport të financimit bazë, për të siguruar që bankat po mbanin një përqindje më të lartë të detyrimeve më të qendrueshme të tilla si, depozitat me pakicë dhe kreditë me shumicë me periudhë maturimi më shumë se një vit (Gerlach, 2013). Këto kërkesa u panë të nevojshme të shtrëngoheshin përsëri në vitin 2013. Ato janë aplikuar me sukses në pjesën më të madhe të bankave, që u përgjigjën duke ndryshuar strukturat e tyre të financimit, për të përmbushur kërkesat e reja, madje edhe para se ato të prezantoheshin zyrtarisht.

SHBA, kanë një përvojë më të gjatë që përdorin politika makroprudenciale edhe pse këto mjete në atë kohë, nuk u formuluan për arritje të objektivave makroprudenciale në mënyrë eksplicite, por më shumë për të mbrojtur qëndrueshmërinë e sistemit financiar (Elliott et al 2013).

Mjetet e politikës kishin për qëllim rregullimin e kërkesës së kredisë ose ofertës për kredi. Kërkesat për rezervë, kufizimet në LTV dhe kufizimet në maturimin e kredisë (hipotekat) janë përdorur për të rregulluar kërkesën për kredi. Për të kontrolluar kërkesat e ofertës për kredi dhe rezervës, janë përdorur tavanet e normave të interesit, kërkesat e kapitalit, si edhe kufizimet mbi llojet e kredive bankare që mund të mbajnë në portofolet e tyre. Rezerva Federale (FED) në vitin 1934, arriti të fitojë të drejtën për të vendosur kërkesat e marzhit diferencues për të kundërshtuar kështu, rritjen e kredive në bursë. Kjo do të çonte në frenimin e kredive bankare për ndërmjetësuesit financiar (brokers). Që nga vitit 1974, kreditimi jobankar ishte rritur mjaftueshëm si një burim kompensues kredidhënie, aq sa Rezerva Federale (FED) doli në konkluzionin që mjetet e kësaj politike nuk ishin më efektive (Gerlach, 2013).

Në ditët e sotme, metodat gjithëpërfshirëse për të vlerësuar përfitimet neto të politikave makroprudenciale në nivel global, mbeten në një fazë fillestare zhvillimi. Një model i kompletuar i politikës makroprudenciale, duhet të jetë në gjendje të përfshijë jo vetëm një vendim se kur duhet ndërhyrë, por edhe një strukturë konceptuale të aftë për të vlerësuar sa më shumë të jetë e mundur, të gjithë variablet e rëndësishme të politikës (IMF, 2013).

FMN-ja po bën një punë të mirë në këtë fushë dhe kontributet nga rrethet akademike janë duke u rritur në numër dhe gjithëpërfshirje (Gerlach, 2013), por duhet bërë edhe më shumë për të ndërtuar aparatin e nevojshëm për të llogaritur në mënyrë të saktë, për implikimin plotë të politikës makroprudenciale në nivelin e mirëqënies, duke u marrë me reduktimin e probabilitetit të krizës, si dhe koston e vetë masave të kësaj politike (Angelini et al, 2012).

4.7 Eksperienca të vendeve që kanë implementuar instrumentat makroprudenciale

Autoritetet e shteteve të ndryshme përdorin paketa të ndryshme instrumentash për të menaxhuar riskun sistemik. Pjesa më e madhe e këtyre instrumentave kanë natyrë prudenciale, por ka edhe disa instrumenta që i përkasin politikave të tjera publike fiskale dhe monetare. Nga një studim i FMN (2011)¹¹⁹ janë rreth 10 mjete të tilla që përdohen më shpesh për të arritur objektivat makroprudenciale, ku tre të tilla gjenden si më poshtë:

- a) Masat që lidhen me likuiditetet, si psh kufizime në pozicionet e monedhave, të mospërputhjeve të monedhave, kufizime në mospërputhjen e maturiteteve dhe të kërkesave të rezervës.¹²⁰
- b) Masat që lidhen me kreditë, psh duke vendosur kufij në LTV, DTI dhe në monedhë të huaj si edhe kufi për kreditë dhe rritjen e tyre.
- c) Masat që lidhen me kapitalin, psh kërkesat variabël për kapitale kundërciklike, provigjionet dinamike të ndryshueshme me kohën, si edhe kufizime në shpërndarjen e fitimit.

Rreziku sistemik i likuiditetit rritet kur sistemi financiar ka një mungesë totale të likuiditetit dhe aktorët e tjerë të tregut nuk janë në gjendje për të marrë fonde me afat të shkurtër (Harris & Silva, 2012).

¹¹⁹ IMF Working Paper-What instruments and How to use them. Lessons from country experiences (2011)

¹²⁰ Kërkesa e rezervës mund të përdoret edhe për mbulesë.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Sipas FMN (2012) leva është shuma e borxhit të huazuar për të blerë asetet. Nëse ka më shumë se një devijim standart levash, atëherë mund të themi se kjo levë quhet e tepruar. Kryesisht këto leva përdoren për të zbutur disa nga kategoritë kryesore të riskut sistemik (IMF, 2011b) sic janë:

- Risqet e krijuara nga rritja e fortë e kredive dhe inflacioni i cmimit të aseteve të krijuara nga kjo rritje.
- Risku sistemik i likuiditeteve.
- Risqet e krijuara nga përdorimi i gjërë i levave financiare.
- Risqet që lidhen me rrjedhjet e mëdha të kapitalit, duke përfshirë këtu borxhin në monedhë të huaj.

Sipas FMN (2011b), 2/3 e vendeve të marra në studim duke filluar nga viti 2008, i kanë vënë në përdorim këto mjete, për të arritur objektivat makroprudenciale. Elementë të makroprudencialitetit kanë ekzistuar edhe më parë në ekonomitë në zhvillim, sidomos gjatë krizës financiare të viteve 1990, kur filluan të përdoren disa instrumente për të adresuar riskun sistemik. Instrumentat makroprudenciale në shumicën e rasteve kanë rezultuar si zbutës të riskut sistemik.


Nga një analizë e bërë nga IMF (2011b) me një grup prej 49 shtetesh u vu në dukje që instrumentat të cilat mund të ndihmojnë në zbutjen e risqeve prociklike janë:

- Vendosja e kufirit të raportit të LTV-së ,
- Kufiri i raportit të DTI-së,
- Kufi për kreditë apo rritjen e kredive, si dhe përcaktimin e kërkesave të rezervave, etj.

Këto instrumente sjellin kufizimet në mospërputhje të pozicioneve të këmbimit si edhe kufizimet në mospërputhjet në maturitete, të cilat ndihmojnë në uljen e riskut ndaj ekspozimeve midis institucioneve dhe tregjeve. Efektiviteti i instrumentave duket që nuk varet as nga ndryshimi i regjimit të kursit të këmbimit dhe as nga madhësia e sektorit financiar, por analizat tregojnë që lloji i goditjeve ka ndikim, lloje të ndryshme të riskut kanë nevojë të trajtohen me lloje të ndryshme instrumentash makroprudenciale. Instrumentat makroprudenciale janë pjesë e një kuadri më të gjërë për stabilitetin makrofinanciar, në të cilin përfshihen edhe menaxhimi i kurseve të këmbimit dhe llogaritë kapitale. FMN (IMF, 2011b) në një nga studimet e shumta të kryera mbi krizën aktuale, thekson faktin se kriza ka detyruar edhe vendet e zhvilluara të përdorin këto instrumenta, por në mënyrë më të reduktuar.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Grafiku nr 6. Objektivat e politikave të instrumentave makroprudenciale



Burimi : IMF, 2011b

Politika makroprudenciale ka disa përparësi në krahasim me politikat e tjera publike për të adresuar riskun sistemik në sektorin financiar. Sipas IMF(2011b), autoritetet e vendeve tregojnë se instrumentat makroprudencialë janë më pak të hapur sesa mjetet monetare dhe janë më fleksibël se pjesa më e madhe e mjeteve fiskale.

Shumë instrumenta si kufinjtë në: LTV, DTI, kreditimi në valutë të huaj dhe pesha e kapitalit të riskut mund të jenë të përshtatura për risqet në sektorë të veçantë apo të portofolit të huave, pa shkaktuar një ulje të përgjithshme të aktivitetit ekonomik, në këtë mënyrë kufizohet edhe kosto e ndërhyrjes së kësaj politike ekonomike. Instrumentat makroprudenciale janë të dobishme kur nuk është e dëshirueshme një politikë monetare e shtrënguar (IMF, 2012).

Autoritetet shtetërore përzgjedhin instrumente të cilat janë të thjeshta, efektive dhe të lehta për t'u zbatuar. Ata e konsiderojnë të nevojshme që përzgjedhja e instrumentave makroprudenciale të jetë në përputhje me objektivat e tjera të politikave publike si fiskale, monetare dhe prudenciale. Gjithashtu ata besojnë se është e rëndësishme të zgjedhin instrumenta makroprudenciale të cilat arrijnë të, minimizojnë arbitrazhin rregullator, veçanërisht në vendet e zhvilluara me sektorë

financiare jo bankarë të mëdhenj, kompleks dhe me sisteme financiare shumë të ndërlydhura (IMF, 2011b).

4.8 Zbatimi i instrumentave makroprudenciale

Shtete të ndryshme kanë vënë në dukje faktin se instrumenta të ndryshme përdoren shpesh për të treguar të njëjtin risk, si dhe rrallë herë përdoret vetëm një instrument për të adresuar një risk sistemik. Kufiri mbi LTV-në (raporti kredi-vlerë) dhe DTI-në (raporti borxh-të ardhura) zbatohen për të ndaluar rritjen e shpejtë të kreditimit në sektorin e pronave të patundshme. Herë pas here zbatohen një tërësi masash. Instrumentat e shumëfishta japin siguri efektive më të lartë pasi e trajtojnë riskun nga kënde të ndryshme. Zbatimi i këtyre instrumentave të shumëfishta përbën një barrë më të madhe rregullatore dhe administrative (IMF, 2011a).

Instrumentat makroprudenciale përdoren më shumë sesa mjetet e politikës monetare e fiskale. Nga eksperiencia, kufijtë mbi LTV-në dhe DTI-në, zbatohen duke marrë parasysh masën e kredisë, vendndodhjen dhe vlerën e pronës. Në disa shtete si: Argjentinë, Kili, Kinë, Indonezi, Peru, Rusi, Serbi, dhe Turqi kërkesat për rezervat që përdoren për politikën me qëllime makroprudenciale dallohen për nga monedha e huaj, llojet e detyrimeve financiare dhe në këtë mënyrë ato zbatohen kur rritja e kreditimit e kalon kufirin zyrtar (IMF, 2011b). Në Kanada për kalibrimin e instrumentave merren parasysh edhe aspektet e tjera zhvëllimore dhe sociale.

Shumë vendeve u duket më e dobishme të përfitojnë plotësisht nga natyra e instrumentave financiare, kurse vendet e tjera i zbatojnë instrumentat më gjerë pa i diferencuar me tepër. Normalisht sistemohen më shpesh instrumentat që kanë si synim rritjen e kreditimit, siç janë kufijtë mbi LTV-në, DTI-në, si dhe kërkesat për rezervat (IMF, 2012). Rregullimet zakonisht bëhen për t'u dhënë instrumentave një impakt kundërciklik që është progresivisht më i lartë. Masat që lidhen me kapitalin, siç janë kërkesat kundërciklike për kapitalin dhe provigjionet dinamike, mendohet se e kalojnë ciklin me një lehtësim, kurse vende të tjera i sistemojnë në faza të ndryshme të ciklit për t'u dhënë një impakt më të fuqishëm kundërciklik (IMF, 2010). Modelimi dhe kalibrimi i instrumentave kryhet zakonisht në bazë të gjykimit dhe jo të rregullave. Kjo u vu re në shumicën e vendeve pjesëmarrëse në studimin e FMN-së, pasi këto vende kanë përdorur në shumicën e rasteve gjykimin e tyre për të modeluar dhe për të kalibruar instrumentat. Përdorimi i instrumentave sipas rregullave minimizon pasiguritë, duke parandaluar kështu presionet politiko-ekonomike dhe inercinë e politikave, ndërkohë që risku sistemik sa vjen dhe

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

rritet. Zbatimi i këtyre instrumentave makroprudenciale është një mësimi gjatë praktikës, ku gjykimi sesi kalibrohet një instrument formohet duke provuar më parë zgjidhjen e kushtëzuar, kjo edhe nga lloji i shokut me të cilin përballet sistemi financiar (IMF, 2012). Instrumentat makroprudenciale zakonisht zbatohen së bashku me politika të tjera makroekonomike. Në Azi dhe Amerikën Latine, kufiri (CAP) i LTV-së dhe i instrumentave makroprudenciale janë përdorur duke u shoqëruar me politika të tjera si politika monetare dhe ajo fiskale. Disa shtete të Europës Lindore që e mbajnë politikën fiskale “të çlirët” kanë shtrënguar politikën monetare dhe janë munduar të frenojnë kreditimin në valutë të huaj nëpërmjet masave makroprudenciale. Ndërthurja e këtyre politikave ndodh zakonisht kur cikli i kreditimit përputhet me ciklin e biznesit dhe kur ka një rrezik të përgjithësuar të teprimit të kredidhënies dhe mbi nxehjes ekonomike (IMF, 2010).


Në raste të tilla, instrumentat makroprudenciale zbatohen si pjesë e një aksioni politikash të mëdha për të kontrolluar kërkesën e tepërt dhe akumulimin e riskut sistematik, në mënyrë që ato të luajnë një rol plotësues të politikave makroekonomike (IMF, 2011a).

Bashkimi Europian i ka kushtuar rëndësi përdorimit të instrumentave makroprudenciale. BE, ka si prioritet zgjedhjen dhe zbatimin e instrumentave makroprudenciale në nivel kombëtar. Bordi Europian i Riskut Sistemik (ESRB) u formua me qëllim që të japë paralajmërime për risqe, si dhe të nxisë aplikimin e instrumentave makroprudenciale të cilat kanë një rëndësi të vecantë në kontekstin e BE-së duke pasur parasysh kufizimet në politikat makroekonomike. ESRB-ja ka gjithashtu për detyrë të nxisë reciproritetin nëpërmjet zbatimit ose shpjegimit në mënyrë që të gjitha bankat të cilat kryejnë një aktivitet në një shtet të caktuar si dhe të jenë subjekt i të njëjtit instrument makroprudencial (IMF, 2011b).


Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Instrumentat makroprudencialë të përdorur

Grafiku nr 7. Tavani i LTV-së




Grafiku nr 8. Tavani i DTI




Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Grafiku nr 9. Tavani i kredive në monedhë të huaj




Grafiku nr 10. Kufiri i rritjes së kredisë




Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Grafiku nr 11. Kufizimet në valutën neto/mospërputhje të monedhës




Grafiku nr 12. Limitet në mospërputhjen e maturimit




Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Grafiku nr 13. Kërkesat e rezervës




Grafiku nr 14. Kërkesa për kapital kundërciklik




Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Grafiku nr 15. Kohë variabël/Provigjionimi dinamik



Grafiku nr 16. Kufizime në shpërndarjen e fitimit



Burimi: IMF Financial Stability and Macprudential Policy Survey, 2011.

4.9 Efektiviteti i instrumentave makroprudenciale

Janë përdorur tre qasje të ndryshme për të vlerësuar efektivitetin e instrumentave makroprudenciale (IMF, 2011b).

E para është rast studimor, që shqyrton përdorimin e instrumentave në një numër të vogël vendesh për të parë nëse i kanë arritur objektivat e synuar.

E dyta është qasje e thjeshtë, që shqyrton performancën e variablave objektiv të riskut para dhe pasi ky instrument makroprudencial të vihet në veprim.

E treta është qasje më e sofistikuar ku përdoret modeli i regresionit. Efekti i instrumentave makroprudenciale vlerësohet me variabla të ndryshme rreziku, duke e krahasuar me vënien në veprim të një instrumenti me skenar kundërshtues ku nuk zbatohet asnjë instrument makroprudencial. Si pjesë e vlerësimit janë edhe vërejtjet dhe vështirësitë e konstatuara.

Së pari, kishte vështirësi në marrjen e të dhënave dhe në cilësinë e tyre. Preferohen të dhënat në nivel firmash përderisa shumë nga instrumentat makroprudenciale synojnë bilancet e këtyre institucioneve financiare, por këto nuk janë lehtësisht të gjetshme dhe konsistente përgjatë kohës apo shteteve. Për më tepër, numri i vendeve që përdorin instrumente makroprudenciale është i vogël pasi politikat makroprudenciale janë vënë në funksion vetëm vitet e fundit, çka e kufizon shkallën e sigurtisë në analizat statistikore (IMF, 2011b).

Vendosja e lidhjes nëpërmjet shkakut dhe pasojës nuk është e drejtpërdrejtë, apo edhe e mundur në disa raste pasi, përzgjedhja do të favorizonte vetëm shtetet me rreziqe të larta ku politikat zbatohen si reagim ndaj zhvillimeve në ekonomi dhe në treg.

Edhe analizat empirike nuk marrin parasysh probleme si kostot dhe deformimet, që janë faktorë të rëndësishëm kur përdoren këto instrumente. Disa shtete i përdorin instrumentat në veçanti, kurse të tjera i ndërthurin dhe i koordinojnë me politika të tjera (IMF, 2013). Instrumentat janë gjithëpërfshirëse por dhe të synuara, disa i mbajnë instrumentat të pandërrueshme ose të ndryshueshme, kurse të tjerë i rregullojnë ato sipas rregullave apo gjykimit të tyre. P.sh., në Kinë, autoritetet arritën në vitin 2010 të ulin rritjen e kreditimit dhe inflacionin e çmimit të shtëpive duke marrë një sërë masash, përfshirë masat fiskale dhe monetare (Borges & Gon, 2013). Në Europën Lindore, autoritetet adoptuan masa të ndryshme për të kontrolluar kreditë e bankave në monedhë të huaj. Instrumentat duket se kanë pasur efekt në ngadalësimin e rritjes së kreditimit dhe në formimin e kapitalit apo mbulimit me likuiditet. Ndërsa në Spanjë, autoritetet prezantuan

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

provigjionimin dinamik si instrumentin e tyre makroprudencial. Ky instrument duket se ka pasur efekt në mbulimin e kredive të humbura gjatë krizës financiare globale, por mbulimi ishte jo i plotë për shkak të shkallës së humbjeve. Një sërë instrumentash mund të jenë efektive për të trajtuar risqet sistemike. Shkalla e efektshmërisë nuk varet nga faza e zhvillimit ekonomik apo kursi i këmbimit. Ekonomitë në zhvillim që kanë kurs këmbimi fiks dhe norma interesi të kufizuara, kanë tendencë për të përdorur më gjerësisht instrumenta makroprudencial. Të njëjtat instrumenta janë po aq efektive kur përdoren në vendet e zhvilluara me regjime fleksibël të kursit të këmbimit. Implementimi i instrumentave makroprudenciale ka kosto të cilat duhen marrë parasysh kur llogariten përfitimet nga këto instrumenta (IMF, 2011a).

Baza për implementimin e suksesshëm të instrumentave makroprudenciale është një strukturë e mirë si dhe mbikqyrje e fortë. Sipas IMF (2011b) kur aplikohen instrumentat makroprudenciale duhet patur parasysh që të njëjtat masa nuk janë të efektshme njësoj në të gjitha vendet ku janë aplikuar. Instrumentat që përdoren nevojiten për të trajtuar risqet sistemike të listuara si më poshtë:

- Për risqet sistemike të shkaktuara nga inflacioni ose rritja e kredisë, instrumentat e duhur që mund të përdoren janë ato që kanë lidhje me kredinë, si përshebull kufiri i DTI-së dhe i LTV-së (IMF, 2011b).
- Për risqet e sistemit të likuiditetit mund të përdoren kufizime në mospërputhjen e likuiditetit ose kufizime në pozicionin neto në monedhë të huaj (nëse rreziku i likuiditetit rrjedh nga financimi në monedhë të huaj) (IMF, 2011b).
- Për risqet e krijuara nga efekti i levës financiare mund të përdoren instrumentat që kanë lidhje me kapitalin. Këto të fundit, krijojnë një situatë kundërciklike nëpërmjet ndryshimeve në kërkesat e kapitalit si dhe peshës së riskut së aseteve. Në këtë mënyrë mundësohet kufizimi i rritjes së tepërt të levave financiare. Nëse kjo rritje vjen si pasojë e kërkesës së bankave për të zgjeruar kredidhënien, atëherë këto masa mund të plotësohen me instrumenta që kanë lidhje me kreditimin (IMF, 2011b).
- Nëse risqet e lartpërmendura janë krijuar si pasojë e fluksit të kapitalit atëherë, instrumentat e listuara mund të përdoren. Instrumentat që përdoren për likuiditetet janë të efektshme në kufizimin e financimeve në monedhë të huaj. Në këtë kontekst, instrumentat që kanë lidhje me kapitalin mund të jenë të dobishme për kufizimin e rritjes së kredidhënies (IMF, 2011b).

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Vende të ndryshme kanë përshtatur hartimin dhe kalibrimin e instrumentave bazuar në rrethanat e tyre të veçanta si: lloji i burimit dhe riskut, aftësinë e sistemit të tyre për të shmangur masat, cilësinë e mbikqyrjes, zbatimit, menaxhimit si dhe marrëveshjet në lidhje me politikën makroprudenciale. Janë për t'u përmendur pikat e mëposhtme që duhen marrë në konsideratë (Gerlach, 2013).

- Një instrument përkundrejt shumë instrumentave
- Me bazë të gjerë përkundrejt atyre të fokusuara
- Rregullat përkundrejt gjykimit
- Koordinimi me politikat e tjera

Avantazhi i përdorimit të mjeteve të shumta qëndron në adresimin e riskut. Kjo bën që të zvogëlohet mundësia e humbjes dhe t'i jepet një garanci më e madhe efektivitetit duke adresuar burime të ndryshme të riskut. Një shembull që ilustron më së miri për sa thamë, është kufiri (cap) për LTV-në dhe DTI-në, që e plotësojnë njëri-tjetrin në ciklikalitetin e kredive me kolateral. Kur përdoren instrumentat që kanë lidhje me kreditin, për të treguar risqet e krijuara nga rritja e tepërt e kredisë, mund të kufizohet risku i financimit të likuiditetit. Bazuar në IMF (2011b), përdorimi i instrumentave të shumta mund të imponojë një kosto më të lartë për bankat, kështu që është e rëndësishme të zgjidhen instrumentat që do të minimizojnë koston në mënyrë që të mos ketë humbje në sektorin financiar. Disa nga instrumentat makroprudenciale mund të përdoren për të adresuar risqe të veçanta, por edhe kjo ka përjashtimet e saj. Përshtatja e instrumentave makroprudenciale përdoret në faza të ndryshme të ciklit për të zbutur natyrën ciklike. Provigjionet dinamike dhe kufiri i mbulimit të kapitalit të përmendura në Bazel III i përkasin këtij atyre instrumentave që zbusin natyrën ciklike (Gerlach, 2013).

Instrumentat që kanë përfitime të dukshme duhet të përdoren më shpesh. Dy shembuj që mund të japim janë: provigjionet dinamike dhe ruajtja e mbulimit të kapitalit.

Përdorimi i këtyre instrumentave ndihmon në parashikimin e mjedisit rregullator. Këto dy mjete bëjnë përjashtim pasi instrumentat e tjerë si kufiri i LTV-së, DTI-së, si dhe kufiri në rezervat e kredisë, mund të kenë nevojë për t'u rregulluar në bazë të vendimit të politikëbërësve (IMF, 2011a). Për të përdorur në mënyrë të lirë instrumentat duhet një strukturë për të drejtuar zhvillimin e politikave makroprudenciale. Brenda kësaj strukture duhet të jetë edhe një mekanizëm për të identifikuar dhe monitoruar riskun sistemik. Gjithashtu, ka shumë instrumenta fiskale dhe monetare që përdoren për të trajtuar riskun sistemik, kështu që duhet një strategji e

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

qartë komunikimi dhe një sërë rregullash të rëndësishme për t'a bërë atë të funksionojë. Përdorimi i instrumentave makroprudenciale të kombinuara me instrumentat e politikës monetare dhe fiskale për të adresuar rrezikun sistemik, kanë tendencë të jenë më efektive kur rreziqet e sektorit financiar janë të ndërthurura me ato të sektorëve të tjerë (IMF, 2013).

Politika makroprudenciale duhet të përdoret vetëm si një plotësues për politikën monetare, e cila është edhe mënyra më e drejtpërdrejtë. Nga ana tjetër, politika makroprudenciale është më e përshtatshme për fusha të veçanta, qëllimi kryesor i përdorimit i këtyre politikave makroprudenciale është qëndrueshmëria e sistemit financiar (Canuto & Cavallari, 2013).

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Tabela nr 13. Përdorimi i Instrumentave Makroprudencialë
Burimi: IMF Staff Analysis 2011(b)

Instrumentat	Si të përdoren	Pro	Kundra	Kur të përdoren
<i>Një instrument përkundrejt Shumë instrumentave</i>	Një instrument	Më të lehta për t'u kalibruar, administruar dhe matur efektivitetin	E pamjaftueshme për shumë burime risqesh.	Kur risku është i kufizuar dhe nga një burim i vetëm
	Shumë instrumenta	Më efektive kur ka shumë burime risqesh. Ndihej për të trajtuar një problem nga kënde të ndryshme	Kosto të larta për institucionet e strukturuar	Përdorimi i shpeshtë i tyre ka kosto shumë të larta
<i>E fokusuar përkundrejt Me bazë të gjerë</i>	Me bazë të gjerë	Impakt më të gjerë	Mund të kenë kosto të larta në rastet e shtrembërimeve të mëdha.	Të përdoren kur nuk ka të dhëna të hollësishme dhe risku është i përgjithësuar
	E fokusuar	Mundësi më e vogël anashkalimi. Objektivi arrihet duke minimizuar koston apo shtrembërimet e mundshme.	Kërkesa për të dhëna të hollësishme Rritet mundësia e shmangies	Të plotësohen me masa me bazë të gjerë për të kufizuar shmangien. Duhet shmangur kompleksiteti i tepërt
<i>Fikse përkundrejt E ndryshueshme me kohën</i>	Fikse	Jep një zbutje minimale. Kosto të ulëta administrative	Mund të mos jenë të efektshme në rrethana që ndryshojnë shpejt.	Duhet evituar kompleksiteti i tepërt dhe rregulluar parametrat me ndryshimin e rrethanave
	E ndryshueshme me kohën	Shmanget matja e kohës së ciklit. Kundërciklike.	Ndryshimet e shpeshta dhe “ad hoc” mund të sjellin probleme	Duhet krijuar principe transparente për menaxhimin e këtyre rregullimeve
<i>Rregullat përkundrejt Gjykimit</i>	Bazuar në rregulla	Transparente, risk më i vogël për mosveprim. Japin sigurinë rregullatore.	Të ndjeshëm në rast anashkalimesh. Mund të jenë të nevojshme ndryshimet në kalibrim.	Të përdoren kur ka rrezik të lartë mosveprimi dhe menaxhimi dhe nuk ka mbikqyrje të mirë
	Gjykimi	Fleksibël, merren parasysh situata të ndryshme, risqe dhe ndryshime strukturale.	Më pak transparente. Mundësi parashikim jo-rregullatore. Në varësi të kapjes rregullatore.	Rivlerësim periodik kalibrimi. Të përdoren kur ka ndryshime të mëdha strukturore dhe risqe që zhvillohen shpejt. Të mos ketë shumë liri veprimi.
Koordinimi	Fiskale, monetare dhe prudenciale	Sinjalizon gadishmëri për të përballuar sfidat. Përmirëson efektivitetin e politikave	Koordinimi i sfidave nëse janë përfshirë shumë agjensi. Vendimarrje e ngadaltë. Përgjegjësitë mund të mos jenë të qarta.	Të vendosen mekanizma për të zgjidhur konfliktet, rregulla të qarta për përgjegjësitë dhe menaxhimin.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

- Raste studimore në disa vende të Europës, Europës Lindore dhe më gjerë

Në Europën Lindore, rreth viteve 2000, kushtet makroekonomike ishin më aktive. Integrimi në BE i dha shpresë vendeve të rajonit në kohën kur në të u pranuan Polonia, Bullgaria dhe Rumania. U vu re një rritje e produktit të brendshëm bruto (PBB) gjatë viteve 2003-2011. Përveç Polonisë, vendet e tjera kishin një defiçit në llogaritë rrjedhëse. Në periudhën para krizës lulëzoi rritja e kredisë, në Bullgari ishte 45%. Këto ndryshime të jashtme kërkonin ndryshime fiskale që të sigurohej stabiliteti. Vendi i vetëm që mbledhi tepricat fiskale ishte Bullgaria, ndërsa vendet e tjera mbajtën defiçitet fiskale. Vetëm dy shtete arritën të reduktojnë borxhin e tyre publik në shkallën që ishte para krizës (Canuto & Cavallari, 2013).

Tabela nr 14. Indikatorët makroekonomik, mesatarja në vitet 2003-2013

	Rritja e PBB në (%)	Kufiri/ PBB në (%)	Deficiti fiskal/PBB në (%)	Borxhi publik/PBB në (%)	Borxhi i jashtëm/PBB në (%)	Rrjedhja e kapitalit neto/PBB në (%)	Detyrimet në monedhë të huaj/totali në 2011 në (%)
Bullgaria	6.3	-15.7	2.2	28.7	79	24.3	58.6
Rumania	6.6	- 9.7	-2.6	20.5	42.3	13.5	42.5
Kroacia	4.3	- 6.6	-2.9	35.1	73.9	13.1	73.6
Serbia	5.7	-12.5	-1	51.7	64.3	19	67.8
Polonia	5.2	- 3.3	-4.1	46.6	49.2	5.6	21.9

Burimi: IMF staff analysis 2013(b)

Rreziku kryesor ishte ai sistemik, i krijuar nga risku i kredisë dhe në mënyrë të vecantë nga kreditë në monedhë të huaj, nga rritja e çmimeve të aseteve dhe rritja e borxhit. Të gjithë shtetet përdorën një sasi instrumentash për të trajtuar rrezikun sistemik.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

4.10 Europa Perëndimore

Tabela nr 15. Raste studimore të Europës Perëndimore

Vendi	Viti	Historiku	Instrumentat Makroprudenciale të përdorur
Austri	2003 - 2010	Në vitin 2003, kishte një numër të madh kredish në monedhë të huaj. Të dy palët, si banka ashtu dhe ata që merrnin kredi, ishin të pambrojtur kundrejt risqeve që shoqërohen me kursin e këmbimit. U morën masa që të ulen numri i kredive në monedhë të huaj dhe të krijohet një fond për risqet e financimeve në monedhë të huaj.	Masat e marra në vitin 2003 në lidhje me uljen e numrit të kredive në monedhë të huaj, u bënë edhe më strikte në vitet në vazhdim. Në vitin 2003 u futën masa për rregullimin e kredive në monedhë të huaj. Në vitin 2006 humarrësit në monedhë të huaj u bënë më të vetëdijshëm karshi risqeve që lidhen me to. Në vitin 2008 u ndërpre dhënia e kredive në monedhë të huaj. Në vitin 2010 u rritën kapacitetet e disa bankave për të përballuar rrezikun.
Itali	2007	Dhënia e kredive bankare në Itali u përshpejtua për shkak të kërkesës nga korporatat për fonde, si pasojë e përmirësimit të aktivitetit. Në të njëjtën mënyrë u rritën edhe kreditë për individët. U rrit numri i kredive për pasuritë e patundshme. U morën masa për të zvogëluar ciklikalitetin e kreditimit.	2007 – Në këtë vit u prezantua Kufiri (Cap) në LTV, duke mos inkurajuar kreditë për shtëpi me një LTV më shumë se 80 % të vlerës së kërkuar. Kapitali i kërkuar për këto raste ka kërkesa më të forta.
Franca	2010	Për shkak të krizës globale financiare, funksionimi i tregut ndërbankar evropian pati shumë problem të likuiditetit. Autoritetet morën masa për të zvogëluar riskun e likuiditetit.	2010 - imponimi për të mbajtur një raport mujor likuiditeti prej 100% si dhe ekspozimet e bankave ndaj klientëve ose një grupi klientësh të kufizuar në jo më shumë se 25 % të kapitalit të bankës.
Greqia	1999 - 2005	Kushte të favorshme ekonomike për shkak të hyrjes së euros, gjë që solli dhe një rritje prej 30% në kreditë e banesave në 1998, duke rritur borxhin e krijuar për këto të fundit, nga 27% në vitin 2000, në 52% në vitin 2004. U krijua një borxh për kreditë e banesave ndaj PBB-së, nga 4% në vitin 1995, në 23% në vitin 2004. Vlerësimi real i çmimeve arriti për shtëpi me 67% për të njëjtën periudhë. U morën masa që të zbutet trysnia e inflacionit dhe të mbahej zgjerimi i kreditit, si dhe të adresohen risqet që lidhen me bumin e kreditimin të individëve.	1999-2000 U përdor tavani i huadhënies në kuadrin e rezervave të papaguara për një shumë ekuivalente me atë të rritjes së kredisë mbi normë. 2005 – Provigjionet: ngritje e raporteve rregullatore të provigjionimit nga 84% deri në 100% për kredi konsumatore të dyshimta DTI: futja e një kufiri tregues prej 40% për borxhin e banesave.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Irlanda	2006	Kreditë e banesave u rritën me shpejtësi në vitet 2000 - 2006. Liberalizimi financiar dhe ardhja e emigrantëve bënë që të rriteshin me shpejtësi çmimet e pasurive të patundshme dhe kreditë për to. Gjithashtu, u ulën në masën 50% tatimet mbi fitimet kapitale, u hoqën plotësisht taksat e pronave dhe u ulën kostot e përdorimit të strehimit. Borxhi për kreditë e banesave ndaj PBB-së u rrit me 159% gjatë 1996 - 2005, ndërkohë që çmimet e shtëpive u rritën me 217%. U morën masa për forcimin e bankave, kundrejt rritjes së kredive të banesave.	2006 – rritje e peshës së rrezikut për kreditë për shtëpi 50% - 100 % të vlerës së kredisë për kredi të dhëna për më tepër se 80 % të vlerës së pronës.
Norvegji	1998	Pasi Norvegjia doli nga kriza në vitin 1991, pati një rritje modeste të çmimeve të banesave dhe të kredive. Në 1996 filluan kreditë për individët dhe çmimet e shtëpive shënuan normat e rritjes vjetore dyshifrore. Arsyeja kryesore për të ndërmarrë masa, ishte që të frenohej inflacioni i çmimeve të pronës dhe rritja e kredisë.	Rritje e peshës së riskut për kreditë me LTV mbi 60% , nga 50% në 100% (u ndërpre në vitin 2001)
	2010	Borxhi vendas e kryesisht ai i kredive të shtëpive arriti një nivel të lartë dhe ishte një rrezik i rëndësishëm në Norvegji. Shkakët e akumulimit të riskut në sektorin bankar, ishin një kombinim i faktorëve të kërkesës dhe ofertës. Faktorët e kërkesës përfshijnë akumulimin e borxhit të ekonomive familjare dhe për ofertën, standardet e dobëta të kreditimit dhe mënyra e kreditimit. Synimi i masave të marra ishte adresimi i problemeve të borxhit të lartë të strehimit.	DTI : Përdorimi i kufirit (cap) në DTI LTV : 90 % cap në LTV për kreditë e banesave dhe 75 % cap në LTV për kreditë e kapitalit për shtëpi
Portugali	1999	Gjatë viteve 1996- 2000, kishte një rritje të çmimeve të shtëpive prej 17%, me një borxh ndaj PBB-së, nga 21% në 41%, e shkatuar nga rënia e normave të interesit në treg. Me masat e marra, synohej që të arrihej stabilitet në qëndrueshmërinë e sistemit bankar dhe ciklet e moderuar në sektorë të veçantë, nëpërmjet kufizimit të rritjes së kredive.	-U forcuan kërkesat e kapitalit për kreditë e banesave me një raport LTV mbi 75% -U vendosën kërkesa të provigjioneve më të forta për kreditë konsumatore. Provigionimi për të tilla raste u rrit në 1.5%.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Suedi	2010	Suedia kishte një borxh të tepruar që do t'i bënte huamarrësit të dobët përpara rënies së çmimeve të pasurive të paluajtëshme.	2010 – Cap në LTV prej 85% për kreditë për shtëpi
Zvicër	2008	Zvicra kishte një përkeqësim të kushteve ekonomiko-financiare të sektorit bankar, si pasojë e krizës që kishte prekur mbarë botën. U hasën vështirësi të shumta në rifinancim dhe rritjet në kredi ishin shumë të ulëta. Synimi i masave të marra ishte që të forcohej qëndrueshmëria e sistemit financiar dhe të reduktohej prociklikaliteti.	2008 - Prezantimi i raportit të levës për bankat me rëndësi sistemike. Futja e shpenzimeve të kapitalit për institucionet me rëndësi sistemike
Spanjë	2000 - 2008	Spanja kishte bumin më të gjatë ekonomik, që zgjati gjatë viteve 1996-2007. Ishin një mori faktorësh që ndikuan në këtë kohëzgjatje. Ndër to mund të përmenden ndryshimet demografike, që rritën normat e banesave, ardhja e emigrantëve dhe investitorët e huaj të pronës. Përshtatja e rregullave me ato të BE-së solli një liberalizim financiar, që shtypi normat reale të interesit dhe bëri të mundur edhe një formë të re të kredisë banesore krahas asaj ekzistueses. Nga ana tjetër ekzistonte një treg shumë i shtrënguar i shtëpive me qera, gjë që bëri që të rriteshin çmimet e shtëpive deri në 121% . Motivet kryesore për të marrë masa ishin që të ndërtohej një tampon në kohë të mira që do të përdorej në kohë të këqija, të zvogëlohej prociklikaliteti i provigjioneve si dhe të ndalej rritja e kredisë.	2000, 2004 – Futja e provigjioneve dinamike. 2008 – Prezantimi i peshave të riskut të aseteve për kreditë që tejkalonin një LTV prej 95% për pronën e banimit dhe 80% për kreditë e tjera.

Burimi: IMF, 2011b

- Spanja

Sipas IMF (2011b), një nga instrumentat prudenciale që Spanja përdori, ishin masat dinamike në vitin 2000. Për bankat kjo do të thoshte që të krijonin një fond rezervë në mënyrë perioke, që llogaritej sipas një formule, që merrte parasysh provigjionet mesatare specifike dhe provigjionet e veçanta në periudhën më të fundit, si dhe humbjet mesatare të kredisë mbi një cikël të plotë ekonomik. Kjo metodë u quajt "Provigjionim Dinamik", pasi kontributi në fondin kundërciklik, varionte sipas ciklit ekonomik. Ky provigjionim u prezantua në Spanjë rreth vitit 1999 në kohën kur ajo sapo hyri në eurozonë. Qëllimi i implementimit të këtij provigjionimi, ishte që të përballohej rritja e riskut për kreditë nëpër banka, si dhe t'i jepej bankave një shtysë për kreditë prudenciale (të kujdesshme), që do të kontrollonin rritjen e kredive, pasi "bindja morale" kishte qënë e pa efektshme dhe kishte rritur konkurrencën midis bankave duke dhënë disa lloje kredish shumë lirë. Përveç kësaj, u ul ndjeshëm numuri i kredive të këqija, që tregonte se provigjionet e veçanta ishin të ulëta (IMF, 2011b).

Instrumentat makroprudenciale në Spanjë, u përdorën si një masë më vete dhe nuk u përdorën masa të tjera për të mbrojtur kreditë. "Provigjionet dinamike" u panë si më të qëndrueshme në krahasim me ato normale, të cilat ishin të përbëra nga provigjione të përgjithshme dhe të veçanta. Provigjionet dinamike u rritën në mënyrë të ndjeshme gjatë rënies të ciklit të kredisë dhe në rastet kur niveli i humbjeve të kredive ishte në rritje (Jimenez et al, 2012).

Me provigjionet dinamike që priten të zvogëlojnë amplitudën e lëkundjeve në provigjionet "normale", autoritetet besonin se ajo mund të ndihmojë në uljen e paqëndrueshmërisë të të ardhurave. "Fine tuning" i provigjioneve dinamike u aplikua në disa kategori kredish duke përfshirë ato hipotekore dhe karta krediti. Gjithashtu, kishte dhe një përshtatje të provigjioneve dinamike që u përdorën vetëm një herë për të ulur normat e provigjionimit në vitin 2005, pasi kreditë e këqija ishin rritur në masën 300%, gjë që shkaktoi dhe rënie të mbulimit të provigjioneve. Mund të themi që instrumentat u përdorën duke u bazuar në rregulla (IMF, 2011b). Kontributi në fondin e provigjioneve dinamike, u tregua në ndryshimin ndërmjet provigjioneve mesatare dhe provigjioneve aktuale. Kështu, provigjionet dinamike ndryshonin me ciklin si provigjione specifike, që ishin të ulta në ngritje të ciklit të kredidhënies dhe të larta gjatë rënies së kredidhënies. Kushtet monetare të vendosura nga Banka Qëndrore Europiane (BQE), nuk ishin aq strikte sa duhej për një vend me kushte ekonomike si Spanja. Kushte më të rrepta u vendosën

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

vetëm në vitin 2008, kur kriza kishte gllabëruar tashmë vendin. Spanja prezantoi kushte më strikte sesa direktivat e Bashkimit European në lidhje me ekspozimet e pasurive të patundshme, si për bizneset, ashtu edhe për individët. Kjo u bë me qëllim që të penalizohen kërkesat për kredi hipotekore, të cilat kishin risk më të lartë, pasi kapitali i lënë peng si garanci për këto kredi nuk ishte i mjaftueshëm (Alberola et al, 2011).

Instrumentat e përdorura në Spanjë ishin shumë efektive në mbulimin humbjeve të kredive gjatë krizës financiare. Me rritjen e kredisë u vu re një ulje e çmimeve të banesave dhe bankat kishin një përmirësim të ndjeshëm të kredive me probleme (NPL) dhe veçanërisht në ekspozimin e pasurive të patundshme. Këto humbje në kredi u absorbuan nga provigjionet dinamike. Rritja e kostos totale të provigjionimit ishte më e ulët sesa ajo e provigjionimeve të veçanta. Në momentin që u kalibrua formula e provigjioneve dinamike, humbjet nga kreditë ishin më të larta sesa ato të pritura dhe kjo bëri që mbulimi të mos ishte i plotë. Rezervat që mbahen për kreditë e humbura, duhet të mbulojnë humbjet e parashikuara teksa kapitali i bankës mbulon humbjet e paparashikuara. Ka të ngjarë që me rregullimet e bëra më parë, normat e provigjioneve dinamike, nuk reflektonin më një parashikim prudencial të humbjeve që priteshin (IMF, 2011b).

Sidoqoftë, nevojat për kapital do të ishin më të larta në mungesën e provigjioneve dinamike. Mosdiferencimi i plotë i normave të interesit të provigjioneve dinamike bëri që disa banka të mos ishin të mbuluara plotësisht dhe të operonin në treg pa patur mbulesë të konsiderueshme. Vetëm pak banka mbajtën mbulesa më të larta. Mund të themi se provigjionimi dinamik ishte më pak i efektshëm, kur bëhej fjalë për të frenuar rritjen e kredive afatmesme (Alberola et al, 2011).

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

4.11 Europa Lindore dhe Vendet e Ballkanit

Tabela nr 16. Raste studimore të vendeve të Europës Perëndimore

Vendi	Viti	Historiku	Instrumentat Makroprudenciale të përdorur
Bullgaria	2004 - 2007	Gjatë periudhës kur ky vend pregatitej të ishte pjesë e Bashkimit European, u vu re një rritje e kredive për banesat për individë. Kjo gjë u shoqërua me një rritje të çmimit të shtëpive. U vu re se kjo rritje, vuri në pikëpyetje aftësinë e bankave për të menaxhuar riskun që lidhej me këto kredi. Për këtë qëllim u morën masa për minimizimin e riskut sistematik, si dhe rritjen e kufizimit të riskut.	2004-2005- U vendosën rregulla më të forta për klasifikimin e kërkesave dhe përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit të bankave, duke përjashtuar fitimet aktuale nga baza e kapitalit. 2004 - Kërkesat e rezervës u bënë më të forta, duke reduktuar pjesën e parave në kasafortë në asetet e caktuara dhe zgjerimin e bazës së detyrimit të depozitave dhe letrave me vlerë me afat maturimi më të gjatë. 2005 – U vendosën provigjione më të larta për kreditë e shtëpive, si dhe u rishikua raporti i LTV, duke e rritur atë në 70% për kreditë e shtëpive me një peshë risku 50%. 2006 - U prezantua një kërkesë marxhinale rezervë për bankat që tejkalojnë rritje mesatare të kredisë. 2007- Rritje e shkallës së kërkesës për reserve.
	2008 - 2010	Për shkak të krizës financiare, rritja ekonomike ishte e pandryshuar. U morën masa për të nxitur rritjen e kredisë.	2008 – 2009 Zvogëlim i kërkesave të rezervës. 2010 - Një zvogëlim i peshës së riskut për kreditë për shtëpitë dhe kreditë hipotekore.
Kroacia	2003 - 2008	Gjatë viteve 2001-2003 në Kroaci, u rritën kreditë bankare për sektorin privat me 20-30% në vit. Në vitet 2003-2008 kishte një rritje ekonomike të vullshme dhe që u pasua nga një “boom” si pasojë e flukseve hyrëse të kapitalit dhe konsumit të brendshëm. 2007- kreditë për shtëpi u rritën me shpejtësi me një normë vjetore 31 %. Gjithashtu, në po të njëjtën periudhë u rritën edhe çmimet e shtëpive me një normë 30%. Risku sistematik u rrit nga kreditë bankare në monedhë të huaj, veçanërisht për huamarrësit e pambrojtur nga standartet e dobëta të bankave. Bankat ishin subjekt i risqeve të likuiditetit dhe ndryshimeve të paparashikuara të investitorëve në rajon. U morën masa që të ngadalësohet rritja e menjëhershme e kredisë, të reduktohej prociklikaliteti, të ngadalësohet huamarrja e huaj dhe u	2003 – Si pasojë e një kërkesë shtesë të likuiditetit u rrit raporti nga asetet likuide të huaj në ato të huamarrjes së huaj në 24%. 2004 -2006 Bankat e panë të nevojshme të vendosnin provigjione shtesë për rritjen e tepërt të kredisë. 2005 – Rritje e likuiditetit në 32%. 2006 – Filloi të përdoret LTV për kreditë e shtëpive në masën 75%. U miratuan ndalimi i kredive të reja, nëse të ardhurat mesatare mujore të një debitori nuk mbulojnë detyrimet e tij totale. 2007-2008 U ul tavani i kreditimit. 2004-2008 Kërkesat e rezervës shtesë për kreditimet në monedhë të huaj nga bankat.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

		inkurajuan bankat që aplikonin politika prudenciale në të tilla raste.	
Hungari	2010	Dobësitë në këtë ekonomi ishin në formën e borxhit të lartë të jashtëm, si dhe ndryshimet në valutë. Një pjesë e madhe e kredive për shtëpi ishte dhënë në monedhë të huaj duke i bërë huamarrësit në këtë kategori të pambrojtur ndaj luhatshmërive të kursit të këmbimit. Masat kishin të bënin me trajtimin e ndryshimit të këmbimit valutor në kreditë e banesave.	2010 - Futja e kufirit të LTV dhe DTI për kreditë e banesave në monedhë të huaj, gjithashtu u ndaluan kreditë e shtëpive në monedhë të huaj.
Poloni	2006 - 2011	Boom-i i kreditit i viteve 2006-2008 adresoi çështjen e standardeve të dobëta të kreditit të përdorur nga bankat. Rritja e numrit të kredive në monedhë të huaj, përkundrejt kredimarrësve të pambrojtur që mbështeteshin nga diferencat e normave të interesit dhe vlerësimit të monedhës vendase, sinjalizuan mundësinë e krijimit të riskut sistemik. Masat e marra synonin që të zbutnin riskun e kreditimit në monedhë të huaj dhe të forconin kapitalin dhe mbulesën e likuiditetit, për të përballuar goditjet.	2008 - Peshat e riskut u diferencuan për kreditë e banesave në monedhën vendase (75%) dhe ato në monedhë të huaj (35%). Ky kreditim në monedhë të huaj u reduktua në 2010 dhe u rrit në masën në 100%, për të gjitha kreditë në vitin 2012. 2009 – Ulje e kërkesave të rezervës nga 3.5% në 3% , për të rritur likuiditetin e sektorit bankar. Gjithashtu, u vendosën kufizime në shpërndarjen e fitimit. 2010- 2011 DTI-ja: cap 50% -65% për kreditë për familjet dhe cap më i ulët, 42% për kreditë në monedhë të huaj. 2010- Tavan për kreditimin në monedhë të huaj i vendosur në masën 50% të totalit të kredidhënies së shtëpive të vendosura në atë vit. Kushte më strikte për kreditë në monedhë të huaj të prezantuara në vitin 2006.
Serbia	2004 - 2011	Serbia kishte një rritje të shpejtë të kredisë, e cila u shoqërua me detyrimet e përgjgjësisë ndaj borxhit të jashtëm. Gjithashtu, risku sistemik u rrit si pasojë e kredive bankare në monedhë të huaj që kishin standarte jo të forta. Risku i këtyre kredive prekte në mënyrë të veçantë huamarrësit e pambrojtur. Masat e marra kishin për qëllim që të kufizonin riskun në valutë, si dhe të kufizonin rritjen e lartë të kredisë.	2004 - DTI-ja (për familjet): futja e tavanit(cap) në DTI-së dhe rikalibrimi i saj disa herë që nga 2004. 2005 – U futën kërkesa të diferencuara të rezervës për monedhën e huaj, si dhe reduktimi i kredive në monedhë të huaj. 2006 - Kapitali: futja e tavanit 200% në raportin e portofolit të kredive për shtëpi. Ky tavan u reduktua në 150% një vit më vonë. 2007 – 2008 Tavan kreditimi në monedhë të huaj duke futur një depozitë minimale prej 20% për kreditë (jo të banesave) për familje. Një vit më vonë kjo u reduktua në 0%. Shtrëngimi i pozicioneve maksimale neto në valutë të hapur, kundrejt kapitalit nga 30%, në 10% në vitin 2007, por me fillimin e krizës financiare u ngrit në 20%. 2008 - Kufizimet në shpërndarjen e fitimit: dividendët dhe pagesat bonus ishin të ndaluara, nëse banka ishte nën provigjionim. Ky rregull është në fuqi edhe në ditët e sotme.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Rumani	Vitet 2000	Në vitin 2003 kishte një rritje të shpejtë të kredisë në sektorin privat, deri në një masë 40%. Një faktor që ndikoi këtë rritje ishte stabiliteti ekonomik dhe kushtet e favorshme ekonomike. Një rritje u vu re edhe në kreditë në monedhë të huaj për kreditë e shtëpive. U morën masa që të ngadalësohej rritja e kreditit, të kufizohej risku në monedhë të huaj, si dhe t'i vendosej një kufi borxhit të individëve.	2004-2007 LTV: cap në LTV prej 75% DTI: cap në DTI prej 35% për kreditë e shtëpive dhe 30% për kreditë konsumatore. Tavan kreditimi në monedhë të huaj për huamarrësit e pambrojtur të limituar në 300% të fondeve të vetë institucionit. 2004-2006 Rritje e kërkesave të rezervës për depozitat në valutë nga 25% në 30% në vitin 2004, nga 30% deri në 40% në vitin 2006. 2005 - Futja e cap në DTI për borxhin e përgjithshme familjare prej 40%, 2002; 2005 - Provigjionet: rregulla për provigjionim të kredisë me rregulla më strikte, si dhe klasifikimi duke marrë parasysh rrezikun e monedhës e huamarrësve.
Sllovakia	2008 - 2009	Ekonomia e Sllovakisë është e vogël dhe e hapur dhe mbështetet shumë në eksportet që kryen. Kriza e fundit e gjeti Sllovakinë në gjendje të mirë ekonomike. Por situata e krizës globale e preku vendin në mesin e vitit 2008. Masat e marra kishin të bënin me riskun e daljes së likuiditeteve. Më konkretisht, u morën masa për të forcuar pozitën e likuiditetit afatshkurtër të bankave, për të parandaluar flukset dalëse të likuiditetit të aseteve likuide, si dhe për të rritur bazën e kapitalit.	2008 - mospërputhje e maturimit: futja e një treguesi të ri të likuiditetit afatshkurtër. 2009 - Kufizimet në shpërndarjen e fitimit: lëshimin e rekomandimit të bankës qendrore, se bankat nuk do të shpërndajnë të gjithë fitimin e tyre nga viti 2008, por do t'a përdorin atë për të rritur fondet e veta.
Rusi	2008 - 2010	Gjatë krizës, sektori bankar nuk kishte rritje kreditimi, por nga ana tjetër kishte një numër të madh kredish të këqija (NPL). Gjithashtu u vu re një tkurrje në ekonominë ruse prej 7.9%, në vitin 2009, me flukset dalëse të kapitalit. Për të dalë nga kriza u morën masa që të nxitej rritja e kredisë, të kufizohej risku i valutës dhe të menaxhohej rrjedhja e kapitalit, si dhe të zbuteshin kufizimet e likuiditetit.	2008 - Rënie në kërkesat për rezervë të detyrueshme. Gjithashtu, u përdorën kërkesa rezervës, sipas vendit të banimit. 2008-2009 Lehtësimi i DTI-së. NOP: Kufij mbi pozicionet neto në valutë të hapur. Provigjionet – u përdorën kërkesa më lehtësuese për vlerësimin e borxhit për kreditë.

Burimi : IMF, 2011b

- Masat e marra në vendet e Europës Lindore

Polonia - iu bashkua Bashkimit Europian (BE) në vitin 2004. Ajo rriti shumë peshën ndaj riskut për kreditë e ekonomive familjare në monedhë të huaj (IMF, 2012).

Në vitin 2006, u bënë përpjekje për të përballuar rrezikun e kreditimit në monedhë të huaj, veçanërisht për kreditë e shtëpive. Gjithashtu Polonia po këtë vit (2006), vendosi normat si LTV-në dhe DTI-në, strikte për huamarrësit e rinj për kreditë e shtëpive në monedhë të huaj. Në vitin 2008- u rrit risku për kreditë e shtëpive, si dhe u prezantua pesha mbi kreditë e shtëpive në monedhë të huaj.

Në vitin 2010 u miratuan masa që synonin kreditimin dhe huadhënien për retail (shitje me pakicë), si dhe kushte më të forta LTV (IMF, 2013).

Kroacia - miratoi disa masa për të frenuar kreditimin në monedhë të huaj.

Serbia - u bë një vend kandidat anëtarësimi në Bashkimin Europian në vitin 2012. Ky vend u përpoq të përmbushë objektivat e inflacionit, duke tejkaluar objektivin, me më shumë se 5% në vitin 2011. Në Serbi në vitin 2006, u prezantuan pesha më të larta të riskut, siç ishte ai i huave në monedhë të huaj mbi një shumë të caktuar. Në vitin 2008 u diferencua klasifikimi i kredive dhe rregullat e provigjionimit sipas monedhës. Banka Kombëtare e Serbisë rriti normën e politikës së saj nga 200 basis point (pbs)¹²¹ gjatë periudhës qershor- dhjetor 2008 (IMF, 2012). Gjithashtu, ajo në të njëjtën mënyrë si Kroacia, miratoi masa për të frenuar kreditimin në monedhë të huaj.

Rumania - iu bashkua Bashkimit Europian në vitin 2007. Në vitin 2005 në Rumani u diferencuan dhe klasifikuan kreditë dhe rregullat e provigjionimit sipas monedhës. Rumania, në vitin 2005 vendosi një normë maksimale të kredive në monedhë të huaj për huamarrësit. Në vitin 2008-2009 forcoi kufijtë e DTI-së për familjet për një periudhë të shkurtër. Gjithashtu Rumania futi LTV e diferencuar sipas monedhës (IMF, 2012).

Bullgaria- mori masa për rritjen e përgjithshme të kredisë dhe rritjen e çmimeve të aseteve, të tilla si tavanet e kredisë, rreziku i bazuar i LTV-së si dhe kërkesat kundërciklike.

¹²¹ <http://www.investopedia.com>: Përkufizimi i BPS :Një njësi është e barabartë me 1/100 e 1% dhe përdoret për të treguar ndryshimin në një instrument financiar. Ky term zakonisht është përdorur për llogaritjen e ndryshimeve në normat e interesit, indekseve të kapitalit dhe dhënien e sigurisë të të ardhurave fikse. Marrëdhënia ndërmjet ndryshimeve në përqindje dhe pikë bazë mund të përmbledhet: 1% ndryshim = 100 pikë bazë ose 0,01% = 1 pikë bazë.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Hungaria - në vitin 2004 iu bashkua Bashkimit European. Në vitin 2010 ajo prezantoi rregullat për LTV-në dhe DTI të diferencuar sipas monedhës, para se të ndaloheshin kreditë hipotekore në monedhë të huaj (IMF, 2011b).

Republika Çeke - iu bashkua Bashkimit European në vitin 2004. Republika Çeke ka qenë vendi i parë që ka synuar dhe arritur të mbajë inflacionin e ulët dhe norma të ulëta të politikave gjatë viteve të fundit, duke treguar një shkallë të lartë të besueshmërisë të këtyre politikave. Përveç Republikës Çeke, normat e interesit për kreditë në monedhë të huaj janë përgjithësisht më të ulëta se ato në monedhën vendase, si pasojë e inflacionit në ekonominë vendase dhe politikave monetare të ulta (ESBR, 2011). Vendet e marra në shqyrtim, e në mënyrë të veçantë ato me norma fikse, kanë patur kredi në monedhë të huaj më të lirë.

Politikëbërësve çekë nuk iu desh të ndërhynin për huatë në monedhë të huaj, pasi ato ishin nga korporatat dhe mbetën të qëndrueshme gjatë dekadës së kaluar (IMF, 2012).

Të gjitha vendet e mësipërme imponuan LTV-në dhe të gjithë, përveç Kroacisë, kufizuan shpërndarjen e fitimit dhe aktivizuan shërbimin e borxhit të të ardhurave. Secili nga faktorët që lidhet me kërkesën dhe ofertën e huave në monedhë të huaj, ka luajtur rol në rritjen e kredive në monedhë të huaj në vendet e lartpërmendura.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

4.12 Vendet e Amerikës së Veriut dhe të Jugut

Tabela nr 17. Raste studimore të vendeve të Amerikës së Veriut dhe të Jugut

Vendi	Viti	Historiku	Instrumentat Makroprudenciale të përdorur
Kanada	2008 - 2011	Ky vend pati një rritje të shpejtë të kredive hipotekore, si dhe rritje në borxhet e shtëpive. U prezantuan disa masa për të mbrojtur dhe forcuar tregun kanadez të shtëpive dhe siguruar stabilitetin e saj afatgjatë.	2008 – Ulje e afatit maksimal për kreditë hipotekore, nga 40 në 35 vjet. 2010 – Qeveria forcoi kufijtë e LTV për transaksionet e refinancimit cash-out, si dhe investimet për kreditë e investimeve. 2011- Periudha maksimale e amortizimit për kreditë e reja të shtëpive të siguruara me LTV 80% ose më shumë se 80%, u reduktua në 30 vjet, nga 35 vjet.
	2005 - 2007	U implementuan masa kundërciklike për të zbutur mosbalancimet, si dhe u reduktua risku në monedhë të huaj.	Të ndryshueshme me kohën/ provigjionet dinamike: provigjionet në prespektivë. 2007 – Zvogëlim në mospërputhjen e monedhave me 30% të kapitalit rregullator.
Brazil	2008 - 2010	Rritje e kredisë si pasojë e përmirësimit të ekonomisë. U morën masa për të reduktuar rritjen e kredisë dhe ndaluar hyrjet spekulative	2010 – U prezantuan kërkesat e rezervës për të reduktuar rritjen e kredisë. Gjithashtu u prezantua nga banka qendrore një rezervë e papaguar prej 60% mbi pozicionet në valutë të huaj, ku tregu e kalonte 3 miliardë USD. Një masë tjetër e marrë ishte e lidhur me kapitalin, banka qendrore rriti kërkesat e kapitalit për kreditë konsumatore me afat të gjatë dhe me LTV të lartë.

Burimi : IMF, 2011b

- Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Përpara viteve 1980, SHBA nuk kishte standarde të kapitalit dhe mbikqyrja në këtë fushë bëhej nga ligjet e shtetit apo politikat federale. Gjatë kësaj periudhe kishte një rritje të numrit të dështimeve bankare, si dhe një rritje të qendrueshme në pozitën e levave të disa bankave të mëdha. Këto faktorë detyruan autoritetet e SHBA për të rishikuar standardet e tyre rregullatore dhe mbikqyrëse për mbarëvajtjen dhe sigurinë e bankave (IMF, 2011b).

Sipas po të njëjtin burim, në vitin 1991 u prezantua raporti i levave financiare, që do të aplikohet në nivel kompanish bankare dhe nivel bankash individuale. Raporti i levave ka për qëllim të përdoret si një shtojcë, në riskun me bazë normën kapitalit, dhe të vendosë një kufizim në shkallën maksimale, në të cilën banka mund të përdorë levën financiare (Mersch, 2013).

Qëllimi i levave nuk ishte aspak makroprudencial, por ato i shërbyen këtyre masave, duke mbajtur rrezikun e levave të tepërta që grumbulloheshin në sistemin financiar. Levat e bankave të investimeve të SHBA u rritën në mënyrë të konsiderueshme pas vitit 2004, teksa levat në bankat tregtare amerikane ishin relativisht të ulëta. Mospërputhjet, treguan provigjione rregullatore të ndryshme të levave për bankat tregtare dhe bankave të investimeve. Raporti i levave mund të anashkalohet nga institucionet financiare, duke supozuar levat përmes ekspozimeve jashtë bilancit. Ato duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe raporti kundërciklik i rregulluar, për të pasqyruar në mënyrë të saktë rritjet në sistem (IMF, 2011b).

SHBA kishte një paqëndrueshmëri financiare deri në fillimet e krizës financiare në vitin 2007. Sipas një studimi të bërë nga IMF (2011f), normat e interesit ishin shumë të ulëta në krahasim me një përgjigje optimale të politikës monetare, si dhe mungesa e një kuadri institucional të përshtatur në mënyrë të qartë të stabilitetit financiar, kontribuoi në rritjen e levave të bankave të mëdha të investimeve, edhe pse mund të kenë ndikuar faktorë të tjerë. Politika monetare filloi në vitet 2000 me një ulje në normat e interesit për të ndihmuar ekonominë për të dalë nga kriza në 2001. Çmimet ishin të ulëta deri në vitin 2004 dhe u pasuan nga një ngritje e vazhdueshme deri në vitin 2006. Goditjet e krizës financiare filluan në 2007 dhe u ashpërsuan më tepër në 2008 (IMF, 2013). Rezultatet sipas IMF (2011b), tregojnë se gjatë viteve 2002 – 2004, normat e interesit ishin më të ulëta sesa duhej, për shumë kohë.

Boom-i i shtëpive në SHBA filloi që në vitin 1998 dhe vazhdoi deri në 2006, pa një ndikim të dukshëm në normat e politikës në rritjen e çmimeve të shtëpive (Schiller, 2007).

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

IMF (2013) pohon se studiues të ndryshëm, si Del Negro dhe Otrok, Cardarelli, etj shprehen se politika monetare ka patur ndikim në çmimet e shtëpive dhe ky ndikim ka qenë i vogël në krahasim me rritjen e përgjithshme të çmimeve të shtëpive. FMN ngre pyetjen, nëse politika monetare nuk ishte fajtori kryesor prapa kësaj flluske në çmimet e pasurive të patundshme në SHBA-së, mos ndoshta ishte mungesa e politikave makroprudenciale që ndikoi në krizë?

Sipas Dodd - Frank (sic citohet në IMF 2013), kriza financiare e viteve 2007- 2008 konfirmoi domosdoshmërinë e nevojës për të futur një kornizë rregullatore me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar .

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

4.13 Vendet e Azisë dhe Turqia

Tabela nr 18. Raste studimore të vendeve të Azisë dhe Turqia

Vendi	Viti	Historiku	Instrumentat Makroprudenciale të përdorur
	2010 - 2011	2008 – Prezantimi i një pakete stimuluese për të përballuar efektet e krizës financiare gjë e cila funksionoi më së miri për të frenuar tkurrjen e prodhimit, por tërheqja e menjëhershme ishte e pamundur. Si rrjedhojë u krijua një “boom” i kredisë së brëndshme. 2009 – Vihet re një rritje çmimeve të shtëpive me një normë mesatare vjetore prej 15-20%. U morën masa për të frenuar rritjen e kredisë dhe inflacionin e çmimeve të strehimit.	2010 – Ulje e LTV-së për ata që blinin shtëpinë e pare, nga 80%, në 70% dhe në 50% në shtëpi të dyta. Tetë-fishim i kërkesave të rezervës. Kërkesa kundërciklike kapitalit u bë e domosdoshme për bankat e mëdha, që të kenë një zbutje kundërciklike dhe sistematike të kapitalit. 2011- Ulje e mëtejshme e LTV në 40% për blerjet e shtëpive të dyta. U prezantua cap - kreditimi tavan në rritjen e kredive për bankat e mëdha, gjithashtu u ndaluan përkohësisht kreditimet nëprëmjet udhëzimeve verbale. Rritje e raportit të mbulimit të provigjioneve nga 100% ,në 150%.
Korea	2002 - 2011	Sistemi bankar Korean u prek nga boom-et në tregun e banesave. Si pasojë e krizës aziatike, politikat për të stimuluar ekonominë, krijuan një bum të kredisë i cili shpërtheu në vitin 2003 dhe adresoi nevojën për rregulla më të forta. Gjatë viteve 2001-2003 çmimet e banesave u rritën me 26 % ,që u pasua me një rritje prej 14% gjatë 2005-2007. Këto çmime u ulën si pasojë e krizës financiare globale. Qeveria Koreane mori masa për rregullimin e tregut të strehimit, si pasojë e ndikimit që ky kishte në mirëqenien sociale dhe në menaxhimin e përgjithshëm makroekonomik.	2002 – U fut cap në LTV. Uljet dhe ngritjet ndodhën disa herë si pasojë e luhatjeve të çmimeve të pronave. 2005 – U prezantua cap në DTI në debt-to-loan. Në bazë të ndryshimeve në çmimet e pronave, ndryshoi disa herë DTI, duke u forcuar dhe liruar disa herë. 2006 - Kërkesat Rezerva, patën një rritje nga 5%, në 7 % për llogaritë e depozitave, depozitat pa afat dhe depozitat e tjera jo të kursimeve. U zvogëlua rezerva e detyrueshme nga 1 %, në 0 % për depozitat e kursimeve afatgjata. Kërkesat e përgjithshme të rezervës u rritën nga 3%, në 3.8% Rritje gjithashtu pësuan edhe kërkesat për rezerva të depozitave pa afat në valutë të huaj, nga 5%, në 7 %. Masa të tjera të marra përfshijnë financimi i subvencionuar, fiskale, ndërtimi dhe blerja e shtëpive të pashitura nga qeveria, mbështetja direkte për sektorin e ndërtimit, lehtësira fiskale, si dhe Loan-to-deposit (Kredi-për-depozita) për një reduktim të këtyre të fundit në 100% duke filluar në vitin 2014.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

	2009 - 2011	Situata e sektorit bankar përpara krizës ishte me një akumulim të borxhit të jashtëm afatshkurtër. Masat e marra në këtë periudhë kishin për qëllim të ulnin financimin me shumicë, të reduktonin borxhin e jashtëm afatshkurtër dhe për të reduktuar paqëndrueshmërinë e rrjedhjes të kapitalit, të forconin standardet e likuiditetit në valutë të huaj, si dhe të parandalonin kreditë e tepërta bankare në monedhë të huaj për tu kthyer në risqe sistemike.	2009 - U përdorën standarte më të forta të likuiditetit në valutë të huaj. 2010 - U vendosën limite për kreditë në monedhë të huaj. 2011 - Rikthimi i një tatimi në burim për blerjet e huaja të thesarit dhe obligacioneve të stabilizimit, si dhe të një takse makroprudenciale për detyrimet në monedhë të huaj (jo-depozitë) të bankave. Kufizime për investimet në valutë të huaj të shprehura në obligacione- Kjo masë konsistonte në kufizime për bankat vendase dhe investitorët e tjerë për të investuar në bono Kimchi (obligacione të shprehura në valutë të huaj të emetuara nga bankat koreane dhe korporat).
Turqia	2008 - 2009	Pasojat e krizës në Turqi u shfaqën nëpërmjet një ngjeshjeje të likuiditetit në monedhë të huaj. Bankat iu përgjigjën këtij faktori duke ulur numrin e kredive në monedhë të huaj dhe të eurobonove. Masat e marra nga autoritetet përkatëse, konsistonin në trajtimin e efektit negativ të krizës globale financiare, si dhe forcimin dhe ruajtjen e pozitës financiare të bankave.	2008 - Ndryshim në raportin e likuiditetit në monedhë të huaj, duke lejuar bankat që përkohësisht të klasifikojnë kreditë në monedhë të huaj , si likuiditete në monedhë të huaj. Kjo do t'i ndihmonte bankat që të mbanin normat e likuiditetit në monedhë të huaj. Futja e kufizimeve në shpërndarjen e fitimit. 2009 - Caps mbi kreditimin në valutë të huaj : duke lejuar kompanitë që nuk fitonin në valutë të merrnin kredi në monedhë të huaj.
	2009 - 2010	Turqia e mori veten me shpejtësi pas krizës globale financiare. Kishte një rritje të shpejtë të kërkesës së brendshme për kredi dhe huamarrje në valutë të huaj nga bankat. Synimi i masave që u morën, kishte për qëllim që të ngadalësonte rritjen e kreditimit dhe për të përmirësuar cilësinë e kredisë .	2010 - LTV : futja e cap në LTV për kreditë e pasurive të paluajtëshme.

Burimi : IMF, 2011

- **KINA**

Organi më i lartë në Kinë është Këshilli i Shtetit, i cili është përgjegjës për qeverinë dhe administratën publike, për zbatimin e politikave dhe strategjive, si dhe orientimet e përcaktuara nga Partia Komuniste Kineze (Romana 2005, cituar nga Borges & Gon, 2013). Nën këtë këshill ka disa institucione të tjera që luajnë një rol të rëndësishëm në mjedisin makroprudencial, në mënyrë të veçantë Bankën Popullore të Kinës dhe agjensitë rregullatore, direkt nën Këshillin e Shtetit. Banka Popullore e Kinës luan një rol të rëndësishëm në shpërndarjen e financave dhe është rregullatore e stabilitetit monetar (IMF, 2011b).

Sipas raportit vjetor të Bankës Popullore të Kinës të vitit 2011, plani 5-vjeçar kishte si detyrë të rëndësishme implementimin e një kuadri makroprudencial kundërciklik. U përdorën instrumentat sasiore dhe ato të bazuara në çmime, për menaxhimin makroekonomik. Banka Popullore e Kinës forcoi rregulloren makroprudenciale nëpërmjet politikave të kreditit, diferencoi raportin e rezervës së detyrueshme dhe raportin minimal të pagesës fillestare, duke dhënë rezultate të mira. Pas shpërthimit të krizës në botë (2007), Banka Popullore e Kinës në vitin 2009 filloi studimet mbi masat makroprudenciale në vijim të marrëveshjeve të pushtetit qendror (Borges & Gon, 2013). Kriza financiare ndikoi në hartimin e politikave makroprudenciale dhe ndryshoi mënyrën sesi qeveritë lokale financonin buxhetin dhe investimet e tyre. Përveç institucioneve të pushtetit qendror, politikat makro janë formuar edhe nga nivele të tjera të institucioneve. Prezantimi i stimulit nga qeveria, parashikonte se qeveritë lokale duhej të kërkonin burimet financiare. Ky skenar krijoi kushtet për tërheqjen e kredive me rrezik të lartë (Borges & Gon, 2013). Rritja e kredisë në Kinë u mbështet pjesërisht nga kreditë për platforma të qeverisjes vendore të financimit, automjetet që u përdorën për të bërë investime në infrastrukturë si dhe në sektorin e pasurive të patundshme, duke përfshirë kreditë për zhvilluesit dhe kreditë e banesave. Problemet e para në sektorin e pasurive të patundshme, filluan në gjysmën e dytë të vitit 2009, duke reflektuar një rritje të çmimit të banesave me një normë vjetore prej 15%-20%, deri në fillim të vitit 2010. Në 2010, u miratuan një sërë masash që të frenonin rritjen e kredisë dhe inflacionin e çmimeve të banesave. Masat e marra ishin në paketa “fine-tuned” me një diferencim midis kredive hipotekore për shtëpinë e parë dhe atë të dytë. Këto u ndryshuan me kalimin e kohës nga politikëbërësit dhe përfshinë masat fiskale dhe ato administrative, si dhe normën e interesit (IMF, 2011b).

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Në Prill 2010 - caps për LTV u ul nga 80%, në 70% për shtëpitë e para dhe në 50%, për shtëpitë e dyta.

Shtator 2010 - U pezulluan kreditë hipotekore për shtëpitë e treta.

Janar 2011 - caps (tavani) për LTV për kreditë hipotekore u ul në 40%.

Prill 2010 - U rritën normat e interesit për kreditë hipotekore për shtëpitë e dyta.

Në 2010 - Për bankat e mëdha u prezantua kapitali i lënë mënjanë, zbutja kundërciklike dhe zbutja e kapitalit sistemik që rriti normën minimale të kapitalit nga 11.5% në 8%. Gjithashtu, u rrit shkalla e mbulimit të provigjioneve nga 100%, në 150% për kreditë me probleme (NPL).

Janar 2010 - U rritën taksat për rishitjen e pronave brenda pesë viteve të blerjes (IMF, 2011b).

Shtator 2010 - Në qytetet ku çmimet e banesave ishin të larta dhe nuk kishte shumë opsione banimi, u vu një kufi për numrin e shtëpive që mund të blinte një familje. Kursi zyrtar i huadhënies u rrit 5 herë gjatë periudhës Tetor 2010 – Korrik 2011. Masat e marra në Kinë kanë qenë të efektshme, pasi ulën kreditimin dhe inflacionin e çmimeve të banesave. U ngadalësua rritja e kreditimit nga bankat në vitet 2009 – 2011 nga 31.7%, në 16.9%. Shitjet e banesave u rritën vetëm 6% në 2011, krahasuar me 30% në të njëjtën periudhë të vitit 2010. Gjithashtu, ranë ndjeshëm shitjet në qytetet e mëdha (IMF, 2011b).

Në Kinë, kërkesat për rezervë janë "përshtatur" në kuptimin që secili institucion financiar ka raportin e vet në bazë të institucionit dhe të treguesve sistemikë. Kërkesa e LTV-së për shtëpitë e para dhe të dyta, kanë një ndikim të rëndësishëm në politikën makroprudenciale në Kinë, për shkak të efektit të saj të mundshëm në inflacionin e tregut të pasurive të patundshme për financat e pushtetit lokal. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se, edhe pse disa banka kineze nuk i kanë miratuar plotësisht standardet e Bazel II, autoritetet kanë imponuar një kërkesë shtesë për zbutjen e humbjes, me anë të kapitalit të kushtëzuar dhe mbulesës të kapitalit anticiklik të rekomanduara nga Bazel III (Borges & Gon, 2013).

KAPITULLI V

Hyrje

Ekonomia në vendin tonë, prej një periudhe disa vjeçare është nën ndikimin e krizës globale të vitit 2007, e shprehur ndryshe, me një ngadalësimin të aktivitetit ekonomik. Kjo situatë ka frenuar investimet si dhe kreditimin. Gjatë kësaj periudhe, BSH-ja ka patur në fokus qëndrueshmërinë e sektorit bankar, si në mbikqyrjen bankare dhe drejtimin e stabilitetit financiar, ashtu dhe në atë të politikës monetare dhe të administrimit të likuiditetit. BSH-ja i është përshtatur situatës së tregut të brendshëm dhe zhvillimeve globale. Siç edhe u përshkrua në rastet studimore në kapitullin V, bankat qendrore gjatë krizës së fundit mbështetën politikën e tyre monetare në ndërmarrjen e masave të nevojshme makroprudenciale.


BSH ka strukturë të njëjtë me BQE. BSH-ja ka një eksperiencë disa vjeçare në përdorimin e masave kundërciklike, si një mënyrë për menaxhimin e ekuilibrit makroekonomik e financiar të vendit. Politika monetare e BSH bazohet në parimet e avancuara të bankikut qendror, si dhe përdor instrumenta dhe një aparat komunikimi, në linjë me praktikën BQE-së. Angazhimi i BSH është ruajtja e stabilitetit të çmimeve, pra zbatimi dhe hartimi i politikës monetare që është ekskluzivisht në funksion të stabilitetit të çmimeve (Fullani, 2013).

5 Situata e sektorit bankar dhe financiar në Shqipëri gjatë së krizës

Në Shqipëri, sistemi ynë bankar konsiderohet si sektori më i rëndësishëm dhe më i zhvilluar i sistemit financiar, pasi më shumë se 60% e këtij sistemi përbëhet nga sistemi bankar. Siç ilustron në grafikun e mëposhtëm, shihet qartë pesha e madhe që zë sistemi bankar në vendin tonë.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Grafiku nr 17. Sistemi financiar, Shtator 2013



Burimi: World Bank, 2014


Nga raporti i fundit i Bankës Botërore për Shqipërinë, në vitin 2012 bankat tregtare përbënin rreth 94% të totalit të aseteve të sistemit financiar ose ndryshe 88.7% të PBB. Ky sistem bankar që është kryesisht me kapital të huaj përbën sektorin me transaksionet më të mëdha financiare (World Bank, 2014). Krediti bankar është i përqëndruar kryesisht në sektorin e korporatave. Rreth 74% e portofolit të kredisë në vitin 2012 ishte për sektorin e përgjithshëm, ndërsa 40% u përfaqësua nga kreditë e pasurive të patundshme (BSH 2013). Një nga pasojat e krizës, ishte edhe ulja e cilësisë së portofolit të kredisë. Në vitin 2013 kreditë me probleme (NPL) përbënin 24.2% të numrit total të kredive dhe pavarësisht rregullave strikte të provigjionimit, kjo shifër është ndër më të lartat në rajon. Pjesa tjetër e sistemit financiar është vetëm 6% e aseteve të këtij sistemi (World Bank, 2014).

Në grafikun nr 18 jepet qartë “outstanding”¹²² i kredive si për biznese, ashtu edhe për kreditë retail. Vihet re një ndarje jo propocionale, pasi kreditë retail zënë më shumë se gjysmën e totalit të “outstanding” të kredive.

¹²² Me “outstanding” do të kuptojmë pjesën e mbetur të pashlyer të një kredie

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Grafiku nr 18. “Outstanding” i kredive, Shtator 2013



Burimi: World Bank, 2014

Shqipëria përballoi krizën financiare relativisht mirë, me më pak tronditje, sesa pjesa tjetër e Europës, si pasojë edhe e përshtatjes monetare dhe stimulit fiskal. Gjatë periudhës së krizës, BSH-ja ruajti një stabilitet financiar në vend, pavarësisht pranisë së bankave të huaja, mëmat e të cilave ishin në vende të prekura thellë nga kriza (IMF,2014). Bazuar në raportin e stabilitetit financiar të BSH-së, në vitin 2013 PBB pati një rritje prej 1.3%, që ishte më ulët, sesa potenciali i saj, i cili kap vlerën 2.7%. Mbulesa e politikave ishte dobësuar, me raportin e borxhit ndaj PBB-së rreth 71% në vitin 2013 dhe një pjesë e madhe e borxhit publik afatshkurtër, paraqiste rrezik të financimit.

Spektori financiar në vend po operon në një mjedis makroekonomik jo shumë të qëndrueshëm.

Janë disa faktorë të mundshëm që ndikojnë në mjedisin makroekonomik duke e bërë këtë mjedis jo të qëndrueshëm si psh :

- Kriza sistemike e cila mund të shkaktohet nga zhvillimet e jashtme dhe të brëndshme ekonomike, si pasojë e lidhjeve të fondit bankar me atë të investimeve;
- Distancimi i SHBA-së nga politika monetare do të zvogëlonte financimet e huaja, e cila për Shqipërinë do të thotë një zhvlerësim i monedhës vendase, si dhe vështirësi për bankat, për shkak të huamarrësve të pambrojtur;

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

- Rishfaqja e stresit financiar në eurozonë mund të sjellë pasoja me probleme në mjedisin makroekonomik;
- Bankat tregtare, ku mëma e tyre ndodhej në vendet e prekura nga kriza, veçanërisht ato të ndodhura në Greqi dhe Itali, do të detyroheshin të ulin ritmin e rritjes së kreditimit.

Përsa i përket sistemit bankar disa nga tiparet që e bëjnë këtë sektori bankar më të ndjeshëm ndaj goditjeve (shocks) janë:

- ✓ Rritja e shpejtë e kredive me probleme (NPL), e cila krijon ngadalësim ekonomik, si dhe shoqërohet me një sërë pengesash të tjera në ekonominë reale;
- ✓ Rënia e përfitueshmërisë së bankave tregtare, si dhe rritja e shpejtë e kredive me probleme. Është vënë re një rënie e përfitueshmërisë të bankave, e cila përpara krizës globale ishte gati 20% dhe për periudhën 2007-2013 kjo përfitueshmëri ra në nivelin 3%. Po të njëjtën periudhë, ka patur një rritje të kredive me probleme nga 3.4%, në 24 %.
- ✓ Lidhjet e forta financiare ndërmjet bankave tregtare dhe klientëve. Rreth 32% e aktiveve të bankave përbëhen nga letrat me vlerë të qeverisë, të cilat përbëjnë dhe 64% të totalit të borxhit të qeverisë. Kjo lidhje financiare midis të dyjave, paraqet risqet sistemike për qeverinë dhe bankat. Gjithashtu, sistemi financiar në tërësi ndikohet dhe nga zgjerimi i shpejtë i fondeve të investimeve, i cili investohet në bono.
- ✓ Euroizëm i lartë për vetë faktin se 50% e kredive janë në monedhë të huaj dhe të pambrojtura. Ka gjithashtu dhe mospërputhje të mëdha të maturimeve, gjë që mund të krijojë rreziqe të konsiderueshme, në rast të goditjeve negative në monedhë të huaj.
- ✓ Prania e bankave të huaja Austriake, Greke, Italiane dhe Turke. Vështirësitë financiare në vëndet e bankave mëmë, mund të ndikojnë në institucionet shqiptare, nëpërmjet ngjitjes së drejtpërdrejtë ose kreditë me probleme më të larta.
- ✓ Një nga rreziqet e mëdha me të cilat përballen bankat tregtare është edhe trendi në rritje i kredive me probleme (NPL). Mbikqyrja që i ka bërë BSH-ja këtyre kredive me probleme deri tani, ka qënë më shumë korrigjuese dhe thekson domosdoshmërinë për standarde më të detajuara prudenciale në menaxhimin e kredive me probleme.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Sipas raportit të Bankës Botërore (WB, 2014), autoritetet e njohin nevojën për të përshpejtuar miratimin e ligjeve, taksave dhe masave prudenciale, për të reduktuar grumbullimin dhe fluksin e kredive me probleme. Një sërë masash të reja janë duke u miratuar për të mbështetur zgjidhjen e kredive me probleme:

- Ristrukturimi i borxhit dhe udhëzimet e vlerësimit, të publikuara në Nëntor 2013 nga Banka e Shqipërisë. Gjithashtu, gjatë vitit 2014, BSH-ja nxorri një rregullore prudenciale për të nxitur shitjet e NPL-ve të specializuara në Institucionet Financiare Jo-Bankare.

- Kanë filluar ndryshime në legjislacionin tatimor në lidhje me bankat.

Një sërë masash specifike kyçe janë propozuar në Ministrinë e Drejtësisë për të sqaruar nene të Kodit Civil në diskrecionin e gjykatës për të shtyrë pagesat, si dhe për të nxjerrë udhëzime të reja për të ofruar stimuj të bazuar privat, të tregut të përmbaruesit, për të përshpejtuar ekzekutimin e kolateralit të nevojshëm për të ulur nivelin e kredive me probleme (WB, 2014).

5.1 Kuadri mbikqyrës i sektorit financiar

- Korniza makroprudenciale

BSH ka për detyrë të sigurojë stabilitetin financiar të sistemit bankar. Ajo e kryen mandatin e saj e ndihmuar nga agjensi, si Grupi Këshillimor i Stabilitetit Financiar (FSAG), e cila ndihmon në koordinimin e politikave dhe për të siguruar shkëmbimin e informacionit mes MF, BSH dhe AMF. Detyrat kryesore janë: zhvillimi financiar, parandalimi dhe menaxhimi i krizave. Në këtë proces u përfshi dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave Shqiptare (ASD) në FSAG (World Bank, 2014). Një sërë politikash makroprudenciale u implementuan në vitin 2007, me qëllim forcimin e tyre më tepër në vitet në vazhdim. BSH ka marrë masa në fazën fillestare për të kthyer degët e bankave të huaja në filiale, si dhe duke forcuar rregullat për likuiditetin gjatë vitit në 2013 dhe 2014. Për të stimuluar një rritje të kredisë, BSH-ja uli disa herë normën bazë të interesit, zbuti kërkesat ndaj likuiditetit, dhe në raportimin e kapitalit, për të inkurajuar bankat, të cilat zgjeruan rritjen e kredisë nga 4% - 10% (WB, 2014). Ndikimi i këtyre masave mund të jetë i kufizuar, por autoritetet duhet të vazhdojnë të peshojnë efektivitetin potencial të masave të tilla në të ardhmen e afërt, me kostot e mundshme. Masat makroprudenciale mund të zgjerohen për të përfshirë instrumentat që adresojnë prociklikalitetin e kredisë (si mbulesë të kapitalit kundërciklik). Autoritetet mund të marrin në konsideratë shpenzimet kapitale sistemike, por duhet

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

të peshojnë rrezikun e intensifikimit të presioneve mbi filialet e bankave të huaja në pronësi (WB, 2014).

- Mbikqyrja bankare

Cilësia e mbikqyrjes bankare është përmirësuar dukshëm vitet e fundit në Shqipëri. BSH ka implementuar udhëzimet e Marrëveshjeve të Bazelit, duke vendosur kritere të qeverisjes korporative, standardet e menaxhimit të bankës, funksionin e auditimit të brendshëm dhe normat e prudenciale për operacionet më të rrezikshme (WB, 2014). Është shumë e rëndësishme që të adresohen dobësitë e mbetura për të përforcuar mbarëvajtjen e sektorit bankar. Në veçanti, mbikqyrja vazhdon të jetë kryesisht e bazuar në masat korrektuese të vendosura në bankat tregtare, të cilat janë zgjedhur kryesisht nga standardet prudenciale dhe nuk janë të fokusuara në adresimin e dobësive të menaxhimit të riskut. Autoriteti mbikqyrës duhet të rritet, duke marrë parasysh krijimin e fondeve të reja të investimeve. BSH-ja është gjithashtu duke konsideruar zbatimin e komponentit të likuiditetit të Basel III, në të cilën mbështetet dhe vetë sistemi. Masat kanë për qëllim zgjidhjen e kredive me probleme dhe forcimin e standardeve, të cilat duhet të përshpejtohen (WB, 2014).

5.2 Roli mbikqyrës i Bankës së Shqipërisë

Një nga objektivat kryesorë të BSh është edhe sigurimi i veprimtarisë bankare të shëndetshme në vend, e cila garanton sigurinë e kursimeve të qytetarëve shqiptarë, mbështet gjithashtu stabilitetin financiar dhe kontribuon në ecurinë pozitive të ekonomisë në tërësi (WB, 2014).

Banka e Shqipërisë në funksion të këtij objekti mbështetet në :

- ✓ *Zhvillimi i metodologjisë*, synon strukturimin e procedurave mbikqyrëse, duke identifikuar përmirësimet e nevojshme, mbështetur kjo në standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mirë. Është i rëndësishëm edhe rishikimi i mëtejshëm i procedurave mbikqyrëse, si dhe analizës së risqeve në rritje të veprimtarisë bankare. Në këtë mënyrë nxitet përdorimi i sistemeve efektive të administrimit të rrezikut, si dhe planifikimit të nevojave për kapital nga bankat tregtare në vend (BSH, 2013).
- ✓ *Zhvillimi i kuadrit rregullator*: orientohet nga objektivi themelor i Basel II, nga direktivat e Bashkimit Europian (BE), si dhe duke shfrytëzuar hapësirat për të ruajtur fleksibilitetin,

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

duke përshtatur aktet rregullative në përputhje me zhvillimet e sistemit bankar. Një nga projektet kryesore në kuadrin e harmonizimit me standardet e BE është edhe adoptimi i rregullores së re mbi mjaftueshmërinë e kapitalit (BSH, 2013).

- ✓ *Forcimi i bashkëveprimit të mbikqyrjes bankare, stabilitetit financiar dhe politikës monetare:* Bashkërendimi i stabilitetit financiar dhe mbikqyrjes bankare, synon harmonizimin efektiv të qasjes mikroprudenciale me atë makroprudenciale. Ky bashkëpunim synon mbështetjen e veprimtarisë rregullative dhe mbikqyrëse të BSh, për të mundësuar aplikimin e politikave makroprudenciale, në funksion të objektivit themelor të ruajtjes së stabilitetit financiar të vendit. Ndërkohë, tërësia e instrumentave mikroprudenciale vijon të kontribuojë në rritjen e efektivitetit të politikës monetare të BSh-së (BSH, 2013).
- ✓ *Dialogu dhe bashkëpunimi me industrinë bankare:* ky dialog me industrinë bankare përqëndrohet në nxitjen e pjesëmarrjes, si dhe të kontributit të vetë industrisë bankare, ku ato synojnë të rrisin përgjegjshmërinë dhe administrimin e veprimtarisë bankare (BSH, 2013).
- ✓ *Rritja e transparencës dhe e mbrojtjes së klientit :* në kuadrin e mbrojtjes së klientit dhe rritjes së transparencës, BSh i kushton një rëndësi të veçantë nxitjes së politikave mbi përcaktimin e kushteve të qarta të ofrimit të produkteve, si dhe transparencës të shërbimeve bankare. Një tjetër dimension i rëndësishëm është ndërgjegjësimi i publikut për instrumentat dhe mundësinë e përdorimit të tyre, në mënyrë sa më efikase për të arritur kështu, edhe përfitim të produktit të synuar, përmes një konkurrence të ndershme (BSH, 2013).
- ✓ *Sistemi i raportimit i të dhënave si dhe cilësia e tyre:* një rritje e cilësisë së statistikave dhe analizave të prodhuara nga BSh, mbështetet në sistemin e përmirësuar të raportimit të të dhënave, i cili po zhvillohet me kontributin e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Ky investim në këtë sistem, përbën një bazë të rëndësishme në mundësimin e analizave më të detajuara dhe efikase (BSH, 2013).

5.3 Stabiliteti financiar si objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë

Kriza e fundit financiare reflektoi nevojën për të kuptuar drejt, për të matur dhe mundësisht për të projektuar ngjarjet sistemike, të cilat kanë një probabilitet të lartë në shkaktimin e ndërprerjes së funksionimit normal të tregjeve financiare, duke rezultuar në ngadalësim të rritjes ekonomike (Buletini i Bankës së Shqipërisë, Nr 7, 2012).

Për BSH, stabiliteti financiar është kusht themelor për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit tonë. Objektivi kryesor i BSH, është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. BSH ka si detyrë kryesore të miratojë, të hartojë dhe të zbatojë në mënyrë të pavarur politikën monetare të Republikës së Shqipërisë. (www.bankofalbania.org)

Stabiliteti ose thënë ndryshe qëndrueshmëria e çmimeve, është kontributi më i madh që një bankë qendrore mund të japë dhe kjo çon në rritjen ekonomike të vendit. BSH-ja në rolin e saj si mbikqyrëse dhe rregulluese e sektorit bankar, jep një kontribut të drejtpërdrejtë thelbësor në ruajtjen e qëndrueshmërisë së sistemit financiar dhe në zhvillimin e tregut financiar. Vendet e Europës Qendrore dhe Lindore kanë mjaft karakteristika të përbashkëta në strukturat e tyre ekonomike dhe financiare. Këto vende u goditën në të njëjtën kohë dhe nga e njëjta krizë. Tashmë është e qartë se, ekonomitë e vëndeve të Europës Qendrore dhe Lindore, karakterizohen nga i njëjti model zhvillimi dhe kanë po të njëjtat probleme. Këto vende arritën të përfitonin nga flukset e mëdha hyrëse të kapitalit, kryesisht kjo, në formën e investimeve të huaja direkte, financimeve nga jashtë dhe remitançave. Gjatë dekadave të fundit bankat me origjinë nga vendet e Europës Perëndimore penetruan në sistemin tonë financiar, duke rritur kështu, ndërmjetësimin financiar dhe lehtësuar flukset hyrëse të kapitalit (Buletini i BSH, 2012).

Kriza globale financiare tregoi se: mbështetja vetëm në rregullimin financiar mikroprudencial, do të çonte në një neglizhim me një dimension të rëndësishëm të stabilitetit financiar, siç është edhe ndikimi i dyanshëm mes ecurisë makroekonomike dhe qëndrueshmërisë së institucioneve financiare¹²³. Kjo ishte edhe arsyeja që BSH vendosi si objektivin kryesor të saj, zhvillimin e politikave të përshtatshme makroprudenciale në qendër të veprimtarisë. Në rolin e saj si rregulluese dhe mbikqyrëse e sektorit bankar, BSH-ja kontribuon në ruajtjen e qëndrueshmërisë së sistemit financiar dhe në zhvillimin e tregut financiar. Një nga objektivat e tjerë të BSH-së është dhe zhvillimi i politikave makroprudenciale. Ky zhvillim lidhet me zbatimin e masave

¹²³ Buletini Zyrtar BSH Dhjetor 2012

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

prudenciale për parandalimin, trajtimin dhe kufizimin e risqeve financiare sistemike. Kuadri i këtyre politikave makroprudenciale u mbështet në pavarësinë institucionale, si dhe ruajtjen e objektivit parësor të kontrollit mbi normën vjetore të inflacionit. Politikat makroprudenciale kërkojnë zhvillimin e instrumentave që të vlerësojnë zhvillimin e risqeve sistemike, si edhe mundësojnë trajtimin e tyre (BSH, 2013).

BSH duke patur si objektiv kryesor stabilitetin financiar, vazhdon të mbështetet në realizimin e disa prej objektivave të mëposhtme si:

- zhvillimi i një treguesi ose indeksi, që vlerëson ecurinë e pasurive të paluajtshme
- zhvillimi i teknikave, të cilat provojnë qëndrueshmërinë e sektorit bankar dhe atij të sistemit financiar
- plotësimi i kuadrit të treguesve, të cilët vlerësojnë ecurinë e riskut sistematik në sistemin financiar
- identifikimi i politikave makroprudenciale kundërciklike, me anë të cilave mundësohet ulja e varësisë së performancës së sistemit financiar, si dhe atij bankar ndaj luhatjeve në ciklin ekonomik
- vlerësimi i nevojës së përmirësimit të kuadrit institucional, i cili lidhet me mbrojtjen e konsumatorit dhe shërbimeve financiare
- trajtimi i “veçantë” i bankave dhe i institucioneve financiare me rëndësi sistemike, duke përfshirë vendosjen e kërkesave më të larta për kapitalizimin dhe likuiditetin e veprimtarisë së tyre
- rritja e transparencës për vlerësimet dhe analizat mbi qëndrueshmërinë e sistemit financiar
- ndërtimi i një modeli që vlerëson ndikimin e ndërsjellë midis performancës së sektorit bankar dhe ecurisë së treguesve makroekonomikë.

- Indikatorët e mbarëvajtjes financiare në Shqipëri , Dhjetor 2007 – Shtator 2013

Në tabelën nr 19 jepen indikatorët e mbarëvajtjes financiare në Shqipëri gjatë periudhës së krizës. Indikatorët janë bazuar në: kapital, kapitali si përqindje e aseteve totale bazuar në asete, të ardhurat dhe shpenzimet, etj. Vihet re se, raporti i kredive me probleme (NPL) është rritur nga 3.4

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

% në fund të vitit 2007, në më shumë se 24% , në shtator 2013. Ky fakt tregon borxhet e qeverisë, si dhe dobësinë ekonomike e cila sipas IMF(2014) është vlerësuar me 5% të PBB. Ndikim kanë patur edhe nga volumet e larta të kreditimit para të krizës globale financiare, ku standarte e mbikqyrjes nuk ishin në aq të forta. Sipas tabelës së mëposhtme vërejmë një rënie të ciklit të kredisë, e cila pasohet nga një riparim në harkun kohor të dhënë. Edhe pse këto rreziqe janë disi më të zbutura, e vlerësuar kjo nga aftësia paguese, rregullat, si edhe standartet më strikte, përsëri vërehet se kreditë me probleme (NPL), arrijnë në 55 % të kapitalit të bankës. Vihet re se ka një rënie të profitabilitetit të bankave, i cili siç edhe shihet në tabelën nr 20, ka një vlerë (-1.7%) në shtator të vitit 2013.

Pozicionet neto të hapura në euro janë të vogla dhe ato përfshijnë :

- ✓ Rrezikun e kredisë, për kreditë në monedhë të huaj të cilat mund të jenë nënvlerësuar si pasojë e rrezikut jo të drejtpërdrejtë të kursit të këmbimit, i cili mund të jetë i vështirë të matet, për më tepër po të kemi parasysh faktin që gjysma e kredive në monedhë të huaj, i përkasin huamarrësve të pambrojtur.
- ✓ Ka mospërputhje të konsiderueshme në maturim.

Siç edhe shihet, ka lidhje të forta sistemike ndërmjet bankave, фондеве të investimit dhe klientëve. Një e treta e aktiveve të bankës përbëhet nga letrat me vlerë të qeverisë dhe këto zotërime përfaqësojnë dy të tretat e totalit të borxhit të qeverisë (WB, 2014). Kjo varësi e fortë financiare paraqet riskun sistematik për bankat, të cilat janë të dobëta ndaj ndryshimeve në vlerën e letrave me vlerë, si dhe për qeverinë, e cila ndikohet nga borxhi i bankave. Ka një numër të madh bankash të huaja në vend, të cilat janë domethënëse për mbarëvajtjen e sistemit bankar në vendin tonë, pasi problemet financiare në vendet mëmë mund të ndikojnë në institucionet shqiptare në mënyrë direkte .

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Tabela nr 19. Indikatorët e mbarëvajtjes financiare, Dhjetor 2007 – Shtator 2013

	<i>Dhjetor 2007</i>	<i>Dhjetor 2008</i>	<i>Dhjetor 2009</i>	<i>Dhjetor 2010</i>	<i>Dhjetor 2011</i>	<i>Mars 2012</i>	<i>Qershor 2012</i>	<i>Shtator 2012</i>	<i>Dhjetor 2012</i>	<i>Mars 2013</i>	<i>Qershor 2013</i>	<i>Shtator 2013</i>
<i>Bazuar në capital</i>												
Kapital rregullator si % e riskut të peshës së aseteve	17.1	17.2	16.2	15.4	15.6	15.9	15.7	15.9	16.2	16.8	17.0	17.8
Kapitali rregullator Tier 1 si % e riskut të peshës së aseteve	16.0	16.3	15.3	14.5	14.3	14.7	14.5	14.5	14.6	15.2	15.4	14.8
<i>Kapitali si % e aseteve totale</i>												
Kapitali rregullator Tier 1 si % e aseteve totale	5.8	6.7	8.7	8.6	8.1	8.3	8.0	7.9	7.9	8.2	7.9	7.7
Kapitali rregullator si % e aseteve totale	6.2	7.0	9.2	9.1	8.8	9.0	8.6	8.6	8.8	9.0	8.8	9.2
Kapitali i aksionerëve 1 si % e aseteve totale	7.6	8.6	9.6	9.4	8.7	8.7	8.6	8.5	8.6	8.6	8.5	8.3
<i>Provgjionimi neto i kredive me probleme si % e kapitalit</i>												
Provgjionimi i kredive me probleme si % e kapitalit Tier 1	12.0	27.2	29.9	38.1	56.6	58.8	60.5	64.9	61.8	62.8	62.5	54.7
Provgjionimit i kredive me probleme si % e kapitalit rregullator	11.2	25.7	28.2	35.9	52.0	54.2	55.8	59.5	55.6	57.0	56.4	45.4
Provgjionimi neto i kredive me probleme si % e kapitalit të aksionerëve	9.1	21.1	27.1	34.8	52.6	56.0	56.3	60.8	56.9	59.4	58.4	50.7
Kthimi në kapital (me bazë vjetore)	20.7	11.4	4.6	7.6	0.8	8.0	4.8	4.2	3.8	5.2	2.9	(1.7)

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Pozicioni neto i hapur në valutë të huaj si % e kapitalit												
Pozicioni neto i hapur në valutë të huaj si % e kapitalit rregullator Tier 1	1.8	4.5	4.1	5.3	4.3	4.3	6.5	4.5	4.1	4.0	4.5	5.2
Pozicioni neto i hapur në valutë të huaj, si % e kapitalit rregullator	1.7	4.3	3.9	5.0	3.9	4.0	6.0	4.1	3.7	3.6	4.0	4.3
Pozicioni neto i hapur në valutë të huaj ,si % e kapitalit të aksionerëve	1.4	3.5	3.7	4.9	4.0	4.1	6.1	4.2	3.8	3.8	4.2	5.2
Bazuar në asete												
Asetet likuide si % e totalit të aseteve (raporti Likuide-asete)*	49.8	42.8	27.6	25.9	26.5	29.0	35.9	29.0	29.4	29.1	27.4	29.2
Asetet likuide si % e detyrimeve afatshkurtra *	55.6	104.7	32.6	30.6	33.1	36.1	36.0	35.8	34.9	34.9	33.8	36.5
Kthimi nga asetet (të ardhurat neto mesatare për asetet e përgjithshme) (bazë vjetore)	1.6	0.9	0.4	0.7	0.1	0.7	0.4	0.4	0.3	0.4	0.3	(0.1)
Kreditë me probleme (bruto) % e totalit të kredisë	3.4	6.6	10.5	14.0	18.8	20.1	21.1	22.7	22.5	23.7	24.2	24.2
Të ardhurat dhe shpenzimet												
Marzhi i interesit ndaj të ardhurave bruto	92.7	106.5	119.6	118.9	147.7	119.7	129.5	130.6	130.4	123.6	131.2	148.3
Shpenzimet pa interes të të ardhurave bruto **	58.5	69.6	83.0	75.5	91.3	71.7	80.4	82.2	85.0	78.7	87.5	98.3

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

<i>Tregues të tjerë (jo kryesorë)</i>												
Depozitat e klientëve, si % e totalit (jo-ndërbankar) të kredisë	215.5	162.6	154.3	166.4	163.2	164.0	168.1	172.3	171.6	171.9	173.9	180.9
Kredi në valutë ndaj totalit të kredisë	72.5	72.6	70.2	69.8	67.9	68.2	67.1	66.5	64.5	64.8	64.5	63.7
Detyrimet në valutë, si % e totalit të detyrimeve	46.9	48.5	48.9	51.0	51.9	52.1	52.3	53.7	52.6	52.4	51.8	52.9
<i>Indikatorë të tjerë</i>												
Asetet e peshës së riskut, si % e aseteve totale	36.4	40.8	56.7	59.2	56.5	56.3	55.2	54.5	54.2	53.7	51.7	52.0
Kreditë totale, si % e totalit të aseteve	39.4	47.6	50.8	49.6	50.5	50.2	49.4	48.5	48.6	48.6	48.1	46.0
Kreditë totale, si % e kapitalit të aksionerëve	516.4	555.1	530.2	527.0	581.9	578.8	575.5	573.6	567.4	562.4	566.7	555.0

*Përkufizimi i aseteve likuide dhe detyrimeve (liabilities) afat - shkurtër të ndyshuara në Tetor 2009.

**Shpenzimet pa interes të përcaktuara si shpenzime të tjera, përveç atyre nga aktiviteti kryesor bankar.

Burimi: IMF, 2014 sipas informacionit të marrë nga BSH.

5.4 Rreziku i kreditit si rreziku kryesor i sistemit bankar

Si rrezik kryesor për qëndrueshmërinë e sektorit bankar, mbetet rreziku i kredisë.

Në bilancet e bankave, zhvillimi i ngadaltë i ekonomisë përbën faktorin kryesor në rritjen e rrezikut të kredisë. Disa nga faktorët që kanë ndikuar në rënien e cilësisë së kredisë, si për bizneset ashtu edhe për familjet janë :

- paqëndrueshmëria e të ardhurave dhe remitançave
- pasiguria për zhvillimet ekonomike
- kushtet e dobëta në tregun e punës

Ulja e e portofolit të kredisë është shoqëruar nga shtrëngim i standardeve të kreditimit nga ana e bankave tregtare, si dhe orientimit të burimeve drejt financimit të aktiveve më të sigurt. Në kahun lehtësues të ofertës, niveli i lartë i likuiditetit, si dhe ulja e marzheve të fitimit ka ndikuar tek individët, ku kredia për ta, është ofruar me komisione dhe marzhe mesatare më të ulëta. Periudhat e ardhshme do të na tregojnë nëse ky fenomen do jetë afatshkurtër, apo do të jetë një prirje e re në aktivitetin kreditues. Aktivët e ponderuara me rrezik u ulën me 21.4 miliardë lekë ose e përkthyer në përqindje në 3.3%, krahasuar kjo me periudhën e fundit të 2012. Kjo lloj ecurie, ka bërë që të sjellë një rënie të mëtejshme të raportit:

“Aktive të ponderuara me rrezik/Totali i aktiveve” në 51.7%, nga 54.2% në gjashtëmujorin paraardhës (BSH 2013).


Në përbërjen e aktiveve sipas koeficientëve të rrezikut, rritja e aktiveve me rrezik të lartë me 14.2 miliardë lekë ose 3.9%, është kompensuar nga rritja e aktiveve pa rrezik, me 7.3 miliardë lekë ose 1.6% dhe rënia e atyre me rrezik shumë të lartë, me 7.1 miliardë lekë ose 5.2% (BSH 2013).

Rreziku i kreditit përfaqëson sfidën më të rëndësishme të veprimtarisë së sektorit bankar. Madhësia e këtij rreziku në të ardhmen afatshkurtër, pritet të jetë më e kontrollueshme dhe të ketë një prirje në rënie graduale. Në fakt kjo pritshmëri lidhet me efektin e ndryshimeve ligjore dhe operacionale që do të hyjnë në fuqi ose që do të gjejnë përdorim më efektiv.

Pritet që këto ndryshime do t’u përmirësojnë aftësinë e industrisë bankare për trajtimin sistematik të kredive me probleme (BSH, raporti stabilitetit financiar i 6-mujorit të dytë të vitit 2013).

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Grafiku nr 19. Rritja e kreditimit sipas sektorëve të ekonomisë




Burimi: Banka e Shqipërisë 2013

Sipas raportit të 6-mujorit të dytë të stabilitetit financiar (2013), për individët tregonte se rritja vjetore e kredisë kryesisht ishte orientuar në “Investime për pasuri të paluajtshme” me rreth 2% dhe në “Konsum të mallrave të qëndrueshëm” me rreth 4%. Po sipas këtij raporti (BSH 2013), kreditimi është rritur për sektorë si “bujqësia” dhe “prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike” ndërsa kreditimi për sektorët e tjerë është tkurrur ndjeshëm. Përsa i perket kredive të reja, duke iu referuar po këtij raporti, në gjysmën e dytë të vitit 2013, sektori bankar dha kredi të re rreth 119.7 miliardë lekë. Duke iu referuar po të njëjtës periudhë, pra një vit më parë, kredia e re ka pësuar një rënie me rreth 22.3 miliardë lekë ose rreth 16 % më pak. Pra raporti i kredisë së mbledhur me kredinë e dhënë është treguesi i përdorimit të kredisë dhe ky raport u përlogarit në 107.2% nga 97.8% referuar vitit 2012, kjo si pasojë e rënies më të lartë të kredisë së re krahasuar me kredinë e mbledhur (BSH, raporti i stabilitetit financiar të 6-mujorit të dytë, 2013).

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Grafiku nr 20. Ecuria e aktiveve me rrezik




Burimi: Banka e Shqipërisë 2013

Pas një rënije të lehtë në fund të vitit të kaluar, pra të vitit 2012, rreziku i kredisë në sektorin bankar kishte tendencë në rritje. Bankat tregtare janë përpjekur për të rritur arkëtimet nga detyrimet e prapambetura të huamarrësve. Gjatë mbylljes së vitit të tyre financiar, rezultoi një përmirësim i lehtë i stokut të kredive me probleme. Sikurse edhe evidentohet nga grafiku i mësipërm, raporti i aktiveve me rrezik ndaj totalit të aktiveve ka rënie. Në përbërjen e aktiveve me rrezik ka vazhduar zhvendosja e portofoleve të investimit të sektorit bankar nga kreditimi në investime, në aktive likuide në tregjet e parasë dhe të kapitalit (BSH, raporti i stabilitetit financiar të 6-mujorit të dytë, 2013).

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Grafiku nr 21. Ecuria e raportit të kredive me probleme




Burimi: BSH 2013

Siç edhe jepet nga grafiku nr 21, huatë me probleme në sektorin bankar, në fund të vitit 2013, u vlerësuan me 133.2 miliardë lekë, nga 140.1 miliardë lekë që ishin vlerësuar në qershor të vitit 2013, si dhe 130 miliardë lekë në dhjetor 2012 (BSH 2013). Gjatë vitit 2013 rritja vjetore e huave me probleme ishte më e ulta që prej vitit 2008. Ngadalësimi i rritjes së këtyre huave me probleme u ndikua kryesisht nga shitja e portofoleve të tyre, si edhe nga fshirja e tyre nga bilanci. Përgjatë gjithë vitit 2013, nga bankat tregtare kanë shitur rreth 10 miliardë lek kredi me probleme (NPL). Kjo ka ndikuar në tkurrjen e portofolit të kredisë duke çuar në ngadalësimin e ndjeshëm të aktiveve me rrezik. Këto aktive në fakt, ranë me 0.4% duke iu referuar vitit 2012. Raporti i: “Aktive të ponderuara me rrezik”/ “Totali i aktiveve” u ul me 2.2 pikë përqindjeje në të njëjtën periudhë (BSH, raporti i stabilitetit financiar të 6-mujorit të dytë, 2013).

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Grafiku nr 22. Ecuria e klasave të portofolit të kredive me probleme



Burimi: BSH 2013


Nga grafiku nr 22, në strukturën e kredive me probleme ka ndodhur zhvendosja e kredive me probleme drejt kategorisë “të humbura” si dhe të kredive “standard” drejt kredive “në ndjekje”. Këto zhvendosje në fakt ndikojnë mbi ecurinë financiare të sektorit bankar. Rritja e vlerës së këtyre kredive në kategorinë “të humbura” nuk bën gjë tjetër përveçse thekson rëndësinë e procesit të ekzekutimit të kolateralit. Gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2013 kredia e klasifikuar “standarde” u zgjerua me 1% ku e cila përbën 68.4% të totalit të kredisë. Kredia e klasifikuar “në ndjekje” u rrit me 17%. Gjithashtu, evidentohet një rritje e kredisë në kategorinë “e humbur”, brenda kredisë me probleme, me 12 miliardë lekë ose 23% , e cila shihet edhe në grafikun e mësipërm (BSH, raporti i stabilitetit financiar të 6-mujorit të dytë, 2013).

Grafiku nr. 23, paraqet kombinimin pikësor të raporteve: “Hua me probleme/ Teprica e kredisë” dhe “Hua në vonesë/Teprica e kredisë”, për bankat tregtare. Krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar (6-mujori i fundit i vitit 2012), sistemi bankar paraqet nivel më të lartë për treguesin e huave në vonesë (nga 42.96% në 60.10%), por lehtësisht më të ulët për atë të huave me probleme (nga 33.54%, në 33.02%).(BSH 2013)

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Pra, zgjerimi i kategorive të kredive me vonesë në pagesë, bën që të rritet mundësia e kalimit të tyre në kredi me probleme.


Grafiku nr 23. Rreziku i kredisë në bilancin bankar



Burimi: BSH 2013

Në grafikun nr 24, tregohet shpërndarja e bankave lidhur me mbulimin me provigjione të huave me probleme. Pra sesi pjesa më e madhe e bankave qëndrojnë në intervale mbulimi më të larta, sesa raporti për sistemin (BSH 2013).

Grafiku nr 24. Raporti i mbulimit me provigjione i huave me probleme




Burimi: Banka e Shqipërisë 2013

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Raporti i huave me probleme ndaj tepricës së kredisë, rezulton në nivelin 10.3%. Ky raport është rritur me 0.3 pikë përqindje krahasuar me dhjetorin 2012 dhe me rreth 1.5 pikë përqindje, krahasuar me mesataren e tre viteve të fundit. Mbulimi me kapital i kredive me probleme i matur nga raporti “kredi me probleme neto / kapitalit rregullator” është 55.6% në dhjetor 2012 dhe një vit më pas është ngjitur në nivelin 56.4%. Një faktor i rëndësishëm është kolateralizimi i kredisë, i cili ka një përmirësim të vogël gjatë gjysmës së parë të vitit. Pra, mbulimi me kolateral i kredisë, ka një rritje prej 1.8 pikë përqindje në vitin 2013. Vihet re se ka një rritje të konsiderueshme të kredisë. Kjo vërehet si për bizneset, ashtu edhe për individët (BSH,2013). Një faktor tjetër i rëndësishëm i mbrojtjes ndaj rrezikut të kredisë është edhe *mbulimi me kolateral*. Ai ishte në nivelin 77.7%, me një rënie të lehtë me 2 pikë përqindjeje krahasuar kjo me gjashtëmujorin e parë të vitit 2013. Tashmë në fund të vitit 2013 mbulimi me kolateral i portofolit të kredive me probleme zbriti në nivelin 80%, nga 83% që vlerësohej në qershor 2013 (BSH 2013). Kreditë me kolateral pasuri të paluajtshme zënë 55.8% në totalin e kredive të kolateralizuara. Pra siç edhe shihet pothuajse në harkun kohor të një viti, cilësia kredive me kolateral pasuritë e paluajtshme rezidenciale është përmirësuar me 7.1 pikë përqindje. Ndërsa janë përkeqësuar me 4.6 pikë përqindjeje për kreditë e kolateralizuara me pasuri të paluajtshme tregtare. Është përkeqësuar edhe cilësia e kredive me kolateral tokë me 5 pikë përqindje. Stoku i kredisë së kolateralizuar me “cash” ra me 11% dhe mbetet në nivele të ulëta në format e kolateraleve (3.3%) (BSH 2013).

Grafiku nr 25. Ecuria e kredisë sipas llojit të kolateraleve



Burimi: BSH 2013


Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Edhe pse kjo tregohet lehtësisht në rënie, mbulimi me kolateral i kredive vlerësohet i kënaqshëm. Por kjo dukuri rrit si nevojën për diversifikimin e llojit të kolateralit që përdoret në kreditimin bankar, ndjeshmërinë ndaj mirëfunksionimit të tregut të pasurive të paluajtshme ashtu edhe ndaj procesit të ekzekutimit të kolateralit. Gjithashtu rritet edhe aftësia e sektorit bankar për të mbuluar me kapital kreditë me probleme. Raporti “kredi me probleme neto / kapital rregullator” në fund të dhjetorit 2013 ra në nivelin 40.2% nga 55.6% në fund të vitit 2012 (BSH 2013).

Në grafikun nr 26 paraqitet tendencat e kreditimit në sektorin privat, në raport me PBB, si para krizës ashtu edhe mbas saj.

- **Një paraqitje kronologjike e rritjes së kreditimit në raport me Produktin e Brendshëm Bruto (PBB), periudha 2006-2013**

Grafiku nr 26. Kreditimi në raport me PPB-në




Burimi: Instat

Siç edhe shihet nga grafiku i mësipërm, kreditimi ka filluar të ulet ndjeshëm në vitet 2009, 2010, 2011 dhe 2013, pavarësisht se rritja e PPB ka qënë në ritme konstante. Kjo tregon se bankat tregtare u tkurrën ndjeshëm gjatë kësaj periudhe të vështirë, për të kredituar si bizneset, ashtu edhe individët. Bankat u fokusuan në menaxhimin e portofolit ekzistues të kredisë, si dhe në kreditë me probleme që u shfaqën gjatë periudhës së krizës. Rënia e kreditimit në sektorë të caktuar të ekonomisë ndodhi për faktin se, bankat shtrënguan shumë kushtet për të kredituar

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

ekonominë në sektorë të ndryshëm. Siç shihet në grafikun 26 nga të dhënat e Instat, PBB nominale në monedhën vendase ka pasur një rritje konstante përgjatë periudhës së krizës. Kuptojmë se, janë bankat tregtare ato që shtrenguan kushtet për kreditimin e sektorëve në ekonomi.

Grafiku nr 27. Paraqitje e Produktit të Brëndshëm Bruto (2006-2013)



Burimi: Instat 2013

Siç shihet në grafikun nr 27, PBB nominale gjatë periudhës 2006-2013 ka vazhduar të rritet në mënyrë konstante.

Përsa i përket ecurisë së sistemit financiar, sipas BSH (2013) ajo paraqitet e qëndrueshme si dhe sektori bankar është i mirëkapitalizuar dhe ka siguruar fitime.

Gjatë periudhës së viteve 2000-2008, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për të gjithë sistemin ka qënë mesatarisht 24 %. Pra, ka qënë pothuajse 2 herë më e lartë, se kapitali minimal rregullator i përcaktuar nga BSh i cili ishte 12% (BSH 2013).

Ajo çfarë ndodhi pas krizës financiare ishte një ulje e nivelit të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit në 15 %, duke na treguar për një mirë-kapitalizim të sektori bankar, si edhe rënia e fitimeve, si nga aktivet e veta, ashtu edhe nga fondet e veta. Ndërsa, përsa i përket ecurisë së aktiveve dhe të pasiveve të sistemit bankar është vënë re një zgjerim i tyre, duke filluar nga viti 2001, deri në vitin 2012 dhe një zgjerim më i ngadalësuar nga viti 2008, deri në fund të vitit 2012. Sipas raportit të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2013 ecuria dhe gjendja e sistemit financiar

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

dhe e sektorit bankar ishte e qëndrueshme. Zhvillimet në kuadrin makroekonomik kanë mbështetur ecurinë e sistemit financiar edhe pse rritja ekonomike ka qenë e ulët.

Sipas BSH 2013, realizimi i marrëveshjes me FMN është një hap i rëndësishëm për të siguruar stabilitetin makroekonomik dhe për të stabilizuar pritshmëritë e agentëve ekonomikë. Për sektorin bankar, treguesit e kapitalizimit dhe të likuiditetit të veprimtarisë sipas raportit të 6-mujorit të dytë të stabilitetit financiar (BSH 2013) ishin në nivele të kënaqshme, mbështetur edhe nga përmirësimi i rezultatit financiar neto. Aktiviteti bankar u zgjerua me ritme të vogla, pra depozitat u rritën me ritme më të ngadalta dhe kreditimi u tkurr. Në fakt ritmi vjetor i rritjes së kredisë me probleme ka shënuar nivelin më të ulët që prej vitit 2008 (Raporti i 6-mujorit të dytë stabilitetit financiar BSH 2013).

5.5 Funkcionimi i politikës monetare duke implementuar instrumentat makroprudenciale

Politika monetare është politika makroekonomike e krijuar nga Banka Qëndrore. Ajo përfshin menaxhimin e monedhave, normat e interesit dhe është një mjet i përdorur nga qeveria e një vendi për të arritur objektivat makroekonomikë të tilla si: rritja ekonomike, inflacioni, konsumi dhe likuiditeti¹²⁴.

Politika monetare përmbledh bazën ligjore në të cilën mbështetet kuadri teorik, i cili përdoret për modelimin e saj, objektivat e ndërmjetëm dhe operacionalë të politikës monetare në kuadrin e instrumentave përdoren për përmbushjen e tyre.¹²⁵ Kjo politikë përfshin ndërhyrjen ose qëndrimin e BSH ndaj tregjeve financiare për të arritur objektivat. Zhvillimi i politikave të përshtatshme makroprudenciale lidhet ngushtë me identifikimin dhe zbatimin e masave kryesisht prudenciale për parandalimin, kufizimin dhe trajtimin e risqeve financiare sistemike. Në kuadrin e politikave makroprudenciale, BSH u mbështetet në pavarësinë institucionale dhe ruajtjen e objektivit parësor të kontrollit mbi normën vjetore të inflacionit (Konferenca X Ndërkombëtare e BSH, 2012). BSH filloi diskutimin për vendimmarrjen për veprime të natyrës makroprudenciale, për t'u mbështetur tek instrumentat më të konsoliduar të politikës monetare. Që politikat makroprudenciale të jenë efektive, ato kërkojnë vendosjen e një kuadri të përshtatshëm institucional, ku përgjegjësitë dhe harmonizimi i veprimeve ndërmjet autoriteteve publike të përfshira të jenë të mirëpërcaktuara.

¹²⁴ www.economictimes.indiatimes.com

¹²⁵ www.bankofalbania.org

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Gjithashtu, këto politika kërkojnë zhvillimin e instrumentave specifike, të cilat vlerësojnë mundësitë e zhvillimit të risqeve sistematike në kohë, si dhe shtrirjes së këtyre risqeve në sektorë të ndryshëm. Këto instrumenta makroprudencialë gjithashtu, mundësojnë edhe trajtimin e këtyre risqeve. Shumë ekonomistë të njohur theksojnë rëndësinë e ndërveprimit të politikës makroprudenciale me politikën monetare. Ata shprehën se kur cikli i ekonomisë është kryesisht i shkaktuar nga goditje të ofertës, politika makroprudenciale gjeneron vetëm benefite modeste për stabilitetin makroekonomik. Dobitë e funksionimit të politikave makroprudenciale janë të konsiderueshme, atëherë kur goditjet financiare ndikojnë në ofertën e huave, si dhe janë faktorë të rëndësishëm të dinamikave të ekonomisë. Në raste të tilla, një bankë qendrore ndihmon autoritetin makroprudencial në mënyrë që të përmirësojë stabilitetin e përgjithshëm ekonomik të vendit.¹²⁶

Përdorimi i instrumentave makroprudencialë nga BSH, si dhe nga disa vende të Europës Qendrore dhe Lindore

"Një mësim i rëndësishëm që mund të nxirret nga kriza, është nevoja urgjente për të përmirësuar mbikqyrjen makroprudenciale në BE , për të gjitha aktivitetet financiare."

De Larosiere Report


Shumë ekonomi me tregje në zhvillim, siç është edhe vendi ynë kanë përdorur dhe përdorin masat makroprudenciale të bazuara në aktive dhe në likuiditete për ruajtje të sistemit financiar nga goditjet e mundshme. Disa vende në përpjekje për të zvogëluar riskun e kursit të këmbimit kanë ndjekur rregullat për kufizimin e pozicioneve të hapura të monedhës .

Grafiku nr 28 tregon edhe masat e makroprudenciale të përdorura në Shqipëri dhe në disa vende të Europës Qendrore dhe Lindore. Shumë nga vendet e rajonit përdorin instrumentat makroprudencialë për administrimin e riskut dhe pothuajse të gjitha këto vende, përdorin kërkesat e rezervës si instrument i politikave monetare, atë të mjaftueshmërisë së kapitalit (Madhusudan Mohanty: Konferenca e X e BSH 2012). Në të vërtetë këto vende, kanë qenë ndër të parat që kanë implementuar instrumentat makroprudencialë.

¹²⁶ Angelini, et al., 2012

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Grafiku nr 28. Instrumenta makroprudencialë të përdorura nga bankat qendrore dhe rregullatorët e Europës Qendrore dhe Lindore (2004-2012)



Burime: FMN, faqet zyrtare të bankave qendrore (Kuruc dhe Takats 2004-2012), siç citohet nga Madhusudan Mohanty në artikullin: Flukset e kapitalit, Politika Monetare dhe Trinia e Pamundur (Konferenca e X e BSH, 2012)

Vendet që janë paraqitur në grafikun e mësipërm: AL=Shqipëri; BA=Bosnja&Hercegovina; BG=Bullgari; HR=Kroaci; CZ=Republika Çeke; EE=Estoni; HU=Hungari; LV=Letoni; LT=Lituani; MK=Maqedoni; ME=Mali i Zi; PL=Poloni; RO=Rumani; RS=Serbi; SK=Sllovaki; SI=Slloveni; TR=Turqi.

Pra, periudha që këto vende kanë përdorur instrumentat makroprudenciale, daton prej vitit 2004 dhe deri në vitin 2012.

Nëse i referohemi vendit tonë, shikojmë se masat që janë përdorur edhe para periudhës së krizës kanë qënë: Kërkesa për rezervë; Mjaftueshmëria e kapitalit; Ponderimi i rrezikut.

- Cilat janë prioritetet e BSH-së në drejtim të rritjes së efektivitetit të politikës monetare?

- ✓ Një nga prioritetet kryesore të BSH-së është edhe puna kërkimore për konsolidimin e modeleve analitike dhe parashikuese. Nëpërmjet vlerësimit më të plotë të rreziqeve, si dhe rritjes së saktësisë së parashikimeve rreth zhvillimeve të ardhshme ekonomike e monetare, si dhe nëpërmjet vlerësimit më të plotë të përshtatshmërisë së instrumentave që do të përdoren për përmbushjen e objektivave – janë këto prioritetet të cilat e udhëheqin BSh në vendimarrje strategjike (www.bankofalbania.org).
- ✓ Prioritet tjetër është edhe zgjerimi i mëtejshëm i bazës së informacionit të përdorur në vendimarrje (www.bankofalbania.org).
- ✓ Prioritet është edhe përmirësimi i funksionimit të tregjeve financiare, ku roli i BSH-së është ai i rregullimit të infrastrukturës së tregut të parasë dhe atij të letrave me vlerë për të përmirësuar

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

proçesin e transmetimit të politikës monetare dhe për t'i shërbyer më mirë operatorëve të tregut. Gjithashtu, BSH-ja duhet të synojë nxitjen e aktivitetit të tregut të parasë dhe të minimizojë rrezikun e pjesëmarrësve në realizimin e shlyerjes së njëkohshme, si dhe duke nxitur rritjen e numrit të veprimeve (www.bankofalbania.org).

- ✓ Prioritet është edhe koordinimi me masat makroprudenciale dhe kuadrin mbikqyrës të sistemit bankar. Bashkëveprimi i mirë mes dy politikave do t'i shërbejë edhe efektivitetit të ndërhyrjes së BSH-së (www.bankofalbania.org).
- ✓ Harmonizimi i politikës fiskale me atë monetare, nëpërmjet shkëmbimit të vazhdueshëm të informacionit, si dhe shkëmbimit të opinioneve mbi ndikimet e ndërsjella të politikave monetare e fiskale (www.bankofalbania.org).
- ✓ Përmirësimi dhe zgjerimi i cilësisë së komunikimit të bankës me publikun dhe zhvillimin e një dialogu të vazhdueshëm, me qëllim thellimin e njohurive mbi politikën monetare (www.bankofalbania.org).
- ✓ Ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë e ruajtjes së stabilitetit të çmimeve dhe formimin e një konsensusi sa më të gjerë social për objektivin e inflacionit të BSH-së (www.bankofalbania.org).

KAPITULLI VI

6. Fillimi i zbatimit të masave mikro dhe makroprudenciale nga Banka e Shqipërisë

Për Bankën e Shqipërisë, mbikqyrja bankare ka si objektiv kryesor sigurimin e një veprimtarie bankare të shëndetshme në territorin shqiptar, ku do të garantojë sigurinë e kursimeve të qytetarëve, stabilitetin financiar dhe të kontribuojë në ecurinë pozitive të ekonomisë në tërësi¹²⁷. Ndërthurja e stabilitetit financiar dhe mbikqyrjes bankare synon harmonizimin efektiv të qasjes mikroprudenciale, me atë makroprudenciale, bashkëpunim i cili synon mbështetjen e veprimtarisë mbikqyrëse dhe rregullative të BSH, për të mundësuar aplikimin e politikave makroprudenciale në funksion të objektivit themelor të ruajtjes së stabilitetit financiar të vendit¹²⁸.

Gjatë periudhës së krizës, teksa inflacioni përgjithësisht është mbajtur nën kontroll, zhbalancimet dhe dobësitë financiare kanë qenë në rritje. Këto dobësi kanë qenë në formën e rritjes së shpejtë të çmimeve të pasurive të patundshme, si dhe ekspozimit të bilanceve ndaj likuiditetit në valutë. Sistemi financiar shqiptar vazhdon të veprojë në një mjedis shumë të pasigurt makroekonomik, i cili bën që të rriten dobësitë në këtë sistem. Sistemi financiar është ende i dobët ndaj goditjeve të jashtme, që vijnë si pasojë e lidhjeve të forta tregtare dhe financiare me eurozonën. (World Bank, 2014).

Shqipëria gjatë krizës financiare në fakt u ndesh me mungesën e likuiditetit, kjo erdhi si pasojë e tërheqjes së depozitave nga frika e njerëzve, remitancat në këtë periudhë pësuan ulje të ndjeshme, gjithashtu edhe investimet e huaja pothuajse u tkurrën fare. Bilancet në këtë periudhë u prekën nga probleme të lidhura me mungesën e likuiditetit si dhe me zhvlerësimin e kursit të këmbimit. Ato më pas u pasqyruan negativisht në konsum dhe në investime. Nisur nga kjo tkurrje e ekonomisë në Shqipëri, instikti i natyrshëm i politikave makroekonomike është ndërmarrja e masave kundërciklike në formën e politikave ekspansioniste monetare dhe fiskale.

Në fakt, të gjitha vendet që përjetuan zhbalancimet më të pakta makroekonomike dhe financiare gjendeshin në një pozicion më të mirë për të ndërmarrë politika kundërciklike dhe ato rezultuan si vendet që i tejkaluan më shpejt goditjet e krizës së fundit.

¹²⁷ Buletini Zyrtar, Dhjetor 2012

¹²⁸ BSH (Modeli Financiar në Shqipëri: Qasje ndaj të Dhënave të Panelit 2013)

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Shqipëria gjatë krizës së vitit 2007 nuk u përball me falimentim bankash apo me injektime të kapitalit nga ana e shtetit, por përjetoi një rritje tepër të vogël ekonomike, ndonëse kjo me një ritëm më të ngadaltë, si dhe u arrit të mbahen pritshmëritë inflacioniste. Shqetësimi i sistemit bankar në përgjithësi ishte i pranishëm¹²⁹:

- Po vërehej se sektori bankar po keqvlërësonte rreziqet. Përqëndrimi i lartë në sektorë apo klientë të caktuar tregonte mungesën e një analize të duhur të rrezikut apo të administrimit të rrezikut nga ana e bankave tregtare, ndërkohë që kreditimi i huamarrësve të pambrojtur në një regjim fleksibël të kursit të këmbimit dukej një çështje potencialisht e lidhur me rrezikun moral.
- Po krijoheshin mjaft hendeqe në një periudhë të shkurtër dhe të shpejtë. Shqetësimi i parë u trajtua nga autoritetet mbikqyrëse duke rritur kështu shkëmbimin e informacionit dhe duke lehtësuar dialogun midis politikës monetare, stabilitetit financiar dhe mbikqyrjes në bankë. Përgjegjësia e politikës monetare tashmë shtrihej nga pika më e ulët, deri tek ajo më e lartë e ciklit të biznesit. Ishte mjaft e rëndësishme, që në procesin e vendimarrjes të politikës monetare, të përfshiheshin edhe mbikqyrësit e stabilitetit financiar. Sipas BSH-së, politikat monetare nuk u përqëndruan vetëm në diskutimin e efekteve makro, por edhe në diskutimin e efekteve mikro të vendimarrjes.

Shqetësimi i dytë që u trajtua nga BSH-ja ishte përmes vendosjes së masave më shtrënguese në rregulloret makroprudenciale dhe përforcimit të mbikqyrjes në vend, të bankave tregtare (Buletini i BSH, 2010).

Përmes këtyre ndërhyrjeve të natyrës rregullative dhe mbikqyrëse të BSH-së, gjatë periudhës së krizës u synua: përmirësimi i transparencës dhe i qeverisjes së bankave tregtare, përforcimi i vlerësimit të rrezikut dhe të strategjive për zbutjen e tij, përmirësimi i raportit të likuiditetit dhe të mjaftueshmërisë së kapitalit, si dhe ulja e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë që rrjedh nga huamarrës të pambrojtur në monedhë të huaj ose nga praktikatat “lakmitare” të ndjekura nga vetë bankat tregtare.

¹²⁹ Banka e Shqipërisë, Raporti Vjetor, 2010

6.1 Masat parandaluese që ndërmori Banka e Shqipërisë gjatë periudhës së krizës globale

Kriza botërore shërbeu si një provë e rëndësishme për të marrë masat parandaluese, si edhe për të synuar stabilitetin financiar tashmë të dobët. Kjo krizë evidentoi kufijtë e saj, për t'u përballur me goditje të huaja, si dhe kufizimet që mund të përballlet ekonomia jonë në një mjedis botëror gjithnjë e më sfidues. Kriza botërore ilustroi rëndësinë që ka ruajtja e bilanceve të shëndosha, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat. Gjithashtu, ajo demostroi se ekonomitë të cilat arrijnë të konkurrojnë me sukses në tregjet botërore, janë ekonomi që kanë norma më të larta e më të qëndrueshme zhvillimi, si dhe ekonomi që kanë patur edhe mbikqyrje dhe rregulla më të forta në nivel makro (IMF, 2011a).

I njëjti mësim është munduar të përvetësohet edhe nga ekonomia shqiptare, si në nivel prodhuesi, ashtu edhe në nivel konsumatori. Zhvillimi i politikave të përshtatshme makroprudenciale, lidhet ngushtë me identifikimin dhe zbatimin e masave kryesisht prudenciale për parandalimin, kufizimin dhe trajtimin e risqeve financiare sistematike. Në këtë periudhë, BSH-ja vendosi objektivin për zhvillimin e politikave të përshtatshme makroprudenciale, nëpërmjet bashkëpunimit ndërinstitucional. Politika lehtësuese që ndoqi BSH-ja gjatë periudhës së parë të krizës, ndikoi në segmente të diferencuara të tregut financiar (www.bankofalbania.org).

Reduktimet e shpeshta të normës bazë të interesit, u reflektuan në tregun primar të letrave me vlerë të qeverisë dhe të sektorit ndërbankar. Këto reduktime të normës bazë kanë qenë të pjesshme në tregun e depozitave, ndërsa në tregun e kredisë pak më të zbehta (Raporti vjetor - BSH, 2012). Veprimet e BSH-së shpjegojnë faktin se në prani të ndryshimeve strukturore të sjelljes në tregun financiar dhe të ekonomisë reale dhe të primeve të shtuara të rrezikut, efektiviteti i veprimit të politikës monetare ishte i ulët. Ishte kjo arsyeja, që BSH-ja vendosi të mbështesë politikën e saj stimuluese monetare, me nismën e ndryshimeve në kahun rregullator mbikqyrës e makroprudencial. Masat makroprudenciale të implementuara nga Banka e Shqipërisë kishin për qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar në vend, si dhe të përballonin goditjet e shkaktuara nga kriza.

Këto masa synonin të ulnin primet e likuiditetit dhe kostot e ndërmjetësimit në tregjet financiare, me qëllim nxitjen e kreditimit dhe rritjen e aktivitetit ekonomik.¹³⁰

¹³⁰Buletini i Bankës së Shqipërisë, 6M-1 2012

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Gjatë periudhës së krizës, BSH-ja filloi të analizonte mjete dhe teknika të reja në përmbushjen e misionit të saj¹³¹. Ajo u përball me një krizë të tipit tashmë të njohur nga vendet e botës dhe filloi të ndërmernte masa prudenciale për të mbajtur sistemin financiar në stanjacion. Duke evidentuar kështu ngadalësimin ekonomik, si rrezikun kryesor me të cilin përballej ekonomia dhe sistemi ynë financiar, si dhe duke vlerësuar rolin që ka kredia bankare në aktivitetin ekonomik, BSH-ja gjatë periudhës së krizës, implementoi instrumenta makroprudencialë. Për bankat tregtare që kishin një rritje në kredi dhe në numrin e kredive me probleme, u morën masa që kishin të bënin më peshat e larta të riskut, si dhe LTV e DTI më të shtrënguese. Masa të tjera që u morën në vitin 2011 me qëllim kufizimin e riskut të ardhur nga vendet e tjera, ishin që të forcoheshin rregulloret e likuiditetit, si dhe të shndërroheshin në filiale degët e bankave të huaja. Gjithashtu u rrit peshat e riskut për huamarrësit e pambrojtur në masën 150%. (WB, 2014)

Disa nga masat të ndërmarra nga BSH-ja, siç përmendet dhe në Buletinin e vitit 2012, konsistojnë në :

- Vendosja e kufijve të rinj sasiorë për llogaritjen, mbikqyrjen dhe raportimin e ekspozimeve të mëdha të bankave, ndaj bankave mëmë dhe subjekteve të lidhura.
- Vendosja e kufijve më të ulët për ekspozimet e mëdha të bankave, me qëllim diversifikimin më të mirë të rrezikut që lind nga përqëndrimi i investimeve të bankave në tregjet financiare ndërkombëtare.
- Kontrolli i brëndshëm, si pjesë integrale e qeverisjes së bankave, i cili duhet të mbulojë çdo pjesë të bankës, me qëllim parandalimin e lindjes dhe të zhvillimit të rreziqeve të padëshiruara.
- Standartizimi i informacionit që bankat dhe degët e bankave të huaja duhet të japin lidhur me veprimtarinë kryesore të bankave, organizimin dhe drejtimin e tyre, ecurinë dhe gjëndjen e tyre financiare, administrimin e rrezikut dhe politikat e kontabilitetit.
- Dhënia e një vëmëndje të veçantë transparencës lidhur me produktet dhe shërbimet bankare dhe financiare të ofruara. Kërkesat e reja ligjore standartizojnë mënyrën dhe formën e dhënies së informacionit për klientët, lidhur me produktet dhe shërbimet bankare të ofruara prej tyre.

¹³¹ Buletini i Bankës së Shqipërisë, 2013

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Në periudhën e vështirë të krizës, BSH-ja injektoi likuiditet të bollshëm në monedhën vendase në tregun ndërbankar, duke përforcuar njëkohësisht mbikqyrjen bankare dhe bashkëpunimin me autoritetet e huaja mbikqyrëse të këtyre bankave. Një zhvillim specifik është dhe rritja e kufirit të sigurimit të depozitave, lëvizje e cila shënoi një pikë të fortë kthese në krizën e besimit të publikut në sistemin bankar, si dhe në problemet e lidhura me likuiditetin në këtë sistem. Nga një perspektivë e ngushtë, e përqëndruar në objektivin kryesor të stabilitetit të çmimeve, natyrshëm që edhe fokusi i politikës monetare ishte marrja e masave ekspansioniste¹³².

Megjithatë, ekonomia shqiptare përfitoi stimul makroekonomik në formën e ekspansionit fiskal. Politika kundërciklike u bë e mundur si rezultat i punës së mëparshme për konsolidimin e pozicionit fiskal dhe për ankorimin e politikave makroekonomike.

Mësimi i parë që doli nga kriza për autoritetet mbikqyrëse, ishte ndjekja e politikave kundërciklike, të cilat do të lejonin marrjen e masave më të guximshme në kohë krize. Në periudha afatshkurtra, bankat qendrore gëzojnë instrumentat e duhura për arritjen e objektivave të tilla si :

- normën bazë të interesit mbi operacionet e rifinancimit
- politika makroprudenciale në nivel sistemi
- mikro-mbikqyrje të kujdesshme të bankave tregtare

Disponueshmëria e objektivave ose e instrumentave, duhet të mundësojë një politikë optimale.

Sa herë që vëndet përballen me probleme serioze ekonomike dhe me ndikime negative mbi sistemin, atëherë në këtë moment fokusi shkon drejt tek stabilitetit financiar.

Dihet se detyra kryesore për një bankë qendrore është siguri i integritetit të parasë dhe ai i sistemit bankar¹³³.

- **Disa nga masat rregullative që ndërmoi BSH për të minimizuar efektet së krizës së fundit**

Gjatë krizës janë shtuar disa amendamente në rregulloren “*Për menaxhimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave tregtare*”. Kjo rregullore hyri në fuqi më 02.08.2009. Nëpërmejt këtyre amendamenteve BSH-ja ka reduktuar përqindjen e maksimumit të ekspozimit me bankat mëmë, apo brënda grupit pra nga 25% në 10% të kapitalit të tyre rregullator (BSH 2010). Është riparë edhe sistemi rregullativ i menaxhimit të riskut të likuiditetit, duke implementuar edhe për

¹³² http://www.bankofalbania.org/web/NJOFTIM_PER_SHTYP_5985_1.php

¹³³ http://www.bankofalbania.org/web/NJOFTIM_PER_SHTYP_6566_1.php

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

herë të parë rregulloren “*Për administrimin e riskut të likuiditetit*” e cila hyri në fuqi më 07.12.2009. Për t’i ardhur në ndihmë janë adaptuar praktikat dhe rregulloret ndërkombëtare më të mira. Kjo rregullore do t’i ndihmojë bankat tregtare si dhe mbikëqyrjen bankare që të zhvillojnë praktika të mira të menaxhimit të riskut të likuiditetit si dhe të standartizojnë analizat e likuiditetit.

Por kjo rregullore kërkonte nga ana e bankave tregtare që të përcaktonin: strukturat administrative të rrezikut të likuiditetit; sistemin e administrimit të informacionit; strategjitë dhe politikat që do të ndjekin; sistemin e kontrollit të brendshëm; analiza të “stress-test”, në lidhje kjo me paraqitjen e më shumë parashikimeve konservative dhe teknikave që lejojnë një kombinim të skenarëve të ndryshëm. Në fakt për këtë u është kërkuar bankave të sigurojnë të dhëna për “stress test” e riskut të likuiditetit.

Gjithashtu është përmirësuar rregullorja “*Për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit*”. Kjo rregullore hyrë në fuqi 02.08.2009. Është sistemuar dhe pasuruar edhe rregullorja “*Për veprimtarinë valutore*”, e cila hyri në fuqi datë 07.12.2009.

Është riparë me shumë kujdes rregullorja “*Për administrimin e rrezikut të kredisë*”, kjo rregullore hyri në fuqi më 02.08.2009 etj.

Në fillim të 2009, ajo cfarë edhe u konstatua ishin edhe fenomenet si, zvogëlimi i disbursimeve të reja, përkeqësimi i portofolit të huasë, pozicioni i likuiditetit të bankave etj. Këto konstatime çuan në vendosjen e një seti të ri informacioni shtesë nga bankat tregtare në muajin shkurt 2009, i cili konsistoi në:

- analizat e GAP-it për cdo monedhë
- ndarjen e depozitave sipas disa intervaleve të shumave
- parashikimi i flukseve të parasë
- depozitat e klientëve (depozitat e reja, depozitat e tërhequra përpara afatit të maturimit, etj).
- Informacion për portofolin e huasë (huatë e reja, shlyerjet e huasë, normat e interesit të aplikuara sipas grupeve, klasifikimi i huasë, etj). (www.bankofalbania.org).

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Disa masa të tjera rregulluese mund t'i përmbledhjmë në:

- ✓ Në rritjen e kontakteve multilaterale dhe bilaterale me bankat, duke kërkuar që të rritet vigjilenca në përshtatje me kushtet aktuale të tregut ndërkombëtar. U rritën kontaktet me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (AMF).
- ✓ Banka Qëndrore në këtë periudhë ka ndjekur një politikë më aktive në media, ka rritur numrin e publikimeve, nëpërmjet të cilave tentohet të sqarohet pozicioni i sistemit tonë bankar si dhe efektet e krizës mbi këtë sistem. Qëllimi kryesor i BSH-së është mbrojtja e institucioneve financiare nga kriza, e bërë kjo edhe në shërbim të qëllimit të rritjes së besueshmërisë së publikut në sistemin tonë bankar. Kjo ka ndikuar në rritjen e depozitave kryesisht nga individët. Në këtë rritje, ka ndikuar edhe politika më agresive e ndjekur nga bankat tregtare, duke rritur normat e interesit dhe duke prezantuar produkte të reja depozitash në treg. Në rritjen e tyre kanë ndikuar edhe prurjet e emigrantëve, kjo edhe për arsyen e pasigurive ndaj bankave të vendeve europiane (si psh Greqi), si edhe për normat e larta të interesave që ofruan në këtë periudhë bankat tregtare në Shqipëri.
- ✓ Është ndryshuar dhe përmirësuar korniza raportuese e bankave. Kjo në lidhje me cilësinë e raportimeve dhe afatet e kohës, në mënyrë të veçantë në lidhje me ekspozimin e tyre në tregjet ndërkombëtare dhe bankat-mëmë. Janë bërë modifikime dhe hartime rregulloresh të reja, për të forcuar mbikëqyrjen. Të dhënat që janë mbledhur nga sistemi bankar janë monitoruar nga afër, duke aplikuar kështu raportime periodike ditore, javore dhe mujore nga ana e bankave tregtare.
- ✓ Niveli i përdorimit të normës së rezervës së detyrueshme është dyfishuar, kjo me qëllim që bankat të përdorin më shumë nga rezervat e tyre në BSH.
- ✓ U intensifikua mbikëqyrja në vend e bankave tregtare, për të monitoruar nga afër procesin e menaxhimit të riskut.
- ✓ Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, u përpunua ndryshimi në legjislacionin e sigurimit të depozitave.
- ✓ Gjithashtu bazuar në analizën e grup-it të task forcës, u kërkuar informacion shtesë për cilësinë e portofolit të huasë dhe masat e mara nga cdo bankë tregtare për të identifikuar klientët/sectorët problematikë për të përmirësuar situatën financiare (BSH 2010).

6.2 Instrumentat makroprudenciale të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë

Duke evidentuar ngadalësimin ekonomik, BSH filloi të analizojë mjete dhe teknika të reja në përmbushjen e misionit të saj. Ngadalësimi ekonomik u pa nga BSH-ja si rreziku kryesor me të cilin po përballej ekonomia dhe sistemi financiar shqiptar. Duke vlerësuar rolin që ka kredia bankare në aktivitetin ekonomik, BSH miratoi një paketë masash makroprudenciale të orientuara drejt nxitjes së kredisë dhe uljes së rrezikut në sistemin bankar¹³⁴. Në mars 2013, BSH miratoi një paketë masash makroprudenciale, të orientuara drejt nxitjes së kredisë, sigurimin e likuiditetit në vend si dhe uljes së rrezikut në sistemin bankar¹³⁵.

Këto masa që u ndërmorën konsistojnë në :

- lehtësimin e kërkesave për kapital për rritjen e kredisë;
- në lehtësimin e kërkesave për likuiditet;
- në rritjen e kërkesave për kapital për aktivet jashtë vendit mbi normat e kërkuara nga BSH;
- në inkurajimin për huamarrjen e brëndshme në valutë;
- në uljen e provigjionimit për kredinë e ristrukturuar;
- pesha më të larta të rrezikut: peshat me rrezik janë tregues prudencialë që vendosen nga autoriteti rregullator. Kjo masë për ekspozime të caktuara, siguron një mbulim më të mirë me kapital të rrezikut, si dhe incentiva për administrimin prudent të niveleve të ekspozimit, ndaj subjekteve/sectorëve të caktuar.

Gjithashtu, BSH-ja po aplikon standarte konservatore për klasifikimin dhe provigjionimin e huave me probleme. Këto standarte mundësojnë një pasqyrim të qartë të cilësisë së portofolit të kredive, për të evidentuar efektet në rezultatin financiar dhe rrjedhimisht, pozicionin e kapitalizimit të tyre. Njohja në kohë e shpenzimeve për provigjione ofron siguri më të madhe mbi qëndrueshmërinë e bankave, kundrejt humbjeve të mundshme nga rreziku i kredisë. BSH ndërmorri rregullore shtrënguese edhe për kapitalin e bankave tregtare që investojnë jashtë kufirit shqiptar. Këto masa synonin rritjen e disponueshmërisë së burimeve për kreditimin e brëndshëm, pra si rrjedhojë këto masa të ndërmarra kanë kontribuar në këtë drejtim.

Paketa e masave të ndërmarra nga BSH-ja për nxitjen e kreditimit ka dhënë rezultate konkrete në rastin e disa prej bankave tregtare (BSH 2014). Efektiviteti i masave në nivel sistemi kushtëzohet

¹³⁴ Buletini i BSH-së (Banka e Shqipërisë 47, 6M-1 2013

¹³⁵ Buletini i Bankës së Shqipërisë 2012

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

nga faktorë të rëndësishëm me natyrë ekzogjene, sidomos toleranca e ulët ndaj rrezikut që shfaqin bankat me origjinë nga BE, e cila është kushtëzuar nga situata në eurozonë dhe masat e ndërmarra nga autoritetet e BE-së, por edhe si rezultat i rënies së përgjithshme të kërkesës së brendshme për kredi dhe pasigurisë së agjentëve ekonomikë mbi zhvillimet e ardhshme në ekonomi. Një nga masat kryesore që ndër morri BSH-ja ishte edhe ai i ristrukturimi i kredive. Ky është një proces që ndikon në administrimin proaktiv të rrezikut të përkeqësimit të mëtejshëm të kredive me probleme, duke riformuluar kështu marrëdhënien midis huadhënësit dhe huamarrësit. E gjithë kjo perpjekje vjen për të mundësuar shlyerjen e detyrimeve në kushtet e vështirësive specifike me të cilat përballlet huamarrësi. Efektet e plota të këtyre masave varen nga niveli i angazhimit të bankave në këtë proces, i cili mbetet të verifikohet në kohë. BSh mori masa të mjaftueshme edhe për sigurimin e likuiditetit në vënd. Nëpërmjet ndryshimeve rregullatore që përmirësuan nivelin dhe cilësinë e likuiditetit që bankat tregtare detyroheshin të mbanin, BSH-ja siguroi që sistemi bankar të mbetej likuid dhe i aftë të shlyente detyrimet ndaj kundërpartive dhe depozituesve në çdo kohë (BSH, 2014).

Një nga momentet më kyçe gjatë periudhës së krizës ishte edhe inkurajimi për huamarrjen e brëndshme në valutë. Ky inkurajim u ndikua nga një sërë faktorësh, ku për nga shkalla e rëndësisë së tyre, mund të përmenden në këtë pjesë.

Disa nga faktorët që ndikuan në mënyrë të konsiderueshme kanë qënë:

- ✓ diferenca e normës së interesit për kreditë në lek dhe ato në valutë;
- ✓ lëkundjet historike në kursin e këmbimit, të cilat mund të konsideroheshin të pakta ose pa asnjë ndikim;
- ✓ prania e lartë e bankave me pronësi të huaj;
- ✓ niveli i lartë i “euroizimit” në ekonomi;
- ✓ mungesa e borxhit afatgjatë në monedhën vendase;
- ✓ hapja e madhe e ekonomisë;
- ✓ rregullat prudenciale të bankave për administrimin e rreziqeve të drejtpërdrejta në kursin e këmbimit;

- **Instrumentat në kuadrin rregullator për të frenuar rritjen e kredisë**¹³⁶

BSH-ja propozoi ndryshime për *menaxhimin e rrezikut të kredisë*¹³⁷, kjo për faktin që: të nxiste bankat tregare të përmirësonin kapacitetet e tyre teknike, për të monitoruar në mënyrë të detajuar ecurinë e kredisë në bazë të sektorit, monedhës, gjeografisë dhe llojin e shpërndarjes, si dhe ajo që ishte akoma më e rëndësishme, për të përcaktuar objektivat reale të rritjes së kredisë.

Kërkesë tjetër për të ndryshuar rregulloren e “*për menaxhimin e rrezikut të kredisë*” ishte edhe nxitja që bankat tregtare të kishin funksione të ndara të shqyrtimit dhe miratimit të kredive, pasi kjo do të çonte në kontrollin dhe cilësinë gjatë procesit të vendimarrjes për kreditë, duke përfshirë edhe ato lloje kredish që rrjedhin nga luhatjet e vlerave monetare, lloji monedhës apo nga zhvillimet e normave të interesit. U rrit kërkesa për nxitjen e bankave tregtare, për të qenë më konservatore në ristrukturimin e kredive. Midis kategorive cilësuese të klasifikimit, lëvizja nga një kategori e ulët, në një më të lartë, përkatësisht për ata lloj klientësh që klasifikohen si : “*nënstandartë*”, “*të dyshimta*” dhe “*të humbura*”. Kjo lëvizje do të ishte e vlefshme vetëm nëse shoqërohet nga dokumenta, të dhënat e të cilave do të jenë të çertifikuara dhe që duhet të jenë pjesë e dosjes të kredimarrësit. Në rregulloren “*për menaxhimin e rrezikut të kredisë*” u pa e nevojshme nxitja e bankave që të pranojnë dhe të analizojnë ato lloj garancish, që janë të lëshuara nga një subjekt që është ligjërisht dhe financiarisht i aftë për të respektuar kushtet e garancisë, pavarësisht vështirësive financiare të huamarrësit. Ndryshimet e propozuara nga BSH-ja, përmbajnë disa kërkesa në lidhje me transparencën që institucioni bankar duhet të ketë kundrejt klientëve të saj, veçanërisht në procesin e kredisë. Një nga këto kërkesa ishte edhe listimi i çështjeve kritike në kontratën e kredisë, duke paralajmëruar kështu huamarrësit në lidhje me rreziqet e hasura, si psh: nëse ai/ ajo është huamarrës me normë të ndryshueshme të interesit; ose në rast kur duhet t’i prezantojë huamarrësit të gjitha pagesat ose shpenzimet e paracaktuara, të bëra të njohura këto, në momentin kur kredia i është akorduar, si dhe gjatë maturimit të saj. U hartuan edhe disa kërkesa të reja specifike në rregulloren “*Për administrimin e rrezikut të kredisë*”. Këto kërkesa kanë të bëjnë me rrezikun e kredisë që rrjedh nga: a) nga rritja e kredive me probleme (NPL); b) një ritëm të lartë i rritjes së kredisë .

¹³⁶ Implementuar në 27 Dhjetor 2006

¹³⁷ http://www.bankofalbania.org/web/PRESS_RELEASE

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Në tabelën nr 20 tregohen **mjetet e politikës monetare** të cilat konsistojnë në *rritje të normës së interesit* si dhe *për kërkesen për rezervën e detyruar*, **masat rregullatore** si dhe ato **administrative**. Informacioni në këtë tabelë përmban kohën kur masat nisën të aplikohen, një përshkrim të shkurtër dhe vlerësimin mbi efektet dhe kufizimet e masave të marra.

(Periudha: 2004-2008 /deri në kohën e krizës.)

Tabela nr 20. Mjetet e politikës monetare

Mjetet e politikës monetare		
Rritje e normës së interesit		
Kërkesa për rezervën e detyruar		
Masat rregullatore		
Pesha më të larta të rrezikut	27 Dhjetor, 2006; 30 Prill, 2008	Bankave që po e zgjerimin portofolin e kredisë më shpejt sesa limitet e përcaktuara (zgjerimi vjetor i portofolit të kredisë, por edhe i peshës së portofolit të kredisë në raport me aktivet totale të bankës), ju kërkua të përdorin një faktor rreziku 150% në llogaritjen e kapitalit të ponderuar me rrezikun. Për këtë arsye, atyre ju duhej më shumë kapital për të ruajtur zgjerimin e bilanceve të tyre. Përderisa pjesa më e madhe e zgjerimit po ndodhte përmes kredive në valutë, kjo masë synonte të ndërpriste këtë lloj kreditimi.
Kufizime të LTV-së (raporti kredi-vlerë)	27 Dhjetor 2006	Si pjesë e masave për kreditë në rrezik, bankave ju kërkua të përdorin dhe të mbajnë raportin LTV deri në 70%.
Kufizime sasiore të kreditimit (për sektorë të caktuar)		
Kufizime në përdorimin e kartave të kreditit		
Masat administrative		
Kritere pranimi për huamarrësit		
Kufizime në raportin pagesë-të ardhura	27 Dhjetor 2006	Si pjesë e masave për kreditë në rrezik, bankave ju kërkua të përdorin dhe të mbajnë raportin pagesë (e disponueshme), kundrejt të ardhurave deri në 25%.
Udhëzime/ rekomandime për bankat ose klientët	10 Qershor 2006, 27 Dhjetor 2006 30 Prill 2008	Pjesa thelbësore e rregullores është në fuqi prej korrikut 2004. Shtesat në rregullore u bënë me vendime.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

- Masat e tjera ishin edhe një sërë kërkesash, siç janë listuar më poshtë :

- a) përgjegjësitë e qarta të bordeve mbikqyrëse dhe drejtuese për të aprovuar dhe për të implementuar politika për një administrim më të mirë të rrezikut të kredisë;
- b) kushtet strikte për përfshirjen e bankave në ristrukturimin e kredive;
- c) termat strikte të bankave për lëvizjen e kredive midis kategorive cilësuese të klasifikimit (veçanërisht lëvizja nga një kategori e ulët në një më të lartë);
- d) kërkesat për vlerësimin e vazhdueshëm dhe të matur të garancisë dhe të mjaftueshmërisë së kolateralit për kreditë, etj.

Të gjitha ndryshimet rregullatore të përmendura më sipër, me disa ndryshime të vogla në mënyrën sesi bankat tregtare kryejnë ristrukturimin e kredive (Shtator 2011), janë ende në fuqi. Gjithashtu regjistri elektronik i kredive po operon si pjesë e Departamentit të Mbikqyrjes që prej janarit 2008.

Në tabelën 21 ,tregohen masat që kanë marrë autoritetet mbikqyrëse në Shqipëri për të ndërprerë kredinë në valutë (e denominuar dhe e indeksuar) për huamarrësit vendas.

Informacioni përmban kohën kur masat nisën të aplikohen, një përshkrim të shkurtër dhe vlerësimin mbi efektet dhe kufizimet e masave të marra. Ky informacioni jepet edhe kur masat nuk u aplikuan më dhe/ose u modifikuan, duke shpjeguar kështu edhe ndryshimin.

(Periudha: 2004-2008 /deri në kohën e krizës.)

Tabela nr 21. Mjetet e politikës monetare dhe masat rregullatore

Mjetet e politikës monetare		
Kërkesa plotësuese nga bankat për rezervën në valutë		
Kërkesa për pasivet bankare për rezervën në valutë		
Masat rregullatore		
Pesha më të larta të rrezikut	27 dhjetor 2006 30 prill 2008	Në ndryshimet rregullatore të aprovuara më 30 prill 2008, bankave iu kërkuar të përdorin një koeficient risku 150% për kreditë e tyre në valutë ndaj huamarrësve të pambrojtur, për llogaritjen e kapitalit të ponderuar me rrezikun.
Raport më i lartë i provigjionimit (kursi më i lartë i parashikuar)		
Kufizime të LTV-së për kreditë në valutë		

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Kufizime sasiore të kreditimit në valutë	30 prill 2008	Gjithashtu, në ndryshimet rregullatore të aprovuara në prill 2008, u vendosën limitet sasiore për kreditë në valutë ndaj huamarrësve të pambrojtur. Çdo sasi përtej atij kufiri do të zbritej nga kapitali rregullator me arsyen e llogaritjes së kapitalit të ponderuar me rrezikun.
Kufizime sasiore të pasiveve bankare në valutë		
Kërkesa të veçanta për likuiditetin në valutë	Tetor 2009	Zbatimi i një raporti kapitalesh disi më detyrues (aktivet likuide-aktivet totale në 20%), pjesë e rishikimit të karakteristikave të aktiveve likuide, synonte të jepte një përcaktim më të ngushtë të aktiveve likuide dhe përbërjen e tyre sipas monedhave, por nuk u vendos asnjë limit për raportin e likuiditetit valutor.
	26 shkurt 2011	U përcaktuan më mirë aktivet likuide; u vendosën raportet e likuiditetit për monedhën vendëse (20%), valutat (20%) dhe niveli agregat 25%.
	27 mars 2013	Si pjesë e një pakete masash për të stimuluar kreditimin e ekonomisë, të gjitha raportet e likuiditetit u ulën secili 5 pikë-përqindje.
Masat administrative		
Kritere pranimit për huamarrësit		
Kufizime në raportin pagesë-të ardhura	27 dhjetor 2006	
Udhëzime/rekomandime për bankat ose klientët		

Këshilli Mbikqyrës i BSH-së gjatë periudhës së krizës miratoi disa shtesa në rregulloret: “Për mjaftueshmërinë e kapitalit”, “Për administrimin e rrezikut të kredisë” dhe “Për administrimin e rrezikut të likuiditetit”, për faktin se gjatë vitit 2012, në vend u konstatua një ngadalësim i ndjeshëm i rritjes së kreditimit nga sektori bankar dhe një rënie e mëtijshme e cilësisë së kredisë. Dobësia e kërkesës për kredi ndikon në kushtet e ngadalësimit të ekonomisë së vendit, por kjo dobësi kërkesë përkoj edhe me tkurrjen e bankave për të kredituar. Për t’iu përgjigjur këtyre zhvillimeve, Këshilli Mbikqyrës i BSH në mbledhjen e datës 27 Mars 2013, miratoi disa ndryshime në kuadrin rregullator, që synojnë të përmirësojnë ofertën e kreditimit nga ana e sektorit bankar, si edhe të mbështesin procesin e ristrukturimit të kredisë, që në momentin ku kredimarrësit shfaqin problemet e para¹³⁸. Pra, për të nxitur kredihënien, ndryshimet rregullatore parashikojnë heqjen e kërkesave për kapital, për rritjen vjetore të stokut të kredisë për ekonominë, nëse ajo është midis 4%-10%. Gjithashtu, ndryshimet rregullatore parashikonin rritjen e

¹³⁸ http://www.bankofalbania.org/web/PRESS_RELEASE_6562_2.php?kc=0,41,8,0,0

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

kërkesave për kapital për shtesën e investimeve të sektorit bankar me institucionet financiare jorezidente. Ndryshimet rregullatore parashikojnë që bankat, sipas profilit të rrezikut të përfitojnë edhe një ulje të përgjithshme me 5 pikë përqindje të kërkesës rregullatore për nivelin e raportit minimal të likuiditetit në total, për monedhën vendase(lekun), si dhe për valutën, në krahasim me nivelin ekzistues. Për bankat që kanë një nivel relativisht më të ulët të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit, këto ndryshime pritet t'i nxisin ato të zhvendosin mjetet e tyre financiare drejt kredidhënies për ekonominë, duke qenë se kjo mund të shoqërohet edhe me një ulje të kostos së veprimtarisë bankare dhe përmirësim të rezultatit financiar¹³⁹.

Për të adresuar dukurinë e rritjes së kredive me probleme, ndryshimet rregullatore mundësonin *ristrukturimin e kredisë* që në fazën kur ajo kategorizohet si kredi e rregullt, pra kur kredimarrësi ka nisur të shfaq problemet e para në pagesën e kredisë. Qëllimi është që me kushtet e reja të kredisë pas ristrukturimit, të ruhet aftësia paguese e kredimarrësit dhe cilësia e kredisë. Kjo kredi do të vijojë të klasifikohet si kredi e rregullt (në dy klasat e para të kategorizimit), por do të kërkojë një normë provigjionimi më të lartë, prej 10 përqind¹⁴⁰.

Në tabelën 22 tregohen **masat që kanë marrë autoritetet mbikëqyrëse në Shqipëri për të zbutur impaktin e krizës në sektorin bankar**. Informacioni i mëposhtëm përmban kohën kur masat nisën të aplikohen, një përshkrim të shkurtër, si dhe vlerësimin mbi efektet dhe kufizimet e masave të marra. Informacioni jepet edhe kur masat nuk u aplikuan më dhe/ose u modifikuan, duke shpjeguar ndryshimin. *(Periudha: prej fundit të vitit 2008.)*

Tabela nr 22. Mjetet e politikës monetare dhe masat fiskale dhe administrative

Mjetet e politikës monetare		
Kërkesa për rezervën e detyruar		
Zgjerimi i grupit të kolateraleve të pranueshme	29 tetor 2008	Ndryshimet lidheshin me vlerë-notat dhe obligacionet, si kolateral. Më parë lejoheshin vetëm bonot e thesarit. Më tej u vendos raporti maksimal i pjesmarrjes prej 70% për banka të veçanta, si provë për të nxitur bankën qendrore të injektojë likuiditet.
Sigurimi i likuiditetit në monedhën vendase	Nëntor 2008	Ndryshoi forma e ankandit për injektimin e likuiditetit sipas marrëveshjeve të anasjella të riblerjes, duke propozuar sigurimin e likuiditetit në monedhën vendase me normë fikse (sasia e likuiditetit përcaktohet nga nevojat e bankave). U hoq në janar 2010.

¹³⁹ http://www.bankofalbania.org/web/PRESS_RELEASE_6562_2.php?kc=0,41,8,0,0

¹⁴⁰ http://www.bankofalbania.org/web/PRESS_RELEASE_6562_2.php?kc=0,41,8,0,0

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

	24 dhjetor 2008 Prill 2012	U ul norma e interesit e Kredisë Njëditore nga “norma repo + 175 “pikë bazë” në “norma repo + 75 “pikë bazë” për të lehtësuar marrjen me kosto më të ulët të likuiditetit nga bankat. Vendimi u kthye në 30 qershor 2010. U dha likuiditeti me maturitet më të gjatë sesa 1 javë, me synimin të arrihej 50% e likuiditetit të injektuar me transaksionet 1-mujore dhe 3-mujore. Për efekt të akordimit të likuiditetit në tregun ndërbankar, BSH-ja injektoi likuiditet përmes blerjes njëherësh të letrave me vlerë në tregun sekondar. Transaksioni u kthye në tremujorin e fundit të vitit.
Sigurimi i likuiditetit sipas kursit të këmbimit	13 mars 2012	Rregullorja “Për kredinë për mbështetje me likuiditet”, rregulloi kreditimin në monedhën vendëse dhe në valutë për bankat me nevoja likuiditeti, por edhe aftësi pague. Lloji i kolateralit u zgjerua duke përfshirë përveç letrave me vlerë shqiptare të pushtetit qendror dhe lokal, edhe letrat me vlerë në valutë. Sasia e kreditimit varet nga sasia e kolateralit të duhur dhe mund të mbartet pas një periudhe fillestare prej 3 muajsh.
Lirimi i rezervave bankare	11 dhjetor 2008, 16 maj 2012	Bankat u lejuan të përdorin 40% të rezervave të tyre në monedhën vendëse gjatë periudhës së mirëmbajtjes, për të administruar sa më mirë situatat me likuiditetin. Rezervat e detyruara në monedhën vendëse mund të ruhen në Bankën e Shqipërisë, si para në letër. Masat u morën për t’ju përgjigjur nevojave të bankave që të ulin aktivet e tyre të ponderuara me rrezikun pa i detyruar të ndërpresin kreditimin e ekonomisë .
Masat rregullatore		
Ndryshime ligjore	17 nëntor 2011	U miratuan ndryshimet në Ligjin për Bankat, mes të tjerash, për të: a) lejuar transformimin e degëve të bankave të huaja në filiale; b) prezantuar bankën “urë” si një institucion që mund të përdoret për të marrë aktivet e mira dhe pasivet e bankave në vështirësi.
Pesha më të larta të rrezikut		
Kufizime të LTV-së		
Objektiva sasiorë për kredinë (për sektorë të caktuar)		
Kufizime në përdorimin e kartave të kreditit		
Rritje e kërkesave për kapitalin minimal	2011	U vendosën kërkesat më të larta për kapitalin minimal (15% e RWC-së) dhe raportet e likuiditetit për 3 filiale të bankave greke.
Ndryshimi i peshave të rrezikut	27 mars, 2013	Rënia e normës së rritjes së kreditimit që e dukshme dhe peshat e rrezikut u ndryshuan për t’a ristimuluar atë. U ulën deri në 0% (nga mesatarja 100%) për normat vjetore të rritjes së kreditimit mes 4% dhe 10%, deri në fundin 2014; U rritën deri në 100% (nga mesatarja 20%) për çdo vendosje shtesë të bankave në institucionet e huaja.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Ndryshime në kuadrin e sigurimit të depozitave	Mars 2009 Korrik 2012 Dhjetor 2012	U rrit garancia e plotë e depozitave në nivelin 2.5 milion lekë (afro 20 mijë euro) Depozitat e institucioneve jobankare u përfshinë në skemën e garancisë së depozitave; U përmirësua aksesimi i ASD-së(Agjencia e Sigurimit të Depozitave) në likuiditete, në rast nevojë; e drejta e ASD-së për t’u kërkuar bankave një kontribut unik për kompensimin e depozituesve; MF(Ministria e Financave), BSH, dhe ASD bënë një marrëveshje për të rritur sasinë e fondeve që i duhen ASD-së në një proces të ardhshëm të kompensimit të depozitave të siguruara.
Kufijtë në shpërndarjen e fitimit	25 mars 2009	Në 2008 dhe përgjatë 2009, u realizua vendimi për të ndaluar shpërndarjen e dividendit për fitim (vendimi u hoq në shkurt 2010).
Masa për ristrukturimin e kredive	27 mars 2013	Që të stimulohej ristrukturimi i kredive në fazën fillestare dhe që të pengohej kthimi i kredive standarde në kredi të këqija, u emërtua një nënkategori e re, e cila reflektonte kreditë standarde të ristrukturuara(dy kategoritë e para).Sasia e sigurimit për kreditë e kësaj nënkategorie është 10% (20% për kategorinë e parë të kredive të këqija). Më tej, u shkurtua nga 9 muaj në 6 muaj koha për ristrukturimin e kredive të këqija, për t’u kthyer në kredi “të mira”.
Masat administrative		
Kritere pranimi për huamarrësit		
Kufizime në raportin pagesë-të ardhura		
Udhëzime/rekomandime për bankat ose klientët	U rekomandua të rritej kreditimi në monedhën vendëse, ku situata me likuiditetin ishte më e mirë. U udhëzua përkrahja e ristrukturimit jashtë gjykatave.	
Masat fiskale		
Rikapitalizimi i bankave		
Garancitë shtetërore për pasivet bankare		
- Në 7 tetor 2008, u morr vendimi për të ulur ekspozimin e bankave shqiptare ndaj grupeve bankare me pronësi të huaj, deri në 10% të kapitalit të tyre rregullator; - U kërkuar raportime më të shpeshta nga bankat, në veçanti për likuiditetin e tyre; - Analiza “ad-hoc” mbi impaktin e krizës ndërkombëtare në sektorin bankar në Shqipëri, përfshirë teste stresi dhe skenarë më të gjithanshëm; - U nis procesi për rishikimin e procedurave të brendshme për administrimin e krizave; - Komunikim më i mirë me bankat; - Komunikim më i mirë me publikun; - Ndarje më e mirë e informacionit me autoritetet e tjera publike në vend. Mbi këtë bazë, prej shkurtit 2012, me themelimin e Grupit Këshillimor për Stabilitet Financiar, u përmirësua komunikimi ndërinstitucional dhe përgatitja për administrimin e krizave; - U rrit komunikimi me autoritetet e huaja mbikqyrëse,veçanërisht me ato në Austri,Greqi, dhe Itali.		

- Masat e marra nga BSH-së për procesin e ekzekutimit të kolateralit

BSH-ja në vitin 2011 mbledhi problemet që përballeshin bankat në procesin ligjor të ekzekutimit dhe një bazë informative sasiore për huamarrësit e çuar për ekzekutim, bashkë me të gjitha të dhënat e nevojshme që lidheshin me procesin. Informacionet vazhdojnë t'i raportohen BSh, si të dhëna operative çdo tre muaj. U organizua një forum i posaçëm në muajin korrik 2011, ku ishin të pranishëm përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, Gjykatës së Lartë, Zyrave të Përmbartimit Publik dhe Privat dhe të bankave. Në këtë forum u paraqitën vështirësitë, problemet dhe opinionet e secilës palë. U konkludua se : nevojitej të krijohet një grup pune ndërinstytucional me qëllim për të diskutuar problemet teknike dhe për të propozuar zgjidhje të ndryshme. Ky grup arriti në përfundimin se duheshin marrë këto masa¹⁴¹:

- T'i dërgohej një letër Gjykatës së Lartë me kërkesën për të nxjerrë qarkore për Kolegjet e Bashkuara të Gjykatave, që të unifikonin proceset gjyqësore për temat e identifikuar.
- T'i kërkohej EURALIUS-it¹⁴² dhe Ministrisë së Drejtësisë të pranonte propozimet e bankave për ndryshime në Kodin e Procedurës Civile.
- Të organizohej një takim mes Komitetit Ligjor të Shoqatës së Bankave dhe Projektit GIZ, për të propozuar disa ndryshime në draft-manualin e shërbimit përmbartimor.
- T'i propozohej kryetarit të Shkollës së Magjistraturës, të përfshinin në kurrikulën e tyre, lëndën për bankat dhe shërbimet financiare.
- Të zhvillohej një fushatë sensibilizimi.

Sipas raportit të stabilitetit financiar të BSH-së të 6-mujorit të dytë të 2013, për sektorin bankar, treguesit e kapitalizimit dhe të likuiditetit të veprimtarisë tregoheshin në nivele të kënaqshme, e mbështetur kjo edhe nga përmirësimi i rezultatit financiar. U vu re se vëllimi i aktivitetit bankar, u zgjerua me ritme të ngadalësuara. Kreditimi u tkurr, ndërsa depozitat u rritën me ritme më të ngadalta. Sipas këtij raporti, ritmi vjetor i rritjes së kredisë me probleme shënoi nivelin më të ulët që prej vitit 2008. Përsa i përket rrezikut të kreditit¹⁴³ ai përsëri përfaqëson sfidën më të rëndësishme të veprimtarisë të sektorit bankar, por në fakt nga madhësia e tij sipas këtij raporti, pritet të jetë më i kontrollueshëm, si dhe të ketë një prirje rënëse graduale në të ardhmen afatshkurtër (BSH,2014). Në fakt kjo pritshmëri lidhet

¹⁴¹ http://www.bankofalbania.org/web/PRESS_RELEASE_6204_2.php?kc=0,41,8,2,0

¹⁴² Misioni evropian i asistencës në Ministrinë e Drejtësisë në Shqipëri

¹⁴³ http://www.bankofalbania.org/web/Raporti_i_Stabilitetit_Financiar_për_gjashtëmujorin_e_dytë_të_vitit_2013_7065_1.php


Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

me efektin që pritet të japin ndryshimet ligjore dhe operationale të cilat do të hyjnë në fuqi ose që do të gjejnë përdorim përgjatë vitit 2014 (BSH 2014). Këto ndryshime do t'a përmirësojnë aftësinë e industrisë bankare për trajtimin sistematik të kredive me probleme.

- Rezultatet e anketimit të bërë në ndihmë të këtij studimi rreth masave makroprudenciale që ndërmori Banka e Shqipërisë.

Përsa i përket masave makroprudenciale që BSH-ja ndërmori gjatë krizës, si edhe për t'i ardhur në ndihmë këtij studimi, lindi nevoja e plotësimit të një ankete nga persona burimor kryesorë të specializuar në institucionet bankare, akademikë autoritetet mbikëqyrëse financiare, biznese, ekonomistë të njohur, etj. Pyetjet të paraqitura në anketë janë në përgjithësi rreth masave makroprudenciale që BSH-ja përdori gjatë krizës së fundit, nëse këto masa arritën që vendi ynë të ketë shpëtuar nga goditjet e forta të krizës etj. Siç edhe është përmendur edhe në paragrafin me sipër këta persona, punojnë në poste menaxheriale të 16 bankave tregtare që operojnë në vend, akademikë, ekonomistë të njohur të vendit, anetarë të këshillit mbikqyrës të BSH-së, drejtues të bizneseve të rëndësishme, etj.

Përsa i përket pyetjes së parë të anketës vërejmë se:



Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Si më poshtë janë paraqitur përgjigjet më të detajuara nga anketuesit tanë rreth pyetjes së bërë lidhur me rrethanat sesi janë njohur me politikat makroprudenciale:


- Pas fillimit të krizës së fundit financiare (2007) në SHBA.
- Nga media rreth rolit të bankave qendrore europiane.
- Në vitin 2009 nga institucionet ndërkombëtare.
- Kur diskutohej shumë për rolin e bankës qendrore në zvogëlimin e efekteve të krizës financiare dhe kontrollin e tendencës së kredive të këqija.
- Kur filloi të flitej për herë të parë për rëndësinë e masave dhe përballimin e krizës që sapo kishte shpërthyer.
- Informacioni i parë nga Banka Qendrore Italiane, në këtë vit filloi të flitej shumë për këtë lloj politikash.
- Në literaturën financiare.
- Pjesa e punës sime dhe angazhimeve.

Konkluzione :

Siç vërehet nga grafiku i mësipërm dhe nga komentet e të anketuarve, rreth 41.2% e tyre janë njohur me politikat makroprudenciale në vitin 2008, vit i cili korrespondon edhe me trumpetimin publik të këtyre masave që ndërmorën bankat qendrore nëpër botë.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Përsa i përket pyetjes së dytë të anketës vërejmë se:



Si më poshtë janë disa nga përgjigjet që anketuesit kanë dhënë gjatë intervistës:


- Pas krizës financiare 2008 politikat makroprudenciale u artikuluan nga bankat qendrore europiane, Fed dhe bankat aziatike.
- Më pelqeu si veprim i BQ-së dhe lexova artikuj/ dokumente të ndryshme që flisnin për të.
- Janë njohje nga impaktet, ekspozimet ndaj tregut.
- Kam njohje me karakter teorik dhe njohuri nga veprimet e bankave qendrore.
- Puna ime në bankë.
- E kam të qartë se cfarë janë por nuk janë pjesë e punës sime.

Konkluzione :

Rreth 39.7% e anketuesve tanë kishin njohje nga puna e tyre e përditshme në sistemin bankar, pasi gjatë krizës bankat tregtare iu nënshtruan këtyre masave të ndërmarra nga BSH-ja . 38.2% e tyre kishin specifike mbi këto masa, si rrjedhojë e studimeve dhe analizave të tyre rreth sistemit bankar dhe financiar në tërësi.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Përsa i përket pyetjes së tretë të anketës vërejmë se:



Si më poshtë janë disa nga komentet e të anketuarve;

- Ishte ndërhyrja në kohën e duhur, megjithëse rezultatet duken në një kohë të mëvonshme, pra e vlerësoj më tepër si mesazh për angazhimin e bankës qendrore në këtë fushë.
- Ka frenuar efektin e disa fenomeneve të dëmshme si kreditë me probleme, dalja e valutës jashtë Shqipërisë, kanë mbikqyrur më mirë bankat tregtare, kanë siguruar mjaftueshëm kapital sipas rregullave të ndërrmarra.
- Kam përshtypje që po ndjek linjën e BQE-së.
- Masat e ndërrmarra kanë shërbyer për të rritur qëndrueshmërinë e sistemit bankar ndaj ndikimeve negative të jashtme në përgjigje të rreziqeve kryesore të identifikuara nga BSH.
- Masat kanë qenë të vonuara, megjithëse kur u ndërmoren patën efekt të menjëhershëm.
- Pas hyrjes në fuqi të masave pati rezultate inkurajuese në procesin e ristrukturimit të kredive me probleme.
- Po, pasi ka ndërmarrë disa masa në lehtësimin e efektit të saj në vend si rishikimin e vazhdueshëm të normave bazë të interesit, rishikimin e rregulloreve të mbikqyrjes bankare lidhur me kreditë apo mjaftueshmërinë e kapitalit.
- Rregulloret mbi ekspozimet e mëdha dhe riskun e kredisë, mjaftueshmërinë e kapitalit etj.


Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

- Sidomos kur ka të bëjë me menaxhimin e likuiditetit në vend, (Risk Ëeight Asset) pesha e riskut mbi asetet.
- Pavarësisht mjedisit bankar në vend, i cili vendime të tilla i përtypi me vështirësi, BSH-ja duhej të kishte më tepër ndërveprim me bankat tregtare.
- BSH i mori në kohën e duhur masat e nevojshme.

Konkluzione :

Siç vërehet nga grafiku, 93% e të anketuarve, besojnë se masat që ndërmori BSH-ja, patën efekt pozitiv mbi sistemin financiar dhe bankar në tërësi. Këto masa kanë shërbyer për të rritur qëndrueshmërinë e sistemit bankar ndaj ndikimeve negative. Falë këtyre masave, sistemi ynë bankar i rezistoi krizës.

Përsa i përket pyetjes së katërt të anketës vërejmë se:




Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Konkluzione :

Gjatë krizës, bankat tregtare u tkurrën në kredithënie, siç vërehet edhe nga përgjigjet e të anketuarve tanë, ndikim më të madh në këtë tkurrje e ka sjellë forcimi i kriterëve për pranimin e kolateralit, si edhe rregjistri elektronik i kredive, por kombinimi i të gjitha masave shtrënguese të lartpërmëndura, ka patur një ndikim mesatar në procesin e kredithënies në vendin tonë.

Përsa i përket pyetjes së pestë të anketës vërejmë se:



Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Specifikimet e të anketuarve :


- Funksionimi paralel i euros dhe lekut
- Marrja e pagave në valutë të huaj.
- Shitja dhe blerja e apartamenteve në valutë të huaj.

Konkluzione :

Përgjigjet në lidhje me grafikun e mësipërm na tregojnë se, sipas opinionit të anketuesve tanë ndikim më të madh në huamarrjen në valutë kanë patur diferenca të normes së interesit ndërmjet kredive në monedhën vendase dhe kredive në valutë. Ndikim të madh, kishte edhe niveli i lartë i euroizmit në ekonominë tonë. Pavarësisht se BSH-ja ka kërkuar gjithmonë nga bankat tregtare të kreditojnë në monedhen vendase, kjo sipas të anketuarve nuk ka patur ndonjë efekt të dukshëm, pasi edhe tregu i pasurive të paluajtshme operon në valutë të huaj. Ndërkohë në nivele mesatare në rritjen e kredidhënies në valutë kanë patur edhe kursimet e pamjaftueshme në monedhën vendase, mungesa e kërkesës së borxhit afatgjatë në monedhën vendase, si edhe hapja e madhe e ekonomise vendase.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Përsa i përket pyetjes së gjashtë të anketës vërejmë se:




Konkluzione :

Siç edhe vërehet nga grafiku i mësipërm, rreth 94.3% i të gjitha masave shtrënguese të lartpërmendura të kombinuara së bashku, kanë patur një ndikim mesatar ndaj reagimit të krizës së fundit globale. Vlen për t'u përmendur se ndikim ka patur edhe kufizimi i LTV-së (raporti kredi-vlerë). Masë tjetër shtrënguese e cila ka patur ndikim ndaj reagimit të krizës, ishte edhe kufizimi i kreditimit në sektorë të caktuar të ekonomisë, rritja e normës së interesit në kredidhënie etj.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Përsa i përket pyetjes së shtatë të anketës vërejmë se:




Konkluzione :

Sipas të anketuarve tanë, ndikim të lartë si masa rregullatore që ndërmori BSH-ja, ka patur kërkesa për rezervë të detyruar, kërkesa për kapital minimal, si edhe masat për ristrukturimin e kredive, pasi në sistemin bankar zbatimi i këtyre masave zbuti ndikimin e krizës si dhe bëri që bankat të ishin shumë të kujdesshme për portofolet e tyre, si dhe ndaj kredive ekzistuese. Gjithashtu, efekt të konsiderueshëm pati edhe zbatimi i masës rregullatore për selektimin e kujdesshem të kolateraleve të pranueshme, sigurimi i likuiditetit në monedhën vendëse dhe

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

zgjerimi i kreditimit si në valutë ashtu edhe në monedhen vendase sidomos për ato banka që kishin mungese likuiditeti. Masë tjetër shtrënguese, që ndikoi paralelisht me masat e lartpërmendura ishte edhe rritja e përqindjes së provigjionimit të portofolit të bankave.

Përsa i përket pyetjes së tetë të anketës vërejmë se:



Si më poshtë disa nga opinionet e të anketuarve:

- Besoj se BSH-ja mori masat e duhura për sigurimin e likuiditetit në vend.
- BSH-ja mori një sërë masash sipas përcaktimeve dhe direktivave të BQE.
- Kufizoi marrëdhëniet me aksionerët, vendosi limit minimal likuiditeti.
- Në të gjitha momentet e vështira të krijuara, asnjëherë nuk është ndjerë mungesa e likuiditetit në vend. Në analizat e BSH-së, deklarohet se sistemi bankar ka qënë likuid.
- Në 2009 ankandet e repove të anasjellta u bënë me çmim fiks dhe me sasi të pakufizuara, kjo u lejoi bankave të huazonin likuiditet në sasinë e dëshiruar nga BSH. Këto masa u morën në kohën e duhur dhe në sasinë e duhur, erdhën si rezultat i monitorimit ore pas ore i situatës së likuiditetit nga BSH.
- Nëpërmjet ndryshimeve rregullatore që përmirësuan nivelin dhe cilësinë e likuiditetit që bankat tregtare detyroheshin të mbanin, BSH-ja siguroi që sistemi bankar të mbetej likuid dhe i aftë të shlyente detyrimet ndaj kundërpartive dhe depozituesve në cdo kohë.
- Rishikimi dhe fleksibiliteti i përdorimit të monedhës së detyrueshme kombëtare, përdorimi i repo-s.


Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

- Rishikimi periodik i normave bazë të interesit.
- Sistemi bankar në Shqipëri ka qënë dhe është likuid dhe i mirëkapitalizuar.
- Tregu vetërregullohet.
- Është folur për këto lloj masash por nuk kam të dhëna konkrete.

Konkluzione :

Siç është lehtësisht e shikueshme nga përgjigjet e të anketuarve tanë, në grafik shikohet se, 93% e të anketuarve tyre besojnë se BSH-ja ka ndërmarrë masa të mjaftueshme për sigurimin e likuiditetit në vend. Bazuar mbi komentet e mësipërme të anketuesve, vërejmë optimizëm mbi këtë masë e cila pati sukses në sigurimin e likuiditetit. Ndërsa 7% e tyre mendojnë negativisht.

Përsa i përket pyetjes së 9-të të anketës vërejmë se:



Si më poshtë disa nga opinionet e të anketuarve:

- Ishte e domosdoshme si pasojë e efekteve të krizës financiare në sektorë të caktuar të ekonomisë shqiptare.
- Ka incentive ligjore për ristrukturimin e kredive dhe ka paqartësi në ligj.
- Ka shumë kredimarrës që e kanë të nevojshëm ristrukturimin e kredisë dhe duhen ndihmuar, kështu përfitojnë edhe bankat.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

- Këto masa ndikuan në shlyerjen e kredisë sepse u tejkaluan nga rritja e vështirësive të kreditimit, nga rritja e riskut të bizneseve, rënia e ritmit të rritjes ekonomike.
- Kryesisht për ato lloj kredish që realisht ndihmonte ristrukturimin. Ka tolerancë që edhe kreditë në prag falimentimi dhe kërkojnë t'a shtyjnë kohën për shlyerjen e borxhit.
- Lehtësoi kredimarrësit në shlyerjen e borxhit.
- Masat e BSH-së duhen parë të ndara nga ristrukturimet e bankave. BSH-ja krijon kushte për ristrukturimin, ndërsa vetë bankat zgjedhin mënyrën, kjo mënyrë e përzgjedhur përcakton edhe suksesin e tyre.
- Megjithëse NPL-të në pamje të parë u rritën, për një pjesë të kredive problematike u arrit të negocioheshin me kredimarrësin ku ndikoi edhe riklasifikimi që i bëri banka këtyre kredive dhe nga kjo masë u lehtësua më tepër shlyerja e tyre.
- Pas hyrjes në fuqi të masave makroprudenciale pati rritje në numrin e kredive të ristrukturuara. Në këtë drejtim unë shoh efektin më të madh të këtyre masave.
- Pati lehtësime në kohëzgjatjen e kredisë e cila i lehtësoi kështu.
- Sollën disa shlyerje të disa prej bizneseve për pagesat e kredive të prapambetura. Megjithëse ristrukturimet jo domosdoshmërisht sollën përmirësimin e situatës ekonomike dhe bizneseve në vend të cilat mund të paguanin kreditë sipas plan bizneseve që kishin sjellë dhe u pranuan që në fillim në banka.
- Sollën lehtësimin e situatës së kreditorëve por bankat vazhdojnë të kenë vështirësi të mëdha në nivelin e lartë të kredive të këqija.

Konkluzione :

Edhe në këtë masë të ndërmarrë, 93% e të anketuarve tanë aprovojnë se kjo ka lehtësuar shlyerjen e kredive me probleme, gjithashtu lehtësuan kredimarrësit për shlyerjen e borxhit. Këto masa përveçse ndikuan në shlyerjen e kredisë, ato ndikuan edhe në tejkalimin e vështirësive të kreditimit, nga rritja e rrezikut të bizneseve, si dhe nga rënia e ritmit të rritjes ekonomike.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Përsa i përket pyetjes së 10-të të anketës vërejmë se:



Shpjegimet e të anketuarve si më poshtë:

- Dhanë efekt minimal për shkak se ishin NPL-të që ndikuan më shumë në standartet e shtrënguara të kredidhënies dhe si pasojë edhe kreditimin. Ulja e konsumit gjithashtu ndikoi në uljen e kërkesës për kredi.
- Jo domosdoshmërisht, bankat vuajnë për likuiditete dhe si pasojë nuk kreditojnë dot bizneset në vend por sepse bankat duhet të jenë shumë të kujdesshme në dhënien e kredive pasi nuk ju kthehen dhe nuk kanë fuqinë e ekzekutimit të kolateraleve apo fshirjes së kredive me probleme nga bilancet e tyre, duke sjellë një situatë jo përfitueshmërie për to.
- Jo nuk dhanë efekt, përkundrazi me implementimin e Bazel III.
- Ju tregoi bankave se në kushte krize nuk mund të mendojnë për dividendë.
- Kryesisht efekt normal dhe garantues.
- Masat e ndërmarra nga BSH, për nxitjen e kreditimit ka dhënë rezultate konkrete në disa banka. Efektiviteti i masave në sistem kushtëzohet nga faktorë të rëndësishëm me natyrë ekzogjene sidomos toleranca e ulët ndaj riskut që kanë bankat me origjinë nga BE. Rënia e përgjithshme e kërkesës për kredi dhe pasiguria e agentëve ekonomike mbi zhvillimet e ardhshme në ekonomi.
- Nuk besoj se arriti deri tek dividendët megjithëse kjo masë rriti kapitalizimin e tyre.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014


- Nuk është se ndikoi në rritjen e kreditimit pasi bankat vazhduan të ishin të tkurrura.
- Nuk mendoj se kjo dha efekt në rritjen e kreditimit pasi bankat edhe pse nuk shpërndajnë dividend prap mbeten të tkurrura.
- Pjesërisht sepse bankat nuk kanë probleme likuiditetit pas vitit 2010.
- Rritja e kërkesave për kapital si pasojë e dhënies së huave në valutë të huaj çoi në frenimin e huadhënies.
- Teorikisht dihet që rritja e nivelit të kapitalit përkthehet nga banka si rritje e mundësisë së kreditimit, si funksion bazë i ndërmjetësve financiarë në ekonomi.

Konkluzione :

Sipas anketuesve, 58% mendojnë pozitivisht se masa e lehtësimit të kapitalit duke mos shpërndarë dividendet bankat tregtare, ka ndikuar në rritjen e kreditimit të ekonomisë, ndërsa 42% nuk e mendojnë se kjo masë ka ndikuar në lehtësimin e kredidhënies. Nga opinionet e të anketuarve mendohet se bankat përsëri mbetën konservatore në kredidhënie edhe pse kjo masë pati zbatim deri në vitin 2010, pas këtij viti kjo masë u hoq.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Përsa i përket pyetjes së 11-të të anketës vërejmë se:




Konkluzione:

Ndër masat fiskale që pati ndikim më të lartë sipas anketuesve tanë, ishte shpeshtësia e raportimeve të bankave tregtare mbi likuiditetet e tyre si edhe analiza “ad hoc” përfshirë testet e stresit mbi impaktin e krizës ndërkombëtare. Në nivele mesatare të ndikimit të këtyre masave fiskale, duke iu referuar anketuesve tanë, pati edhe rishikimi i të gjitha procedurave bankare si edhe ulja e ekspozimit të bankave shqiptare ndaj grupit të bankave me pronësi të huaj.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Përsa i përket pyetjes së 12-të të anketës vërejmë se:



Komentet e të anketuarve për masat e mësipërme:

- Ato masa kanë ndikuar në uljen e ritmeve të kreditimit për shkak të shtrëngimit të standarteve, por kjo ka rritur artificialisht kredinë e pakthyer.
- Duke konsideruar eksperiencën time në tregun financiar jo bankar, ky instrument nuk pati ndikim të menjëhershëm.
- Këto masa kanë ndikuar ndjeshëm negativisht edhe pse kjo ishte e përkohshme.
- Kjo i vuri bankat në vështirësi por rriti garancinë për stabilitetin e tyre.
- Nuk pati falimentime bankash në Shqipëri përmes provigjionimit konservativ bankat sot kanë fonde për pastrim bilanci.
- Standartet mundësojnë një pasqyrim të qartë të cilesisë së portofolit të kredive për të evidentuar efektet në rezultatin financiar dhe rrjedhimisht pozicionin e kapitalizimit të tyre. Njohja në kohë e shpenzimeve për provigjone ofron siguri më të madhe mbi qëndrueshmërinë e bankave kundrejt humbjeve nga rreziku i kredisë.


Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

- U bënë në kohën dhe mënyrën e duhur.
- Zbatimi i bazel i rezultoi efektiv në përballimin me efektivitet të krizës.

Konkluzione:

Sipas anketuesve, 62.7% e tyre mendojnë se masa shtrënguese e provigjionimit të huave me probleme ndikoi ndjeshëm. Kjo masë i vuri bankat tregtare në vështirësi si dhe bëri që të kishin qëndrueshmëri financiare, disa prej tyre, pra 16.4% u shprehën se kjo masë jo vetëm u ndërmor në kohën e duhur por pati edhe shumë efekt. 20.9 % nuk besuan se kjo masë pati efekt.

Përsa i përket pyetjes së 13-të të anketës vërejmë se:



Të anketuarit i janë përgjigjur më specifikisht se përse kjo masë ka ndikuar apo jo në rritjen e kreditimit në vend:

- Bankat e ulën rrezikun përmes uljes së kreditimit dhe kanalizimit të fondeve drejt borxhit të qeverisë. Kështu që nevojat për kapital u ulën dhe nxjerrja e fondeve jashtë nuk i rriti tej mase kërkesat shtesë për kapital.
- Bankat janë plot me depozita dhe mund të japin kredi.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014


- Bankat në këtë kohë kishin mungesë fondesh dhe si pasojë edhe e krizës që solli shumë efekte në ekonomi, bënë që të frenoheshin në dhënien e huave, sidomos sektorët si ndërtimi ku u pa dhe nga studimet e bëra se ishte sektori me një përqindje më të madhe të kredive me probleme.
- Edhe kjo masë rregulluese nuk ndikoi pasi bankat tregtare edhe pse u ndaluan të investonin jashtë ato mbajtën të njëjtin pozicion ndaj kredidhënies.
- Ishte masë për të dekurajuar daljen jashtë të kapitalit në momentet e krizës.
- Kishte faktorë të tjerë të brendshëm frenues.
- Kjo masë nuk i detyroi bankat tregtare të levronin kredinë.
- Meqënëse raporti depozita/kredi është rritur në favor të depozitave, kjo bën që në momente të caktuara, bankat të investojnë jashtë për të mos e lënë stok.
- Kanë bërë kujdes për të investuar në instrumenta me risk të ulët.
- Sipas informacionit tim nuk kanë pësuar humbje nga ky aktivitet.
- Pjesërisht pasi minimizoi efektin e ndikimit të krizës globale në vend.

Konkluzione:

Bazuar në përgjigjet e të anketuarve, 72 % e tyre cilësonin se kjo masë nuk pati efekt mbi rritjen e kreditimit në vend. Kjo bazohet edhe mbi faktin se kreditimi në vend mbeti në të njëjtat nivele, edhe mbas kësaj mase shtrënguese. Ndërsa 28% e tyre mendojnë pozitivisht mbi këtë masë shtrënguese.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Përsa i përket pyetjes së 14-të të anketës vërejmë se:



Shpjegimet e anketuesve si më poshtë:

- Banka duhej të monitoronte më me kujdes kushtet e huadhënies para krizës. Rregjistri i kredive duhej të kishte funksionuar para krizës pasi nuk kishte të dhëna historike të huamarrjes dhe huaja u bë një produkt shumë i dëshiruar për të zgjidhur problemet pa menduar se duhej shlyer, i duhej dhënë rëndësi më e madhe kolateralit.
- BSH-ja dha një mesazh të qartë për tendencën e politikës së saj monetare duke ndjekur hap pas hapi ecurinë e inflacionit, masat makroprudenciale i çliruan bankat nga disa kredi problematike.
- Masat makroprudenciale janë një kosto dhe si pasojë shtrëngim standartesh.
- Nuk mendoj se dhanë efekt edhe pse BSH-ja bëri disa manovra të tilla pro-kreditimi vazhdoi të ishte i ulët nga ana e bankave.
- Përgjithësisht këto masa kanë impaktuar rritjen e likuiditetit, uljen e kostove të fondeve që e transmetuan ngadalë dhe pjesërisht në uljen e kostos së kredisë por jo të standarteve.
- Periudha e ndikimit ishte e ngadaltë dhe e dobët.
- Pjesërisht pati efekt, pasi bankat tregtare mendojnë se identifikojnë rreziqe më të mëdha nëse lironin kreditimin edhe pse politikat monetare ishin në favor të tyre.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014


- Risku që bankat identifikonin nga faktorët e tjerë jashtë politikës monetare dhe makroprudenciale, pra ishte më i lartë.
- Shumë nga standartet janë kushtëzuar nga faktorë të tjerë sidomos niveli i tolerancës së bankave ndaj rrezikut duke vepruar kështu në mënyrë të pavarur nga stimuli i dhënë nga politikat monetare dhe makroprudenciale e BSH-së, të cilat operojnë kryesisht nëpërmjet kanalit të normës së interesit dhe incentivave me karakter prudencial.
- Standartet e shtrënguara të kredidhënies ndikuan më shumë nga sasia e lartë e NPL-së. Edhe sot standartet janë të shtrënguara ndonëse politika monetare është më akomoduese se kurrë më parë.

Konkluzione :

Gjithashtu edhe për këtë masë, pra të uljes së shpeshtë të normës së interesit, anketuesit tanë tregohen konservativ, pasi 58% e tyre shprehen se kjo masë nuk ka dhënë asnjë efekt mbi rritjen e kreditimit në vend. Disa janë të mendimit se këto masa kanë efekte të ngadalshme në kohë si dhe nuk stimulojnë bankat për rritjen e kredidhënies. 42% e përgjigjeve, besojnë se ulja e herë pas herë e normës bazë ndikoi në rritjen e kredidhënies.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Përsa i përket pyetjes së 15-të të anketës vërejmë se:




Konkluzione :

69.1% e të anketuarve, mendojnë se BSH-ja ka luajtur një rol shtrëngues dmth, me ndikim të fortë në aktivitetin e bankave tregtare ndaj riskut të kredisë, si dhe ndaj mjaftueshmërisë së kapitalit. Ndërkohë që ndikim mesatar ka patur risku i likuiditetit, i kolateralit, i normës së interesit edhe LTV-së (raporti kredi-vlerë).

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Përsa i përket pyetjes së 16-të të anketës vërejmë se:



Si më poshtë disa nga arsyet kryesore që anketuesit dhanë më konkretisht rreth pyetjes së mësipërme:

- BSH-ja imponoi një kulturë të re në procesin e huadhënies si dhe në analizat që duhen bërë për këtë problem e cila e kombinuar dhe me menaxhimin e mirë të brendshëm të vetë bankave rezultuan në bilance pozitive edhe pas krizës.
- I kanë lehtësuar bankat tregtare në dy drejtime, në shpejtësinë e ekzekutimit të kolateralit si dhe në pastrimin e bilanceve nga kreditë e humbura dhe të pashpresa.
- I kanë lehtësuar bankës disa shërbime dhe detyrime që mund të ndikonte negativisht në shkallën e përfitueshmërisë.
- Jo në mënyrë të drejtpërdrejtë pasi nuk mund të bëhet lidhje midis politikave makroprudenciale dhe fitimeve të bankave, politikat synojnë stabilitetin.
- Masat e BSH-së kanë shërbyer si ndihmës në përfitueshmërinë e bankave tregtare.
- Masat makroprudenciale çojnë në stabilitet financiar dhe vendosin rregulla loje të cilat ulin normën e fitimit të biznesit ose të operacioneve të tregut.
- Mbikqyrja dhe rregullimi rigoroz i bankave ka nxitur identifikimin monitorimin kontrollin dhe administrimin më efektiv të rreziqeve bankare duke ndikuar në kufizimin e humbjeve të mundshme.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014


- Në disa raste u përshpejtua ekzekutimi i kolateralit duke çliruar bankat nga provigjionet shtrënguese dhe njëkohësisht vendimi i ministrisë së financave për të pastruar bilancet nga kreditë e humbura ndikoi në përfitueshmërinë e bankave.
- Pasi ndihmuan bankat tregtare për ristrukturimin e kredive ose për ekzekutimin e kolateraleve gjë që ndikoi në bilancet e tyre, edhe pse përfitueshmëria e këtyre bankave nuk ishte si në periudhat e para krizës përsëri ato jo vetëm që i rezistuan krizës por edhe patën përfitueshmëri të konsiderueshme.
- Përfitueshmëria ka rënë për shkak të provigjionimit të lartë së rritjes së NPL-ve, kostos relativisht të lartë të interesit të depozitave.
- Sa më shumë masa të ndërmarra, aq më pak përfitim për tregun financiar bankar.
- Shumë prej bankave kanë dalë me humbje si rrjedhojë e rritjes së provigjioneve prej kredive të këqija.
- Uljet e normave të interesit kanë ulur së tepërmi kostot e financimit për bankat tregtare. Synimi ka qënë për të ndihmuar bankat që t'a menaxhojnë siç duhet procesin e pastrimit nga bilanci të kredive të humbura, lehtësimi i ristrukturimit ka çuar në zgjerimin e këtij procesi dhe një përmirësim relativ të cilesisë së portofolit të huave.

Konkluzione :

Nga përgjigjet, 25% e tyre mendojnë se këto masa nuk kanë ndikuar në përfitueshmërinë e bankave por më tepër në stabilitetin e tyre. Ndërkohë që pjesa më e madhe e përgjigjeve rreth 75% e tyre, shprehen se këto masa kanë ndikuar në përfitueshmërinë e bankave, pasi BSH-ja me masat e ndërmarra ndikoi edhe në menaxhimin e mirë të brendshëm të tyre të cilat implementuan një kulturë të re në analizën e kredidhënies si dhe të kombinuara së bashku ndikuan në bilance pozitive edhe pas krizës.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Përsa i përket pyetjes së 17-të të anketës vërejmë se:



Si më poshtë disa nga komentet e të anketuarve.

- Edhe pse BSH-ja u mundua të krijojë një klimë në favor të kredithënies, bankat nuk e rritën kreditimin e tyre por u munduan të përballojnë efektet e krizës duke mos qenë shumë tolerante në kreditim.
- Është ruajtur në nivel të kënaqshëm qëndrueshmëria e sistemit.
- Ka ndjekur me vëmendje dhe veprime konkrete ecurinë e krizës dhe ndikimet e saj duke marrë masa parandaluese dhe sinjalizuese për ecurinë e sektorit bankar, megjithëse publiku ka pak njohuri për masat makroprudenciale të BSH.
- Ka qenë vazhdimisht prezente dhe parandaluese me veprimet e saj.
- Masat e marra nga BSH-ja kanë luajtur rol, sidomos për sigurimin e likuiditetit.
- Ndonëse ka patur një krizë të fortë globale dhe sidomos pak më të forta në vendet fqinje, masat prudenciale të BSH-së, bashkuar si dhe me politikat ekonomike dhe fiskale të qeverisë bënë të mundur t'i rezistonin krizës.
- Në kushtet e një tregu financiar si i yni, BSH-ja ka amortizuar paraprakisht problemet e mundshme.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

- Ofroi likuiditet në kohën dhe sasinë e duhur në drejtim të uljes së normave të interesit, pati vend për të bërë më shumë.
- Politika ka qënë pak e ngurtë dhe konservatore dhe krijohet përshtypja që i ka shkuar pas ngjarjeve sesa i ka parandaluar.
- Publiku nuk ka shumë informacion për politikat e BSH-së në këtë drejtim.
- Qëndrimi i BSH-së dhe masat e ndërmarra kanë qënë proaktive duke mundësuar një përballim më të mirë të efekteve të krizës financiare.
- Raporti i fundit i stabilitetit financiar, konstatoi një qëndrueshmëri të sistemit financiar dhe atij bankar, likuiditeti është në nivelet e kërkuara nga BSH-ja, pro-kritik mbetet ende niveli i huadhënies dhe normat e larta të interesit të huasë edhe pse norma bazë është në nivelet më të ulta historike.
- Shkalla e lartë e informalitetit rigjallëruan tregun informal të kredisë. Qëndrimet e zbutura dhe bashkëpunuese me politikat fiskale kanë zbehur ndikimin e BSH-së.
- Tregu financiar i pazhvilluar në raport me krizën. Tregu i vogël financiar më lehtësisht i kontrollueshem është pozitiv, ka ndjekur këshillat dhe instrumentet e BQE-së. Menaxhimi i infrastrukturës së induktuar në mënyrë eficiente. Rritja e nivelit profesional të vendimarrësve të BSH-së, ka ndikuar në përballimin e krizës së fundit.


Konkluzione :

Më shumë se gjysma e të anketuarve, rreth 66.2% mendojnë se BSH-ja me masat e ndërmarra luajti një rol të rëndësishëm në stabilitetin financiar gjatë krizës së fundit.

BSH dhe masat e marra, kanë qënë proaktive duke mundësuar një përballim më të mirë të efekteve të krizës financiare.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014


Ndërlidhja e disa pyetjeve të trajtura në anketë



Konkluzione :

Nga ky ndërkryqëzim midis dy pyetjeve të mësipërme, shihet qartë se 28 persona nga 68 të anketuar, mendojnë pozitivisht se këto instrumenta kanë bërë të mundur t'i rezistohet më mirë krizës së fundit, janë njohur me politikat makroprudenciale pikërisht në momentin e krizës, ndërsa 14 prej tyre janë njohur para vitit 2005 dhe vetëm 13 prej tyre janë njohur në vitin 2007.


Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014



Konkluzione :

Nese i referohemi grafikut të mësipërm vërejmë se nga ata të anketuar që mendojnë pozitivisht rreth pyetjes së parë, 36 prej tyre mendojnë se shtrëngimi i kushteve për kredidhënie nga bankat tregtare si kufizimet në raportin pagesë-të ardhura ndikojnë, ndërsa 14 prej tyre mendojnë se nuk ndikojnë, pjesa tjetër pra 13 prej tyre janë të bindur se këto kufizime ndikojnë shumë.


Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014



Konkluzione :


Të anketuarit të cilët menduan pozitivisht rreth pyetjes së parë, 33 prej tyre vlerësuan se regjistri elektronik i kredive ndikoi shumë që krizës së fundit ti rezistohej më mirë, 24 prej tyre vlerësuan se kjo masë ka ndikuar mesatarisht dhe 6 prej tyre vlerësuan se regjistri elektronik nuk ka ndikuar.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014



Konkluzione :


Përsa i përket ndëlidhjes së dy pyetjeve të mësipërme, vërejmë se nga ata të anketuar që mendojnë pozitivisht rreth pyetjes së parë, 41 prej tyre janë vlerësojnë se forcimi i kriterëve për pranimin e kolateralit ka ndikuar shumë, ndërsa 22 prej tyre mendojnë se ka ndikuar mesatarisht.



Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

Konkluzione :


Ndër ata anketues të cilët vlerësuan se masat që ndërmori BSH-ja iu rezistua krizës së fundit, 25 prej tyre vlerësojnë se kërkesa për kolateral në raport me madhësinë e huasë ndikon shumë në masat makroprudenciale që përdori BSH-ja, ndërsa 38 prej tyre janë shprehur se ndikon mesatarisht.



Konkluzione :

Sicç edhe tregohet qartë në grafikun e mësipërm, 36 nga të anketuarit vlerësojnë se rritja e përqindjes së provigjionimit mbi portofolin e një banke ka ndikuar mesatarisht në masat që përdori BSH-ja, ndërsa 15 prej tyre tregohen më entuziastë ndaj kësaj masë, duke menduar se kjo rritje përqindjeje e provigjionimit ka ndikuar mesatarisht. 11 prej tyre nuk janë të mendimit se kjo masë ka ndikuar në përballimin e krizës.


Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014



Konkluzione :

Ristrukturimi i kredive si masë e ndërmarrë nga BSH-ja, 32 prej anketuesve vlerësojnë se ka ndikuar mesatarisht, 29 prej tyre vlerësuan se kjo masë ka ndikuar shumë në aspektin e rezistencës ndaj krizës së fundit dhe 2 prej tyre mendojnë se zbatimi i kësaj mase nuk ka patur fare ndikim.


Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014



Konkluzione :

Rreth 44 persona, nuk vlerësojnë se kjo rregullore shtrënguese rreth investimit të kapitalit të bankave tregtare jashtë kufirit të Shqipërisë ka ndikuar në rritjen e kreditimit në ekonomi. Ndërsa 19 prej tyre mendojnë se kjo masë shtrënguese ka ndikuar në rritjen e kreditimit.


Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014



Konkluzione :

Janë rreth 35 anketues që nuk vlerësojnë se masat që ka përdorur BSH-ja kanë bërë të mundur t'i rezistohet më mirë krizës financiare, gjithashtu edhe ulja e normës bazë të interesit të ketë ndikuar në lirimimin e standarteve të kredidhënies. 27 anketues, vlerësuan pozitivisht se ulja e shpeshtë e normës të interesit pati ndikim në lirimimin e standarteve të kredidhënies.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014




Konkluzione :

Përsa i përket përgjigjeve pozitive rreth pyetjes së parë vërejmë se : 41 nga të anketuarit tanë vlerësojnë se masat e BSH-së për provigjionimn e huave me probleme ka ndikuar mesatarisht, ndërsa 11 prej tyre vlerësojnë se ka ndikuar shumë dhe vetem 10 prej tyre mendojnë se kjo masë ka ndikuar pak.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014


***Mendoni se masat makroprudenciale që ka përdorur dhe po përdor BSH-ja, kanë bërë të mundur që krizës së fundit t'i rezistohet më mirë?**
*** Sigurimi i likuiditetit në monedhën vendase**



Konkluzione :

21 prej tyre janë shumë optimistë rreth masës së sigurimit të likuiditetit në monedhën vendase duke vlerësuar se ka ndikuar shumë në sigurimin e likuiditetit në monedhën vendase, ndërsa 42 prej tyre mendojnë se kjo masë ka ndikuar mesatarisht për sigurimin e likuiditetit në monedhën vendase dhe 3 prej tyre vlerësuan se kjo masë nuk ka ndikuar fare.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014



Konkluzione :

Siç edhe shihet nga grafiku, 62 nga 68 të anketuarit që janë shprehur pozitivisht se masat që ndërmoi BSH-ja bënë të mundur që krizës së fundit ti rezistohet më mirë, kanë vlerësuar pozitivisht se BSH-ja mori masa të mjaftueshme për sigurimin e likuiditetit në vend, 1 prej tyre vlerësoi se kjo masë nuk ka ndikuar.

KAPITULLI VII

7. Konkluzione

- Masat mikro dhe makroprudenciale të vëna në funksion nga BSH çuan në parandalimin e situatave të vështira ekonomike e financiare të vendit.
- Masat makroprudenciale të implementuara nga BSH kishin për qëllim ruajtjen e stabilitetit bankar e financiar në vend, si dhe përballimin e goditjeve të shkaktuara nga kriza.
- Nëpërmjet ndryshimeve rregullatore të cilat përmirësuan nivelin dhe cilësinë e likuiditetit të bankave tregtare, BSH siguroi që sistemi ynë bankar të mbetej likuid, si dhe i aftë të shlyente detyrimet ndaj depozituesve në çdo kohë.
- Në kushtet e një tregu bankar dhe financiar si i yni, BSH me masat që ndërmori ka amortizuar paraprakisht problemet e mundshme.
- BSH-ja arriti të frenojë edhe efektin e kredive me probleme, daljen e valutës jashtë Shqipërisë, siguroi mjaftueshëm kapital sipas rregullave të ndërmarra dhe ka mbikëqyrur në mënyrë strikte bankat tregtare.
- BSH-ja gjatë krizës së fundit ka përdorur instrumenta makroprudenciale me qëllim ruajtjen e stabilitetit bankar dhe financiar. Në vitin 2007 përdori pesha më të larta të riskut, LTV dhe DTI më strikte të vendosura në bankat tregtare, duke tejkaluar kështu kufijtë e normës së rritjes së kredisë dhe nivelet e NPL-ve.
- Përdorimi i instrumentave mikro dhe makroprudenciale të kombinuara me instrumentat e politikës monetare fiskale bëhen efektive kur rreziqet e sektorit bankar dhe financiar, janë të ndërthurura me sektorët e tjerë të ekonomisë.
- Nëse BSH-ja përdor në mënyrën e duhur i instrumentave makroprudenciale, nga ana e BSH-së atëherë ato mund të aplikohen për të identifikuar në mënyrë efektive risqe të caktuara.
- Masat mikro dhe makroprudenciale të vëna në funksion nga BSH kanë çuar jo vetëm në stabilitetin bankar por edhe në atë të përmirësimit të përfitueshmërisë të bankave tregtare.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

- Politikat makroprudenciale efikase lehtësojnë fushën e veprimit të politikave monetare, i shmangin atyre implikimin në objektiva shtesë përtej atij të qëndrueshmërisë së çmimeve.
- Nuk janë vetëm politikat monetare por dhe ato makroprudenciale dhe ekonomike, të cilat duhen të implikohen seriozisht në administrimin e paqëndrueshmërisë financiare.
- Politikat monetare nuk mund t'a luftojnë të vetme krizën ekonomike dhe paqëndrueshmërinë financiare.
- Jo të gjitha instrumentat e përdorura mund të japin efekte të menjëhershme ose efekte në kohë.
- Politikat makroprudenciale efikase, të paracaktuara për të rritur rezistencën e sistemeve financiare, ia lehtësojnë fushën e veprimit politikave monetare.
- Zbatimi i instrumentave makroprudenciale të shumëfishtë përbën një barrë më të madhe rregullative dhe administrative.
- Vlera edhe rëndësia e stabilitetit të sistemit financiar duhet kuptuar më vete dhe jo si shuma e ndërmjetësve dhe e tregjeve me të cilat është e përbërë.
- Sfida e stabilitetit financiar lidhet ngushtë me aftësinë për të identifikuar dhe matur rreziqet dhe për të vënë në funksion me efektivitet politikat makroprudenciale.
- Duhet punuar në drejtimin e krijimit të një sistemi efektiv, për analizën e rreziqeve sistemike si dhe për ndërhyrjen e menjëhershme.
- Politikat makroprudenciale efikase, të projektuara për rritjen e rezistencës së sistemeve financiare, ia lehtësojnë fushën e veprimit politikave monetare.
- Stabiliteti financiar të ndiqet me politikat makroprudenciale të cilat duhet të jenë në funksion të kontrollit të rrezikut të sistemit financiar.
- Zbatimi i politikave makroprudenciale ka shpenzime afatshkurtër, sa më i gjerë të jetë efekti i elementëve makroprudenciale dhe sa më i shtrënguar të jetë vendosja e tij, aq më i kushtueshëm do të jetë implementimi i atij instrumenti.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

- Nëse do të mbështeteshim vetëm në rregullimin financiar mikroprudencial, kjo do shkaktonte një neglizhim të madh të stabilitetit bankar dhe financiar.

7.1 Rekomandime

- Që politikat makroprudenciale të jenë efektive, ato kërkojnë vendosjen e një kuadri të përshtatshëm institucional, ku përgjegjësitë dhe harmonizimi i veprimeve ndërmjet autoriteteve publike të përfshira të jenë të mirëpërcaktuara.
- Politika makroprudenciale duhet të plotësohet me politika të forta makroekonomike, duke përfshirë politikat fiskale, monetare dhe strukturore pasi këto politika më vete nuk japin rezultat në kufizimin e riskut sistemik.
- Politikëbërësit nuk duhet të besojnë se çdo qasje sasimore është e mjaftueshme për vlerësimin e riskut sistemik. Ata duhet të jenë të vetëdijshëm në kufizimet e teknikave që përdoren për të vlerësuar dimensionin e plotë të risqeve sistematike.
- Politikëbërësit nuk duhet të “gënjejnë” nga stabiliteti makroekonomik i së tashmes, pasi pabarazitë shpesh rriten nën sipërfaqen e qetësisë së dukshme.
- Nuk mund të pritët që politika makroprudenciale të parandalojë të gjitha krizat e ardhshme. Politikëbërësit duhet të pranojnë se kriza do të vazhdojë të ndodhë. Ata duhet të jenë të përgatitur për menaxhimin e krizave nëpërmjet politikave të përshtatshme.
- Përdorimi i instrumentave makroprudenciale mund të jetë i dobishëm kur nuk është e dëshirueshme një politikë monetare e shtrënguar, pasi këto instrumenta ndikojnë vetëm në disa sektorë pa ulur aktivitetin ekonomik.
- Bankat tregtare duhet të jenë në gjendje të kuptojnë, adresojnë dhe trajtojnë dobësitë e tyre.
- Risku për ato banka tregtare të cilat kanë kredituar në valutë, duhet të zbutet me anë të mekanizmave të përshtatshme të çmimeve, ndërsa risku për huamarrësit me të ardhura në monedhën vendase të cilët janë kredituar në valutë, mund të adoptohet duke implementuar norma shtrënguese LTV-je dhe DTI-je.
- Përdorimi i masave prudenciale që BSH-ja implementoi në vitin 2013 kërkon kujdes sidomos në përpjekjet për të stimuluar kredidhënien. Masat prudenciale për stimulimin e kredisë zakonisht mbartin dhe riskun e destabilitetit financiar.
- Për të ndihmuar bankat për cilësinë e kredive të reja, BSH-ja duhet të inkurajojë praktika më strikte të raportimit financiar nga huamarrësit e korporatave të mëdha.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

- Instrumentat makroprudenciale të përdorura nga Banka e Shqipërisë kanë qenë efektive në zgjidhjen e mangësive, por përdorimi i tyre duhet të zgjerohet edhe më shumë për të mbuluar problemet e menaxhimit të riskut.

SHËNIME

Zbatimi i instrumentave në nivel ndërkombëtar: Bazel III

Organizmi i ngarkuar për rregullimin (kontrollin) bankar ndërkombëtar, është edhe *Komiteti i Bazel*, i cili përbëhet nga përfaqësues të lartë të autoriteteve të kontrollit dhe të bankave qendrore. Detyra kryesore e këtij komiteti është përmirësimi dhe harmonizimi i legjislacionit bankar, për sigurimin e aftësive paguese të institucioneve (BIS, 2014).

Për të mbrojtur bankat nga risku sistemik, si dhe për të zvogëluar rreziqet e një krize bankare që mund të infektonte, si sistemin financiar, ashtu dhe ekonominë reale, u adoptuan njëra pas tjetres marrëveshjet e Bazel I dhe Bazel II. Në vitin 1988, Komiteti i Bazelit përgatiti dhe publikoi tërësinë e kërkesave për bankat në kuadrin e “Cooke ratio”, ku theksi u vu në *riskun e kreditit* dhe sasinë e kapitalit dhe aktiveve që bankat duhej të kishin për t’i bërë ballë humbjeve të mundshme (Kashyap, 2004). Në vitin 2004, Bazel II propozoi “*McDonough ratio*”, i cili e zgjeronte gamën e risqeve dhe perfeksiononte metodën e llogaritjes së koeficientëve të ponderimit të riskut. Kornizat e para të rregullimit, Bazel I dhe Bazel II, janë pranuar për të siguruar stabilitetin e bankave në nivel individual, nëpërmjet raporteve (ratio) të fondeve të veta (ratio Cooke et Donough). Me daljen nga kriza, komiteti i Bazel ka propozuar një tjetër rregullim bankar, që ka për qëllim zbutjen e mangësive të vërejtura në etapat e mëparshme. Kjo do të forconte detyrimet mikroprudenciale në kapital, likuiditetet dhe stimujt (leva financiare, leva fiskale) dhe që do të sillte gjithashtu, një dimension makroprudencial. Ky vizion zgjeroi mbikqyrjen bankare që materializohet nga një numër provigjionesh, me anë të cilave hyjnë në zbatim manovra të ndryshme të fondeve të brendshme të bankave, si rritja e cilësisë dhe e nivelit të fondeve të veta “bazë”(La note d’analyse, 2013). Kjo do të përforconte dukshëm menaxhimin, mbikqyrjen dhe mbulimin e risqeve që bankat duhet t’i kenë parasysh, por edhe pasuron tërësinë e mjeteve prudenciale, nëpërmjet kërkesave për likuiditet. Në Europë, ashtu si dhe në SHBA, me këtë rregullim të ri, shtohet edhe krijimi i një komiteti europian, i cili ka për detyrë mbikqyrjen dhe kontrollin e riskut sistemik dhe që është i pavarur nga Banka Qendrore. Ai nuk i ka të gjitha fuqitë

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

mbi instrumentat makroprudenciale. Marrëveshjet e Bazel I dhe Bazel II, për shkak të karakterit të tyre mikroprudencial, shfaqën një sërë dobësish, të tilla si¹⁴⁴ :

- 1) nuk penalizohej përqëndrimi i portofoleve vetëm në disa angazhime të caktuara, madje ponderimi i riskut, inkurajonte përqëndrimin e portofoleve në aktive me risk të ulët (të tilla si bonot e thesarit të qeverive të ndryshme, kreditë hipotekore, huatë ndërbankare, etj) dhe përdorimin masiv të produkteve derivative të tipit CDS (credit default sëap), të cilat e maskonin nivelin e riskut, në mënyrë që të justifikonin nevojën për kapitale shtesë;
- 2) duke përdorur vetëm treguesin e riskut global unik, modelet matematike dhe ekonometrike, injoronin ndikimin e riskut specifik të një vendit të veçantë, në riskun global dhe shkallën e ekspozimit të mjaft institucioneve e tregjeve ndaj këtij risku;
- 3) marrëveshjet e Bazel I dhe II, nuk merrnin sa duhet në konsideratë, riskun që ndërmerrnin institucionet financiare në aktivitetet e tyre në treg, sidomos titrizimin e kredive dhe aktivitetet jashtë bilancit, duke i ekspozuar shumë këto institucione përballë krizave të likuiditetit;
- 4) rregullimi i kapitaleve ishte pro-ciklik, në masën që risku nënvleftësohet në periudha ekspansioniste dhe mbivlerësohet në periudha reçesioni, ndërkohë që vlerësimi i aktiveve, duhej të bazohej në vlerën e tyre të tregut. Pra, vlerësimi i riskut bëhej në një moment të dhënë, dhe jo kundrejt gjithë ciklit, duke vënë në rrezik efencën e politikave rregulluese.

- Çfarë garanton Bazel III ?

Ashtu siç pohohet edhe nga BIS (2012), kriza financiare që filloi në vitin 2007 dëshmoi se rregullimet me natyrë mikroprudenciale ishin të pamjaftueshme për të garantuar stabilitet financiar. Rregullimet me natyrë mikroprudenciale, në vend që t'a eliminonin riskun sistemik, rrezikonin t'a amplifikonin atë. Megjithë konsensusin që dominonte se, sistemi i rregullimit financiar duhej të pajisej me mekanizma eficientë për zbulimin e riskut sistemik dhe administrimin e tij, në fakt nuk u arrit dot të përcaktohej natyra dhe përmasat e treguesve që shprehnin këtë risk, aq më tepër të përcaktohej dhe të matej efekti zinxhir, që shërbimet financiare mund të shkaktonin në gjithë sistemin financiar, ekonominë reale, rritjen ekonomike, mirëqënien sociale, etj.

¹⁴⁴ Civici "Revista Bankieri" Dhjetor 2013

Mbikëqyrja makroprudenciale nën optikën e paketës së masave të Bazel III

Kjo paketë propozon një seri politikash dhe detyrimesh në kuadrin e rregullimit financiar kundërciklik, të cilat besohet se do japin efekte pozitive në sferën e stabilitetit financiar. Marrëveshja Bazel III, e cila është publikuar në 16 dhjetor 2010, propozon një seri politikash makroprudenciale të cilat bazohen në një kuptim më të plotë të riskut sistemik dhe elementeve të destabilitetit financiar (BIS, 2011). Një nga objektivat është zvogëlimi i tendencës së sistemit bankar për amplifikimin e luhatjeve të cikleve ekonomike, nëpërmjet një oferte të kreditit në fazat e qeta dhe zvogëlimin drastik të tij, në fazat e tensionuara. Kërkesat minimale për nivelin e kapitalizimit kalojnë nga 8% në 10.5%, duke përdorur kështu një instrument të ri makroprudencial: futjen e një fondi të ri të detyrueshëm fleksibël kundra-ciklik në masën 0%-2.5%.

Bankat e ndërtojnë këtë fond kundra-ciklik në *fazën rritëse* të ciklit financiar, në mënyrë që ta përdorin atë në *fazën zbritëse* negative, duke eliminuar kështu efektet e ndërsjellta (BIS, 2011). Masë tjetër masë makro-prudenciale është edhe niveli i kapitalizimit në raport me aktivet e ponderuara në funksion të shkallës së riskut. Kjo masë, synon një mbikëqyrje më të mirë të efektit levë në institucionet financiare, e cila rrit rentabilitetin potencial të bankave dhe shton njëkohësisht mundësinë e humbjeve. Bankat e mëdha autorizohen t'a përcaktojnë vetë shkallën e riskut dhe koeficientët e ponderimit. Ndërkohë, Bazel III parashikon futjen e një tavani kufizues për efektet levë, duke limituar shumën totale të aktiveve që një bankë mund të zotërojë në funksion të kapitalit të saj. Ky instrument krijon mundësi për kufizimin e riskut të institucioneve financiare, megjithëse shumë nga bankat vazhdojnë të kundërshtojnë idenë e publikimit të efekteve levë të tyre (BIS, 2012). Bazel III parashikon gjithashtu futjen e dy kriterëve të reja kufizuese përse i përket likuiditetit, në mënyrë që ti detyrojë bankat t'i përdorin aktivet e tyre në investime afatgjata jo likuide. Dy kriteret kufizuese i detyrojnë bankat që të ruajnë një rezervë minimale likuiditeti (BIS, 2011) :

I pari, është një përqindje likuiditeti afatshkurtër, që iu imponon bankave që të mbajnë një sasi aktivesh likuide, për të mbuluar nevojat e parashikuara në një periudhë një mujore.

I dyti, është një përqindje, që përcakton likuiditetin në periudha afatgjata, qëllimi i të cilit është garancia se bankat disponojnë rezerva të mjaftueshme për të mbuluar nevojat e tyre për një periudhë 12 mujore. Bankat kanë kohë deri në vitin 2019 për të aplikuar tërësisht rregullat e Bazel

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

III, por Komiteti i Bazelit rekomandon se ato duhet të fillojnë sa më shpejt përgatitjet dhe aplikimin e pjesshëm të tyre edhe përpara kësaj date. Megjithatë, në mjediset bankare e financiare dhe ato ekonomike në përgjithësi, ekziston dhe një debat i nxehtë, në lidhje me efektet anësore dhe pasojat që mund të kenë rregullat e Bazel III (BIS, 2011). Këtu mund të përmendim, dyshimet dhe paqartësitë për pyetjet si më poshtë:

A i përgjigjet si duhet kjo marrëveshje problematikës së lidhjeve ndërbankare, e cila është në origjinë të shumë elementeve të destabilitetit financiar?

A është parashikuar si duhet “koordinimi ndërmjet politikave makro-prudenciale dhe politikave monetare”, duke arritur deri në propozime që kërkojnë një integrim sa më të plotë të këtyre dy politikave nën ombrellën e bankave qëndrore?

Si do të jetë zgjedhja e instrumentave të konsideruar si më të përshtatshmet nga autoritetet makro-prudenciale dhe cilat do të jenë limitet e fushës së tyre të veprimit?

Kufizimet e para për rregullat e Komitetit të Bazel III

Pengesa e parë, për zbatimin optimal është nevoja për një vullnet të fortë politik ndërkombëtar, për të reformuar sistemin në tërësi të tij dhe për të pakësuar shtrembërimet e konkurrencës që bëhen nga bankat që kanë një fuqi të madhe në treg (BIS, 2011).

Një tjetër vështirësi e këtij rregullimi të ri lidhet me perimetrin (fushë-shtrirjen) e zbatimit, sepse të stabilizosh vetëm sektorin bankar nuk mjafton për të stabilizuar sistemin financiar në tërësi. Përforcimi i detyrimeve që peshojnë mbi institucionet bankare, mund të favorizojnë zhvendosjen e aktiviteteve financiare drejt sektorit të parregullt (jashtë kontrollit) ose të një sistemi bankar “fantazmë”. Me qëllim që të evitohet mundësia e arbitrazhit rregullues, është e domosdoshme integrimi i institucioneve që janë jashtë kontrollit, si dhe mbledhja e informacionit të nevojshëm për vlerësimin e riskut sistemik, gjë që do të lejojë marrjen e disa masave korrigjuese për të pakësuar presionin e konkurrencës (BIS, 2011). Një pengesë e fundit e rregullimit prudencial është edhe paaftësia për të vepruar një vend i vetëm. Kështu p.sh Spanja, ka qënë një nga vendet e para që vendosi në vitin 2000 provigjione, si një instrument kundërciklik. Ky instrument ka qënë efikas për të ndihmuar në mbulimin e humbjeve që vinin prej kredive gjatë krizës financiare. Por, shtrirja e tyre rezultoi e pamjaftueshme kundrejt thellësisë së humbjeve. Rezervat nuk mundën të

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

zbutin zgjerimin e kreditit në sektorin imobiliar që buron nga një politikë monetare të përshtatur sipas rrethanave (BIS, 2012). Sistemi finaciari, së bashku me praninë e një rregullimi makroprudencial efikas, ka nevojë gjithmonë për një mbështetje nga politika të tjera ekonomike dhe sidomos për një koordinim me politikën monetare. Në plotësim të rregullimit të ri, në Europë duhet një bashkim bankar. Për të shoqëruar këtë rregullim të ri bankar, kërkohet një politikë europiane, e cila në mënyrë të veçantë duhet t'i hapë rrugë detyrimeve që rrjedhin nga mungesa e politikave monetare kombëtare. Arsyeja kryesore është nevoja për të patur një huadhënës përfundimisht të përbashkët ¹⁴⁵, por gjithashtu edhe të kthehet besimi në një treg bankar të integruar të eurozonës, fuqisë ekzekutive të tij, përpara se të sigurohet një parandalim i risqeve, të cilat nuk marrin parasysh interesat kombëtare. Projekti i krijimit të një bashkimi bankar, i cili u pranua që në propozimet e para nga ana e Komisionit Europian në shtator 2012, u bashkua edhe me rregullimin bankar të Komitetit Bazel III, për të siguruar besueshmërinë e tregut financiar të eurozonës (European Commission Memo, 2013). Ky mekanizëm i mbikqyrjes bankare nga ana e BQE, që aktualisht është në rrugën e negociatave, përbëhet nga tre segmentë të ndërlidhur mes tyre (IMF, 2011b):

1. Autoriteti i mbikqyrjes
2. Fondet e garancisë së depozitave
3. Autoriteti vendimarrës

Gjithashtu, BQE ka përgjegjësinë më të madhe të misionit të mbikqyrjes së stabilitetit finaciari, për të gjitha bankat e zonës euro. Mekanizmat e tjerë, për të cilat edhe sot vazhdojnë negociatat, do të kenë fuqi për masa më të forta për ndërhyrje të shpejtë dhe për një vendimarrje në rast krize. Propozimi i mekanizmit të vendimarrjes së bashku me garancinë e depozitave të individëve parashikon që:

Një autoritet kombëtar mund t'a detyrojë bankën kur nuk ka fuqi paguese, të ndërpresë aktivitetet ose të krijojë burime financiare për aktivet e rrezikuara (bad banks), pa qënë nevoja të lajmërojnë aksionerët ose të procedojë në një "bail in" (që do të thotë në një rikapitalizim i cili kërkon një rifurnizim fondesh të brendshme, përpara se të kërkojë ndihmën e atyre shteteve, ku kreditorët kanë pësuar humbje), me qëllim që të mbrohen paraprakisht konsumatorët dhe kreditorët, duke shprehur që këto propozime të çojnë në zgjidhje (BIS 2011).

¹⁴⁵ Wyplosz C. (2012), "On banking union, speak the truth", *Vox column*.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

SHTOJCA

Pyetësoni

Sondazh mbi impaktin dhe efektin në kohë të masave makroprudenciale të Bankës së Shqipërisë në përballimin e krizës së fundit

Zonjë/Zotëri

Do të lutesha për vëmendjen dhe qëndrimin tuaj në këtë pyetësor i cili për mua është pjesë e analizës dhe hipotezës në studimet e mia doktrinale.

Qëllimi kryesor që synoj të provoj në këtë sondazh është se:

Mbikqyrja e stabilitetit financiar dhe makroekonomik nga Banka Qëndrore e Shqipërisë gjatë krizës së fundit dhe në periudha më afatgjata kërkon adoptimin e strukturave të referimeve makroprudenciale të përcaktuar dhe të kalibruara me saktësi si një element ndihmës në përshtatjen, zbatimin dhe përmirësimin e këtyre masave me qëllim që të funksionojnë edhe në të ardhmen.

Përgjigjet tuaja do të mbeten konfidenciale dhe emri juaj nuk do të jetë i shkruar në pyetësor.

Kur të prezantohen rezultatet e studimit, ju nuk do të identifikoheni nga emri ose nga ndonjë informacion tjetër që mund të përdoret për të dëshmuar identitetin tuaj.

Pjesëmarrja juaj është vullnetare dhe ju mund të tërhiqeni nga ky pyetësor në çdo kohë që ju dëshironi.

Sondazhi ka për qëllim të veprojë në përputhje me të gjitha kodet etike.

Duke ju ftuar të plotësoni pyetësorin në vijim do të doja t'ju falenderoja paraprakisht .

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

1. Kur keni dëgjuar për herë të parë për politikat makroprudenciale, dhe në çfarë rrethanash?

- a) Para vitit 2005
- b) Viti 2007
- c) Viti 2008
- d) Viti 2013

2. Cilat janë njohuritë dhe dijet tuaja për përmbajtjen dhe efektin e këtyre politikave?

- a) Të përgjithshme
- b) Teorike specifike
- c) Eksperienca nga bankat tuaja
- d) Të dëgjuara rastësisht

3. Mendoni se masat makroprudenciale që ka përdorur dhe po përdor Banka e Shqipërisë kanë bërë të mundur që krizës së fundit t'i rezistohet më mirë?

- a) Nëse **Po** specifikoni
- b) Nëse **Jo** specifikoni

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

4. Mendoni se shtrëngimi i kushteve të pranimit të aplikimit për kredi nga ana e bankave të nivelit të dytë ka qënë:

(Përdorni shkallëzimin: **1** deri në **3** ku: **1**-nuk ndikon dhe **3**-ndikon shumë)

	Ndikimi
Kufizime në raportin pagesë-të ardhura	
Regjistri elektronik i Kredive që po operon si pjesë e Departamentit të Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë që prej vitit 2008	
Forcimi i kriterëve për pranimin e kolateralit	
Kërkesa për kolateral/në raport me madhësinë e huasë	
Apo të kombinuara të gjitha së bashku	

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

5. Si mendoni se cilët nga faktorët e mëposhtëm kanë ndikuar më shumë në huamarrjen e brendshme në valutë?

(Përdorni shkallëzimin: **1** deri në **3** ku: **1**-nuk ndikon dhe **3**-ndikon shumë)

	Ndikimi
Diferenca e normës së interesit për kreditë në lek dhe ato në valutë	
Niveli i lartë i “euroizimit” në ekonomi	
Tregjet pak të zhvilluara të kredisë në monedhën vendase	
Kursimet e pamjaftueshme në monedhën vendëse	
Mungesa e kërkesës së borxhit afatgjatë në monedhën vendëse	
Lëkundjet e pakta historike të kursit të këmbimit	
Kërkesa e BSH për t’i dhënë prioritet kredisë në lekë	
Prania e lartë e bankave me pronësi të huaj	
Hapja e madhe e ekonomisë	
Faktorët e tjerë (lutemi t’i specifikoni):	

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

6. Në kushtet e krizës globale, ndaj bankave tregtare u ndërmorën morën masat e mëposhtëme për t'i reaguar situatës së vështirë ekonomike që u krijua.

(Përdorni shkallëzimin: 1 deri në 3 ku: 1-nuk ndikon dhe 3-ndikon shumë)

	Ndikimi
Rritje e normës së interesit	
Pesha më të larta të rrezikut <i>Ps: Bankave që po e zgjerimin portofolin e kredisë më shpejt sesa limitet e përcaktuara iu kërkua të përdorin një faktor rreziku 150% në llogaritjen e kapitalit të ponderuar me rrezikun. Për këtë arsye, atyre ju duhej më shumë kapital për të ruajtur zgjerimin e bilanceve të tyre</i>	
Kufizime të LTV-së (raporti kredi-vlerë)	
Kufizime sasiore të kreditimit (për sektorë të caktuar)	
Kufizime në përdorimin e kartave të kreditit	
Apo të kombinuara të gjitha së bashku	

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

7. Cilat nga masat rregullatore të mëposhtme që ndërmori BSH ndaj bankave tregtare në vend, kanë qënë më të efekshme për të zbutur impaktin e krizës në sektorin bankar ?

(Përdorni shkallëzimin: **1** deri në **3** ku: **1**-nuk ndikon dhe **3**-ndikon shumë)

	Ndikimi
Kërkesa për rezervën e detyruar	
Ngushtimi i grupit të kolateraleve të pranueshme	
Sigurimi i likuiditetit në monedhën vendëse	
Zgjerimi i kreditimit në monedhën vendase dhe në valutë për bankat me nevoja likuiditeti por edhe aftësi pagueese	
Rritja e përqindjes së provigjionimit mbi portofolin e një banke	
Rritje e kërkesave për kapitalin minimal	
Masa për ristrukturimin e kredive	

8. A mendoni se Banka e Shqipërisë mori masa të mjaftueshme për sigurimin e likuiditetit në vend?

a) Nëse **Po**shtjelloni.....

b) Nëse **Jo**shtjelloni.....

9. Mendoni se masat që u morën për ristrukturimin e kredive me probleme e lehtësuan shlyerjen e tyre?

- a. Nëse **Po**Pse?.....
- b. Nëse **Jo**Pse?.....

10. A mendoni që lehtësirat për kapitalin, pra mos shpërndarja e dividendëve të bankave tregtare dhanë efekt në rritjen e kreditimit të ekonomisë?

- a) Nëse **Po**, shtjelloni
- b) Nëse **Jo**, shtjelloni

11. Ndër masat fiskale që u ndërmorën ishte edhe rikapitalizimi i bankave tregtare. A mendoni se këto masa kanë qënë efektive?

(Përdorni shkallëzimin: 1 deri në 3 ku: 1-nuk ndikon dhe 3-ndikon shumë)

	Ndikimi
Në 7 tetor 2008, u mor vendimi për të ulur ekspozimin e bankave shqiptare ndaj grupeve bankare me pronësi të huaj deri në 10% të kapitalit të tyre rregullator	
U kërkuan raportime më të shpeshta nga bankat, në veçanti për likuiditetin e tyre	
Analiza “ad-hoc” mbi impaktin e krizës ndërkombëtare në sektorin bankar në Shqipëri, përfshirë teste stresi dhe skenarë më të gjithanshëm	
U nis procesi për rishikimin e procedurave të brendshme për administrimin e krizave	

12. Si gjykoni , masat më konservative të Bankës së Shqipërisë për kolateralin dhe provigjionimin e huave me probleme sa kanë ndikuar?

- a) Aspak.....
- b) Pak.....
- c) Ndjeshëm.....
- d) Shumë efekt.....

13. Banka e Shqipërisë ndërmori rregullore shtrënguese për kapitalin e bankave tregtare që investonin jashtë kufirit Shqiptar, a mendoni se kjo ndikoi në rritjen e kreditimit në ekonominë brënda vëndit?

- a) Nëse **Po**, Pse.....
- b) Nëse **Jo**, Pse.....

14. A mendoni se vendimet e politikave monetare të Bankës së Shqipërisë pra të uljes së normës bazë të herë pas herëshme, dhe të masave makroprudenciale patën ndikim në lirimimin e standarteve të kredidhënies?

- a) Nëse **Po**, Pse.....
- b) Nëse **Jo**, Pse.....

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

15. Për cilat nga risqet e mëposhtëme, ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë ka qënë më shtrënguese gjatë aktivitetit të bankave tregtare?

(Përdor shkallëzimin: **1** deri në **3** ku: **1**-nuk ndikon dhe **3**-ndikon shumë)

	Ndikimi
Risku i Likuiditetit	
Risku i kredisë	
Risku i kolateralit	
Risku i normës së interesit	
Mjaftueshmëria e kapitalit	
LTV(raporti kredi –vlerë)	
Të tjera – lutemi specifikoni	

16. Mendoni se masat mikro dhe makroprudenciale të përdorura nga Banka e Shqipërisë kanë cuar në përmirësimin e përfitueshmërisë të bankave tregtare?

- a) Nese **Po**..... ju lutem komentini tuaj.....
- b) Nese **Jo**..... ju lutem komentini tuaj

17. Si e mendoni rolin e Bankës së Shqipërisë gjatë krizës së fundit, ka qënë :

- a. I gabuar.....
- b. I pandjeshëm.....
- c. Me pak ndikim.....
- d. Eficient.....
- e. Shumë eficientë.....

Specifikoni dhe pse ?.....

Ju faleminderit për kohën dhe vëmendjen tuaj

Me respekt

Orkida Ilollari(Findiku) Phdc

BIBLIOGRAFIA

Libra

1. Angjeli, A. 2012. *Në ethet e krizës*. Tiranë : Botimet Toena [u.a.].
2. Bagehot, W. 1991. *Lombard street*. Philadelphia: Orion Editions.
3. Bernake, B. S. 2004. *Essays on the great depression*. Princeton University Press.
4. Carandini, A. 2009. *Roma, Il primo giorno*. Bari: Editori Laterza.
5. Civici, A., 2011. *Iluzionet monetare: Mashtrimet e mëdha*, Tiranë: Ombra OVG.
6. Clower, R.W. and Leijonhufvud, A.1981. *Say's principle, What it means and doesn't mean*. Intermountain Economic Review, Oxford University press.
7. Field, A. J. 2011. *A great leap forward*. New Haven: Yale University Press.
8. Friedman, M. & Friedman. R. 1979, *Anatomia di una crisi, in Liberi di scegliere*. Milano: Longanesi.
9. Friedman, M. & Schwartz, A. J. 1993. *A monetary history United States 1867-1960*. New York: National Bureau of Economic Research.
10. Friedman, M. 1962. *Capitalism and freedom*. Chicago: University of Chicago Press.
11. Galbraith, J. K.1989, *La crise economique de 1929, anatomie d'une catastrophe financiere*. Payot.
12. Galbraith, J.K.,1990, *Storia dell'economia*. Milano:Rizzoli.
13. Garber, P. 2000, *Famous First Bubbles*. MIT Press.
14. Garrison, R. w. 2001. *Time and money*. London: Routledge
15. Greenspan, A. 2007. *The age of turbulence*. Neë York: Penguin Press.
16. Hahm, J., Mishkin, F.S.,Shin, H.S., & Shin K, 2011, *Asia economic policy conference Asia's role in the post-crisis global economy : Macroprudential Policies in Open Emerging Economies*.
17. Hanspeter K. Scheller, 2006, *The European Central Bank: History, Role, and Functions*.
18. Kalecki M.1979 *Il ciclo economico*, in *Antologia di scritti di teoria economica*, Bologna: Il Mulino.
19. Kalecki, M. 1990. *Capitalism, business cycles and full employment*. Oxford [Oxfordshire]: Clarendon Press.
20. Keynes, J. M.1983 *I mezzi per raggiungere il benessere economico, Come uscire dalla crisi*, Bari: Editori Laterza.
21. Kindleberger, C.P. 1981, *Euforia e panico. Storia delle crisi finanziarie*, Editori Laterza.
22. Kindleberger, C.P. 1988, *La Grande Crise Mondiale 1929-1939*, Economia.
23. Marx, K.; 1979. *Teorie sul plusvalore*, vol. II, cap. XVII, 555-584, Roma: Editori Riuniti.
24. Mishkin, F. S. 1997. *Understanding Financial Crises*. Cambridge, Mass.: National Bureau of Economic Research.
25. Portes, R. 1998, *The Asian Financial Crisis: Origins, Implications, and Solutions*. Springer US.
26. Reinhart, C. M. & Rogoff, K. S. 2009. *This time is different*. Princeton: Princeton University Press.
27. Sweezy, P.M. 1972. *La teoria dello sviluppo capitalistico*. Boringhieri, Torino.
28. Taylor, J.B., 2010, *Getting Off Track: How Government actions and Interventions Caused prolonged and worsened the Financial Crisis*.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

29. Riasanovsky, N.V. 1969, *The Teaching of Charles Fourier*, University of California Press.
30. Rosser, R, Jr. 2000. *From Catastrophe to chaos: A general theory of economic discontinuities*, Kluwer Academic, 2nd edition.
31. Saurina, J. 2009. Loan Loss Provisions: A working Prudential Tool.
32. Schinasi, G.J. 2003. Responsibility of central banks for stability in financial markets.
33. Mises, L. 2010. *A Treatise on Economics*, Liberty Fund Inc.
34. Schumpeter, J. 1934. Depressions. In *Economics of the Recovery Program*, ed. D. Brown.

Burime Interneti

35. Ahmed S., Levin A. & Wilson B.A. (2002). Recent U.S. macroeconomic stability: good policies, good practices or good luck? Board of Governors of the Federal Reserve System (U.S.). *International Finance Discussion Papers*, 730.
36. Aiyer, S., Calomiris, C. & Wieladek, T. (2012), Does Macro-Pru Leak? Evidence from a UK Policy Experiment, *NBER Working Paper Series*, 17822.
37. Alberola E. , Trucharte C. & Vega, J. L. (2011), Central banks and macroprudential policy. Some reflections from the spanish experience Documentos Ocasionales, *Banco de España*, 1105.
38. Allen F., & Gale D. (2000). Bubbles and crisis, *Economic Journal*, 110, 236-255.
39. Allen, W. A., & Wood, G. (2006). Defining and achieving financial stability. *Journal of American Economic Review*, 102(2), 1029-1061.
40. Andreë Crockett (BIS management speeches 2000)
41. Angelini P., S. Blacks & F. Panetta (2011), Monetary and macroprudential policies, *Temat e diskutimit*, 801, Banka e Italisë.
42. Angelini, P., Neri, S. & Panetta F. (2012), Monetary and macroprudential policies, *ECB Working Paper Series*, 1449
43. Angelini, P., Nicoletti-Altimari, S. & Visco, I. (2012), Questioni di Economia e Finanza, *Occasional papers*, 140.
44. Arregui, N., Beneš, J., Krznar, I., Mitra, S., & Santos, A., (2013), Monetary and Capital Markets, Evaluating the Net Benefits of Macroprudential Policy: A Cookbook, *IMF Working Paper WP/13/167*.
45. Banca d'Italia, (2009), Financial Market Regulation in the Wake of Financial Crises: The Historical Experience.
46. Bank of England, (2008), Financial Stability Report.
47. Bank of England, (2009), The role of macroprudential policy, A discussion paper– November 2009
48. Bank of England, (2013), Financial stability, 24.
49. Banka e Shqipërisë, 2013, Raporti i Stabilitetit Financiar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2013 http://www.bankofalbania.org/web/pub/sektori_bankar_copy_2_6187_1.pdf accessed on 01/03/2014.
50. Banka e Shqipërisë, 2013, Raporti i Stabilitetit Financiar për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2013, http://www.bankofalbania.org/web/Raporti_i_Stabilitetit_Financiar_për_gjashtëmujorin_e_dytë_të_vitit_2013_7065_1.php

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

51. Bellenzier V, Bertocco C, Franco D, Gastaldello C (2010), *Dalla crisi subprime USA alle difficoltà del sistema finanziario mondiale: la trasmissione del contagio*.
52. Bellenzier, V., Bertocco, C., Franco, D. & Gastaldello, C. (2011), *Processi di trasmissione della crisi subprime dal mercato finanziario USA al sistema finanziario mondiale ed effetti sull'economia globalizzata, Focus: Dalla crisi subprime USA alle difficoltà del sistema finanziario mondiale: la trasmissione del contagio*.
53. Benati, L. & Mumtaz, H., (2007), *U.S. Evolving Macroeconomic Dynamics - A Structural Investigation* European Central Bank , *Working Paper Series*.
54. Bencivelli, L. & Zaghini, A. (2012), *Modern Economy, Financial Innovation, Macroeconomic Volatility and the Great Moderation*, 3, 542-552
55. Bernanke, B. & Gertler, M. (2001). *Should central banks respond to movements in asset prices. The American Economic Review*, 91, 253-257.
56. Bernanke, Ben S., and Mark Gertler. 2001. "Should Central Banks Respond to Movements in Asset Prices?" *American Economic Review*, 91(2), 253-257.
57. Bezemer, D.J. (2011), *Causes of Financial Instability: Don't Forget Finance, Working Paper*, 665.
58. Biggar, D & Heimler, A. (2005), *International competition network - antitrust enforcement in regulated sectors - an increasing role for competition in the regulation of banks*, Bonn.
59. BIS (1997), 67th annual report, *The evolution of Central Banks, Bank for International Settlements*, 140-160.
60. BIS (2009a), 80th BIS Annual Report 2009/10, *Macroprudential policy and addressing procyclicality, Bank for International Settlements*, 89-102.
61. BIS(2009b), *Issues in the Governance of Central Banks, Bank for International Settlements*, 17-56.
62. BIS (2011)., *Liquidity – Frequently asked questions*.
63. BIS, (2011), *Basel Committee on Banking Supervision, Basel III definition of capital - Frequently asked questions*.
64. BIS, (2012), *Frequently asked questions on Basel III Monitoring. Basel Committee on Banking Supervision*.
65. BIS, (2014), *Basel III: the Net Stable Funding Ratio - consultative document*.
66. BIS, Yoshikuni, S., (1996) *Proposals for improving global derivatives market statistics, CGFS Publications*, 6.
67. BIS. (2003). *Financial Stability and the Business Cycle: Five Views, BIS Paper*. 18, 7-15.
68. Bordo, M., Klingebiel, D. & Martinez-Peria, M.S, (2001), *Is the Crisis Problem Growing More Severe?, Economic Policy*.
69. Borges, C. S. & Gon, P. B., (2013), *Emerging Countries' Perspectives on Development and Financial Regulation: Brazil and China's Approaches to Macroprudential Policy*.
70. Borio, C. & Shim, I. (2007), "What can (macro-) prudential policy do to support monetary policy?", *BIS Working Paper*, 242.
71. Borio, C. (2003). *Towards a macroprudential framework for financial supervision and regulation?, CESifo Economic Studies*, 49(2), 181–216.
72. Borio, C. (2012), *The financial cycle and macroeconomics: What have we learnt?, BIS Working Papers*, 395.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

73. Borio, C., (2001), A hundred ways to skin a cat: comparing monetary policy operation procedures in the United States, Japan and the euro area, *Bank for International Settlements*, 9, 1-22.
74. Boyer, R., Dehove, M., & Plihon, D., Les crises financières, La documentation française, 413.
75. Brockmeijer, J., (1995), Issues of measurements related to market size and macroprudential risks in derivatives markets, *Euro-Currency standing committee of the G-10 Central Banks*, (Bank for International Settlements).
76. Buletini i Bankës së Shqipërisë (201), Banka e Shqipërisë 47, 6M-1.
77. Bundesbank, (2008) , Symposium on Financial Stability and the Role of Central Banks, www.bundesbank.de accessed on 20/02/2014
78. Canuto, O & Ghosh S.R., (2013), Dealing with the Challenges of Macro Financial Linkages in Emerging Markets, International Bank for Reconstruction and Development, *The world Bank*.
79. Canuto, O., Cavallari, M., (2013), Monetary Policy and Macroprudential Regulation: Whither Emerging Markets, *World Bank Policy Research Working Paper*, 6310.
80. Caprio, Gerard, Jr & Demirguc- Kunt, A.(1998). The Role of Long-Term Finance: Theory and Evidence. *World Bank Research Observer*. 13 (2), 171-89.
81. Cattaui, P., Cova, P, Pagano, P. & Visco, I. (2010), *The role of macroeconomic policies in the global crisis, Çështjet e ekonomisë dhe financave*, 69, Banka e Italisë.
82. Cecchetti Stephen, B., Hooper P, Kasman B, Schoenholtz K, and Watson M, (2007), Understanding the Evolving Inflation Process, *Rosenberg institute of Global Finance*.
83. Chang, R. & Velasco, A., (2001), A Model of Financial Crises in Emerging Markets, *The Quarterly Journal of Economics*, 116 (2), 489-517.
84. Cioffi, M., Franco, D., & Marino, M.R., (2012), Rules and Institutions for Sound Fiscal Policy after the Crisis, 11.
85. Clarida R, Gali', J., Gertler M., 2000, Monetary policy rules and macroeconomic stability: evidence and some theory. *The Quarterly Journal of Economics*, 115(1), 147-180.
86. Clement, P. (2010), The term "macroprudential": origins and evolution, *BIS Quarterly Review*.
87. Committee on the Global Financial System, (2012), Operationalising the selection and application of macroprudential instruments, CGFS Papers, 48.
88. Crockett, A. (2000), In search of anchors for financial and monetary stability *Speech at the SUERF Colloquium in Vienna*.
89. Crockett, A. 2000. Marrying the micro-and macro-prudential dimensions of financial stability. *BIS speeches*, 21.
90. Dell'Ariccia, G., Igan, D., Laeven, L., & Tong, H., (2012), Policies for Macrofinancial Stability: How to Deal with Credit Booms, *IMF Staff Discussion Note*, 12/06.
91. Deutsche Bundesbank, (2013), Macroprudential oversight in Germany: framework, institutions and tools, *Monthly Report*.
92. Diamond D.W. & Rajan R.G. (2011). Fear of fire sales, illiquidity seeking, and credit freezes. *The Quarterly Journal of Economics*, 126 (2), 557-591.
93. Dowd, K. (2009). Moral Hazard and the Financial Crisis. *Cato Journal*. 29(1), 141-166.
94. Drehmann, M., Borio, C. & Tsatsaronis, K. (2012), Characterising the financial cycle: Don't lose sight of the medium term!, *BIS Working Papers*, 380.

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

95. Dushku, E. & Kota, V., (2013), Modeli Financiar në Shqipëri: Qasje ndaj të dhënave të panelit
96. Elliott, D., Feldberg, G. & Lehnert, A. (2013), The history of cyclical macroprudential policy in the United States, *Financial and Economics Discussion Paper Series, Federal Reserve Board Elsevier*.
97. ESRB , (2012). The ESRB at work – its role, organisation and functioning, *Macroprudential Commentaries*. 1.
98. ESRB, (2011), Recommendation on the macroprudential mandate of national authorities, *Official Journal of the European Union*, 3.
99. ESRB, (2013), Recommendation on intermediate objectives and instruments of macroprudential policy, *Official Journal of the European Union*, 1.
100. et al. New York: McGraw-Hill.
101. European Commission, (2013). A comprehensive EU response to the financial crisis: a strong financial framework for Europe and a banking union for the eurozone European Commission. Memo/13/679
102. Evolimi dhe adoptimi i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë
103. Federal Reserve Bank of New York For the Year Ended December 31, 1931 http://fraser.stlouisfed.org/docs/historical/frbny/1931_frb_newyork.pdf accessed on 10/03/2014
104. Ferguson, R. (2003). Should financial stability be an explicit central bank objective. *Challenges to Central Banking from Globalized Financial Systems, International Monetary Fund, Washington DC*, 208-223.
105. Friedman, M. & Schwartz, A. 1963. *A monetary history of the United States, 1867-1960*.
106. Friedman, M.(1968), The Role of Monetary Policy, *The American Economic Review*. 58(1), 1-17.
107. Friedrich Hayek, Prices and Production and Other Works: F.A. Hayek on Money, the Business Cycle, and the Gold Standard
108. Fullani, A. (2010), Stabiliteti makrofinanciar në vendet kandidate dhe vendet e mundshme kandidate për në BE: mësimet për t'u nxjerrë, Njoftim për shtyp në takimin e nivelit të lartë mbi politikat makroprudenciale, Frankfurt.
109. G-10 Report on Financial Sector Consolidation (2001)
110. Galati, G. & Moessner, R., (2011), Macroprudential policy – a literature review, *Working Papers BIS*, 337, February.
111. Galati, G. and R. Moessner, (2011), Macroprudential Policy—A Literature Review, *BIS Working Papers*, 337.
112. Garry J. Schinasi, (2004). Defining Financial Stability, *IMF Working Papers* 04,187.
113. Gerlach, S. (2013), Macroprudential Policy in Ireland, *Central Bank of Ireland*.
114. Gerlach, S., (2013), Macroprudential Policy in Ireland, *Speech to the University of Limerick*, 19 September 2013.
115. Gide, C. & Rist, C. (1948), *A History of Economic Doctrines from the Time of the Physiocrats until the Present Day*. London: G.G. Harrap & Co.
116. Goodfriend M, (2004), Inflation Targeting in the United States? *National Bureau of Economic Research*.
117. Greenspan, A. 1996. *Remarks by Alan Greenspan, Board of Governors of the Federal Reserve System at the 40th Economic Conference of the Federal Reserve Bank of Boston*,

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

- Chatham, Massachusetts, June 6, 1996.* Washington, DC: Board of Governors of the Federal Reserve System.
118. Harris, R. E. and Silva, L. A. P. (2012), Sailing through the Global Financial Storm: Brazil's recent experience with monetary and macroprudential policies to lean against the financial cycle and deal with systemic risks. *Brazilian Central Bank Working Paper*, 290.
119. Heikensten, L. (2004). Speech at the Risk Management Conference, Swedish Riksbank, Stockholm (November 16; available at www.riksbank.com)
120. <http://opinionjournal.com/editorial/feature> accessed on 06/03/2014.
121. http://www.bankofalbania.org/web/NJOFTIM_PER_SHTYP_6566_1.php accessed on 20/03/2014
122. <http://www.businessdictionary.com/definition/economic-crisis.html> accessed on 1/02/2014
123. <http://www.centralbanking.com/central-banking/news/2307045/leaning-against-the-wind-does-more-harm-than-good-warns-svensson>. accessed on 1/02/2014
124. <http://www.cfr.org/world/role-european-central-bank/p28989#p4> The Role of the European Central Bank, Author: Christopher Alessi, September 12, 2012. Accessed on 15.03/2014
125. <http://www.worldfinancialreview.com/?p=1306> accessed on 1/02/2014
126. Inal, E., 2010, The recent greek crisis: harbinger of a new contagion? *The Columbia Journal of European Law Online*.
127. IMF, (2001), Macroeconomic Policy and Poverty Reduction.
128. IMF, (2013c), Key aspects of macroprudential policy.
129. International Monetary Fund (2011b), *Macroprudential Policy: What Instruments and how to use them, Lessons from Country Experiences*.
130. International Monetary Fund 2011c, *Developments in Financial Supervision and the Use of Macroprudential Measures in Central America*, Board Paper (Washington: International Monetary Fund).
131. International Monetary Fund, (2011a), *Macroprudential Policy: An Organizing Framework*
132. As the global financial system has yet to recover from the subprime
133. International Monetary Fund, (2011e), *Multilateral Aspects of Policies Affecting Capital Flows*, Board Paper (Washington: International Monetary Fund).
134. International Monetary Fund, (2011f), *The interaction of monetary and macroprudential policies—background paper*
135. International Monetary Fund, (2012), *Monetary and macroprudential policies: background paper; the interaction of monetary and macroprudential policies*.
136. International Monetary Fund, (2013a). *Brazil: Technical Note on Macroprudential Policy Framework*
137. International Monetary Fund, (2013b). The Interaction of Monetary and Macroprudential Policies, 2013, International Settlements.
138. Issing, O., 2003, *Monetary and financial stability: is there a trade-off*, speech, 28 March.
139. Jiménez, G., Ongena, S., Peydró, J-L. & Saurina, J. (2012), Macroprudential policy, countercyclical bank capital buffers and credit supply: Evidence from the Spanish dynamic provisioning experiments.
140. Joseph E. Stiglitz, "Knowledge as a Global Public Good" in Global Public Goods

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

141. Kalecki, M. 1990. *Political Aspects of Full Employment*, Oxford: Clarendon Press.
142. Kashyap, A.K., Stein, J.C. (2004), Cyclical implications of the Basel II capital, 1, 18-31
143. Keynes, J.M., (1914), What is Money? *The economic journal*, 24(95).
144. Kuznets, S. (1940), Schumpeter's Business Cycles, *The American Economic Review*, 30(2), 257-271.
145. Kydland, F. & Prescott, E. (1977) Rules rather than discretion: The inconsistency of optimal plans. *Journal of Political Economy*. 85, 3.
146. Le Moign, C., (2013), La politique macroprudentielle contre l'instabilité financière , *Note d'analyse*, 330.
147. Lo, A. (2009), The Feasibility of Systemic Risk Measurements, *written testimony for the House Financial Services Committee on Systemic Risk Regulation*.
148. Lounsbury, M. and Hirsch, P. M. 2010. *Markets on trial*. Bingley, UK: Emerald.
149. Macroprudential, microprudential and monetary policies: conflicts, complementarities and trade-offs, by
150. Mersch, Y., The European Central Bank's role in overcoming the Crisis; *Speech at the UniCredit Business Dialogue*, Hamburg, 17 June 2013.
151. Milton Friedman: Critical Assessments, edited by John C. Wood, Ronald N. Woods
152. Minsky H. (1977), The financial instability hypothesis: An interpretation of Keynes and an alternative to 'standard' theory, *Challenge*, 20-27.
153. Mishkin , F.S., (2011), Monetary policy strategy: Lessons from the crisis. *National Bureau of Economic Research*.
154. Mishkin, F., (1996) The Channels of Monetary Transmission: Lessons for Monetary Policy
155. Mishkin, F., (2008), How should we respond to asset price bubbles?
156. Moreno, R., (2011). Policymaking from a "macroprudential" perspective in emerging market economies. *BIS Working Papers*, 336.
Nga e kaluara drejt vizionit për të ardhmen. *Strategjitë e Politikës Monetare për Ekonomitë e Vogla, Konferenca VII Vjetore e Bankës së Shqipërisë*.
157. Online economic dictionary: www.investopedia.com accessed on 20/02/2014
158. Osinski, J., Seal, K. & Hoogduin, L., (2013a), Macroprudential and Microprudential Policies: Toward Cohabitation, *IMF*.
159. Panara, M., La rivoluzione dell'auto, tre mosse per cambiare, "La Repubblica", 26 gennaio 2009
160. People's Bank of China (2011), Annual report.
161. Porter, A., (2010), La crisi, le banche e i mercati finanziari, 102.
162. Rabanal, P., Scott, A. & Kannan, P., (2009), Macroeconomic Patterns and Monetary Policy in the Run-Up to Asset Price Busts; *IMF working paper*.
163. Romer, C.D. & Romer, D.H. (2002). A Rehabilitation of Monetary Policy in the 1950's, *The American Economic Review*, 92(2), 121-127.
164. Rossi, S. (2012). La crisi globale ed europea, le politiche per la stabilità finanziaria. *Convegno estivo ADEIMF - Associazione Docenti Economia Intermediari Mercati Finanziari*.
165. Sachs, D. J. (1995), Alternative Approaches to Financial Crises in Emerging Markets, *Background paper for discussion during meetings in Basel, SZ, December 9-10, 1995*

Politikat e Bankës së Shqipërisë për Garantimin e Stabilitetit Bankar
-Roli dhe Efekti i Masave Makroprudenciale-
2006-2014

166. Schinasi, G.J. 2003, Responsibility of Central Banks for Stability in Financial Markets, *IMF Working Paper*, 03/121. Washington, DC.
167. Schularick M.& Tayler A.M., (2012), Credit booms gone bust. Monetary policy, leverage cycles and financial crises, 1870-2008.
168. Schumpeter, J. 2006, History of Economic Analysis. *Taylor & Francis e-Library*.
169. Smaghi, B. (2009), La crisi finanziaria: sfide e risposte, Testo integrale del discorso tenuto da Lorenzo Bini Smaghi all'Associazione Pianificatori Bancari, Firenze
170. Smaghi, L.B., & Grung, M.T., (2013), SUERF – The European Money and Finance Forum Vienna.
171. Spaventa, L., (2009), La grande crisi finanziaria del nuovo millennio.
172. Spiethoff, A. (1953), Business Cycles, *International Economic Papers*, 3, 75-171.
173. Stock. J., & Watson, M. (2002). Has the business cycle changed and why?, *NBER Macroeconomics Annual*.
174. Svensson, L.E.O. (2009), Speech. Flexible inflation targeting – lessons from the financial crisis, *BIS*.
175. Taylor, J., 2009, *Getting Off Track: How Government Actions and Interventions Caused, Prolonged, and Worsened the Financial Crisis*, Hoover Institution Press
176. Tobin, J. (1984), On the Efficiency of the Financial System, *Fred Hirsch Memorial*.
177. Tong, H. & Wei, Sh-J. (2008), Real Effects of the Subprime Mortgage Crisis: Is it a Demand Or a Finance Shock?
178. Torre, A. & Ize, A., (2009). Regulatory reform: integrating paradigms. The World Bank Policy Research, *Working Paper Series*, 4842.
179. Trichet, J-C., (2009), The financial crisis and the role of central banks: The experience of the ECB, *International symposium marking the 50th anniversary of Bank Al-Maghrib, Marrakech*.
180. Tucker, P., (2011), Macro and Microprudential supervision, *Speech at the British Bankers' Association Annual International Banking Conference*, London.
181. Turner, P. (2010), Macroprudential Policies and the Cycle, The Financial Stability Board: An Effective Fourth Pillar of Global Economic Governance?, Special Report, *The Centre for International Governance Innovation*, 43-48.
182. Warwick commission, (2010), Macro-Prudential and Micro-Prudential Regulation
183. William, A. & Wood, G., (2006). Defining and achieving financial stability, *Journal of Financial Stability*, Elsevier, 2(2), 152-172.
184. Wyplosz C. (2012), On banking union, speak the truth, *Vox column*.
185. Yellen L.J, (2009), The Outlook for the Economy and Real Estate, Federal Reserve Bank of San Francisco, *Presentation to the Phoenix Chapter of Lambda Alpha International*, November 10.